REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË

DISERTACION

PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE

"DOKTOR"

"TË DREJTAT THEMELORE TË TË AKUZUARIT NË LEGJISLACIONIN PENAL SHQIPTAR DHE PËRQASJA E TYRE ME PARIMET E KONVENTËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT"

"ROLI I AVOKATIT NË GARANTIMIN E TYRE"

Përgatiti: **UDHËHEQËS SHKENCOR**

Brunilda BARA **Prof.Dr.Skënder KAÇUPI**

Tiranë, 2013

Përgatitur në përputhje me kërkesat e Rregullores **“PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË DOKTORATAVE”**, miratuar në Mbledhjen e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës me Vendimin nr. 20, datë 13.11.2008.

Redaktor letrar:

Kolë Gjokaj

© Të gjitha të drejtat të rezervuara: Brunilda BARA

Shtëpia Botuese:

Dedikuar:

Familjes sime për gjithë nxitjen, mbështetjen, përkujdesjen dhe forcën që më japin.

Falënderime:

Falënderoj familjen time për dashurinë dhe kujdesin që më ka kushtuar!

Falënderoj bordin e profesorëve që më dhanë shansin dhe mundësinë t'i përkushtohem një teme të tillë, shoqen time të mirë gjyqtare Artën dhe, në veçanti, vjehrrin tim, që më bëri të kuptoj se ka gjithmonë diçka për të mësuar dhe se procesi i të mësuarit na shoqëron gjithë jetën!

Duke trajtuar këtë temë mendoj se kam bërë një hap modest në fushën e gjerë të drejtësisë, profesion që e ëndërrova e ju përkushtova që në krye të herës, me pasion e dëshirë, duke e zgjedhur mes shumë sektorëve të tjerë të shkencave.

Natyrisht, hapa të tjerë më presin në të ardhmen në sistemimin dhe trajtimin e përvojave dhe problemeve të këtij sektori; si në aspektin teorik, ashtu dhe atë praktik, me qëllim që brezat e ardhshëm të juristëve të jenë në nivele dhe më të larta se i sotmi.

Çdo ditë përballemi me probleme të drejtësisë. Detyra jonë si juristë është t'i evidentojmë ato, të njihemi me praktikat ndërkombëtare, e, të gjithë së bashku, t'i vëmë ato në rrugën e zgjidhjes, me qëllim që drejtësia të ngrihet më lart e të fitojë besimin e njerëzve.

"Padrejtësia, kudoqoftë, është kërcënim ndaj drejtësisë kudo"
Martin Luther King

Përmbajtja

"Të drejtat themelore të të akuzuarit në legjislacionin penal shqiptar dhe përqasja e tyre me parimet e konventës europiane për të drejtat e njeriut" 1
"Roli i avokatit në garantimin e tyre" 1
FJALORTH TERMINOLOGJIK 7
Oxford Dictionary of Law - 5th edition 7
Black's Law Dictionary 7th edition 8
The Essential Law Dictionary 1st edition 8
Bloomsbury Reference - Dictionary of Law 4th Edition 9
Ballentine's Law 3rd edition 9
Oxford Dictionaries Online 9
Fjalor i Shqipes së Sotme 9
HYRJE XI
Objekti i kërkimit shkencor XI
Qëllimi i përzgjedhjes së kësaj teme XI
Fokusi i studimit XIII
Pyetjet që ky studim ngre për diskutim: XIV
Metoda e analizës XIV
Citimi i punimit XV
Metodologjia e punimit XVI
Terminologjia e shkurtimeve XVII
KAPITULLI I PARË 18
HISTORIA E PROCEDURËS PENALE DHE E LINDJES SË TË DREJTAVE TË TË AKUZUARIT 18
Historia e hershme e Procedurës Penale 19
Origjina e sistemit inkuzator dhe akuzator. Gjykimi nga një juri 21
Rënia e sistemit inkuizitor. *Preuve Légale (Prova ligjore)* dhe tortura 22
Revolucioni Francez dhe Kodi i Napoleonit mbi Instruksionet Penale *(Code d'Instruction Criminelle)* 23
Ndryshimet në procedurën penale angleze: Hetimi dhe periudha para gjykimit 25
Procedura penale angleze - ndryshimet në gjykim 28
Historiku i Procedurës Penale në Shqipëri 29
KAPITULLI II 34
E DREJTA PËR TU MBROJTUR DHE ROLI I AVOKATIT NË DHËNIEN E DREJTËSISË 34
Zhvillimi historik i mbrojtjes 34
E drejta për tu mbrojtur dhe roli i avokatit në ruajtjen e garantimin e të drejtave të të akuzuarit 35
Funksionet e avokatit gjatë realizimit të mbrojtjes 39
Roli i mbrojtësit në administrimin e drejtësisë. 41
Roli i mbrojtësit si oficer i gjykatës e shërbyes i drejtësisë 42
Deklarimet e dëshmia e rreme dhe ruajtja e konfidencialitetit 44

Jurisprudenca amerikane dhe problemet komplekse që lindin nga deklarimet e rreme të të akuzuarit..... 47
KAPITULLI III..... 51
STANDARDI I MBROJTJES EFEKTIVE DHE RËNDËSIA E TIJ 51
Cili është qëllimi i drejtësisë penale?..... 51
Problemet lidhur me rregullat mbi mbrojtjen efektive. Prezumimi i kompetencës dhe përgjegjësisë.....52
Sindroma e avokatit të përgjumur.....54
E drejta për mbrojtje efektive si një e drejtë procedurale 55
Jurisprudenca për mbrojtjen efektive.....58
Jurisprudenca Amerikane..... 58
Jurisprudenca Europiane..... 60
Jurisprudenca shqiptare..... 62
Përfitimet që do të sillte ekzistenca e një standardi kushtetues. Sugjerime.....65
KAPITULLI IV 68
REALIZIMI I MBROJTJES NË RASTE TË VEÇANTA.....68
Gjykimi i shkurtuar, personat në pamundësi ekonomike për të realizuar mbrojtjen, vetëpërfaqësimi ligjor dhe mbrojtja ligjore e detyruar 68
Gjykimi i shkurtuar..... 68
Gjykimi i shkurtuar sipas modeleve anglo-saksone dhe modelit shqiptar..... 68
Roli ndërmjetësues i mbrojtësit në gjykimin e shkurtuar 69
Efektiviteti i mbrojtësit në gjykimet e shkurtuara sipas jurisprudencës amerikane. 73
Gjykimi i shkurtuar sipas sistemit shqiptar..... 78
Personat në pamundësi ekonomike për të siguruar mbrojtjen 81
E drejta për mbrojtje efektive e personave në pamundësi ekonomike për të siguruar mbrojtjen, sipas jurisprudencës së huaj 81
E drejta për mbrojtje efektive për personat në pamundësi ekonomike në Shqipëri. 88
Vetë përfaqësimi ligjor dhe mbrojtja ligjore e detyruar.....94
KAPITULLI V..... 98
E DREJTA PËR NJË GJYKIM TË DREJTË NË ÇËSHTJE PENALE 98
Hyrje 98
Momenti i fillimit të mbrojtjes së ofruar nga parimi i procesit të rregullt ligjor ... 101
"Akuza penale" si koncept autonom..... 105
Akuza penale sipas konceptit shqiptar..... 107
E drejta për t'iu drejtuar një gjykate 112
Gjykata e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj..... 113
Afati i arsyeshëm për shqyrtimin e çështjes 120
KAPITULLI VI 123
PREZUMIMI I PAFAJËSISË 123
Historia e prezumimit të pafajësisë..... 123
Parimi i prezumimit të pafajësisë..... 125
Paraburgimi dhe prezumimi i pafajësisë.....132
Evidenca dhe prova.....134
Barra e Provës *(Onus probandi)* 140

Llojet e provës..... 143
Kurthi..... 146
Dëshmitarët anonimë..... 147
KAPITULLI VII..... 148
E DREJTA PËR TË HESHTUR DHE PRIVILEGJI KUNDËR VETËINKRIMINIMIT.....148
Historia e zhvillimit të së drejtës për të heshtur.....149
Ç'është e drejta për të heshtur?.....152
Jurispudencat e huaja mbi të drejtën për të heshtur dhe privilegjin kundër vetë-inkriminimit.....153
Jurisprudenca amerikane..... 153
Jurisprudenca europiane..... 156
Jurisprudenca shqiptare..... 159
KAPITULLI VIII..... 161
PARIMI N*E BIS IN IDEM* DHE RËNDËSIA E TIJ NË ÇËSHTJET PENALE...161
Historia e *ne bis in idem*.....163
Forma dhe substanca e parimit. Origjina e tij në ligjin romak.....164
Ne bis in idem v. Res judicata.....166
Rationale e parimit *ne bis in idem*.....166
Ndërkombëtarizimi i *ne bis in idem*.....172
Jurisprudenca për *ne bis in idem*.....176
Jurisprudenca amerikane e *ne bis in idem/double jeopardy*..... 176
Jurisprudenca europiane e *ne bis in idem*..... 180
Jurisprudenca shqiptare e *ne bis in idem*..... 186
KONKLUZIONE..... 189
BIBLIOGRAFIA..... 192
Libra..... 192
Revista Juridike..... 193
Jurisprudenca Amerikane..... 194
Jurisprudenca Europiane..... 196
Jurisprudenca Shqiptare..... 199
Akte Ndërkombëtare..... 200
Websites..... 200
Fjalorë..... 201

FJALORTH TERMINOLOGJIK

Oxford Dictionary of Law - 5th edition

krim - Një veprim (ose ndonjëherë mosveprim), që konsiderohet nga ligji apo *common law* si një veprim publik i gabuar e, si rrjedhojë, i ndëshkueshëm nga shteti në gjykime penale. Çdo krim përbëhet nga *actus reus* i shoqëruar me një *mens rea* të caktuar dhe organi i prokurorisë duhet të provojë këto elementë të krimit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Disa krime janë padrejtësi të rënda të një natyre morale (p.sh. vrasja ose përdhunimi); të tjerë ndërhyjnë në funksionimin e qetë e të patrazuar të shoqërisë (p.sh. kundravajtjet që kanë të bëjnë me parkimin). Shumica e ndjekjeve penale për krime kryhen nga policia (megjithëse ato mund të iniciohen dhe nga palët private)[1]; disa kërkojnë pëlqimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Krimet zakonisht ndahen në krime që gjykohen nga gjyqtari dhe juria dhe krime që gjykohen nga magjistratë. Disa janë hibride (që gjykohen në secilën prej mënyrave). Krimet gjithashtu ndahen në krime të arrestueshme dhe të paarrestueshme. Dënimet për një krim përfshijnë dënimin me vdekje (për tradhti), burgim të përjetshëm (p.sh. për vrasje), burgim për një kohë të caktuar, dënime me burgim të pezulluara, lirim me kusht, lirim me kohë prove, zotim dhe gjobë. Në shumicën e rasteve gjyqtarët kanë diskrecion në vendosjen e llojit të dënimit. Disa krime mund të jenë dhe veprime të gabuara civile. Kështu për shembull, vjedhja dhe dëmtimet penale janë krime të dënueshme me burgim dhe me dëmshpërblim, ku dëmshpërblimi mund të kërkohet nga viktima.[2]

akuzë - Akuzim formal për një krim, që zakonisht bëhet nga policia pas marrjes në pyetje. [3]

aktakuzë[4] - Një dokument formal që akuzon një ose disa persona për kryerjen e një vepre ose veprave të dënueshme. I lexohet të akuzuarit në gjykim. Ka një formë të veçantë. Në krye vendosen emri i çështjes dhe vendi i gjykimit. Ka një parashtrim të veprës penale, duke treguar se cila vepër penale pretendohet se është kryer, e ndjekur nga të veçantat e veprës, p.sh. detaje të tilla si: data dhe vendi i kryerjes së veprës, malli i vjedhur, etj. Nëse i akuzuari dënohet për më shumë se një vepër penale, çdo pretendim dhe dënimi përkatës vendosen në një paragraf të veçantë. Ato, megjithatë mund të alternohen. Nëse ka dy ose më shumë paragrafë, akuzat mund të jenë të ndryshme, por edhe mund të jenë për të njëjtën çështje. I akuzuari mund të dënohet dhe vetëm për njërën

[1] Kjo lloj mënyre e fillimit të ndjekjes penale është tipike e Mbretërisë së Bashkuar. Iniciues i ndjekjes penale, krahas organeve përkatëse shtetërore, mund të jetë dhe çdo individ.
[2] Oxford Dictionary of Law (5th ed.), 128.
[3] ibid 74.
[4] *indictement*, ibid 249.

prej tyre; p.sh. kur i akuzuari në një paragraf akuzohet se ka kryer veprën penale dhe në një tjetër se ka vepruar si ndihmës, në lidhje me të njëjtën ngjarje.

evidencë - ajo që ka për qëllim të provojë ekzistencën ose mosekzistencën e një fakti. Mund të konsistojë në dëshmi, evidencë dokumentare, evidencë reale, e, në rastet kur pranohet, evidencë thashethemesh (fjalësh të thëna nga të tjerët). Ligji për evidencën përfshin të gjitha rregullat që drejtojnë prezantimin e fakteve dhe provës në procedimet para gjykatës, duke përfshirë veçanërisht rregullat që drejtojnë pranueshmërinë e evidencës dhe rregullat për përjashtimin e saj.[5]

provë - 1. mjetet të cilat bindin gjykatën për ekzistencë ose mosekzistencën e një fakti, përfshirë dëshminë, evidencën dokumentare, prezumimet dhe njoftimin gjyqësor. Duke qenë se shumica e fakteve, që i paraqiten gjykatës, është e pamundur të testohen në mënyrë empirike, prova në sensin ligjor është e ndryshme nga ajo në kontekstin matematikor ose shkencor. Evidenca e paprovuar e një dëshmitari të besueshëm përbën provë të mjaftueshme për shumicën e qëllimeve në ligj. 2. *(Informale)* pohimet me shkrim të një dëshmitari të mundshëm të marra nga një avokat. Thuhet se një dëshmitar nuk ka provuar faktin, nëse ai nuk arrin të dëshmojë në përputhje me evidencat që ka.

Black's Law Dictionary 7th edition

i akuzuar – 1. Një person i fajësuar për kryerjen e një veprimi të gabuar; 2. Specifikisht, një person, i cili i është nënshtruar kufizimit të lirisë përmes një arresti ose një person, të cilit i është njoftuar akuza.

The Essential Law Dictionary 1st edition

akuzë – Padia e ngritur ndaj dikujt për kryerjen e një krimi; nisja e procedurave ligjore ndaj një krimineli të dyshuar.

i akuzuar – Dikush i paditur për një krim.

padi penale[6] – Akuzimi i dikujt për kryerjen e një vepre penale.

[5] Tekstet e sistemeve *common law* dallojnë evidencën nga prova. Me evidencë kuptohen të gjitha ato fakte që paraqiten para gjykatës për të provuar akuzën. Të gjitha faktet e provuara përtej çdo dyshimi të arsyeshëm përbëjnë prova.
[6] Charge.

Bloomsbury Reference - Dictionary of Law 4th Edition

i akuzuar – një person ose disa persona të paditur për një krim.

Ballentine's Law 3rd edition

akuzë/a – paditja e një personi për kryerjen e një vepre penale; mund të jetë informale, përmes informimit gojarisht; ose formale, përmes një aktakuze; informacioni ose ankimi për shkak të të cilit nis ndjekja penale.

Oxford Dictionaries Online

(http://oxforddictionaries.com/)

evidencë - tërësia e fakteve ose informacioneve, që tregojnë nëse çka besojmë ose propozojmë është e vërtetë ose e vlefshme; *Sipas ligjit* Informacion i marrë përmes dëshmisë, një dokumenti ose një objekti material, që përdoret për të përcaktuar faktet në një hetim ligjor ose të pranueshme si dëshmi në gjykatë; shenja, indikacione të diçkaje.

provë - evidencë ose argument që vendos vërtetësinë e një fakti ose pohimi; *Sipas ligjit,* evidencë e marrë në gjykim përmes dëshmisë ose me shkrim; veprimi që vendos vërtetësinë e një pohimi; ...

Fjalor i Shqipes së Sotme

(Publikim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë - Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë)

akuzë - 1. veprimtari e organeve ose njerëzve të caktuara me ligj, që ka për qëllim të vërtetojë para gjyqit fajësinë e dikujt; akti që përmban fajet e që lexohet në gjyq; pala që ngre padinë. 2. faj që i ngarkohet dikujt.

akuzoj - 1. ngre një akuzë kundër dikujt, e padit në gjyq. 2. I hedh fajin dikujt, e fajësoj për diçka.

i akuzuar - ai, kundër të cilit është ngritur një akuzë në gjyq.

krim - 1. veprim që kryhet në kundërshtim me ligjet në fuqi, që ka pasoja të dëmshme e të rrezikshme për shtetin, për shoqërinë a për ndonjërin nga pjesëtarët e saj, dhe, që dënohet në bazë të Kodit Penal. 2. Shkatërrime e veprime të tjera çnjerëzore, që bëhen nga ushtritë pushtuese, etj.; vrasje; veprim i keq e i dënueshëm.

provë - 1. e dhënë që sillet për të vërtetuar, për të mbrojtur ose për të hedhur poshtë diçka; dëshmi, fakt, argument, send a diçka tjetër konkrete që merret si dëshmi për të vërtetuar krimin, ose për të përcaktuar njeriun që e ka kryer atë. 2. vërtetim në praktikë i diçkaje, eksperiment që bëhet për të parë si është diçka ose për ta vërtetuar atë. 3. veprim paraprak që bëhet për të kontrolluar saktësinë a masën e diçkaje para se ta përfundojmë, shkallën e përgatitjes ose gatishmërinë për diçka. 4. diçka e vështirë, që duhet ta bëjë dikush për të parë aftësitë a cilësitë e tij, para se t’i ngarkohet një detyrë me përgjegjësi; sprovë. 5. veprimi me të cilin vërtetojmë se një përllogaritje është e përpiktë.

evidencë - shënime të rregullta që mbahen në një regjistër a në një fletë të posaçme për gjendjen e punëve a të veprimtarisë së një ndërmarrjeje, etj.; regjistri a fleta ku mbahen shënime të tilla; pasqyrë.

HYRJE

Objekti i kërkimit shkencor

Objekt i këtij kërkimi shkencor janë të drejtat e të akuzuarit në procesin penal, e në veçanti të të akuzuarit shqiptar; historia e lindjes dhe zhvillimit të këtyre të drejtave si dhe rëndësia e ruajtjes dhe garantimit të tyre.

Për një përqasje sa më të mirë të legjislacionit shqiptar me legjislacionet e huaja, terminologjia e këtij punimi është përdorur duke përafruar terminologjinë shqiptare me atë të legjislacioneve të huaja. Kështu, është përdorur termi “i akuzuar” dhe jo “i pandehur”, duke pasur parasysh që të dy termat nënkuptojnë të njëjtin moment procedural dhe të njëjtin individ, atë të cilit i është njoftuar “aktakuza”. Gjithashtu, është përdorur termi “evidencë” dhe jo “provë” duke shpjeguar dhe ndryshimin procedural që qëndron mes tyre në terminologjinë e huaj, të cilës i është referuar ky punim.

Qëllimi i përzgjedhjes së kësaj teme

Një thënie e vjetër angleze thotë: “Është më mirë që 99 fajtorë të lirohen, sesa një i pafajshëm të ndëshkohet”.

Vendosja e një balance mes nevojës për zbatimin e ligjit, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së shtetasve nga shtypja e padrejtësia e “makinerisë” shtetërore, që merret me zbatimin e ligjit, nga ana tjetër, është problem i hershëm i artit të qeverisjes.

Në një demokraci, mbrojtja dhe zhvillimi i dinjitetit dhe vlerave të personalitetit njerëzor janë bërthama dhe pika themelore të besimit në qytetërim. Karakteri i padhunueshëm i njeriut si individ duhet të mbrohet në masën më të madhe si në mendimet, ashtu dhe në besimet e tij.

Të drejtat janë esenciale si për konceptin e lirisë, ashtu dhe për rolin që një shtet duhet të ketë. Disa të drejta fitohen që me lindjen e njeriut, për faktin e thjeshtë të ekzistencës së tij si qenie njerëzore, ndërsa disa të tjera janë krijuar nga shoqëritë me qëllim të mbrojtjes së individit nga ndërhyrjet e pa drejta të shtetit.

Shumë përparime në mbrojtjen e të drejtave, që gëzojmë sot, kanë ardhur si rrjedhojë e përpjekjeve politike, etnike, fetare, të minoriteteve, apo dhe shpesh herë nga përpjekje të një pakice individësh që mendonin tërësisht në kundërshtim me shumicën e shoqërisë.

Në ditët e sotme vihet theksi në lidhjen e ngushtë që ekziston mes të drejtave dhe lirisë personale por, dhe ato të drejta që identifikohen si personale (si p.sh. të drejtat e personit të akuzuar për krime), përsëri kanë bazë shoqërore. Të drejtat nuk janë krijuar që të çlirojnë individin nga zbatimi i normave shoqërore, përkundrazi, qëllimi i tyre është promovimi i një lirie të përgjegjshme, në mënyrë që, gjithsecili të jetë i lirë nga përdorimi arbitrar i pushtetit. Tërësia e të drejtave është krijuar për të parandaluar ndërhyrjen e paligjshme të shtetit në jetët e individëve.

Qëllimi i legjislacionit penal, në përgjithësi, e i atij procedural në veçanti, është vendosja e rregullave procedurale penale që sigurojnë një zbatim efektiv të normave penale dhe që sigurojnë një rregullim të drejtë të marrëdhënieve ligjore penale, pa ndërhyrje të pajustifikuara në jetën e personit. Kur përpiqemi të formulojmë qëllimet e ligjit penal është e rëndësishme të kemi parasysh si arsyet që kërkojnë një gjë të tillë, ashtu dhe natyrën e problemeve që mund të shkaktojë. Qëllimi i çdo shteti është jo vetëm parandalimi i krimeve, por njëkohësisht shmangia e dënimit të personave të pafajshëm, duke rritur në këtë mënyrë ndjenjën e sigurisë në shoqëri, që është një nga funksionet kryesore të procedurave penale.

Ligjet procedurale penale përcaktojnë mënyrat se si duhen administruar ligjet penale substanciale. Pa procedurat përkatëse ligjet substanciale nuk do të kishin vlerat dhe rëndësinë e duhur. Rregullat e procedurës penale kanë për qëllim gjetjen e së vërtetës, kusht ky i rëndësishëm në dhënien e drejtësisë.

Lind pyetja: Pse të drejtat e kësaj pakice/të akuzuarve duhet të triumfojnë mbi vullnetin e shumicës? Pse duhet të shtrijmë mbrojtjen kushtetuese edhe ndaj njerëzve që akuzohen për krime të tmerrshme? Këto janë pyetje të drejta, por që shmangin rolin e të drejtave në një shoqëri demokratike. Liria i përket individit dhe jo shoqërisë në përgjithësi, prandaj kemi zgjedhur të mbrojmë lirinë personale sa më shumë të jetë e mundur, brenda nevojës për rend publik. Kemi arritur në përfundimin se mënyra më e mirë për garantimin e kësaj lirie është kufizimi i pushtetit të qeverisë.

Zbulimi i së vërtetës për krimet e dyshuara nuk mund të jetë funksion ekskluziv i drejtësisë penale. Përdorimi i torturës, kontrollet e banesave, përgjimet telefonike, pavarësisht se mund të jenë shumë efektive në zbulimin e aktiviteteve penale e në gjetjen dhe kapjen e kriminelit, përsëri ndaj këtyre veprimeve duhen vendosur kufizime, pavarësisht se vendosja e tyre mund të kufizojë zbulimin e së vërtetës. Ruajtja e të drejtave dhe lirive të individit prej abuzimit të pushtetit nga ana e ushtruesit të ndjekjes penale, si dhe ruajtja e drejtësisë, janë qëllimet bazë të një shoqërie demokratike.

Statusi i "të akuzuarit" përmban, krahas detyrimeve, edhe të drejta. Pjesë e këtij studimi janë pikërisht të drejtat e mjetet që një individ duhet të gëzojë e të përdorë, kur përballet me drejtësinë penale. Ky studim tenton të trajtojë disa nga të drejtat themelore të të akuzuarit, duke vënë theksin kryesisht në rolin e mbrojtjes dhe rëndësinë e saj, si kusht primar i ruajtjes dhe garantimit të këtyre të drejtave.

Fokusi i studimit

Qëllimi kryesor i çdo qeverie është dhe duhet të jetë zbatimi i ligjit dhe rregullit. Shumica e Kushtetutave u njohin shteteve disa pushtete, me qëllim që shteti të garantojë ruajtjen e rregullit dhe sigurisë së shtetasve, mbrojtjen e jetës, pasurisë dhe të drejtave të individëve të shoqërisë. Organet policore dhe ato të ndjekjes penale marrin masa që ndalojnë disa individë të lëndojnë të tjerë përmes kryerjes së veprave penale. Shumica e shtetasve kërkojnë nga shteti të jetë i ashpër ndaj shkelësve të ligjit, t’i kapë dhe t’i dënojë ata. Megjithatë, ka disa kufizime në ushtrimin e pushteteve. Qëllimi i këtyre kufizimeve është parandalimi i abuzimeve në përdorimin e pushtetit të shtetit.

Me qëllim që të japin drejtësi, shteti dhe institucionet shtetërore duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të individit, që nënkupton, ndër të tjera, dhe respektin ndaj të drejtave të të akuzuarve. Si rrjedhojë, legjislacioni në fuqi mund të arrihet të kuptohet qartë vetëm përmes shqyrtimit se si gjykatat janë shprehur në lidhje me rëndësinë e mbrojtjes së të drejtat të të akuzuarit, si dhe, cilat janë mjetet që shtetet ofrojnë në rast cenimi të këtyre të drejtave.

Megjithëse teorikisht, institucionet shtetërore sigurojnë e mbrojnë të drejtat e njeriut, duke u kushtuar një rëndësi të veçantë dhe të drejtat e të akuzuarve në procesin penal, ku vlejnë të përmenden: e drejta për mbrojtje në gjykimet penale; e drejta për një gjykim të drejtë; e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj; prezumimi i pafajësisë; e drejta për të heshtur dhe privilegji kundër vetëinkriminimit, barra e provës në çështjet penale, barazia e armëve, mosgjykimi dy herë për të njëjtë vepër penale. Përmes studimit të rasteve konkrete të jurisprudencave të ndryshme synohet të tregohet që, shpesh herë, këto të drejta janë cenuar. Si rrjedhojë, lind nevoja e pasjes dijeni mbi mjetet ekzistuese shqiptare dhe ato ndërkombëtare që synojnë vënien në vend të të drejtave të cenuara.

Ky punim ka për qëllim pikërisht ekzaminimin e mbrojtjes që ofrohet në rastin e marrjes në cilësinë e “të akuzuarit” në procesin penal, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë rolit të mbrojtjes, si një ndër elementët më të rëndësishëm të procedimit penal, si dhe nevojës për ekzistencën e një standardi mbrojtjeje efektive.

Përmes analizimit të jurisprudencave të gjykatave të huaja ky punim synon të ngrejë në nivel kushtetues standardin e mbrojtjes në gjykimet penale, përmes sigurimit të një mbrojtjeje efektive, si një parim i domosdoshëm për ruajtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në çështjet penale, parim që duhet të jetë jo thjesht i shkruar formalisht, por dhe që duhet zbatuar, me qëllim që të garantohet ekzistenca e një shoqërie vërtet demokratike e që i pafajshmi të mos dënohet.

Pyetjet që ky studim ngre për diskutim:

- Si kanë evoluar të drejtat e të akuzuarit gjatë historisë?
- Si i krijuan sistemet e ndryshme të procedimit penal (akuzator dhe inkuizitor)?
- Si kanë evoluar këto të drejta në Shqipëri?
- Ç’ kuptojmë me akuzë penale?
- Ç’ kuptojmë me të akuzuar?
- Cilat janë të drejtat themelore të të akuzuarit në procesin penal?
- Cili është roli i mbrojtjes në këtë proces?
- Cilat janë detyrat e mbrojtjes?
- Ç’ masa duhen marrë për garantimin e një mbrojtjeje efektive?
- Sa i rëndësishëm është mirëfunksionimi i raportit i akuzuar - mbrojtës?
- A duhet të ketë një standard kushtetues për mbrojtje efektive?
- Cilat janë detyrimet e mbrojtësit për realizmin e mbrojtjes efektive?
- Cilat janë problemet me të cilat përballen mbrojtësit gjatë realizmit të mbrojtjes dhe si ndikojnë ato në realizimin e një mbrojtjeje efektive?
- A ka dhe a duhet të ketë një mbrojtje efektive në procedurat e veçanta të gjykimit, si p.sh. gjykimi i shkurtuar?
- Ç’ masa mund të merren nga shtetet për realizimin dhe garantimin e kësaj mbrojtjeje?
- Ç’ masa duhet të merren nga shteti për garantimin e një mbrojtjeje efektive për personat në pamundësi ekonomike për të siguruar mbrojtjen?
- Si duhet kuptuar gjykimi i drejtë në çështjet penale?
- Cilët janë faktorët ndikues të një gjykimi të drejtë?
- Sa rol luajnë gjykatat në dhënien e drejtësisë?
- Sa i rëndësishëm është prezumimi i pafajësisë në çështjet penale?
- Sa të rëndësishme janë e drejta për të heshtur dhe privilegji kundër inkriminimit?
- Ç’ kuptojmë me barazi të armëve në procesin penal?
- A duhet të ketë barazi financiare mes palëve?
- A ka barazi në fazën e hetimeve paraprake?
- Ç’ është ne bis in idem dhe si ndikon ky parim një ekzistencën e një shoqërie demokratike, e cila synon ruajtjen e sigurisë juridike dhe rendin shoqëror?

Metoda e analizës

Në këtë punim është përdorur një përzierje e formave përshkruese dhe analitike të të shkruarit.

Citimi i punimit

Në këtë punim është përdorur formë uniforme e citimit, duke iu referuar kryesisht OSCOLA-s (Oxford Standard for Citation of Legal Authorities), por duke ruajtur njëkohësisht standardet e citimit të përdorura nga jurisprudenca shqiptare.

Metodologjia e punimit

Ky punim është shtrirë në disa faza kryesore, të ndara në:

Faza e parë: Përcaktimi i një ideje të qartë mbi llojin e punimit dhe çështjet që ky punim merr përsipër të trajtojë, mënyrën e trajtimit, metodikën e punimit si dhe përcaktimin e materialit të nevojshëm për realizimin e plotë të kësaj teme.

Faza e dytë: Mbledhja dhe përzgjedhja e literaturave të huaja dhe shqiptare, të nevojshme për realizimin e një punimi sa më dinjitoz, duke synuar arritjen e qëllimit të këtij punimi.

Faza e tretë: Sistemimi i materialeve të përzgjedhura sipas nevojave të kapitujve dhe temave të veçanta që do të trajtohen, analizimi i tyre si dhe përcaktimi i një lloj hierarkie dhe mënyre trajtimi, duke i renditur ato sipas rëndësisë.

Faza e katërt: Përmbledhja me shkrim e ideve, materialeve, jurisprudencave të huaja e shqiptare, duke bërë të mundur jo vetëm realizimin e këtij punimi, por dhe duke përmbushur njëkohësisht qëllimin bazë të tij: "Mbrojtjen e temës së disertacionit".

Vlen të theksohet se trajtimi i temës së të drejtave të të akuzuarit në procesin penal është shumë i gjerë. Trajtimi i çdo parimi e detaji, që lidhet me të drejtat e të akuzuarit në procesin penal, do të ishte i pamundur të kryhej brenda afatit të mbarimit të doktoraturës, sipas parashikimeve të Rregullores së lartpërmendur.

Ky punim merr përsipër të trajtojë të drejtat kryesore, cenimi i të cilave sjell cenim të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara jo vetëm në Kushtetutë, por dhe me një sërë aktesh ndërkombëtare, të pranuara e ratifikuara dhe nga shteti shqiptar.

Terminologjia e shkurtimeve

KP	- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
KPP	- Kodi i Procedurës Penale të republikës së Shqipërisë
GJK	- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
KEDNJ	- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
KADNJ	- Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	- Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut
KE	- Komisioni Europian i Bashkimit Europain
GJS	- Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës
KNDCP	- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
DUDNJ	- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
KSHNJ	- Komisioni Shtetëror për Ndihmë Juridike
KEE	- Konventa Europiane për Ekstradim
KETPCP	- Konventa Europiane për Transferimin e Procedimeve në Çështje Penale
KEVNGJP	- Konventa Europiane mbi Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale

KAPITULLI I PARË

HISTORIA E PROCEDURËS PENALE DHE E LINDJES SË TË DREJTAVE TË TË AKUZUARIT

Procedura penale është e ndryshme për vende të ndryshme. Dallohen dy sisteme kryesore ai *common law* dhe ai *civil law*. Pavarësisht dallimeve që ekzistojnë mes tyre, historia e krijimit të dy sistemeve është pothuajse e njëjtë.

Rreth 800 vite më parë as që mund të bëhej fjalë për dallime mes sistemeve të ndryshme procedurale penale të shteteve. Sistemi anglo-sakson dhe ai kontinental ishin identikë. Pikërisht në këtë kohë ndodhën një numër i madh ngjarjesh me rëndësi historike, të cilat bënë të nevojshme njohjen si dhe krahasimin e legjislacionit dhe procedurës penale mes shteteve.

Historia e procedurës penale në vendet e Europës Lindore është, në një fare sensi, historia e shteteve, që veprimtarinë dhe traditat e tyre i kopjonin nga ato të vendeve të tjera e kryesisht atyre fqinje, me referim të drejtpërdrejtë ose jo.

Kështu, sistemet e ndryshme të traditës Romako-Gjermanike, përmes shumë reformave, kanë përthithur gjithnjë e më shumë traditën *common law*. Franca dhe Belgjika, dy sistemet më besnike të sistemit inkuizator, në kohën e Revolucionit Francez kopjuan jurinë, të drejtën për të mos u shprehur, gjykimet publike dhe parimin se tribunali që vendoste mbi fajësinë apo pafajësinë duhej të ishte i ndryshëm nga trupa që kryente hetimet fillestare. Më pas Gjermania shkoi dhe më tej, duke marrë nga tradita *common law* parimin se gjykata që shqyrtonte çështjen duhej të dëgjonte dëshmitarët, duke përforcuar, në këtë mënyrë, parimin e ndarjes së funksionit investigues (hetimor) nga funksioni i gjyqtarit dhe duke hequr ekuivalentin gjerman të *juge d'instruction*.

Italia ka shkuar akoma më tej, duke futur në 1988 nocionin e *guilty plea*/*pranimi i fajësisë* (të paktën në parim)[7] dhe nocionin se, aktet e dosjes së mbledhur nga institucioni i ndjekjes penale, nuk kanë statusin e evidencës në gjykim (parim ky shumë i huaj për traditën franceze). Një ndër shembujt më ekzemplarë është ai i prokurorit, një institucion që Anglia mori nga Skocia, e cila, sipas një teorie, e kishte kopjuar vetë nga Europa kontinentale.[8]

Çdo sistem ka mënyrën e tij se si trajton veprimet e kundraligjshme. Çdo vend bën përgjithësisht 2 ndarje: krime dhe kundravajtje. Në Angli p.sh. Gjykata e Kurorës

[7] Ekuivalenti shqiptar – *gjykimi i shkurtuar*.
[8] J. R. Spenser, *European Criminal Procedure. Early history and ordeals*, Cambridge University Press (2002), 4.

trajton çështjet e krimeve të rënda dhe gjykatat magjistrale trajtojnë çdo çështje tjetër. Në disa vende të tjera kjo ndarje është më e komplikuar. Franca bën një ndarje të veprimeve të kundraligjshme në: krime, delikte *(délits)* dhe kundravajtje *(contraventions)*.

Çdo sistem ka procedura më të thjeshta për trajtimin e atyre veprave penale, që konsiderohen se kanë rrezikshmëri të ulët. Sistemi gjerman ka *Strafbefehlsverfahren*, përmes të cilit prokurori i shkruan të dyshuarit dhe gjykatës, duke propozuar një dënim të caktuar, i cili më pas, nëse i dyshuari nuk ka kundërshtime, zbatohet. Përveç procedurave të lartpërmendura, ka dhe disa procedura më të thjeshta, të cilat legjislacionet kombëtare i konsiderojnë më shumë administrative se penale (pavarësisht se Gjykata Europiane mund të mos mendojë në këtë mënyrë)[9]. Nga ana tjetër, secili vend ka procedura të veçanta për trajtimin e veprave të caktuara penale apo krimeve të kryera nga një kategori e caktuar personash, si psh. terroristë, punonjës të forcave të armatosura apo qeveritarë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Pavarësisht nga dallimet, historia i krijimit të procedurës penale, kryengritjet e masave popullore, klerit, etj. në zhvillimin e normave fillestare të procedurës penale, ishin pothuajse të njëjta.

Historia e hershme e Procedurës Penale

Në Mesjetë procedura penale ishte pothuajse e njëjtë në të gjithë Europën. Ndaj atyre që kapeshin në kryerje e sipër të veprës penale, ose duke u larguar nga vendngjarja, kryhej një procedurë barbare e shkurtuar gjykimi, e cila mund të quhet, me analogji, "arrest" ose "vrasje". F.W. Maitland përshkruante në këtë mënyrë versionin anglez të tij: "Kur kryhej një krim, njerëzit duhet të bërtisnin e të ulërinin *(hutesium et clamor)*. Komshinjtë duhet të dilnin me shigjeta, thika, e ç'mjete të tjera të kishin. Përveç ulërimave duhej dhe t'u biheshin brirëve në mënyrë që të merrej vesh nga çdo fshat. Nëse një individ do të kapej me shenjat e krimit akoma në të, ai kishte të drejtën për një rrëfim të shkurtër. Nëse do të kundërshtonte një gjë të tillë, do të vritej. Por, edhe nëse i nënshtrohej kapjes, fati i tij ishte tashmë i vendosur ... Do të paraqitej para një gjykate (të përbërë nga individë të mbledhur shpejt për këtë qëllim) dhe do të varej, t'i pritej koka apo të hidhej nga një shkëmb, pa u lejuar të thoshte asnjë fjalë. Pronari i sendeve të vjedhura mund të ishte i pranishëm si amator në ekzekutim."[10]

Kjo mënyrë trajtimi e të akuzuarit nuk linte aspak hapësirë për vlerësim të provave. Në rast se personi mohonte krimin, çështja e pafajshmërisë ose fajësisë së tij zgjidhej në 2 mënyra. Sipas mënyrës së parë, i akuzuari ftohej të betohej mbi pafajësinë e

[9] ibid
[10] F.Pollock and F.W.Maitland, *The history of English Law Before the Time of Edward I*, revised by S.F.C.Milsom 2 Vol. London, (1968), Vol.II, 578-579.

tij së bashku me një grup "ndihmësish në betim". Nëse ai arrinte të mblidhte një numër të caktuar komshinjsh, të cilët do të betoheshin me të për pafajësinë e tij, atëherë ai do të lirohej. Sipas mënyrës së dytë, gjykata i drejtohej Zotit t'i jepte përgjigje, duke e bërë të akuzuarin t'i nënshtrohej një prove. Disa herë kjo prove merrte formën e një "gjykimi përmes dyluftimit", sipas të cilit, i akuzuari dhe akuzuesi viheshin në dyluftim ndaj njëri-tjetrit. Ishte Zoti ai që do të tregonte të vërtetën duke lënë të jetonte atë që kishte të drejtë. Megjithatë, më shpesh, prova kryhej me zjarr ose ujë. Sipas të parës, një pjesë hekuri skuqej në zjarr dhe më pas vihej në dorën e palës. Dora lidhej dhe inspektohej disa ditë më vonë. Nëse plaga do të qelbëzohej, Zoti kishte vendosur kundra kësaj pale. Prova me ujë të ftohtë kërkonte lidhjen e palës dhe zhytjen e tij në një pellg me ujë, liqen, etj. Nëse ai do të zhytej, konsiderohej se uji e kishte marrë atë së bashku me bekimin e Zotit.[11]

Pavarësisht se sa të çuditshme dhe joracionale mund të duken sot këto prova, ato u përdorën për shekuj me radhë pasi njerëzit mendonin se këto mënyra funksiononin. Të vetmit që e dinin se përmes këtyre provave po dënohej personi i pafajshëm ishin dy: personi i dënuar, të cilin nuk e besonte askush dhe personi që duhej të ishte dënuar, i cili sigurisht, mendonte që ishte e udhës të mos bënte zë.

Besimi i publikut tek këto prova filloj të vanitej rreth shekullit të 12. Kjo për arsye se dyshimi rreth këtyre provave filloj të shfaqej nga përfaqësues të Kishës.[12] Në vitin 1215 këto dyshime ishin shtuar aq shumë saqë kisha i dënoi ato zyrtarisht.

Deri në 1215-tën, natyra dhe zhvillimi i procedimeve penale në kontinentin europian ishte e padallueshme nga ajo angleze. Mënyra predominuese e akuzës ishte ajo private dhe gjykimi bëhej përmes kryerjes së provave gjatë ceremonive fetare. Superstitcioni dhe arbitrariteti sundonin kudo. Ndryshimet filluan në qershor të vitit 1215, kur fisnikët detyruan Mbretin John të nënshkruante *Magna Carta*, dokument që garantoi të drejtën e gjykimit nga individë të barabartë dhe i cili vendosi bazat për një sistem racional mbi zbulimin e fajtorit.

Vetëm dy muaj pas nënshkrimit të *Magna Carta* ndodhi një ngjarje tjetër dhe më e rëndësishme, e cila bëri një korrektim të dytë të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë penale. Papa Innocent III, përkrahës i Mbretit John, në mbledhjen e Këshillit të Katërt Lateran, ndaloi klerikët të zhvillonin gjykime përmes provës. Si rrjedhojë e këtij ndalimi, anglezët, ashtu si dhe njerëzit e tjerë të kontinentit, u detyruan të gjenin metoda alternative, më racionale, për përcaktimin e fajësisë apo pafajësisë së të akuzuarve. Zgjidhja, që anglezët i dhanë kësaj çështjeje, ishte e ndryshme nga ajo kontinentale, duke e vendosur të akuzuarin në procesin penal në pozicione shumë të ndryshme.[13]

[11] J.F.Stephen, *A history of criminal law of England*, London: Macmillan (1883), Vol. I, 265.
[12] R.C.Van Caenigem, *The birth of the English Common Law*, 2nd edition, Cambridge, (1988), Kapitulli 3.
[13]< http://www.wcl.american.edu/journal/lawrev/15/mueller.pdf> aksesuar më 01.03.2013.

Origjina e sistemit inkuzator dhe akuzator. Gjykimi nga një juri

Në vende të ndryshme të Europës boshllëku i krijuar u mbush, gjatë viteve, në mënyra të ndryshme. Në shumicën e vendeve të Europës kontinentale mbretërit dhe princët morën mësime nga Kisha. Ata adoptuan metodat e gjetjes së fakteve, që përdoreshin gjatë hetimit të pretendimeve lidhur me krime, veprime të pahijshme të kryera nga klerikët, apo herezi; përmes krijimit të një komisioni me njerëz të besuar, me qëllim kryerjen e hetimeve. Këto hetime kryheshin përmes pyetjes së dëshmitarëve dhe të dyshuarit, regjistrimit me shkrim të thënieve të tyre, dhe eventualisht vendosjes, në përfundim të këtyre procedurave, mbi çështjen. Ky hetim formal *(inquisition)* përbën origjinën e atij që më vonë u quajt "sistem inkuizitor".

Në Angli u adoptua një tjetër mënyrë zgjidhjeje, e cila konsistonte në mbledhjen e një grupi njerëzisht nga vendi ku kishte ndodhur ngjarja dhe detyrimi i tyre t'i përgjigjen, nën betim, të njëjtës pyetje që, përmes provave me zjarr apo ujë, i drejtohej Zotit: I akuzuari është apo jo fajtor? Kjo ishte dhe origjina e gjykimit nga një juri dhe krijimi i saj çoi në një formë tjetër procedure penale, e cila ishte, në themel, akuzatore në kuptimin se gjykata nuk hetonte çështjen, por kryente funksion më të kufizuar, atë të dëgjimit të akuzave ndaj një të dyshuari dhe të vendosjes nëse ai ishte apo jo fajtor për krimin për të cilin akuzohej.

Në fillim, procedura inkuizitore paraqitej më racionale dhe e civilizuar, ndërkohë që juria angleze ishte e ashpër dhe e egër. Gjyqtari kontinental inkuizitor gjykonte çështjen përmes kërkimit dhe gjetjes së provave dhe përdorimit të arsyes. Në gjykimet e hershme angleze me juri, nuk kishte prova. Juria duhej të vendoste çështjen e fajësisë ose pafajësisë mbi bazën e asaj çka anëtarët e jurisë dinin, nëse dinin ndonjë gjë[14]. Edhe nëse nuk kishin dijeni për çështjen, ata përsëri duhej të jepnin vendimin e tyre, pasi ligji refuzonte dhënien e përgjigjes "nuk e di" në gjykim. Kështu, në vend që të dënohej mbi bazën e provave, i akuzuari anglez rrezikonte të dënohej mbi bazën e thashethemeve, hamendjes ose thjesht për shkak të faktit se juria donte të ikte në shtëpi. Megjithatë, në rrjedhën e disa qindra vjetëve, gjykimi akuzator anglez u përmirësua, ndërsa procedura inkuizitore kontinentale u përkeqësua.

Në Angli, gjyqtarët filluan të lejonin palët të thërrisnin dëshmitarë, që t'i tregonin jurisë se ç'kishte ndodhur, kur juria nuk e dinte vetë.[15] Në këtë mënyrë, juria, gradualisht, krijoi rolin e saj modern si trupë individësh të pavarur, të cilët vendosnin për fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit mbi bazën e provave të dhëna nga dëshmitarët e thirrur nga organi i ndjekjes penale dhe mbrojtja. Shekujt 17-18 shënuan një zhvillim të mëtejshëm. Parlamenti u hoqi mbretërve të Anglisë të drejtën për të gjykuar oponentët politikë në

[14] Megjithëse thuhet se juria inkurajohej të bënte kërkimet e veta para gjykimit të çështjes. Pollock and Maitland, *History of English law*, Vol I, 622-625.
[15] Nga fund i shekullit të 15 kjo u kthye në një praktikë të zakonshme. T.Plucknett, *A coinsise history of the common law*, 5th ed., Boston, (1956), 129-130.

Star Chamber dhe *Gjykatën e Komisionit të Lartë (Court of High Commission)*, të cilët gjykoheshin nga këto gjykata pa asnjë farë mundësie suksesi; si dhe u hoqi të drejtën t'i burgosnin ata arbitrarisht. Tashmë të gjithë kundërshtarët politikë do të gjykoheshin në gjykata, në të cilat çështja e fajësisë apo pafajësisë do të përcaktohej nga juria. Megjithëse të tilla gjykime qenë përgjithësisht të suksesshme në dënimin e kundërshtarëve politikë të mbretërve, në një numër të konsiderueshëm rastesh ato dështuan thjesht për shkak të faktit se juria vendosi pafajësinë e tyre.[16] Përmes këtij procesi, juria mori një rol të ri simbolik, si mburojë e shtetasve ndaj pushtetit të tepruar mbretëror.

Rënia e sistemit inkuizitor. *Preuve Légale (Prova ligjore)* dhe tortura

Procedura inkuizitore kontinentale, ndërkohë, kishte nisur të shkatërrohej përmes përdorimit sistematik të torturës. Në mënyrë paradoksale, kjo rrjedhje negative e ngjarjeve kishte ardhur duke pasur fillimisht vetëm qëllime të mira. Me qëllim të mbrojtjes së të akuzuarit nga dënimi i padrejtë për shkak të pamjaftueshmërisë së provave si dhe, për të siguruar se vendimmarrja do të ishte sa më e përafërt me atë që mund të jepte vetë Zoti, gjykatat vendosën, që herët, se ata që nuk do të pranonin fajësinë, mund të dënoheshin bazuar në evidencën e dy dëshmitarëve. Mbi bazën e kësaj ideje u krijua një bazë ligjore teknike dhe komplekse mbi provat dhe të provuarin, e njohur nga ligjvënësit Francezë si *preuve légale*.[17] Kjo krijoi një bllokim të dukshëm të drejtësisë në shumë raste, të cilin sistemi u përpoq ta shmangte përmes lejimit të torturës së të akuzuarve ndaj të cilëve kishte një minimum provash, me qëllim që ata të tregonin.[18]

Procedura inkuizitore kontinentale u ripunua dhe u formalizua në Kode të ndryshme, ku më të rëndësishmit ishin *Constitutio Carolina*, e miratuar për Perandorinë e Shenjtë Romake nga Karli V në 1532[19] dhe në Francë nga *Grand Ordonnance* e Luigjit të XIV-të në 1670.[20] Megjithëse kishte disa dallime nga një vend në tjetrin, procedura e parashikuar në këto kode ishte mjaft e ngjashme. Procedura ishte sekrete, vetëm dënimi kryhej në publik. Procesi përqendrohej në krijimin e një dosjeje të shkruar, e cila më pas kqyrej dhe merrej në konsideratë nga gjyqtarët. Megjithëse kishte një prokuror, detyra e hetimit aktiv të çështjes kryhej nga gjykata dhe nuk kishte një ndarje të qartë mes rolit të

[16] Siç ishte rasti i ndjekjes penale të Miller dhe Woodfall në vitin 1770, që del nga "*Letra të Juniusit*". Shih *Howell's State Trials* 870, 895.
[17] A. Esmein, *History of continental criminal procedure, with special reference to France* (Boston, 1913), 251.
[18] J.H.Langbein, *Torture and the law of proof*: *Europe and England in the Ancient Regime* (Chicago University Press), 176.
[19] J.H.Langbein, *Prosecuting crime in renaissance: England, Germany and France* (Cambridge, Massachusetts, 1974).
[20] M. Isambert, D. Decrasy and F.A.Jourdan, *Recueil général des anciennes lois françaises depuis l'an 420 jusqu'à la Révolution de 1789* (Paris, 1823-33), Vol. XVIII, 371-423.

gjyqtarit dhe atij të prokurorit. Në qendër të procedimit ishte pyetja e dëshmitarit, të cilit i kërkohej t'u përgjigjej pyetjeve nën betim. Nëse ai nuk kishte prova të mjaftueshme e nuk pranonte kryerjen e veprës penale, i nënshtrohej torturës.

Pavarësisht se sot kjo procedurë ngjan shumë e egër dhe shtypëse, në atë kohë nuk shihej si e tillë. Tortura, në veçanti, nuk dukej se e shqetësonte shumë opinionin e publikut në Europën kontinentale. Për shekuj me radhë kjo pranohej si metodë e qartë e zbulimit të së vërtetës, ashtu siç shekuj më parë pranoheshin provat. Megjithatë, nga fundi i shekullit të 17-të e më pas, studiues të iluminuar[21] të Europës kontinentale filluan të kundërshtojnë torturën si mjet mizor, pasi, me shumë gjasa, çonte në dënimin e të pafajshmit.[22]

Ndërkohë që në Kontinent u shtua kritika ndaj torturës, në të njëjtën kohë u rrit dhe admirimi ndaj procedurës penale Angleze. Kritikët iu referuan si sistem i cili, të paktën zyrtarisht, operonte pa përdorim të torturës ndaj të dyshuarve si dhe pa teknikalitetet e *la preuve légale*. Gjatë shekullit të 18 debati mbi procedurën penale në kontinent u ndërlidh me debatin për reforma kushtetuese, ku gjykimi nga një juri u pa si mjet i rëndësishëm në kufizimin e pushtetit mbretëror. Ky admirim kontinental i sistemit Anglez të drejtësisë, pikërisht në këtë periudhë, hodhi dhe bazat e idesë, që sot mbështetet nga shumë juristë, mbi superioritetin e këtij sistemi, që sipas tyre, gjithë bota e ka zili.[23]

Revolucioni Francez dhe Kodi i Napoleonit mbi Instruksionet Penale *(Code d'Instruction Criminelle)*

Një ndër gjërat e para që bënë revolucionarët francezë ishte zëvendësimi i procedurës penale ekzistuese vendase me atë çka ata besuan se ishte kopje e procedurës penale në Angli.[24] Ky ndryshim, megjithatë, rezultoi një katastrofë. Procedura e re rezultoi shumë inefektive për të përballuar atë valë krimi dhe parregullsie, që përfshiu Francën në fillimet e rënies së rendit shoqëror ekzistues. Ky fakt, së bashku me dobësimin e entuziazmit kombëtar për idetë dhe institucionet angleze, pas rreth dy dekadave luftë me Anglinë, bëri që shumë francezë të shihnin virtytet e sistemit autoritar të procedurës penale, që revolucionarët kishin shfuqizuar. Ndërmjet tyre ishte dhe Perandori Napoleon. Në 1808, si pjesë e kodifikimit të plotë, që ai synonte të arrinte, Franca përshtati një sistem të ri procedure penale, që kombinonte ato që në atë kohë

[21] *Age of Enlightment - Periudha e Iluminimit*, e quajtur ndrysh dhe *Periudha e Arsyes*, përbën një lëvizje kulturore në fund të shekullit 17 dhe shekullit të 18, e cila u zhvillua më parë në Europë dhe më pas u shtri dhe në kolonitë amerikane.
[22] ibid (n 17) 351.
[23] ibid (n 8) 10.
[24] ibid 408.

konsideroheshin si avantazhe të sistemit anglez, të prezantuara nga revolucionarët, dhe sistemit të mëparshëm që kishte zëvendësuar.

Kodi i Instruktimit Penal i Napoleonit, i vitit 1880, paraqiste një version më të pastër e të përpunuar të modelit të vjetër të procedurës penale, pa torturën, sigurisht, e cila mund të përdorej vetëm në rastet e kryerjes së veprave penale të rënda, si fazë paraprake e procesit penal.[25] Një polic gjyqësor, *juge d'instruction*,[26] merrte në pyetje të pandehurin dhe dëshmitarët, regjistronte thëniet e tyre, përgatiste një dosje, e cila më pas formonte bazën e çështjes kundër të akuzuarit. Megjithatë, në ndryshim nga procedura e vjetër inkuizitore, gjyqtari, i cili kryente hetimet fillestare, nuk përfshihej në vendimmarrjen mbi fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit. Kjo tashmë kryhej në një gjykim publik, të mbajtur para gjyqtarëve të tjerë, të cilët, në rastet e krimeve serioze, thërrisnin dhe jurinë. Juria jepte mendimet personale mbi provat, si dhe, në ndryshim nga gjykatat para revolucionit, nuk i nënshtrohej rregullave të *preuve légale*. Për francezët ky nuk përbënte kthim në sistemin e mëparshëm inkuizitor, por përbënte krijimin e një sistemi të ri, i cili nuk ishte as akuzator e as inkuizitor. Këtë sistem e quajtën dhe vazhdojnë e e quajnë dhe sot e kësaj dite, sistem "të fiksuar". Kjo strukturë bazë u mbajt në vitin 1958, vit në të cilin *Code d'Instruction Criminelle* u zëvendësua me kodin e ri, *Code de Procédure Penale*, i cili, me ndryshime të shumta, është në fuqi akoma dhe sot e kësaj dite.

Code d'Instruction Criminelle i Napoleonit u bë i detyrueshëm për zbatim në shumë vende të Europës kontinentale gjatë pushtimit francez të këtyre vendeve. Pas largimit të francezëve, disa vende, tashmë të lira (si Belgjika), vazhduan ta mbanin këtë kod, ndërsa vende të tjera si Italia dhe Gjermania e përdorën si bazë për krijimin e kodeve të tyre të procedurës penale.

Historia e mëtejshme e procedurës penale në Europën kontinentale tregon se disa vende, që fillimisht pranuan këtë kod, me kalimin e kohës, e ndryshuan atë ose nuk e përdorën. Një ndër tendencat e vëna re ishte ajo e heqjes së *juge d'instruction*, që ishte simbol i sistemit francez. Në Gjermani ai u hoq në 1974, ndërsa në Itali në 1988. Arsyet e heqjes së tij janë të ndryshme. Pjesërisht, heqja e tij kishte për qëllim reduktimin e vonesave, pasi puna e tij shihej si e panevojshme dhe shpenzim kohe për diçka që përsëritej, për shkak se ishte kryer më parë nga prokurori dhe policia. Një arsye tjetër ishte pjesërisht ideologjike, pasi statusi i tij si gjyqtar përbënte ngatërresë mes funksionit hetimor dhe gjyqësor, gjë që vinte në pikëpyetje nocionin e gjykatës së pavarur, element ky thelbësor në mbrojtjen e të akuzuarit. Edhe në Francë ka pasur 2 propozime serioze për heqjen e *juge d'instruction*. I pari në 1949[27] dhe i dyti në 1990[28], pikërisht në momentin kur një pjesë e publikut britanik kërkonte futjen e *juge d'instruction* si

[25] ibid 462.
[26] Term ky i ri. Periudha para revolucionare përdorte termin *juge instructeur*.
[27] Në raportin e një komisioni zyrtar të drejtuar nga Profesor Donnadieu de Varbres. Shih [149] RSC 499, and J. Pradel, *L'instruction préparatoire* (Paris, 1990), 37.
[28] Commission justice pénale et droits de l'homme, *La Mise en état des affaires pénales, (*Paris, 1991).

mbrojtje kundër atyre ndjekjeve "të zellshme" penale, të cilat çonin në dënimin e të pafajshmit. Megjithëse në Francë kjo figurë ishte nën sulm, kishte gjithsesi mbështetës të fortë. Në ndryshim nga prokurori, i cili në Francë mund të merrte urdhra nga Ministri i Drejtësisë, *juge d'instruction* ishte i lirë nga ndërhyrja e qeverisë, liri kjo që e ndihmonte në kryerjen e hetimeve për vepra penale të kryera nga politikanë, të cilët mund të përdornin influencën e tyre politike për pushimin e hetimeve mbi këto çështje.[29]

Ky largim nga modeli Napoleonik u shfaq, në një farë mase, përmes huazimit të të tjera ideve nga tradita *common law*. Kështu, Gjermania, e influencuar nga shkrimtarë si Anselm von Feuerbach dhe Carl Mittermaier, huazoi idenë se gjykata, gjithmonë, duhet të dëgjojë dëshmitë e dhëna me gojë nga dëshmitarët më të rëndësishëm. Në 1988 Italia adoptoi nocionin (bazë për traditën *common law*, por i huaj për traditën franceze) që dëshmitë me shkrim, të marra nga dëshmitarët gjatë hetimit, nuk duhet të pranohen nga gjykata si evidencë në gjykim; si dhe nocionin e pranimit të fajësisë (i njohur nga tradita *common law*).

Nga ana tjetër, largimi nga modeli Napoleonik çoi në braktisjen ose modifikimin e një ndër elementëve më të rëndësishëm që *Code d'Instruction Criminelle* kishte huazuar nga legjislacioni anglez: jurisë. Në Europën kontinentale, ideja se juritë janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave të shtetasve, ndryshoi gjatë Revolucionit francez, kur juria dërgoi në gijotinë mijëra individë të pafajshëm. Si rrjedhojë, që nga fillimi i shekullit të 19 pati një tendencë të largimit nga gjykimet me juri (të paktën në mënyrën se si juritë funksionojnë në Angli). Hollandezët hodhën poshtë jurinë pothuajse ditën e nesërme të largimit të francezëve. Në Gjermani juria u hoq në vitin 1924 nën sundimin e Republikës së Weimarit dhe u zëvendësua me gjyqtarë profesionalë që gjykonin së bashku me individë të përzgjedhur (*Schöffen)*. Një procedurë e ngjashme zbatohet dhe sot në Itali. Edhe në Francë, juria e pavarur, e parashikuar në *Code d'instruction criminnelle*, tashmë nuk ekziston. Ajo u zëvendësua në 1941[30] me një rregullim të tillë (akoma në fuqi), sipas të cilit, një juri individësh të përzgjedhur gjykon dhe vendos së bashku me 3 gjyqtarë profesionistë.

Ndryshimet në procedurën penale angleze: Hetimi dhe periudha para gjykimit

[29] Rasti më i famshëm është ai i Roland Dumas, ish ministër dhe mik i ngushtë i Presidentit Mittterrand, i cili, pas hetimeve të gjata, në Maj të vitit 2001 u dënua me 2 vjet burgim për vjedhjen nga arka e kompanisë shtetërore të Naftës, të 8000.000 frangave franceze. *Le Monde,* 31 Maj 2001.

[30] R. Merle and A.Vitu, *Traité de droit criminel* (4the edn, Paris, 1989), pp 523.

Që nga fundi i shekullit të 18, procedura penale angleze i është nënshtruar një sërë ndryshimesh të cilat ishin po aq të rëndësishme sa ato që ndodhën në kontinent. Për këto ndryshime nuk pati as revolucion politik e as një kod të ri procedure.

Ndryshimi i parë kishte të bënte me mjetet që përdoreshin për kryerjen e hetimeve dhe mënyrën se si ato silleshin para gjykatave. Në shekullin e 18 Anglia nuk kishte as polici profesionale e as prokuror dhe, në mungesë të të dyve, zbatimi i legjislacioni penal lihej në duart e privatëve. Në një numër të vogël çështjesh politike të bujshme, apo vrasjeve, ndjekja penale kryhej nga organe shtetërore si prokurori i përgjithshëm apo zëvendësi i tij. Për të gjitha veprat e tjera penale ndjekja kryhej nga palët private: viktima ose familjarët e tij, e në raste të veçanta, dhe persona të tjerë që shpresonin të përfitonin shpërblim. Ndonjëherë ndihmoheshin nga magjistratë, pjesë e funksionit të të cilëve, në atë kohë, ishte mbledhja e provave dhe arrestimi i të dyshuarve. Në raste revoltash mbështeteshin edhe nga ushtria. Në këtë pikë të historisë, mund të thuhet se praktikisht zbatimi i legjislacionit penal ishte në duar e shtetasve dhe jo organeve shtetërore.

Që në fillimet e shekullit të 19 u vu re se ky lloj sistemi antik nuk ishte në gjendje të përballonte urbanizimin dhe kriminalitetin në rritje. Nevoja kërkonte krijimin e një force policore profesionale, ashtu siç ekzistonin në Francë dhe vende të tjera të Europës kontinentale. Pavarësisht kësaj, në Angli, ideja e krijimit të një force policore profesionale hasi në rezistencë të fortë nga ata individë që e shihnin si shqetësim atë që kishte ndodhur në Francë nën pushtetin e Burbonëve dhe Napoleonit. Ata i konsideronin policinë profesionale dhe prokurorët si forma diktatoriale dhe tiranie, të cilat do të minonin liritë civile dhe do të kthenin vendin në një shtet policor.[31]

Kjo rezistencë u superua dhe ligjet e nxjerra nga 1829 deri 1856 krijuan një polici profesionale për të gjitha pjesët e Anglisë dhe Uellsit. Megjithatë, këto forca policore kishin mjaft ndryshime nga homologët e tyre në Europën kontinentale. Së pari, organizimi i tyre ishte lokal, me përjashtim të Policisë Metropolitane, dhe nuk ishin në drejtimin direkt të qeverisë. Së dyti, ata nuk operonin nën drejtimin e prokurorit, sepse në këtë periudhë të historisë së Anglisë, nuk kishte prokuror. Si rrjedhojë, kur kjo polici e krijuar kapte kriminelët, ata i ndiqnin vetë penalisht, dhe veprimet e tyre konsideroheshin jo si veprime të agjentëve shtetërorë, por si veprime të "shtetasve".

Sigurisht që ky sistem kishte shumë dizavantazhe. Në një përpjekje për t'i shmangur këto, në 1879 u krijua zyra e Drejtorit të Prokurorisë, megjithëse në këtë kohë si dhe deri 100 vjet më vonë, ai nuk drejtonte ndjekjen penale, por luante një rol thjesht udhëheqës dhe këshillues për policinë. Në 1985 u krijua Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës *(Crown Prosecution Service),* si organ i centralizuar i përbërë nga prokurorë, të cilët operonin nën urdhrat e Drejtorit të Prokurorisë, i cili vetë vepronte nën mbikëqyrjen e Prokurorit të Përgjithshëm. Funksioni kryesor i Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës

[31] L.Radzinowicz, *A history of English criminal law* (5 vols, London, 1948-56), Vol.III; D.Hay and F.Snyder, *Policing and prosecution in Britan*, 1750-1850, Oxford, (1989).

ishte vazhdimi i ndjekjes penale që policia kishte iniciuar, duke vendosur vazhdimin e hetimeve ose ndërprerjen e tyre.

Futja në sistemin anglez e policisë profesionale dhe prokurorëve çoi në një ndryshim tjetër të rëndësishëm. Tradicionalisht qendra e sistemit anglez të procedurës penale ishte gjyqi. Në parim, vendimet më të rëndësishme merreshin gjatë gjykimit. Krijimi i një policie profesionale dhe prokurorisë ndikoi në rregullimin e një faze po aq të rëndësishme, atë të "para gjykimit"[32].

Në periudhën kur hetimi dhe ndjekja penale kryhej nga shtetasit, ligji u jepte atyre shumë pak pushtet. Edhe ai pushtet që mund të kishin ishte i pamjaftueshëm në praktikë aq sa, shumë shpesh, me qëllim që të kryenin punën e tyre, policët e tejkalonin këtë pushtet. Kur policia mblidhte provat përmes tejkalimit të pushtetit, që u ishte ngarkuar, gjykata tentonte të dënonte thyerjen e këtyre rregullave. Si rrjedhojë e pakënaqësive të krijuara, në vitin 1984 Parlamenti miratoi Aktin mbi Policinë dhe Evidencën Penale, akt i cili kodifikoi menjëherë pushtetin policor duke e zgjeruar atë, duke u dhënë në veçanti pushtetin që në Francë njihej si *garde à vue*, pushtet i cili lejonte ndalimin e të dyshuarve dhe marrjen e tyre në pyetje në rajonin e policisë. Në momentin kur policisë iu dhanë "mjetet ligjore për kryerjen e detyrës së tyre", gjykatat filluan të marrin seriozisht kufizimin e pushtetit policor, duke përcaktuar masa specifike për mos pranimin e provave të marra në tejkalim të këtij pushteti.

Tashmë faza e gjykimit nuk ishte më pika kyçe e procedurës penale angleze, gjatë së cilës merreshin vendimet më të rëndësishme. Për shumë vite gjyqi kishte qenë kyç, pasi shumë çështje, të lehta ose të vështira, përfundonin në një seancë dëgjimore në sallën e gjyqit. Megjithëse në gjykim çështja duhej të provohej përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, provat e nevojshme për fillimin e ndjekjes penale ishin minimale. Me futjen e policisë profesionale dhe prokurorit, filloi gradualisht të pranohet se ishte detyrë e këtyre organeve të eliminonin çështjet që nuk kishin të dhëna të mjaftueshme për fillimin e procedimit penal, si dhe të ndiqnin ato për të cilat kishte evidenca të forta, pavarësisht se procedimi mund të mos ishte në "interes të publikut". Si rrjedhojë, shumë çështje nuk përfundonin më në gjykata. Ky ndryshim solli krijimin e rregullave të rëndësishme mbi çështje të tilla si: ushtrimi i ndjekjes penale si dhe shmangia nga përfundimi në gjykata i disa çështjeve përmes "paralajmërimit" të kundërvajtësve nga policia në vend të procedimit penal.

Në këto dy aspekte, procedura penale angleze është pak a shumë e ngjashme me atë kontinentale, ku faza "para gjykimit" ka ekzistuar me kohë dhe ku vetëm çështjet që kishin më shumë shanse në dënimin e të pandehurit, mund t'i paraqiten gjykatës për të vendosur.

[32] *Pre trial phase*, ose e njohur në legjislacionin penal shqiptar si faza e hetimeve paraprake.

Procedura penale angleze - ndryshimet në gjykim

Në mesin e shekullit të 18 faza e hetimeve paraprake pësoi disa ndryshime themelore.[33] Në 1750 pothuajse çdo çështje gjykohej nga një juri, ndërkohë që institutet e "pranimit të fajësisë" dhe "gjykimit të shkurtuar" ishin të panjohura. Megjithatë, juria e asaj kohe ishte shumë e ndryshme nga e sotmja. Nuk kishte rregulla mbi marrjen e provës, madje, në shumicën e rasteve, nuk kishte juristë as për mbrojtjen dhe as për ndjekjen penale. Në rastet e krimeve, i akuzuari nuk lejohej të kishte të tillë. Ai nuk kishte mbrojtës edhe në rastet kur mund të merrte një. Shtetasit, të cilët ishin ata që në atë kohë çonin çështjen para gjykatës, mungonin gjithashtu gjatë gjykimit. Si rrjedhojë, gjykimi me juri ishte një gjykim i shkurtër, në të cilin rolin kryesor e luante gjyqtari. Kjo mënyrë, në fakt, është e ngjashme me mënyrën se si gjykimet e shkurtuara trajtoheshin deri vonë në gjykatat angleze. Ndihma ligjore ishte pothuajse e panjohur. I vetmi ndryshim në shekullin e 18 ishte fakti, se gjyqtarët nuk jepnin më dënime me vdekje. Megjithatë, që nga shekulli i 18 e këtej, gjyqtarët filluan të shqetësoheshin gjithnjë e më shumë për gabimet në dhënien e drejtësisë.

Ashtu siç shpjegon dhe historiani ligjor John Langbein: "Në dekadat e para të shekullit të 18 gjyqtarët ishin të mendimit se sistemi i tyre funksiononte siç duhej si dhe krenoheshin për numrin e madh të çështjeve që gjykonin. Diku nga fundi i shekullit të 18 gjyqtarët filluan të kishin dyshime lidhur me problemet që mund të ekzistonin në procesin penal, megjithëse nuk dihet saktësisht se kur lindën këto dyshime si dhe pse.[34]

Ndjekja penale dhe dënimi i të dyshuarve bëhej nga një numër individësh joprofesionalë, të cilët mund të bënin abuzime të shumta. Një ndër shkaqet e këtyre abuzimeve konsistonte në dhënien e shpërblimeve për marrjen e informacioneve lidhur me kryerjen e veprës penale.[35]

Gjykatat filluan të pranonin avokatët mbrojtës gjatë gjykimit të çështjes. Qëllimi fillestar ishte dhënia e ndihmës ndaj të akuzuarit për ekzaminim e provave të paraqitura nga ndjekja penale. Ndërkohë, vetë gjykatat filluan të krijojnë rregulla mbi evidencën me qëllim që të parandalonin sa më shumë që të ishte e mundur dënimin e të pafajshëmve.

Si rrjedhojë e kësaj, në shekullin e 19-të, veprimtaria e gjykatave në vendimmarrje u ngadalësua shumë. Me qëllim që të mos cenohej dhënia e drejtësisë, u ndërmorën dy hapa shumë të rëndësishëm: Nga njëra anë, Parlamenti miratoi një sërë

[33] J.H.Langbein, *The criminal trial before the lawyers* (1978) 45 *University of Chicago Law Review* 263; *Shaping the eighteenth century criminal trial: a view from Ryder sources* (1983) 50 University of Chicago Law Review 1; T*he prosecutorial origins of defense council in the eighteenth century* (1999), 58 Cambridge Law Journal, 314.

[34] ibid

[35] Një ndër çështjet më të bujshme ishte çështja Macdaniel. Macdaniel dhe shokët e tij përfitonin të ardhura përmes akuzimit të padrejtë të individëve për vjedhje. Si rrjedhojë e kësaj shumë persona të pafajshëm u dënuan me vjedhje dhe u ekzekutuan.

aktesh, të cilët nxitën përdorimin e gjykimit të shkurtuar. Në fillim gjyqtarët ishin skeptikë ndaj pranimit të fajit *(guilty pleas)*, pasi nuk pranonin dënimin e të pandehurve pa parë e shqyrtuar provat. Me kalimin e kohës filluan ta pranojnë gjithnjë e më shumë si pjesë të gjykimit, duke krijuar madje dhe mjete të tilla si "dhënia e një dënimi më të lehtë" për ata që pranonin kryerjen e veprës penale. Kjo çoi në uljen e numrit të çështjeve që dëgjoheshin nga juria. Në ditët e sotme vetëm 1-2 % e çështjeve përfundojnë në këtë mënyrë. Sot, gjykimi i shkurtuar shoqërohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

E gjithë kjo ka ndikuar në sistemin anglez të dhënies së drejtësisë në atë mënyrë që, dhënia e vendimit tashmë mbështetet në evidencën e shkruar e shumë pak në evidencën e dhënë gojarisht. Sigurisht, ekziston dhe marrja e provave gojarisht, megjithatë, në rastet e pranimit të fajësisë, gjykata merr vendimin bazuar në evidencën e shkruar, p.sh. në pohimet e marra dëshmitarëve me shkrim nga organet policore.

Historiku i Procedurës Penale në Shqipëri

Edhe në Shqipëri, në kohët e hershme, procedimi penal ka ndjekur pak a shumë të njëjtat praktika si në vendet e tjera të Europës, me disa ndryshime e veçori që lidhen kryesisht me ndikimin e pushtimeve të huaja. Në shekujt VII-V p.e.s. u krijuan kushtet për lindjen e formacioneve shtetërore, të cilat u zhvilluan gradualisht.

Në shekullin IV, në shtetin ilir, krahas pushtetit të mbretërve, vepronte dhe e drejta zakonore e lashtë, ose "Kanuni i vjetër". Pushtuesit romakë ngritën gjyqet e tyre, por populli nuk i njohu ato dhe vazhdoi të zbatonte normat zakonore edhe për zgjidhjen e konflikteve gjyqësore. E njëjta gjë ndodhi dhe gjatë pushtimit otoman. Kanunet përbënin tërësi normash të pashkruara, të zbatueshme në krahina të caktuara.[36]

Përgjithësisht, kanunet tek ne përbënin vendime, marrëveshje a besëlidhje, norma të pashkruara ose të shkruara të së drejtës zakonore, të cilat vepronin brenda një katundi, krahine, e, në raste të veçanta, dhe në shkallë ndërkrahinore. Ato shënuan një etapë të re në zhvillimin e të drejtës zakonore shqiptare, atë të kalimit nga e drejta zakonore e pashkruar në atë të shkruar. Zhvillimi i marrëdhënieve sociale të kohës çoi në krijimin e normave të reja, të cilat u përfshinë në kanunet e shkruara. Këto kanune çuan në rregullimin, në një stad tjetër, të marrëdhënieve shoqërore në krahinat malore shqiptare.

Në bazë të kanuneve funksionet gjyqësore i kryenin gjyqet e pleqve, të formuar nga njerëz të shquar për njohjen e zakoneve. Ata kishin të drejtë të merrnin vendime zakonore dhe të jepnin disa dënime, me përjashtim të atyre të rënda, për të cilat kërkohej pëlqimi i krerëve dhe i Kuvendit.

[36] Halim Islami, *Demokratizimi i legjislacionit penal*, Shtëpia Botuese "Luarasi" (2000), 10.

Gjyqi i pleqve vihej në lëvizje me kërkesën e të dëmtuarit. Në rastin e krimeve të pazbuluara ndihmonte dhe fshati. Hetime për fajësinë e të akuzuarit bënin edhe pjesëtarët e porotës ose garantet për t'u siguruar për ndershmërinë dhe sinqeritetin e të akuzuarit. Kur autori kapej në flagrancë, i dëmtuari kishte të drejtë ta lidhë atë dhe t'ua dorëzonte pleqve. Në këtë rast nuk kërkoheshin prova të tjera.

Normat kanunore parashikonin dhe figurën e një hetuesi të caktuar nga palët, për zbulimin e veprave penale.[37] Ai kishte të drejtë të grumbullonte prova dhe t'i parashtronte ato në gjyqin e pleqve. Para se të fillonte gjykimi palët detyroheshin të dorëzonin sende të çmuara për të treguar nënshtrimin ndaj vendimit të gjyqit. I dëmtuari kishte të drejtë ta tërhiqte akuzën në çdo fazë të gjykimit. Kur arrihej pajtimi bëheshin gosti nga të dy palët.

Dënimi përcaktohej nga rëndësia e veprës e mund të ishte gjobë, dëbim, djegie e shtëpisë, shkatërrim i pasurisë ose dënim me vdekje. Kur vendimi i gjyqit nuk zbatohej vullnetarisht, Mbledhja e Kuvendit e zbatonte atë forcërisht, duke shtuar masën e dënimit, deri në dënim me vdekje. Vendimet e gjyqit të pleqve ishin të paankimueshëm.[38]

Në periudhën e Skënderbeut kanë vepruar paralelisht disa sisteme të drejtash. Krahas të drejtës laike, të krijuar nga pushteti qendror, ekzistonin e drejta zakonore dhe e drejta kishtare. Bujarët feudalë gjykoheshin nga kryetari i shtetit. Ky i fundit kishte të drejtën e faljes. Fshatarët gjykoheshin nga bujari feudal. Me kalimin e kohës kompetencat gjyqësore të bujarëve feudalë u kaluan qeveritarëve të Skënderbeut.

Pas pushtimit turk u vendos sistemi gjyqësor fetar i sheriatit. Në qytete dhe fshatrat pranë tyre u vendosën gjykatat e kadiut, që vepronin sipas rregullave të Kuranit, të detyrueshme për çdo mysliman. Procedimi penal fillonte vetëm me kërkesën e të dëmtuarit, me përjashtim të krimeve kundër pushtetit turk.[39] Procedura e gjykimit ishte e thjeshtë, pa formalitetet e procedurës perëndimore. Seancat zhvilloheshin në territorin e xhamisë dhe aty ekzekutoheshin dhe vendimet, me përjashtim të dënimit me vdekje ose gjymtim. Prova të rëndësishme konsideroheshin shkresat, dëshmia dhe pohimi i të akuzuarit. Beja lejohej kur nuk kishte prova për të rrëzuar një prezumim në dobi të palës tjetër. Kur i akuzuari e pohonte fajin nuk merreshin prova të tjera. Beja zbatohej vetëm për të akuzuarit me vjedhje. Ajo bëhej në xhami ose në ndonjë vend tjetër të shenjtë.

Në vitin 1879 u krijua Kodi i Procedurës Penale Otomane, i cili kishte për model atë të Napoleonit. Ky Kod përshtati sistemin procedural të përzier dhe sanksionoi parimet e organizimit dhe procedurës gjyqësore franceze të ndarjes së pushteteve, të patundshmërisë së gjyqtarëve, barazisë së palëve, mbrojtjes me avokat, gjykimit me dyer të hapura, oralitetit, çmuarjes së provave sipas bindjes së brendshme të gjyqtarit, etj. Ai u

[37] ibid Në Kanunin e Lek Dukagjinit ai quhej "këpucari", kurse në atë të Labërisë "këpucëgrisuri".
[38] ibid 11.
[39] ibid 12.

zbatua në Shqipëri, jo vetëm nga gjykatat shtetërore turke, por dhe nga gjykatat shqiptare të krijuara pas shpalljes së Pavarësisë.

Sipas këtij Kodi, ndjekja penale ushtrohej nga prokurori, ndërsa hetimet kryheshin nga gjyqtari hetues, vetë ose përmes policisë gjyqësore. Në përfundim të hetimeve, gjyqtari hetues ia dërgonte çështjen prokurorit, i cili vendoste, sipas rastit, kalimin në gjykatë ose pushimin e saj. Kundravajtjet dhe deliktet gjykoheshin nga një gjyqtar, kurse krimet me trup gjykues. Vendimi i gjykatës për kundravajtjet ishte i formës së prerë, ndërsa për deliktet lejohej ankimi në gjykatën e apelit.

Ky kod hodhi hapat e parë në avokati, me qëllim që t'u vinte në ndihmë personave të akuzuar për krime. Avokatët nuk kishin përgatitje juridike e përvojë profesionale. Ata shpesh herë spekulonin me hallet e popullit.[40]

Përpjekjet e para për riorganizimin e drejtësisë u pasqyruan në kodin e Zharisë (Jurisë), i cili nuk pati jetë të gjatë.[41] Me shpalljen e pavarësisë kombëtare dhe krijimin e shtetit të pavarur shqiptar (28 Nëntor 1912), qeveria e përkohshme, e kryesuar nga Ismail Qemali, i kushtoi kujdes të veçantë krijimit të bazës juridike të saj, si dhe organizimit të administratës civile e gjyqësore sipas orientimit perëndimor. Në kushte tepër të vështira, qeveria nxori Kanunin e Jurisë, më 10 Maj 1913, si aktin më të rëndësishëm juridik për organizimin e gjykatave shtetërore. Kanuni i Jurisë ishte menduar të zbatohej për të gjithë shqiptarët, por copëtimi i kombit shqiptar (1913) në gjashtë shtete e bëri të pamundur realizimin e këtij qëllimi.[42] Në parathënien e tij jepet nocioni i veprës penale, si veprim që prek të drejtat e njeriut, jetën, lirinë dhe pronën e tij. Rëndësi të veçantë paraqet dhe ndarja e fajeve (veprave penale) në tre kategori, sipas modelit perëndimor: në dëme (kundravajtje), faje të vështira (delikte) dhe faje të shëmtimeve (krime).[43] Në Kanun realizohej lidhja organike e kuptimit të fajit (veprës penale) me mënyrën e gjykimit të tij, pra lidhja e të drejtës penale me atë të procedurës penale dhe të organizimit gjyqësor. Kanuni i Jurisë u orientua nga legjislacioni demokratik i shteteve perëndimore për organizimin gjyqësor, pranoi sistemin e jurisë dhe shfuqizoi sistemin osman të kadinjve.

Një ndër masat e para të shtetit të ri shqiptar ishte organizimi i gjyqeve (1913), sipas të cilave u krijuan gjykatat e shkallës së parë të nënprefekturave, që ishin kompetente për gjykimin e çështjeve civile dhe kundravajtjeve e delikteve, ndërsa krimet gjykoheshin nga juria, e cila u zbatua në një çështje të Elbasanit dhe më vonë u suprimua, sepse populli ynë nuk ishte i përgatitur për të plotësuar qëllimet e gjyqit me juri.

Me dekretin e datës 4 Qershor 1914 u bënë disa ndryshime të vogla të organizimit gjyqësor të vitit 1913. Ndërkohë vepronte dhe e drejta zakonore penale shqiptare, sidomos për vrasjen dhe gjakmarrjen. Më 4 Qershor 1914 u vu në zbatim ligji "Për

[40] ibid 16.
[41] ibid 14.
[42] Ismet Elezi, Ela Elezi, *Historia e të Drejtës Penale*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar (2010), 112.
[43] ibid, 113.

gjykatat e drejtësisë në Shqipëri", sipas të cilit u krijuan gjyqet fillore, të apelit dhe të diktimit.

Me ardhjen në fuqi të Esat Pashës, në vitin 1915, hyri në fuqi një organizim tjetër i cili, përveç gjykatave të shkallës, parashikonte dhe një gjyq, pa marrë parasysh ligjin e miratuar nga Kuvendi i Vlorës pas shpalljes së pavarësisë kombëtare. Pas dëbimit të Esat Pashës nga ushtritë austro-hungareze, u organizuan gjyqet, duke vënë në zbatim ligjin e paqit më 1916, dhe formuan gjyqin e shkallës I në prefektura dhe gjyqin e apelit në Shkodër. Gjyqet ndëshkimore (penale) shqyrtoheshin prej gjykatave ushtarake, sipas rregullave të luftës.[44]

Pas pushtimit të disa krahinave jugore nga Italia, gjyqet u shkatërruan dhe nuk vepronte as gjykata civile, as gjykata penale. Me 16 Maj 1919, u vu në zbatim, për qarqet e Beratit, Elbasanit, Durrësit e Shkodrës, një organizim i gjykatave pajtuese dhe gjykatave të diktimit. Në zonat malore vazhdonte të zbatohej e drejta zakonore penale dhe gjyqet e pleqve.

Pas Kongresit të Lushnjës u krijua një sistem i ri gjyqësor. Në 1925 sistemi i ri gjyqësor iu përshtat ndarjes administrative. Gjykatat u ndanë në dy degë: civile dhe penale. Avokatia u organizua në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Pushtimi fashist ruajti strukturat gjyqësore ekzistuese, megjithatë u vu re krijimi i gjyqeve partizane, të cilët shqyrtonin lloje të caktuara veprash penale. Ata nuk ndiqnin një procedurë të caktuar, por zbatonin udhëzimet e lëshuara nga komandat ushtarake. Sipas këtyre udhëzimeve, gjyqtari nuk ishte i lidhur me provat, por jepte vendimin sipas gjykimit të lirë. Shumë nga këto procedura u ruajtën dhe pas luftës.

Në 1953 u miratua Kodi i Procedurës Penale, i cili veproi deri në prill të vitit 1980. Në vitin 1967 u bë një hap i madh prapa me heqjen e avokatisë. Avokatia u konsiderua si një organ i dëmshëm e i panevojshëm, që nuk ndihmonte, por pengonte zgjidhjen e drejtë dhe të shpejtë të çështjeve. Për të justifikuar këtë u krijuan zyrat e ndihmës juridike, si hallka shtetërore pranë çdo gjykate rrethi. Të akuzuarit u lanë pa mbrojtës me arsyetimin se ata i mbron gjykata dhe prokurori i paanshëm. Shkëputja në 1976-ën e hetuesisë nga prokuroria çoi në uljen e nivelit të tyre profesional dhe shtimin e shkeljeve të ligjit procedural gjatë hetimeve paraprake. Përmes KPP të vitit 1979 prokurorit iu hoqën disa kompetenca, duke i lënë vetëm të drejtën e miratimit të arrestit dhe kontrollit të banesës. I pandehuri kishte të drejtën e protestës ndaj shkeljeve të hetuesisë, e cila shqyrtohej po nga organi i hetuesisë. [45]

[44] idid.
[45] Halim Islami, *Demokratizimi i legjislacionit penal*, Shtëpia Botuese "Luarasi" (2000), 23.

Edhe KPP i 1979 sanksionoi parimet "revolucionare" të legjislacionit procedural penal e nuk njohu, as formalisht, parimet demokratike të prezumimit të pafajësisë, barazisë së palëve, oralitetit, kontradiktoritetit, etj.[46]

Ndryshimet e mëtejshme të KPP synuan ta përmirësojnë atë. Mbrojtja me avokat u rifut, por me disa kufizime në fazën e hetimeve paraprake, ndërsa më 1991 u miratua ligji "Për avokatinë"[47].

Në vitin 1995 u miratuan Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale që janë sot në fuqi. [48]

Ndryshimet e mëtejshme të këtyre Kodeve, të bëra deri në ditët e sotme, kanë tentuar rregullimin e boshllëqeve dhe përmirësimin e tyre, për t'i përafruar ato, gjithnjë e më shumë, me standardet ndërkombëtare.

[46] ibid
[47] Ligj nr. 7541, date 18.12.1991 "Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë".
[48] Ligj nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" dhe ligj nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penal të Republikës së Shqipërisë".

KAPITULLI II

E DREJTA PËR TU MBROJTUR DHE ROLI I AVOKATIT NË DHËNIEN E DREJTËSISË

Zhvillimi historik i mbrojtjes

Që nga koha e revolucionit francez, procedurat penale, si ajo angleze, ashtu dhe ajo kontinentale, kanë hasur pak a shumë në të njëjtat probleme dhe kanë arritur në pothuajse të njëjtat zgjidhje. Një ndër aspektet e rëndësishme ka qenë dhe përmirësimi i pozicionit të mbrojtjes. Kështu, u bënë hapa përpara për t'i dhënë të akuzuarit mundësinë e aksesit për një përfaqësim ligjor apo këshillim më të mirë.

Një ndryshim i rëndësishëm në procedurën penale angleze ishte shfuqizimi i rregullit, sipas të cilit, personat e akuzuar për krime të rënda nuk kishin të drejtën e një avokati mbrojtës gjatë gjykimit të çështjes në gjyq. Ky rregull u shfuqizua përfundimisht nga Parlamenti në vitin 1836. Çështje shumë e diskutueshme në Europën Lindore ka qenë dhënia e ndihmës ligjore të dyshuarit që në fazat e para të hetimit, e pikërisht, që në momentin e marrjes në pyetje nga organet policore. Gjermania e njohu këtë të drejtë në vitin 1964, Italia në 1971, Anglia dhe Uellsi në 1984, Franca në 1993. Përveç kësaj ka pasur dhe veprime të tjera pozitive përsa i përket të drejtës së të akuzuarit për t'u informuar mbi akuzën. Kështu, në Angli u morën një sërë masash, që lejonin mbrojtjen të njihej me materialet e dosjes së prokurorit, veprime të cilat më pas çuan në miratimin e Ligjit mbi Procedurën Penale dhe Hetimin në vitin 1996. Po të njëjtat masa u morën dhe në Francë, duke i lejuar avokatit mbrojtës më shumë të drejta në aksesin e dosjes së prokurorit.

Garantimi i këtyre të drejtave ka ndikuar në rritjen e numrit të çështjeve të paraqitura para gjykatave e, për rrjedhojë, dhe në vonesa në dhënien e drejtësisë. Për këtë shkak, shumë vende janë detyruar të hartojnë politika për zgjidhjen e këtyre problemeve. Kështu, disa vende kanë bërë një ndarje të çështjeve, sipas seriozitetit të veprës penale të kryer. Në vende të tjera shumë veprime të kundraligjshme nuk përfundojnë fare në gjykatë. Shpesh here shkelësit e rregullave shoqërore ose ligjeve mund të "dënohen" me një "paralajmërim" *(warning)*, duke u bërë të ditur, se në rast përsëritjeje të veprës penale, do të ketë procedim penal të tyre. Të tjera vende kanë gjetur mënyrat e tyre për zgjidhjen e problemit të rritjes së numrit të çështjeve të paraqitura para gjykatave si dhe për reduktimin sa më shumë të kohës së nevojshme për dhënien e vendimit nga gjykata.

Pozita e mbrojtësit shqiptar ndryshoi pas luftës së dytë botërore me vendosjen e sistemit socialist të tipit sovjetik, gjatë të cilit roli i mbrojtësit u dobësua aq shumë, saqë u

quajt gati i padobishëm e, në ndonjë rast, edhe i dëmshëm. Shqipëria shkoi dhe më tej në këtë proces regresiv, duke e hequr dhe nga ligji institucionin e mbrojtjes. Për gati 25 vjet procedimi penal u zbatua pa praninë e mbrojtësit, duke u kthyer në një mjet represioni për realizimin në praktikë të luftës së klasave, duke proceduar e duke dënuar kundërshtarët politikë të shtetit totalitar.

Në vitin 1990, në prag të përmbysjes së shtetit totalitar, u rivendos institucioni i mbrojtjes: Avokatia. Por, të drejtat e mbrojtësit në procesin penal u pranuan të cunguara, duke mos u lejuar pjesëmarrja e tij gjatë fazës së hetimit. Me ligjin "Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë"[49] u bënë përmirësime të rëndësishme, por jo të nivelit bashkëkohor. Të drejtat e mbrojtësit dhe veçanërisht raportet e tij me të akuzuarin u përcaktuan saktë vetëm me ligjin e ri "Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë"[50] dhe Kodin e ri të Procedurës Penale.[51]

Sigurisht që, luftimi i krimit nga njëra anë, si dhe ruajtja e të drejtave të njeriut nga ana tjetër, janë të vështira të garantohen së bashku. Si rrjedhojë, shumë vende shpesh herë ndërmarrin reforma legjislative, në mënyrë që të përshtatin sa më mirë të jetë e mundur këto dy aspekte; uljen e kriminalitetit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

E drejta për tu mbrojtur dhe roli i avokatit në ruajtjen e garantimin e të drejtave të të akuzuarit

E drejta për tu mbrojtur njihet dhe garantohet nga një numër shumë i madh aktesh kombëtare e ndërkombëtare. Amendamenti i 6-të i Kushtetutës Amerikane, Neni 6 i KEDNJ, neni 31/"ç" i Kushtetutës shqiptare garantojnë të drejtën e kujtdo, që, gjatë procesit penal ndaj tij, të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas kur nuk ka mjete ligjore të mjaftueshme.

Nga të gjitha të drejtat që një i akuzuar ka, e drejta për tu përfaqësuar nga një mbrojtës është më e rëndësishmja, pasi ndikon drejtpërsëdrejti në aftësinë e të akuzuarit për të mbrojtur të drejtat e tjera që mund të ketë.[52]

Në jurisprudencën e saj, GJEDNJ ka theksuar se, ndërsa neni 6/3 i KEDNJ i jep të drejtën çdokujt, që është akuzuar për një vepër penale, të mbrohet vetë ose nëpërmjet një mbrojtësi, nuk specifikon mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejte. KEDNJ u lë shteteve anëtare të bëjnë zgjedhjen e mjeteve, që do të sigurojnë, brenda sistemit të tyre gjyqësor, të drejtën e mbrojtjes. GJEDNJ kontrollon nëse metoda e zgjedhur nga shtetet, për

[49] ibid (n 47).
[50] Ligj nr. 7827, datë 31.05.1994 "Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë".
[51] Halim Islami, *Demokratizimi i legjislacionit penal*, Shtëpia Botuese "Luarasi" (2000), 136.
[52] *United States v. Cronic*, 466 U.S. 648, 654 (1984).

garantimin e kësaj të drejte, është e pajtueshme ose jo me kërkesat e gjykimit të drejtë. KEDNJ ka për qëllim që të garantojë të drejta që janë praktike dhe efektive e jo iluzore dhe, thjesht caktimi i mbrojtësit, nuk e garanton në vetvete efektivitetin e asistencës ligjore që i nevojitet të akuzuarit gjatë procesit penal. GJEDNJ ka theksuar se as dispozita dhe as fryma e nenit 6 të KEDNJ nuk e ndalon një person të heqë dorë me vullnetin e tij të lirë, duke shprehur haptazi ose me heshtje, të drejtën për të pasur një proces të drejtë. Megjithatë, në një rast të tillë i akuzuari duhet të përfitojë, në mënyrë të padiskutueshme nga garancitë minimale, pa të cilat një proces penal nuk mund të konsiderohet në përputhje me qëllimet e Konventës. Gjithashtu, në raste të tilla nuk duhet mënjanuar interesi publik për të bërë drejtësi në përputhje me standardet.[53]

E drejta e mbrojtjes duhet parë në fazën e hetimeve në dy aspekte: në të drejtën e mbrojtjes që ka/duhet të ketë personi i dyshuar për kryerjen e veprës penale dhe e drejta e mbrojtjes pas komunikimit të akuzës. Personi i dyshuar nuk mund të merret në pyetje pa iu siguruar mbrojtja ose asistenca nga një mbrojtës i kualifikuar.[54] Që në momentin e thirrjes së personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, ky ka të drejtën të kërkojë asistencën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij ose, nëse nuk ka mundësi, të një mbrojtësi të caktuar nga organi procedues.[55]

GJK shqiptare, në jurisprudencën e saj, është shprehur lidhur me interesin publik për të bërë drejtësi se: "Interesat e drejtësisë kërkojnë detyrimisht realizimin e mbrojtjes, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht, të të akuzuarit që gjykohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, në të cilin, ndër të tjera kërkohet një rëndim i dukshëm i pozitës së tij, në krahasim me vendimin e dhënë për këtë çështje nga gjykata e apelit. Vlerësimi, nëse ndodhemi para interesit të drejtësisë ose jo në gjykimin që do të zhvillohet në Gjykatën e Lartë, varet sipas rastit nga natyra e çështjes, nga subjekti që ka paraqitur rekursin dhe kompleksiteti apo vështirësia e problemeve ligjore të parashtruara në të, nga lloji dhe masa e dënimit që rrezikon të jepet ndaj të akuzuarit në krahasim me vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta, etj. Ajo varet gjithashtu edhe nga vendi, roli dhe detyrat që kryen një gjykatë e tillë në çdo vend të veçantë. Në këtë kuadër, theksohet se ndihma ligjore është veçanërisht e rëndësishme në vendet ku e drejta e aksesit në këto gjykata mund të realizohet vetëm nëpërmjet avokatit mbrojtës ose legjislacioni procedural respektiv nuk parashikon mundësinë e kundërrekursit nga ana e palës kundërshtare".[56]

Lidhur me caktimin e mbrojtësit nga gjykata, kur i pandehuri dëshiron të mbrohet prej tij, por nuk ka mundësi ta zgjedhë vetë, KPP shqiptare ia njeh mundësinë nëpërmjet nenit 6/2 të tij dhe nenit 256 kur personi nuk është marrë akoma i pandehur. Ajo që

[53] Arta Vorpsi, *Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë,* Maluka (2011), 161.
[54] ibid 162.
[55] ibid 163.
[56] Vendim nr.16, datë 08.06.2006 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.

mbetet për tu parë është mënyra e ushtrimit efektiv të mbrojtjes, gjë që mund të verifikohet gjatë zhvillimit të procesit.[57]

Parimi i shtetit të së drejtës nënkupton një angazhim nga ana e avokatit në konceptin e drejtësisë së barabartë për të gjithë, brenda një sistemi të hapur dhe të paanshëm. Që institucionet gjyqësore të funksionojnë në mënyrë efektive, ato duhet të ngjallin respektin e publikut. Për shkak të ndryshimeve në marrëdhëniet njerëzore dhe të metave në funksionimin e institucioneve, për përmirësimin e administrimit të drejtësisë duhet të bëhen përpjekje të vazhdueshme me qëllim ruajtjen e respektit të publikut për to.

Një rol të rëndësishëm për këtë luan dhe avokati. Ai, për shkak të përvojës, vëzhgon punimet dhe zbulon anët e forta dhe dobësitë e ligjeve, institucioneve ligjore dhe autoriteteve publike. Roli i tij është të çojë përpara dhe të kërkojë përmirësime në sistemin ligjor, por çdo kritikë e tij ose propozim duhet të bëhet *in bona fede* dhe të jetë i arsyetuar.

Roli i avokatit në garantimin e të drejtave të të akuzuarit

Pozicioni i mbrojtësit në komunitet dhe përgjegjësitë e tij janë më të mëdha se ato të një qytetari të thjeshtë. Avokati nuk duhet të shkelë ligjin duke këshilluar ose ndihmuar në veprimtari që janë në kundërshtim me të, dhe nuk duhet të kryejë veprime, që ulin respektin dhe besimin e publikut në sistemin juridik, pjesë e të cilit është dhe ai vetë. Avokati duhet të kujdeset që të mos dobësojë apo të prishë besimin e publikut në institucionet ligjore apo autoritetet publike përmes akteve të papërgjegjshme, akuzave për korrupsion ose anësi. Ai duhet të jetë veçanërisht i kujdesshëm në jetën publike, për shkak se të qënit avokat jep peshë dhe kredibilitet për çdo deklaratë të tij. Për të njëjtën arsye, avokati nuk duhet të ngurrojë të flasë kundër një padrejtësie.

Në çështjet penale mbrojtësi ka një rol thelbësor në administrimin e drejtësisë. Një gjykatë e strukturuar siç duhet, përpara së cilës shqyrtohet një çështje penale, duhet të shikohet si një përbërje e pandashme tre entitetesh: gjyqtari (ose, kur është rasti, juria), mbrojtësi dhe organi i ndjekjes penale.

Detyra bazë e mbrojtësit në administrimin e drejtësisë është që ai t'i shërbejë të akuzuarit, përmes realizmit të mbrojtjes. Kjo mbrojtje duhet ushtruar me kurajë e përkushtim, me qëllim që përfaqësimi të jetë cilësor dhe efektiv. Në rastet e dënimeve maksimale, ose të dënimeve me vdekje (kur është rasti), mbrojtësi duhet të bëjë përpjekje të jashtëzakonshme në emër të të akuzuarit.

Në rast se gjatë ushtrimit të mbrojtjes avokati vë re papërshtatshmëri ose padrejtësi në ligjin substancial ose procedural, ai duhet të marrë masat e nevojshme e të

[57] ibid

bëjë përpjekjet e duhura për ndreqjen e tyre. Ai duhet të mbajë parasysh se vepron si mbrojtës i të akuzuarit dhe në realizmin e saj, egoja e tij duhet lënë mënjanë.

Mbrojtësi, pavarësisht nëse i zgjedhur nga i akuzuari ose i caktuar kryesisht, duhet t'u bindet të gjitha rregullave ligjore, kodeve, vendimeve të gjykatave, rregulloreve, kodit të etikës profesionale. Ai nuk duhet, qëllimisht, të shtrembërojë faktet e paraqitura para gjykatës.

Me qëllim miradministrimin e drejtësisë, mbrojtësi duhet të shmangë vonesat ose shtyrjet pa shkak të shqyrtimit gjyqësor të çështjeve si dhe marrjen përsipër të çështjeve që kanë qëllim kryesor shtyrjen sa më shumë të shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Ai duhet të paraqesë të gjitha kërkesat ose pretendimet kur i kërkohen, duke treguar kundrejt të akuzuarit, si dhe të gjithë pjesëmarrësve në gjykim, rëndësinë e korrektesës në gjykatë. Mbrojtësi nuk duhet të marrë përsipër një numër të madh çështjesh, pasi kjo mund të ndikojë në cilësinë dhe efektivitetin e përfaqësimit e të vërë në rrezik interesat e klientit, çka mund të çojë në shkeljen e detyrimeve të tij profesionale.

Qëllimi i mbrojtësit duhet të jetë vendosja e një marrëdhënie besimi dhe konfidenciale me të akuzuarin. Avokati duhet të diskutojë me të objektivat e përfaqësimit si dhe t'i bëjë të ditur të akuzuarit rëndësinë e dhënies së të gjithë informacionit mbi faktet që ai (i akuzuari) di si dhe qëllimin e këtij informacioni: realizimi i një mbrojtjeje efektive. Shteti duhet të marrë të gjitha masat që, pavarësisht nëse i akuzuari ndodhet në dhomat e paraburgimit, në burg ose gjatë gjykimit, realizimi i komunikimit mes mbrojtësit dhe të akuzuarit të jetë konfidencial dhe diskutimet të jenë private.

Mbrojtësi ka detyrimin të paraqesë çdo problem, të ngrejë pretendime, të bëjë pyetje, pavarësisht se sa të pakëndshme mund të jenë, për të cilat ai është i mendimit se mund të ndihmojnë çështjen e klientit të tij. Pranimi i fajësisë mbrojtësit nga i akuzuari mund të vendosë kufizime mbi sjelljen e avokatit në gjykim, dhe i akuzuari duhet të jetë i vetëdijshëm për këtë. Për shembull, në qoftë se i akuzuari i pranon në mënyrë të qartë avokatit elementet faktike dhe mendore, që tregojnë për kryerjen e veprës penale nga i akuzuari, avokati, nëse është i bindur se pranimet janë të vërteta dhe vullnetare, mund të ngrejë në gjykim pretendime për juridiksionin e gjykatës, për formulimin e aktakuzës, ose për pranueshmërinë apo pamjaftueshmërinë e provave, por nuk duhet të pretendojë para gjykatës se një person tjetër ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet klienti i tij. Avokati ka të drejtë të testojë provat e dhëna prokurorisë nga secili dëshmitar dhe të argumentojë, se ato, në tërësinë e tyre, janë të pamjaftueshme për të provuar se i akuzuari është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet. Ai asnjëherë nuk duhet të heqë dorë ose braktisë të drejtat ligjore të klientit pa pëlqimin e informuar të tij.

Krahas këtyre, mbrojtësi duhet të marrë të gjitha masat e mundshme me qëllim kualifikimin e vazhdueshëm ligjor dhe rritjen e aftësive të tij profesionale. Ai duhet të jetë të gatshëm të pranojë mbrojtjen e të akuzuarit, pavarësisht se ekziston urrejtje

publike ndaj tij e pavarësisht opinionit të tij personal për krimin e kryer ose për personin e akuzuar.

Funksionet e avokatit gjatë realizimit të mbrojtjes

Shekuj më parë[58] procedura penale organizohej sipas parimit që një person i dënuar për krime serioze nuk duhej të kishte përfaqësues ligjor në gjyq, me pretendimin se "çdokush me aftësi normale të menduari mund të mbrohet shumë mirë vetë si të ishte avokati më i mirë", e se "të jesh i çiltër dhe i ndershëm nuk kërkon asnjëfarë lloj aftësie".[59]

Në ditët e sotme rëndësia e mbrojtësit, si para dhe pas gjykimit, është e padiskutueshme. Sigurisht që për të kuptuar rëndësinë e mbrojtësit në sistemin e drejtësisë penale duhen kuptuar të gjithë aktorët që marrin pjesë në dhënien e kësaj drejtësie: gjyqtari, prokurori dhe vetë avokati mbrojtës. Pa njërin prej këtyre aktorëve, dhënia e drejtësisë është e pamundur. Ajo çka vlen të mbahet gjithmonë parasysh është roli që luan secili prej tyre si dhe rëndësia e koordinimit të të tre aktorëve së bashku. Pse themi që ky koordinim është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm?

Siç dihet, veprimtaria e gjyqtarit varet nga provat e paraqitura para tij nga prokurori dhe avokati mbrojtës. Ai vetë nuk ndodhej në vendngjarje në momentin e kryerjes së krimit. Po kështu, as prokurori nuk ishte prezent në vendngjarje në momentin e kryerjes së veprës penale. Atij i duhet të mbështetet tek provat dhe dëshmitë. As avokati nuk ishte në vendngjarje në momentin e kryerjes së krimit. Atij i duhet të mbështesë e ndërtojë mbrojtjen bazuar në thëniet e klientit të tij; të akuzuarit.

Roli i avokatit në dhënien e drejtësisë është shumë i rëndësishëm. Çdo shtet synon drejt një demokracie sa më të përsosur, por, pa ndihmën e avokatëve mbrojtës, rruga drejt kësaj demokracie dhe garantimi i të drejtave të individëve do të ishte shumë i vështirë. Kështu, nëse asnjë avokat nuk do të merrte përsipër mbrojtjen e një të dyshuari për vepra penale të rënda, atëherë individit të akuzuar do i mohohej e drejta e një gjykimi të drejtë. Një gjë e tillë ndikon negativisht në të drejtat e të akuzuarve, pasi rrit mundësinë e dënimit, padrejtësisht, të individëve që në fakt nuk kanë kryer veprën për të cilën ata janë akuzuar, duke i dënuar thjesht për faktin se nuk arritën të siguronin mbrojtje.

[58] si psh. në Angli.
[59] William Hawkins, *A Treatise of the Pleas of the Crown*, Vol. 2, (1972), p. 400 (London, 2 Vols., 1716, (1721).

Roli i avokatit, sidomos në çështjet penale, është i një rëndësie të jashtëzakonshme. Aspektet kryesore të veprimtarisë së tij janë:[60]

- Avokati mbrojtës, së pari, duhet të veprojë si ***njeri i besuar*** i të akuzuarit. Ai duhet të mundohet të kuptojë situatën e të akuzuarit, dhe, deri në një farë masë, të përfshihet në këtë situatë. Kjo, jo domosdoshmërisht, nënkupton që avokat-mbrojtësi të ketë të njëjtin opinion me të akuzuarin. Shpesh herë ai është i vetmi person me të cilin i pandehuri mund të komunikojë në mënyrë konfidenciale, pa ndërhyrjen e personave të tjerë. Si rrjedhojë e përmbushjes së detyrave të tij, avokati mbrojtës duhet të ruajë sekretin.

- Detyra e tij kryesore është ajo e ***realizimit të mbrojtjes***. Avokati mbron ekskluzivisht të drejtat e klientit të tij. Ai nuk duhet të ketë asnjë interes tjetër që bie në kundërshtim me interesat e personit që ai mbron. Ai lufton kundër çdo lloj shkeljeje të të drejtave të të akuzuarit dhe qëllimi kryesor i tij është një rezultat sa më i favorshëm për klientin e tij. Ai duhet të përdorë ekspertizën e tij juridike, pa rezerva, për të mirën e klientit. Përmbushja e kësaj detyre kërkon që ai të shfrytëzojë të gjitha mundësitë mbrojtëse të lejuara me ligj për sigurimin e kësaj mbrojtjeje.

- Mbrojtësi është gjithashtu një ***përkthyes***. Roli i tij si i tillë konsiston në përkthimin, klientit të tij, të sistemit të drejtësisë penale, si dhe në interpretimin dhe paraqitjen e pikëpamjes së të pandehurit, pjesëmarrësve në sistem. Rëndësia e tij në këtë aspekt qëndron në qartësimin e fakteve apo rrethanave sipas perspektivës së të akuzuarit si dhe të bëjë pyetje për to.

Avokati i jep ndihmën e tij të akuzuarit përmes:[61]

- pranisë dhe dhënies së ndihmës ligjore në rastin e shoqërimit, ndalimit, arrestimit, gjatë procesit të hetimit, shqyrtimit gjyqësor të personave
- këshillimit ligjor për çështjen,
- përgatitjes së kërkesave për çdo fazë të procedimit e gjykimit penal të çështjes, sipas parashikimeve ligjore në fuqi,
- përgatitjes së kërkesës, ankesës, rekursit e çdo lloj tjetër kërkese drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, Gjykatës Kushtetuese, gjykatave ndërkombëtare ose çdo lloj organizmi në të cilin shteti aderon;
- veprimeve të tjera të ndihmës juridike të parashikuara në ligj/e.

Në shumë shtete të drejtat e avokatit mbrojtës burojnë direkt nga ligji. Qëllimi i këtyre të drejtave qëndron në krijimin e mundësive në mënyrë që avokati të kryejë mbrojtjen e klientit të tij, duke përmbushur detyrat e përshkruara më lart. Megjithatë, ky

[60] *Some issues on the role of the Defense Counsel*, Mikhail Wladimiroff, <http://law.case.edu/journals/JIL/Documents/%2816%29Mikhail%20Wladimiroff.pdf>, aksesuar më 07.02.2013.
[61] Agim Gjoleka, Esmeralda Gjoleka, *Avokati në procesin penal*, ALBJURIS, 9.

detyrim nuk është absolut. Detyrimi kryesor i mbrojtësit është kryerja sa më mirë e detyrës së tij profesionale.[62]

Garanci për sigurimin real të të drejtave të të akuzuarit është ndihma e kualifikuar juridike nëpërmjet mbrojtësit. Sigurimi i mbrojtjes ligjore në Shqipëri ka qenë një arritje e rëndësishme në përpjekjet e gjata e të vështira të forcave progresive për të demokratizuar procedimin penal. Roli i mbrojtësit u bë një faktor i rëndësishëm në luftën kundër padrejtësive. Mbrojtësi i bë një figurë procedurale e respektuar, duke qëndruar përballë akuzës si palë kundërshtare, e aftë për të zhvilluar një debat konstruktiv e për të ndihmuar në zgjidhjen e drejtë të çështjes.[63]

Roli i mbrojtësit në administrimin e drejtësisë.

Baza e çdo gjykimi penal është zbulimi i të vërtetës, ose, të paktën, duhet të jetë. Organi procedural ka për detyrë marrjen e të gjitha masave për zbulimin e rrethanave të ngjarjes dhe gjetjen e të vërtetës. Dëshmitarët merren në pyetje, gjithashtu, gjatë gjykimit, me qëllim zbulimin e të vërtetës. Gjyqtarët kanë për detyrë të zhvillojnë një gjykim të drejtë bazuar në rregulla procedurale dhe duke bërë interpretimin e tyre në mënyrë të tillë që të zbulohet e vërteta. I gjithë procesi gjyqësor përshkruhet si një kërkim i të vërtetës.

Por, ç'detyrime kanë mbrojtësit gjatë gjithë këtyre procedurave? A kanë dhe ata detyrimin për zbulimin e të vërtetës? Cili është roli i tij në gjykimet penale?

Mbrojtësi, në gjykimet penale ka një rol të trefishtë. Së pari, si anëtar i profesionit të ligjshëm të avokatit, përfaqëson interesat e klientit të tij. Së dyti, ai është oficer në shërbim të sistemit të drejtësisë dhe, së treti, është shtetas, që ka një përgjegjësi të veçantë për cilësinë e drejtësisë së dhënë.[64] Ky përkufizim nuk bën dallim mes fushave të ndryshme që praktikojnë mbrojtësit e as nuk u jep prioritet roleve të ndryshme të tij. Mungesa e këtij diferencimi nënkupton se të gjithë mbrojtësit, pavarësisht fushës së ligjit që ata praktikojnë, kanë një detyrim, i cili shkon përtej faktit të thjeshtë të mbrojtjes së klientit të tyre. Ata janë ruajtës të sistemit të drejtësisë dhe duhet të veprojnë si oficerë të gjykatës duke respektuar rëndësinë që ka zbulimi i të vërtetës, brenda kufijve që u

[62] Mund të thuhet gjithashtu se kryerja siç duhet e kësaj mbrojtjeje të avokatit kryhet brenda tre rretheve. Në rrethin e jashtëm qëndron detyrimi i mbrojtësit të kryeje detyrën e tij brenda kufijve ligjorë. Ky detyrim është më kryesori dhe përfshin rrethet në vazhdim. Në rrethin e mesit qëndron detyrimi i avokatit të veprojë në përputhje me rregullat e etikës profesionale. Ndërsa në rrethin e tretë qëndron morali i tij, mënyra se si ai vetë i kupton detyrime e tij. Për shkak të elementit subjektiv është e pamundur të bësh pohime lidhur me rrethin e tretë.

[63] Halim Ismali, *Demokratizimi i legjislacionit penal,* Shtëpia Botuese "Luarasi" (2000), 135.

[64] *Rregulla të Veprimtarisë Profesionale të Avokatit,* American Bar Association, Preambula.

lejohen në një sistem që bazohet në parimin e kontradiktoritetit në gjykim e që ka si qëllim kryesor dhënien e drejtësisë.

Sigurisht që, detyrimi i parë e më i rëndësishëm i mbrojtësit është t'i shërbejë klientit të tij. Në këtë mënyrë, përmes përfaqësimit të interesave të të akuzuarit, mbrojtësi përmbush detyrimin e tij ligjor; së pari, në administrimin e drejtësisë, dhe së dyti si oficer i gjykatës. Mbrojtësi duhet të këshillojë dhe mbrojë, me kurajë dhe përkushtim, interesat e klientit të tij, si dhe të përfaqësojë denjësisht e efektivisht të akuzuarin.[65] Ndërsa disa mund të jenë të mendimit që mbrojtësi i të akuzuarit ka një rol të vetëm: atë të përfaqësimit me zell të klientit të tij, brenda kufijve ligjorë, si dhe të mbrojë të akuzuarin nga pushteti i gjerë i shtetit, (quajtur ndryshe dhe "roli partizan" i mbrojtësit), mbrojtësi ka dhe një detyrim tjetër të rëndësishëm. Ai është gjithashtu një oficer i gjykatës. Si i tillë, ka detyrimin të respektojë gjykatën dhe të tjerët e të marrë vendime që reflektojnë respektin për funksionin dhe rolin e procesit gjyqësor në tërësi, për zbulimin e gjetjen e të vërtetës. Mbrojtësit nuk i lejohet të shtrembërojë të vërtetën, të mashtrojë ose të tregohet i pandershëm.

Edhe në Shqipëri, parashikohet detyrimi i avokatit për të vepruar me përkushtim dhe gatishmëri kur përfaqëson një klient dhe për t'u shërbyer interesave të tij në mënyrën më efikase të mundur.[66] Ai ka për detyrë ta ushtrojë profesionin e vet me ndershmëri dhe dinjitet, të respektojë rregullat e etikës profesionale dhe të përdorë të gjitha mjetet e ligjshme për mbrojtjen me besnikëri të të drejtave dhe të interesave të personave që mbrohen ose përfaqësohen prej tij.[67] Avokati nuk duhet të japë, asnjëherë, me dijeninë e tij, informacion të rremë ose çorientues gjatë procesit gjyqësor, si dhe nuk duhet të nxisë një dëshmitar që të bëjë një dëshmi të rremë.[68]

Roli i mbrojtësit si oficer i gjykatës e shërbyes i drejtësisë

Detyrimi fillestar i mbrojtësit penal është realizimi i mbrojtjes së klientit të tij me kurajë e përkushtim dhe përfaqësimi i denjë e efektiv i tij. Por, krahas rolit të lartpërmendur, mbrojtësi është gjithashtu një shtetas, me një detyrim të veçantë ndaj drejtësisë. "Dhënia e drejtësisë" është koncept shumë më i gjerë se "zbulimi i të vërtetës". E vërteta është pjesë përbërëse e drejtësisë.[69] Ky detyrim vendos ndaj të gjithë mbrojtësve, pa përjashtim, përgjegjësinë për ruajtjen dhe garantimin e drejtësisë, si një ndër vlerat themelore të çdo shoqërie.

---

[65] Roberta K Flowers, *The Role of the Defense Attorney: Not Just an Advocate*, Ohio State Journal of Criminal Law, Vol.7, (2010), 648.
[66] Kodi Etik i Avokatit, nenet 5-6.
[67] Ligj nr. 9109 date 17.07.2003 "Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë", neni 9.
[68] Kodi Etik i Avokatit, neni 34.
[69] Charles P. Curtis, *The Ethics of Advocacy*, 4 Stanford Law Review 3, (1951), 12.

Drejtësia, në vetvete, ka për qëllim të garantojë të drejtat substanciale dhe procedurale të të akuzuarit gjatë gjithë procesit penal. Kjo nënkupton përdorimin e metodave dhe proceseve të duhura, përmes të cilave realizohet dhënia e drejtësisë. Në situata të veçanta, detyrimi i mbrojtësit është ruajtja e sistemit të drejtësisë penale, jo vetëm nga përdorimi arbitrar i pushtetit të shtetit, por njëkohësisht nga dhënia e vendimeve të padrejta.

Mbrojtësi ka një rol të veçantë si oficer i gjykatës. Si i tillë, ai ka detyrim të veçantë në zbulimin e të vërtetës dhe dhënien e drejtësisë. Por, a nënkupton ky rol i mbrojtësit vënien e interesave të gjykatës mbi interesat e klientit të tij? Cilat janë detyrimet e mbrojtësit si oficer i gjykatës?

Mbrojtësi ka disa detyrime ndaj gjykatës:

- *T'i bëjë të ditur gjykatës çdo informacion që ka për të akuzuarin.* Ai nuk mund të kryejë veprime që orientojnë palët ose gjyqtarin në drejtime të gabuara. Të tilla konsiderohen jo vetëm ato raste kur mbrojtësi drejton pyetjet dhe zhvillimin e gjykimit në drejtimin e gabuar, duke pretenduar kryerjen e veprës penale nga persona të tjerë, ose në rrethana të tjera, por edhe ato raste kur p.sh. mbrojtësi është në dijeni se prokurori i çështjes do të vonohet e, megjithatë, nuk bën me dije gjyqtarin për këtë vonesë, duke ndikuar në gjykimin e çështjes në mungesë të prokurorit.

- *Të mos abuzojë procesin gjyqësor.* Mbrojtësi nuk duhet të përdorë mjete e procedura që i japin klientit të tij avantazh mbi palën tjetër. Të tilla do të konsideroheshin ato veprime të mbrojtësit që kanë për qëllim zgjatjen e procedurave gjyqësore. Kështu, kërkesa e mbrojtësit për kryerjen e hetimeve në një drejtim të gabuar, me qëllim që të lodhë palën tjetër ose që t'u mbarojnë fondet, konsiderohen abuzim me procesin gjyqësor.

- *Të mos korruptojë administrimin e drejtësisë.* Roli i mbrojtësit është zbulimi i të vërtetës dhe dhënia e drejtësisë. Në asnjë rast mbrojtësi nuk duhet të kryejë veprime të tilla që kanë për qëllim korruptimin e sistemit të dhënies së drejtësisë duke synuar arritjen e një përfundimi e dhënien e një vendimi të padrejtë nga organet gjyqësore.

- *Të ushtrojë veprimtarinë e tij me efikasitet.* Detyrë e mbrojtësit në administrimin e drejtësisë nuk është thjesht përfaqësimi i interesave të klientit të tij. Mbrojtësi duhet të marrë të gjitha masat që ky përfaqësim të jetë efikas dhe të realizohet brenda një kohe të arsyeshme. Çdo veprim i mbrojtësit që kryhet në kundërshtim me këto detyrime përbën

keqadministrim të drejtësisë nga ana e tij. Mbrojtësi duhet t'i kushtojë kohën dhe mjetet e nevojshme realizimit të një mbrojtjeje efektive të interesave të klientit të tij.[70]

- *Të mos bazojë mbrojtjen e tij në dëshmi, për të cilën ai ka dijeni se është e rreme.* Një ndër detyrat themelore të mbrojtësit në administrimin e drejtësisë dhe në rolin e tij si oficer i gjykatës, është mospranimi i dhënies së dëshmisë së rreme, si nga i akuzuari, ashtu dhe nga dëshmitarët e mbrojtjes.

Deklarimet e dëshmia e rreme dhe ruajtja e konfidencialitetit

Zbulimi i të vërtetës luan një rol të padiskutueshëm në dhënien e drejtësisë. Prokuroria zhvillon hetime për zbulimin e të vërtetës. Dëshmitarët merren në pyetje për zbulimin e të vërtetës. Gjyqtari zhvillon gjykimin dhe pyet palët në gjykim pikërisht për gjetjen e të vërtetës. Por, cili është roli i mbrojtësit në këtë mes? A kanë ata përgjegjësi për zbulimin e të vërtetës? Duke qenë se janë si mbrojtës të interesave të klientit të tyre, njëkohësisht dhe oficerë të gjykatës, kur këto dy detyra konfliktojnë me njëra-tjetrën, cila duhet të ketë përparësi? Cilat janë përgjegjësitë e mbrojtësit kur klienti i tij kërkon të japë dëshmi të rreme? A duhet të triumfojë e vërteta?

Ndodh ndonjëherë që një mbrojtës, e në veçanti një mbrojtës që mbron klientin e tij për një çështje penale, përballet me një situatë të tillë ku klienti i tij e bën me dije se do të japë dëshmi të rreme. Lind pyetja, si oficerë të gjykatës dhe garantues të drejtësisë penale, a janë mbrojtësit të detyruar, që në rast se vihen në dijeni se klienti i tyre ose dëshmitari i tij, do të kryejnë dëshmi të rreme, t'ua bëjnë të ditur këtë fakt organeve përkatëse? Nëse po, a do të kishte cenim të raportit konfidencial mbrojtës-klient? Si duhet vepruar në raste të tilla?

Hapi i parë që një mbrojtës duhet të ndërmarrë, në rast se ai vihet në dijeni se dëshmitarët e mbrojtjes do të bëjnë dëshmi të rreme, është t'u kërkojë të mos e kryejnë një veprim të tillë. Në rast se organi i ndjekjes penale vihet në dijeni të dëshmive të tilla, ai ka të drejtë të kërkojë dënimin e dëshmitarëve për veprën penale të dhënies së "dëshmisë së rreme"[71], çka rëndon dhe më shumë pozitën e të akuzuarit. Një avokat që ka bërë të qartë, që në fillim, rolin e tij si mbrojtës, ka shumë më gjasa të bindë dëshmitarët e klientit të tij të mos kryejnë dëshmi të tillë. Njëkohësisht, një klient, i cili ka besim në aftësitë e mbrojtësit, ka shumë më gjasa të dëgjojë sugjerimet dhe këshillimet e mbrojtësit të tij.

---

70 <http://havilahlegal.com.au/index.php/weblog/entry/lawyers_duty_as_an_officer_of_the_court_unmasked/>, aksesuar 24.06.2013.

71 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 306.

Ajo çka përbën një dallim shumë të madh në këtë drejtim, ndërmjet legjislacionit penal shqiptar dhe legjislacioneve të huaja, qëndron në mënyrën se si legjislacioni ynë i cilëson sjellje të tilla. Kështu, sipas legjislacionit penal shqiptar, kushdo që, gjatë hetimeve apo procedimeve penale, i pyetur nga një prokuror ose oficer i policisë gjyqësore, që të japë informacionin e duhur, jep të dhëna, me gojë ose me shkrim, që ai e di se janë, tërësisht ose pjesërisht, të rreme apo fsheh fakte ose prova, dënohet me gjobë ose me burgim, nga gjashtë muaj (kur pyetet nga oficeri i policisë gjyqësore) deri në një vit (kur pyetet nga prokurori). Dispozitat e këtij neni nuk janë të zbatueshme në rast se akti është kryer në çdo fazë të procedimit penal nga një person i dyshuar ose i pandehur për veprën penale ose nga dikush, që duhej të ishte përjashtuar nga kërkesa për informacion apo për të dëshmuar, për çdo arsye të ligjshme, ose që nuk ishte paralajmëruar për të drejtën për të mos dëshmuar apo për t'iu përgjigjur pyetjeve.[72]

Deklarimet e bëra gjatë procedimit nga i pandehuri nuk mund të përdoren si dëshmi.[73] Dëshmia e rreme e bërë përpara gjykatës përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Refuzimi për t'iu përgjigjur pyetjeve rreth dijenisë për kryerjen e një vepre penale apo të autorit të saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.[74]

Sipas një përcaktimi të tillë:

- së pari: pozita e të pandehurit ose e të akuzuarit është e ndryshme nga pozita e dëshmitarit, çka përforcohet dhe nga përcaktimet e Kodit të Procedurës Penale shqiptare, sipas të cilit deklarimet e bëra gjatë procedimit nga i pandehuri nuk mund të përdoren si dëshmi;[75]

- së dyti, personat nën hetim, ose ata të akuzuar për kryerjen e veprës penale, përjashtohen nga dënimi në rastet e dhënies së deklarimeve të rreme.

Kodi Penal shqiptar është hartuar bazuar në Kodin Penal italian dhe atë francez, por ajo çka vlen të përmendet është se si Kodi Penal italian, ashtu dhe ai francez nuk përmbajnë dispozita përjashtimore ndaj personit nën hetim ose të akuzuarit, siç vihet re në legjislacionin shqiptar. Kështu, sipas Kodit Penal francez, dëshmia e rreme, e bërë nën betim, përpara çdo lloj juridiksioni, ose përpara një oficeri të policisë gjyqësore, gjatë marrjes në pyetje, ndëshkohet me burgim ose gjobë.[76] Edhe në këtë Kod, ashtu si në Kodin Penal shqiptar, parashikimi i një dispozite të tillë gjendet në seksionin e veprave penale kundër drejtësisë.

---

[72] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, nenet 305/a, 305/b. Këto dispozita janë shtuar me ligjin nr.9686, datë 26.02.2007.
[73] Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 36.
[74] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, nenet 306, pp.1 dhe 307, pp.1.
[75] Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 36.
[76] Kodi Penal i Franës, nenet 434-12, 434-13.

Parashikimet e bëra në Kodin Penal italian shkojnë dhe më tej. Sipas Kodit Penal italian dënohen jo vetëm ato që, gjatë një procedimi penal, të kryer nga prokurori ose nga prokurori i Gjykatës Penale Ndërkombëtare, japin deklarime falso ose heshtin;[77] por njëkohësisht edhe nëse këto deklarime të rreme i japin ndaj vetë mbrojtësit,[78] duke parashikuar në një dispozitë të veçantë dëshminë e rreme[79].

Çka vihet re është se, sipas legjislacionit shqiptar, si personat e dyshuar, ashtu dhe ata të vendosur nën akuzë, përjashtohen nga përgjegjësia penale për dhënien e deklarimeve të rreme.[80] Por, sa e cenon një gjë e tillë sistemin e drejtësisë? Në një sistem penal që ka si qëllim kryesor zbulimin e së vërtetës, parashikime të tilla a nuk bien ndesh me këtë parim të përgjithshëm? Sa e sigurtë është shoqëria shqiptare kur vetë legjislacioni penal "lejon" dhënien e deklarimeve të rreme përpara organeve përkatëse?

Në legjislacionin penal shqiptar dorëheqja e mbrojtësit parashikohet në nenin 55 të Kodit të Procedurës Penale. Neni 55/1 parashikon: "Mbrojtësi që nuk pranon detyrën që i është besuar ose që heq dorë prej saj njofton menjëherë organin procedues *dhe atë që e ka caktuar*". Sipas nenit 56/2 dhe 56/3, "Këshilli drejtues i dhomës së avokatëve ka të drejtë të marrë masa disiplinore në rastin e lënies së mbrojtjes ose të refuzimit të mbrojtjes së caktuar kryesisht. Kur këshilli drejtues i quan të përligjura lënien ose refuzimin, për shkak të shkeljes së të drejtave të mbrojtjes, masa disiplinore nuk jepet edhe në qoftë se shkelja e të drejtave të mbrojtjes nuk është njohur nga gjykata". Ndërkohë, neni 13 i ligjit Nr.9109, datë 17.7.2003 "Për profesionin e avokatit në RSH" (ndryshuar me ligjin nr.9795, datë 23.7.2007 dhe ligjin nr.10047, datë 24.12.2008) parashikon: "1. Nëse avokati vendos të heqë dorë nga përfaqësimi ose mbrojtja e mëtejshme e një personi, është i detyruar ta njoftojë atë 15 ditë përpara mbarimit të shërbimit nga ana e tij. 2. Avokati është i detyruar t'i shërbejë klientit të tij gjatë periudhës 15-ditore para mbarimit të shërbimit dhe t'ï njoftojë atij çdo të dhënë për çdo shumë parash, prona apo kompensim që avokati mban për klientin. 3. Brenda 15 ditëve nga dhënia e njoftimit, avokati duhet t'i kthejë klientit të gjitha dokumentet e lidhura me çështjen ose t'i dërgojë ato në adresën e treguar nga avokati i ngarkuar rishtas. Gjithashtu, avokati është i detyruar t'i kthejë klientit parapagimin që ka marrë prej tij, përveç kur, bashkërisht, merren vesh ndryshe."

Nga mënyra e formulimit, në nenin 55 të KPP vihen re disa paqartësi: Së pari: Në rastin e dorëheqjes, mbrojtësi është i detyruar të njoftojë organin procedues dhe *atë që e ka caktuar*. Shprehja "atë që e ka caktuar" nënkupton se mbrojtësi mund të caktohet dhe nga persona të tjerë, si p.sh. familjarët, ndërkohë që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë është shprehur se e drejta e mbrojtjes është një e drejtë kushtetuese që i përket vetë individit.[81] Së dyti: Neni 56/3 shprehet: "Kur këshilli drejtues i quan të përligjura

[77] Kodi Penal Italian, neni 371-bis.
[78] ibid neni 371-ter.
[79] ibid neni 372.
[80] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 305/a, paragrafi II.
[81] Vendim nr.4, datë 10.02.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.

lënien ose ...". Shprehja "lënie" duket se presupozon dorëheqjen. Ndërsa në nenin 55/1 është përdorur termi "heq dorë" në nenin 56/3 përdoret termi "lë", çka mund të krijojë konfuzion në interpretim. Krahas kësaj, KPP nuk parashikon rastin e dorëheqjes për shkak të marrjes dijeni të mbrojtësit se i akuzuari do të kryejë dëshmi të rreme. Duke qenë se këshilli drejtues i avokatëve vendos mbi dorëheqjen e avokatit, a mundet avokati shqiptar t'i bëjë me dije këshillit qëllimin e të akuzuarit për të dhënë dëshmi të rreme? Deri në ç'masë është i detyruar mbrojtësi shqiptar të ruajë konfidencialitetin?

Për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve vlen të hidhet vështrimi në jurisprudencën amerikane lidhur me mënyrën se si trajtohen veprime të tilla sipas legjislacionit amerikan, si dhe rolin e mbrojtësit në raste të tilla.

Jurisprudenca amerikane dhe problemet komplekse që lindin nga deklarimet e rreme të të akuzuarit

Ndërkohë që sistemi penal amerikan funksionon mbështetur në *common law*, sipas të cilit i akuzuari ka të drejtë të japë dëshmi lidhur me ngjarjen, gjatë gjykimit, para gjyqtarit ose jurisë, për një mbrojtës, që përballet me problemin e dëshmisë së rreme të klientit të tij, ka tre alternativa: 1) të heqë dorë nga çështja, 2) të lejojë klientin të japë dëshmi të rreme, duke mos përmendur këtë dëshmi në pretendimet përfundimtare, 3) të paraqesë dëshminë e klientit si të ishte e vërteta.[82]

Në rastet e dhënies së dëshmisë së rreme nga klienti, mbrojtësi ndodhet para një trileme: të ushtrojë me zell veprimtarinë e tij, përmes garantimit të mbrojtjes së klientit me çdo kusht; të ruajë konfidencialitetin e raportit klient-mbrojtës; të jetë i çiltër me gjykatën. Mbrojtësi ka për detyrë të veprojë me "zell të arsyeshëm" në përfaqësimin e klientit të tij. Së dyti, mbrojtësi "nuk duhet të japë informacione që kanë të bëjnë me përfaqësimin e klientit të tij" dhe, së treti, "nuk duhet që me ndërgjegje të plotë ... të japë të dhëna që i di se janë të pavërteta".[83] Nëse mbrojtësi "di" se klienti i tij do të japë dëshmi të rreme, ai duhet të përpiqet të bindë klientin për mosdhënien e kësaj dëshmie, të mos e lejojë të dëshmojë, të japë dorëheqjen nga çështja, e, nëse asnjë nga këto nuk është e mundur, t'i bëjë të ditur gjykatës qëllimet e klientit. Në një rast të tillë mbrojtësit i duhet të zgjedhë mes ushtrimit të profesionit të tij me zell e mbrojtjes së interesave të klientit të tij, dhe respektimit të gjykatës përmes mosdhënies së të dhënave të rreme dhe thënies së të vërtetës. Vendimi që mbrojtësi merr në raste të tilla përcakton se dhe cilat vlera ai i konsideron më të rëndësishme.

[82] Maria Jane Chiepalich Wells, *The Lawyer's Responsibility When a Defendant Intends To Commit Perjury*, Journal of Legal Profession, Vol.3, (1978-1979), 161.
[83] Model Rules Of Professional Conduct, American Bar Association, R. 1.3, 1.6(a), 3.3(a)(3) (2002).

Një ndër çështjet më të bujshme amerikane për dhënien e dëshmisë së rreme nga i akuzuari është çështja e paraqitur në GS të SHBA *Nix v. Whiteside*.[84] I pandehuri, Whiteside, ishte akuzuar për vrasje të shkallës së dytë. Fillimisht ai i tha mbrojtësit të tij se kishte kryer veprën penale në kushtet e vetëmbrojtjes, pasi kishte parë se viktima ishte munduar të nxjerrë armën. Më pas, Whitesnake i kishte pohuar mbrojtësit të tij se ai nuk e kishte parë armën, por se kishte qenë i bindur se viktima kishte një të tillë. Një javë para fillimit të gjyqit, Whitesnake kishte pohuar për herë të parë se kishte parë diçka metalike në duart e viktimës. "Nëse nuk them që pashë armën, jam i vdekur" i kishte pohuar ai mbrojtësit të tij. Mbrojtësi, pas këtyre pohimeve të Whitesnake, kishte konkluduar se versioni i ri i ngjarjeve, i dhënë nga klienti i tij, do të përbënte dëshmi të rreme në gjykim. Si rrjedhojë, ai i ishte shprehur Whitesnake se nuk do ta përfaqësonte nëse do të jepte dëshmi të rreme dhe se, nëse insistonte të dëshmonte sipas versionit të ri, do t'ia bënte këtë të ditur gjykatës. Whitesnake nuk dha dëshmi të rreme, e në përfundim, u dënua nga gjykata.

Whitesnake paraqiti ankim *(habeas corpus)* duke pretenduar se i ishte mohuar e drejta për mbrojtje efektive dhe e drejta për t'u mbrojtur, pasi mbrojtësi e ndaloi të dëshmonte ashtu siç donte. Pavarësisht se Gjykata e Apelit pranoi vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të Gjykatës së Lartë të Iowa-s se mbrojtësi, me të drejtë, kishte menduar se Whitesnake do të kryente dëshmi të rreme, në përfundim Gjykata e apelit u shpreh se shprehja e dëshirës për të kryer dëshmi të rreme mbrojtësit, nuk ndryshon të drejtën e të akuzuarit për mbrojtje efektive. Si rrjedhojë, paralajmërimi që mbrojtësi i bëri Whitesnake cenonte detyrimin e mbrojtësit për të ruajtur privilegjin e klientit, përmes cenimit të standardit të përfaqësimit efektiv, të përcaktuar në *Strcklanv v. Washington.*

Në çështjen *State v. Henderson*,[85] i akuzuari në një çështje penale i kërkoi avokatit mbrojtës z. Anderson, ditën e premte para gjykimit të çështjes së tij ditën e martë të javës pasardhëse, që të kryente mbrojtjen bazuar në dëshminë e rreme të tij. Ditën e shtunë, mbrojtësi vajti në shtëpinë e gjyqtarit të çështjes dhe i kërkoi atij leje të tërhiqej nga çështja, pa u shprehur për komunikimet që mbrojtësi kishte pasur me klientin, por duke e njoftuar gjyqtarin se arsyeja e kësaj dorëheqjeje ishte se klienti i tij kishte ndër mend të kryente dëshmi të rreme. Ditën e diel, mbrojtësi vuri në dijeni klientin e tij për veprimet që kishte ndërmarrë. I akuzuari refuzoi të merrte mbrojtës të ri, duke dashur të përdorë veprimet e mbrojtësit si shkaqe për të apeluar vendimin e mundshëm të gjykatës. Në gjykim, përpara formimit të jurisë, mbrojtësi përsëriti kërkesën e tij për të hequr dorë, kërkesë e cila, përsëri, nuk u pranua nga gjykata. Juria vendosi deklarimin e të akuzuarit "fajtor".

Pretendimi kryesor i të akuzuarit, në apelim, ishte cenimi i të drejtës së tij për një përfaqësim të plotë dhe të drejtë, për shkak se gjykata kishte refuzuar kërkesën e mbrojtësit të tij për tu tërhequr nga çështja. Gjykata Supreme e Kansasit, lidhur me

[84] *Nix v. Whiteside*, 475 U.S. 157 (1986).
[85] *State v. Henderson*, 205 Kan. 231, 468 P.2d 136 (1970).

çështjen, u shpreh se gjyqtari nuk kishte abuzuar me diskrecionin e tij kur ishte shprehur për vazhdimësinë e përfaqësimit të mbrojtësit. Veprimin e mbrojtësit për tu tërhequr nga çështja, Gjykata Supreme e konsideroi të drejtë duke u shprehur se nuk kishte pasur shkelje ose cenim të konfidencialitetit në marrëdhënien mbrojtës-klient përmes veprimit që kishte ndërmarrë z. Anderson, duke i bërë të ditur gjykatës qëllimin e të akuzuarit për të kryer dëshmi të rreme. Gjykata u shpreh se, ndërsa është rregull i përgjithshëm që mbrojtësi nuk duhet të nxjerrë asnjë informacion për të cilin vihet në dijeni nga klienti i tij, ose që zbulon gjatë ushtrimit të profesionit, shprehja e qëllimit të klientit për të kryer dëshmi të rreme ose, çfarëdolloj krimi tjetër, nuk përfshihet brenda parimit të konfidencialitetit, që mbrojtësi është i detyruar të respektojë.

Në çështjen *People v Blye*,[86] mbrojtësi nuk kërkoi dorëheqjen nga çështja kur u vu në dijeni se klienti i tij do të kryente dëshmi të rreme. Përkundrazi, ai njoftoi, për këtë, gjyqtarin e çështjes, në prani dhe të Prokurorit të Rrethit, por pa praninë e të akuzuarit. Mbrojtësi u shpreh se do të ishte jo etike t'i drejtonte pyetje të akuzuarit, duke e ditur që ai do të jepte dëshmi të rreme, dhe gjyqtari pranoi kërkesën e mbrojtësit që ky i fundit të mos marrë në pyetje të akuzuarin. I akuzuari apeloi vendimin e dhënë. Gjykata e apelit u shpreh se mbrojtësi, paraprakisht, duhet të kishte kërkuar leje të tërhiqej nga çështja dhe se i akuzuari kishte të drejtë të dëshmonte, nëse do të kërkonte heqjen e mbrojtësit që kishte dhe marrjen e një mbrojtësi të ri, apo nëse do të përfaqësohej vetë.

Në një opinion jo zyrtar të Komitetit mbi Etikën Profesionale të American Bar Association (ABA), nëse një mbrojtës vihet paraprakisht në dijeni nga klienti i tij, se ky i fundit dëshiron të kryejë dëshmi të rreme, mbrojtësi ka për detyrë të këshillojë klientin e tij se ai duhet të: 1) heqë dorë nga përfaqësimi përpara se i akuzuari të japë dëshmi të rreme, ose 2) t'i raportojë gjykatës se dëshmia e dhënë është e rreme, nëse klienti insiston ta japë atë. Një opinion tjetër jo zyrtar këshillon që mbrojtësi të heqë dorë nga çështja, nëse klienti insiston në dhënien e dëshmisë së rreme, me qëllim që të parandalohet thyerja e konfidencialitetit të klienit, por duke u munduar në të njëjtën kohë të shmanget kryerja e dëshmisë së rreme.[87]

Sipas standardeve të ABA-s lidhur me funksionin e mbrojtjes, një mbrojtës që përballet me një klient që kërkon të japë dëshmi të rreme, duhet të japë dorëheqjen nga çështja, nëse është e mundur. Kjo heqje dorë është e lejueshme, por jo e detyrueshme, kur klienti do të veprojë në mënyrë të kundraligjshme.

Sipas disa autorëve, dorëheqja e mbrojtësit nga çështja nuk është zgjidhje. Ajo thjesht i kalon problemin një mbrojtësi tjetër. I akuzuari mund të mos i thotë mbrojtësit të dytë të vërtetën, për shkak të shkeljes së konfidencialitetit nga mbrojtësi i parë. Si

[86] *People v Blye*, 233 Cal. App. 2d 143, 43 Cal. Rptr. 231 (1965).
[87] Maria Jane Chiepalich Wells, *The Lawyer's Responsibility When a Defendant Intends To Commit Perjury*, Journal of Legal Profession, Vol.3, (1978-1979), 163.

rrjedhojë, dëshmia e rreme mund të jepet gjithsesi, pa u vënë në dijeni mbrojtësi i dytë.[88] Nxjerrja e qëllimeve të klientit cenon privilegjin klient-mbrojtës, çka shkakton dekurajimin e të akuzuarit për t'i treguar të vërtetën mbrojtësit. Pa njohjen e të vërtetës mbrojtësi është në pamundësi për t'i kërkuar klientit moskryerjen e dëshmisë së rreme si dhe për ta mbrojtur atë siç duhet.

Autorë të tjerë janë të mendimit se përfaqësimi jo i duhur, në të tilla raste, është rrjedhojë e zgjedhjes së vetë të akuzuarit, për të pranuar një përfaqësim jo adekuat në shkëmbim të mundësisë për të kryer dëshmi të rreme.[89] Sipas tyre, zgjedhja e të akuzuarit për t'u përfaqësuar nga mbrojtës, është në fakt zgjedhja për t'u përfaqësuar nga një mbrojtës që ka disa kufizime. Një i akuzuar për një vepër penale nuk ka të drejtën për të përfituar lirinë si rrjedhojë e dhënies së dëshmisë së rreme. Si rrjedhojë, është vendim i klientit të jetë i hapur ose jo me mbrojtësin e tij. Nëse një i akuzuar nuk ka të drejtë të japë dëshmi të rreme, atëherë mbrojtësit të tij i duhet të zgjedhë mes dy mundësive: ose të mos i kërkojë mbrojtësit të tij të dëshmojë ose të lejojë klientin të dëshmojë vetëm në lidhje me disa fakte, duke mos e pyetur lidhur me faktet për të cilat klienti ka vendosur të japë dëshmi të rreme. Nëse i akuzuari lejohet të dëshmojë, mbrojtësi duhet të vendosë se si të kryejë marrjen në pyetje. Alternativë tjerë është që të lejojë klientin të paraqitet para jurisë, por të mos i drejtojë pyetje, për të cilat ai e di se përgjigja do të jetë e rreme si dhe të mos i paraqesë pohimet e klientit në pretendimet përfundimtare.

Në çështjen *Whiteside v. Scurr*[90] Gjykata e Qarkut të tetë parashikoi standardin e "bazës së fortë faktike", sipas të cilit mbrojtësi duhet të ketë bazë të fortë për të arritur në përfundimin se klienti do të kryejë dëshmi të rreme. Gjykata të tjera kanë përdorur standardin "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm".[91] Ka dhe standarde të tjerë lidhur me përcaktimin e "pasjes dijeni", çka tregon se juridiksione të ndryshme japin përcaktime të ndryshme.

Mbrojtja e sistemit të drejtësisë penale dhe rendit shoqëror, në tërësi, mbështeten në përpjekjet e vazhdueshme të shoqërisë dhe organeve shtetërore për zbulimin e të vërtetës. Përcaktimi i përgjegjësive penale ndaj personave, të akuzuar ose jo, në rastet e bërjes së deklarimeve të rreme, kallëzimeve ose dëshmive të rreme, dhënies së informacioneve të rreme, etj. ndikon në forcimin e sistemit të drejtësisë penale, në mosdënimin e të pafajshmit dhe kapjen e fajtorëve. Detyrë e vazhdueshme e organeve të ndjekjes penale është zbulimi i të vërtetës përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Të gjitha këto janë mjete të rëndësishme për mirëfunksionimin e shtetit dhe rendit publik.

[88] Monroe Freedman, *Professional Responsibility of the Criminal Defense Lawyer: The Three Hardest Questions*, 64 Michigan Law Review 1 (1966) 469.
[89] Charles Wolfram, *Client Perjury*, 50 *S.* California Law Review, (1977) 857.
[90] *Whiteside v. Scurr*, 744 F.2d. 1323 (8th Cir. 1984).
[91] *Commonwealth v Alderman*, 437 A.2d 36 (Pa. Super. Ct. 1981).

KAPITULLI III

STANDARDI I MBROJTJES EFEKTIVE DHE RËNDËSIA E TIJ

Roli i mbrojtësit në çështjet penale, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personit të akuzuar, është i padiskutueshëm. Në një shoqëri demokratike sigurimi i kësaj mbrojtjeje garanton ruajtjen e shtetit të së drejtës, miradministrimin e drejtësisë, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit dhe mirëfunksionimin e shoqërisë.

Por vetëm garantimi i mbrojtjes në çështjet penale është i pamjaftueshëm. Një vëmendje e rëndësi e veçantë i duhet kushtuar pasjes dhe ushtrimit të një mbrojtjeje efektive.[92]

Për realizimin e një mbrojtjeje efektive, një rëndësi të veçantë merr garantimi kushtetues i kësaj të drejtë në çështjet penale, për shkak të vetë rëndësisë që paraqesin këto çështje, pasi kufizimi i lirisë së individit sjell rrjedhimisht dhe cenimin e gëzimit të çdo të drejte tjetër të mbrojtur e garantuar me ligj e akte ndërkombëtare.

Cili është qëllimi i drejtësisë penale?

Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit.[93]

Me qëllim që të përcaktohet se ç'është mbrojtja efektive në çështjet penale dhe se si mund të garantohet ajo, duhen analizuar qëllimet e sistemit të drejtësisë penale dhe roli që mbrojtësi luan në arritjen e këtyre qëllimeve. Ka të paktën 4 pikëpamje kryesore përsa u përket këtyre qëllimeve: gjetja e të vërtetës, vendimi i drejtë, zbatimi i të drejtave, si dhe pikëpamja tjetër, sipas të cilës, sistemi i drejtësisë penale është krijuar për të dhënë vendime të pranueshme nga publiku, pavarësisht se të drejta apo jo.

Sigurisht që, qëllim i rëndësishëm i sistemit të drejtësisë është edukimi i individëve mbi mënyrat e sjelljes si dhe për të garantuar disa vlera morale dhe sjelljeje në

[92] "Kur fjalët humbasin kuptimin, njerëzit humbasin lirinë", Confucius, Rreth 500 P.E.S.
[93] Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 1.

përputhje me dispozitat ligjore.[94] Në rast se mbrojtja nuk është efektive, të drejtat kushtetuese të të akuzuarit për një gjykim të drejtë, për të mos u vetëakuzuar, zbulimi i të vërtetës, i provimit të kryerjes së veprës në procesin penal, të gjitha këto do të jenë shkelur.

Gjykimi është, në një farë mase, një lloj drame morale që, përmes vendimit, përcjell një mesazh publik.[95] Nëse publiku pranon këtë mesazh, nënkuptohet se një vendim fajësie paraqet një vendim moral mbi një ngjarje të caktuar dhe jo thjesht një pohim të aftësive të prokurorisë për të provuar faktet. Një qëllim i rëndësishëm i vendimit është që procesi të jetë strukturuar në mënyrë të tillë, që ngjall besim tek publiku. Nëse publiku beson se vendimi ka qenë i padrejtë ose kishte gabime gjatë procesit, siç mund të jetë dhe mbrojtja inefektive, ai do të kundërshtojë dënimin e këtij veprimi.

Të drejtat që i jepen të akuzuarit i shërbejnë forcimit të besimit të publikut në drejtësinë e vendimit. Kur prokuroria arrin të provojë, pavarësisht dizavantazheve që mund të ketë, si psh. provimi i fajësisë, privilegji i vetëinkriminimit, ndalimi i paraqitjes së një kategorie provash, ka më shumë gjasa që publiku të besojë se vendimi ka qenë i drejtë dhe se vendimi është dhënë për shkak të fajësisë së të akuzuarit. Në këtë aspekt, roli i mbrojtësit është të paraqesë provat më bindëse, në mënyrë që të provojë, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, pafajësinë e të akuzuarit. Për të arritur këtë qëllim mbrojtësi duhet të përdorë të gjitha mjetet ligjore në dispozicion.

Problemet lidhur me rregullat mbi mbrojtjen efektive. Prezumimi i kompetencës dhe përgjegjësisë

Pavarësisht se nuk ka një analizë studimore mbi komptencën e avokatit mbrojtës, disa[96] kanë raportuar nga eksperienca e tyre se inkompetenca e mbrojtësit penal është shumë e përhapur dhe po aq serioze. Studimet mbi sjelljet e mbrojtësit penal në rastet e pranimit të fajësisë, fenomen që vihet re në shumë raste të kryerjes së veprave penale, tregojnë për një nivel të lartë inkompetence dhe se shumë mbrojtës vënë interesat e tyre para interesave të klientit. Si rrjedhojë, vendosja nga gjykatat shqiptare e një standardi kushtetues për efiçencën e mbrojtësit do të ishte një element shumë i rëndësishëm për sigurimin e gjykimeve të drejta, duke respektuar kështu parimin e shtetit të së drejtës.[97] Sigurisht që, është po aq e rëndësishme që gjykatat të prezumojnë kompetencën

[94] Mirjan R. Damaska, *Evidentiary Barriers to Conviction and Two Models of Criminal Procedure: A Comparative Study*,121 University of Pennsylvania Law Review 506 (1973);
[95] Charles Nesson, *The Evidence or the Event? On Judicial Proof and the Acceptability of Verdicts.* 98 Harvard law Review., Volume 98, Nr.7, (1985) 1357.
[96] Gjyqtari Chief Justice Burger. Burger, *The Special Skills of Advocacy: Are Specialized Training and Certification of Advocates Essential to Our System of Justice?*, 42 Fordham Law Review (1973) 227.
[97] Vendim nr.58, datë 24.12.2012 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, ss. B/ii.

profesionale të mbrojtësit. Nëse një prezumim i tillë nuk bëhet, shumë gjykime do të ngrinin pikëpyetje dhe do të viheshin në dyshim. Një dyshim i tillë do të ishte shumë i rrezikshëm duke pasur parasysh, jo vetëm impaktin e vendimeve penale në jetën e të akuzuarit, por dhe kohën, përpjekjet, paratë dhe burimet që përdoren në një gjykim penal.

Mungesa e njohurive për seriozitetin e inkompetencës së mbrojtësit penal, si dhe mospasja e një mundësie për të kuptuar këtë, bën të nevojshme prezumimin e kompetencës së mbrojtësit. Qëllimi i këtij prezumimi është funksionimi i sistemit të drejtësisë penale. Megjithatë, duhet pasur gjithmonë parasysh se inkompetenca e mbrojtësit mund të krijojë padrejtësi serioze. Për rrjedhojë, krijimi i një shërbimi mbrojtjeje të financuar, i cili ofron një sërë programesh trajnimi, është gjithashtu po aq i rëndësishëm.

Përcaktimi i moskompetencës së mbrojtësit është shumë më i vështirë se ç'mendohet. Në përcaktimin, nëse veprimet e avokatit janë të njëjta me veprimet e një mbrojtësi me aftësi mbrojtjeje normale, gjykatës i duhet të shqyrtojë të gjitha rrethanat. Në këto rrethana mund të përmenden dhe kufizimet në kohë e para, të cilat influencojnë, që në fillim, veprimet strategjike të avokatit.[98] Një ndër rastet tipike është ai i *Knighton v.Maggio.*[99] Shteti i Luizianës dënoi Knighton me vdekje për veprën penale të vrasjes së një personi. Avokati i tij Phillips ishte një ndër avokatët me emër të zonës. Si rrjedhojë, numri i çështjeve që ai ndiqte ishte shumë i madh. Gjykimi i Knighton u krye nga gjykata në një kohë shumë të shkurtër, duke mos i lënë avokatit mundësinë të përgatiste siç duhet mbrojtjen.

Pra, thjesht fakti që mbrojtësi mund të ketë eksperiencë është i pamjaftueshëm për një mbrojtje efektive. Në këtë rast mund të thuhet se krahasimi i aftësive të tij profesionale me ato të një mbrojtësi normal do të ishte i pavlerë.

Detyrimi kryesor i mbrojtësit është të jetë efektiv. Kjo nënkupton që, nëse ai kërkon më shumë kohë ose para, duhet t'i kërkojë ato. Mbrojtësi duhet t'i paraqesë këto kërkesa me shkrim dhe t'i depozitojë për administrim në dosjen gjyqësore. Ai duhet, gjithashtu, të krijojë një marrëdhënie bashkëpunimi efektive me të akuzuarin. Krijimi i një mirëkuptimi të tillë është shpesh herë i vështirë, pasi të akuzuarit nuk u besojnë avokatëve të tyre, sidomos kur bëhet fjalë për mbrojtës të caktuar kryesisht. Ajo çka mbrojtësi duhet të mbajë parasysh është se duhet të mbështesë gjithmonë pohimet e të akuzuarit. Nëse klienti thotë se ka fakte që mund të provojnë pafajësinë e tij, atëherë mbrojtësi duhet të bazojë hetimet në atë drejtim.

Shumica e mbrojtësve e dinë se klienti i tyre është fajtor apo se ai po gënjen, të paktën në fillim. Një mbrojtës me eksperiencë i sheh fjalët e klientit si mundësi për të vënë në diskutim provat dhe jo thjesht si të dhëna. Një ndër qëllimet kryesore të

[98] *Washington v. Strickland*, 693 F.2d 1243, 1255 (5th Cir. 1982).
[99] *Knighton v. Maggio*, 740 F.2d 1344 (5th Cir. 1984), *cert. denied*, *105* S. Ct. 32 (1984).

"hetimeve" që kryen mbrojtësi është të provuarit e versionit të ngjarjeve sipas pretendimeve të klientit.[100]

Fakti se një mbrojtës ka prova të mjaftueshme për të mbështetur versionin e klientit nuk do të thotë se ai duhet të jetë më pak vigjilent. Edhe në rastet e pranimit të fajësisë, mbrojtësi nuk duhet të ulë nivelin e mbrojtjes së tij. Rastet e vështira kërkojnë më shumë përpjekje dhe, me rritjen e numrit të provave në favor të të akuzuarit, mbrojtësi duhet të bëhet dhe më agresiv.

Inefikasiteti i mbrojtësit është i vështirë të provohet nga procesverbalet e mbajtura rreth çështjes. P.sh. nëse një mbrojtës nuk ka hetuar mbi çështjen apo nuk ka pyetur dëshmitarët, kjo mund të dalë nga dosja gjyqësore, por shkaqet për këtë nuk shpjegohen. Kërkesa mbi ineficencën e mbrojtësit duhet bazuar në standardin se si një mbrojtës me aftësi profesionale normale do të kishte vepruar.

Sigurisht, diskriminimi financiar[101] është një problem tipik i drejtësisë penale dhe vendosja e rregullave mbi efikasitetin e mbrojtësit nuk e ndryshon këtë fakt, megjithatë ndihmon.

Sindroma e avokatit të përgjumur

Disa nga çështjet më të bujshme lidhur me efektivitetin e mbrojtjes janë ato që krijuan dhe termin *"sindroma e mbrojtësit që fle"*. Një rast i tillë ishte ai i Calvin Jerry Burdine[102]. Shumica e avokatëve e njohin këtë çështje si çështja e mbrojtësit që flinte. Calvin u dënua pas vetëm 12 orësh dëshmi, si dhe një vendimmarrjeje prej 17 minutash të jurisë, përmes të cilës u vendos fajësia e tij. Ai u dënua me vdekje nga juria. Calvin u "mbrojt" nga një avokat, i cili nuk kishte bërë as hetime e as ishte përgatitur mbi çështjen. Si rrjedhojë, ai pothuajse nuk foli fare gjatë gjykimit të çështjes. Calvin ishte gay, fakt të cilin prokuroria e përmendi shumë shpesh gjatë gjykimit. Në gjykim mbrojtësi nuk bëri asnjëlloj prapësimi ndaj përdorimit të këtij fakti nga prokuroria, e cila e konsideroi qenien gay si fobi. Mbrojtësi nuk mori në pyetje asnjë dëshmitar, detyroi z. Burdine të dilte para jurisë dhe të thoshte se nuk kishte dëshirë të dëshmonte para jurisë, nuk kundërshtoi kur prokurori u shpreh se dënimi me burgim të përjetshëm do të ishte piknik për një njeri homoseksual si Calvin e, madje, përdori dhe vetë epitete diskretituese ndaj klientit të tij. Kundërshtimi që ky mbrojtës paraqiti para gjykatës kishte të bënte më shumë me ndalimin e dënimit me vdekje, në përgjithësi, dhe nuk tha asgjë për klientin e tij. Jo

[100] Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, nenet 335-336.
[101] Për shkak të pamundësisë financiare të të akuzuarit për të zgjedhur avokat me përvojë dhe aftësi profesionale.
[102] *Burdine v. Johnson*, 262 F.3d 336 (5th Cir. 2001); *Burdine v. State*, 719 S.W.2d 309 (Tex.Crim.App. 1986); *Deputy v. State*, 500 A.2d 581, 596 (Del. 1985), *cert. denied*, 480 U.S. 940 (1987).

vetëm kaq, për avokati i tij, z. Cannon, flinte në mënyrë të përsëritur gjatë seancave, për intervale të gjata kohe, ndërkohë që bëhej fjalë për një dënim që mund të ishte dhe me vdekje. Sigurisht që, s'kishte si të ndodhte ndryshe. Më 30 Janar 1984 juria dënoi z. Burdine me dënim me vdekje. Madje, gjykata emëroi z. Cannon si përfaqësues të z. Burdine dhe në apel. Dënimi me vdekje u pohua dhe nga kjo gjykatë. Cannon fjeti gjithashtu edhe gjatë gjykimit të çështjes së Carl Johnson, ndaj të cilit kishte gjithashtu kërkesë për dënim me vdekje.[103]

Ndërkohë që Kushtetutat e të gjitha vendeve shprehen se, kushdo ka të drejtë të zgjedhë mbrojtësin e tij, asnjë nga Kushtetutat nuk shprehet se ky mbrojtës duhet të jetë zgjuar.[104] E njëjta gjë mund të thuhet dhe për çështjen e George McFarland, i cili u dënua me dënim me vdekje në vitin 1992 për vrasjen e Kenneth Kwan, pronari të një minimarketi. Çështja e tij u shqyrtua me një shpejtësi marramendësi. Paraqitja e pretendimeve u bë me 10 Gusht 1992, dënimi për fajësi u dha më 12 Gusht dhe dënimi me vdekje më 14 Gusht. U deshën vetëm 16 orë për të shndërruar George McFarland nga "i prezumuar i pafajshëm" në "një kufomë të gjallë".

Fakti më befasues në çështjen e tij, fakt që nuk gjendet i shkruar në procesverbalet e seancës, kishte të bënte jo me të akuzuarin, por me mbrojtësin e tij, John Benn. Sipas përshkrimeve të një reporteri të gazetës "Houston Chronicle", John Makeig, i cili ishte i pranishëm në sallë gjatë shqyrtimit të çështjes, *"Avokati John Benn kaloi pothuajse gjithë pasditen e të Enjtes në gjykatë, në gjumë të thellë. Goja i hapej shpesh dhe koka i varej mbi supe. Zgjohej sa për të rregulluar veten. Pastaj flinte përsëri, e përsëri. Sa herë që hapte sytë në stendë qëndronte një dëshmitar tjetër, duke përshkruar një aspekt tjetër të ... arrestit të George McFarland."* Kur gjyqtari i gjykatës së Distriktit, Doug Shaver, kërkoi pushim, Benn u pyet nëse vërtet kishte fjetur gjatë gjykimit të një çështjeje që përfshinte dënimin me vdekje. "Është e mërzitshme", ishte shfajësuar avokati 72 vjeçar".

E drejta për mbrojtje efektive si një e drejtë procedurale

Në një shoqëri që bazohet në respektin për shtetin e së drejtës, mbrojtësi luan një rol të veçantë. Detyrimet e mbrojtësit nuk fillojnë ose mbarojnë thjesht me kryerjen, brenda kufijve ligjorë, të një veprimtarie për të cilën ai ka studiuar dhe është edukuar. Mbrojtësi duhet t'i shërbejë jo vetëm interesit të drejtësisë, por njëkohësisht duhet të mbrojë interesat, të drejtat dhe liritë e personit që ka marrë përsipër të mbrojë, person i cili ia ka besuar këtë mbrojtje atij. Si rrjedhojë, avokati mbrojtës nuk ka thjesht detyrimin që të mbrojë çështjen e klientit të tij, por të jetë njëkohësisht këshilluesi i tij. Respekti për

[103]David R. Dow, *The State, The Death Penalty, and Carl Johnson*, 37 Boston College Law Review (1996) 694–95.
[104] *McFarland v. State*, 928 S.W.2d 482 (Tex. Cr. App. 1996).

rolin dhe funksionin e profesionit të avokatit mbrojtës është thelbësor për garantimin e shtetit të së drejtës dhe demokracinë në shoqëri.[105]

Roli i mbrojtësit, pavarësisht nëse ushtrohet nga një individ, korporatë ose shteti, është ai i këshilltarit dhe përfaqësuesit të besuar të klientit. Ai respektohet nga palët e treta dhe është përfaqësues i pazëvendësueshëm në miradministrimin e drejtësisë. Përmes mishërimit të të gjithë këtyre elementëve mbrojtësi përmbush njëkohësisht rolin e tij në shoqëri, atë të parandalimit të konflikteve dhe siguron zgjidhjen e tyre në përputhje me parimet e njohura të së drejtës, për mbrojtjen e lirisë, drejtësisë dhe rendit ligjor.

Roli i mbrojtësit është themelor në një shoqëri demokratike. Sigurisht që në ditët e sotme garantohet e drejta e çdokujt që të sigurojë mbrojtjen, gjatë një procesi gjyqësor. Por a mjafton vetëm kaq? A duhet interpretuar kjo e drejtë në kuptimin e ngushtë? A është garantimi i përfaqësimit me mbrojtës në procesin penal i mjaftueshëm për realizimin real të kësaj të drejte?

E drejta për mbrojtje në një proces nënkupton të drejtën për një mbrojtje efektive. Thjesht fakti që mbrojtësi të ketë plotësuar kërkesat ligjore bazë për të ushtruar mbrojtjen është i pamjaftueshëm. Mbrojtësi duhet të jetë i aftë të sigurojë një mbrojtje reale, efektive. Vetëm edukimi universitar në këtë fushë nuk është i mjaftueshëm. Avokati duhet të jetë gjithmonë koherent me jurisprudencën. Fokus i rëndësishëm i veprimtarisë së tij duhet të jetë dhe përditësimi i njohurive.[106]

Që në çështjet e para, të cilat vendosën të drejtën që të gjithë të akuzuarit të kishin një avokat mbrojtës, veçanërisht për ata që nuk ishin në gjendje financiare të merrnin një të tillë, gjykatat janë shprehur se kjo mbrojtje duhet të jetë "efektive në përgatitjen e çështjes për gjykim".[107] Qeveria nuk duhet të ndërhyjë në këtë përfaqësim, as përsa i përket përzgjedhjes së përfaqësuesve që ofrojnë mbrojtjen, as në vendosjen e kufizimeve ndaj mbrojtësit, të cilat pengojnë detyrën e tij në dhënien e drejtësisë.[108]

Çdo mbrojtës duhet të jetë koshient për rëndësinë që ka për të akuzuarin mbrojtja që ai ofron. Detyrë e tij nuk është thjesht pjesëmarrja në gjykim, por realizimi efektiv i mbrojtjes. Aftësitë e avokatit, sidomos në çështjet penale, kanë rëndësi jetike, mes lirisë dhe burgimit, mes jetës dhe vdekjes[109]. Nëse një i akuzuar përfundon në burg ose jo, ekzekutohet ose jo masa e dënimit, varet nga aftësitë profesionale të avokatit. Mungesa e

[105] Karta Europiane e Parimeve Themelore të e Profesionit të Avokatit, 4; Kodi i Veprimit për Mbrojtësit Europianë, neni 1.1.
[106] Thënie amerikane: "Një burrë i mençur mund të shohë më shumë nga fund i një pusi se një budalla nga maja e malit".
[107] *Powell v. Alabama*, 287 U.S. 45 (1932), 71-72; *Glasser v. United States*, 315 U.S. 60 (1942), 70.
[108] ibid *Glasser v. United States*. Gjykata kërkoi përfaqësimin e të akuzuarit si dhe të bashkë-akuzuarit nga i njëjti mbrojtës, pavarësisht se të akuzuarit kishin interesa të ndryshme. *Geders v. United States*, 425 U.S. 80 (1976), gjyqtari nuk lejoi konsultimet e të akuzuarit me avokatin e tij mbrojtës; *Herring v. New York*, 422 U.S. 853 (1975), mbrojtja u ndalua të paraqiste konkluzione përfundimtare.
[109] Në vendet ku dënimi me vdekje lejohet me ligj.

këtyre aftësive, gjithsesi, nuk duhet të konsiderohet si fitore e prokurorisë. Të akuzuarit duhet të dënohen e të vuajnë dënimin vetëm për shkak të krimeve të provuara siç duhet.

Prokurorët janë unikë për shkak se ata kanë si të drejta, ashtu dhe detyrime, që avokatët nuk i kanë. Detyra e një prokurori duhet të jetë që të kërkojë drejtësi, dhe jo thjesht të dënojë. "Prokurori nuk duhet të jetë përfaqësues i një pale në gjykim dhe qëllimi i tij gjatë ushtrimit të ndjekjes penale nuk duhet të jetë ai i fitimit të një çështjeje, por dhënia e drejtësisë. Në këtë kuptim, ai është shërbëtor i ligjit në të dy kuptimet e tij: së pari: se fajtori nuk do t'ia hedhë, dhe, së dyti se i pafajshmi nuk do të dënohet. Ai duhet të ushtrojë me seriozitet ndjekjen penale e, ndërkohë që i lejohet të kërkojë dënime të rënda, nuk i lejohet të gabojë. Moszbatimi i metodave të papërshtatshme me qëllim dhënien e një dënimi të gabuar, është po aq detyrë e tij, sa ç'është përdorimi i çdo mjeti legjitim për të dhënien e drejtësisë".[110]

"Cilësitë e një prokurori të mirë janë po aq ekskluzive dhe të pamundshme për t'u përcaktuar, sa ç'janë ato që përcaktojnë një zotëri. Ndjeshmëria dhe korrektësia janë ndoshta mbrojtja më e mirë kundër abuzimit me pushtetin. Siguria e qytetarëve qëndron në një prokuror që paraqet zell dhe mirësi njerëzore, që kërkon të vërtetën dhe jo viktima, i cili ndjek ligjin dhe jo qëllime të veçanta si dhe kryen detyrën e tij me përulësi".[111]

Në një shtet që investon[112] në kapjen dhe dënimin e kriminelëve, në procedimet penale, prezenca e mbrojtësve të aftë e të kualifikuar, bëhet po aq e nevojshme dhe e rëndësishme, me qëllim që dënimi i dhënë të jetë i merituar. Duke qenë se e gjithë kjo varet nga aftësitë e mbrojtësit, ligjet dhe politikat ligjore duhet të sigurojnë që ai të jenë kompetent. Madje, një hap i rëndësishëm do të ishte vendosja e një standardi kushtetues për përcaktimin e performancës së mbrojtësit në çështjet penale.

Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në dy çështje të vitit 1984, *United States v. Cronic*[113] dhe *Strickland* v. *Washington*[114] , adresoi pyetjen e mbrojtjes efektive në çështjet penale.[115] Gjykata vendosi një rregull të ri, që, si fillim, ishte relativisht i dobët, standardin e asistencës kushtetuese efektive si dhe përcaktoi rregulla të detajuara për zbatimin e tij. Një vendim i tillë pati rëndësi të veçantë sidomos për ata të akuzuar që vuajnë për shkak të performancës jo të mirë të mbrojtësve të tyre.

---

[110] *Berger v United States*, 295 U.S. 78, (1935) 88.
[111] Fjalim i 1 prill 1940 i Robert H. Jackson, Prokuror i Përgjithshëm dhe më pas Gjyqtar i i Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara, <http://www.roberthjackson.org/the-man/speeches-articles/speeches/speeches-by-robert-h-jackson/the-federal-prosecutor/>, aksesuar më 24.02.2012.
[112] Përmes hartimit të politikave sa më efikase në ndjekjen e kriminelëve, përmes trajnimit të prokurorëve, etj.
[113] *United States v. Cronic*, 466 U.S. 648 (1984).
[114] *Strickland v. Washington*, 466 U.S. 668 (1984).
[115] Gary Goodpaster, *The adversary system, advocacy, and effective assistance of counsel in criminal cases*, New York University Law Journal – Review of law and social change.

Sigurisht që këto rregulla nuk u japin mbrojtësve dije praktike dhe nuk ndikojnë në cilësinë e mbrojtjes penale, megjithatë, vendosja e tyre ndikon në garantimin e parimit të gjykimit të drejtë dhe mbrojtjen e barabartë të këtyre garancive për palët në gjykim.

Jurisprudenca për mbrojtjen efektive

Jurisprudenca Amerikane

Në çështjen *Powell v Alabama*[116] Gjykata e Lartë Amerikane vendosi se në çështje për të cilat dënimi që mund të jepet është dhe me vdekje, e drejta e një mbrojtjeje *efektive* është një e drejtë kushtetuese. Mbrojtësit në këtë çështje nuk bënë asgjë me shumë se thjesht ishin prezent gjatë gjykimit. Ata nuk bënë asgjë që të mbronin klientët e tyre, dhe, përsa i përket mbrojtjes që realizuan, mund dhe të mos ishin paraqitur fare në gjykim. Gjykata vendosi se mbrojtja e ofruar duhet të jetë reale, ose e quajtur ndryshe *efektive.*

Në çështjet *United States v. Cronic* dhe *Strickland v. Washington*[117] Gjykata e Lartë Amerikane u shpreh se asistenca në mbrojtje[118], në çështjet penale, kërkonte që kjo asistencë të jetë efektive. Shumë gjykata më të ulëta kishin vënë shpesh herë në diskutim një gjë të tillë. Në çështjet e shqyrtuara para dhënies së vendimit për këto çështje, gjykatat ishin shprehur se, deri atëherë, kishte pasur tre situata kur mbrojtja kishte qenë inefektive: për shkak të moskompetencës;[119] për shkak të kufizimeve të vendosura nga vetë shteti, si p.sh. kohë e shkurtër për përgatitjen e mbrojtjes;[120] apo për shkak të ekzistencës së një konflikti interesi.[121]

Në çështjen *Cronic* pyetja që shtrohej ishte, nëse inefektiviteti kishte ardhur për shkak të barrierave të vendosura nga vetë shteti, apo nga eksperienca e vetë mbrojtësit. Cronic akuzohej për skema mashtrimi me postë, çështje të cilën prokuroria e kishte hetuar për 4 vjet e gjysmë. Pak para gjykimit mbrojtja e zgjedhur nga Cronic u tërhoq. Gjykata emëroi si mbrojtës të tij një avokat, i cili kishte eksperiencë në legjislacionin që kishte të bënte me pasuritë e paluajtshme, por jo në fushën për të cilën akuzohej Cronic.

---

[116] *Powell v. Alabama* 287 U.S. 45 (1932).
[117] *United States v. Cronic, 466 U.S. 648 (1984), Strickland v. Washington*, 466 U.S. 668 (1984).
[118] Parashikuar në Amendamentin e 6 të Kushtetutës së SHBA.
[119] *McMann v. Richardson*, 397 U.S. 759 (1970), 771 (Nëse e drejta për mbrojtje duhet t'i shërbejë qëllimit për të cilin është krijuar, të akuzuarit nuk duhen lënë në mëshirë të mbrojtësve joefektivë").
[120] *Geders v. United States*, 425 U.S. 80 (1976); *Herring v. New York*, 422 U.S. 853 (1975); *cf. United States v. Decoster*,624 F.2d 196,201 (D.C. Cir. 1976) (diskutimet mbi barrierat e vendosura nga shteti në ofrimin e një mbrojtjeje efektive).
[121] *Holloway v. Arkansas*, 435 U.S. 475 (1978) (gjykata dështoi në emërimin e mbrojtësve të veçantë për bashkë-të-pandehur si dhe të merrte masat e nevojshme për të shmangur rrezikun e konfliktit të interesit).

Përveç kësaj, gjykata i dha avokatit të ri vetëm 25 ditë për të përgatitur mbrojtjen. Në gjykimin e çështjes në apel, gjykata u shpreh se ishte cenuar e drejta e Cronic për një mbrojtje efektive. Ajo u shpreh, gjithashtu, se për shkak të seriozitetit të veprës penale si dhe kompleksitetit të çështjes, koha që i ishte dhënë mbrojtësit (pa eksperiencë në këtë fushë) ishte e papërshtatshme. Si rrjedhojë e këtyre rrethanave, gjykata u shpreh se mbrojtja nuk kishte qenë efektive.[122]

Të njëjtin qëndrim mbajti Gjykata Supreme dhe në çështjen *Strickland v. Washington*. Në këtë çështje Gjykata, jo vetëm që mbështeti qëndrimin e mbajtur në *Cronic*, por e zhvilloi atë dhe më tej, duke përcaktuar dhe se si gjykatat duhet të sillen në rastet e ankimeve për mbrojtje joefektive. Në çështjen *Stricland* shteti i Floridas dënoi Washington me tre dënime me vdekje. Gjykata emëroi një avokat ekspert për ta mbrojtur. Kundër këshillave të avokatit të tij, Washington pranoi dy vrasje, hoqi dorë nga gjykimi i mëtejshëm i çështjes dhe pohoi fajësinë për të gjitha akuzat. Washington hoqi dorë gjithashtu nga e drejta e tij për t'u dënuar nga një juri e posaçme për dënimet me vdekje, duke zgjedhur që të dënohet nga vetë gjyqtari i çështjes. Mbrojtësi, duke e parë situatën të pashpresë, përgatiti mbrojtjen vetëm mbi bazën e dëshmive të Washingtonit dhe të gruas e mamasë së tij. Ai nuk kërkoi as thirrjen e dëshmitarëve e as ekzaminim psikiatrik. Ai vendosi të mos paraqesë asnjë provë mbi karakterin e Washingtonit dhe gjendjen e tij emocionale, pavarësisht të drejtës së çdo të pandehuri, ndaj të cilit qëndron një akuzë për dënim kapital, për të paraqitur rrethana lehtësuese, që mund të bindin autoritetin dënues për t'i shpëtuar jetën. Bazuar dhe në thëniet e vetë gjyqtarit të çështjes, se "ai respektonte njerëzit që pranonin përgjegjësinë për veprimet që kanë kryer", avokati mbrojtës u shpreh se pranimi i fajit duhej përdorur si arsye për të mos dhënë dënim me vdekje. Pavarësisht nga kjo, gjyqtari e dënoi me vdekje. Pas këtij vendimi Washington kërkoi ulje të dënimit, duke pretenduar, mes të tjerash, se mbrojtja nuk kishte qenë efektive, sepse ajo nuk kishte thirrur e pyetur dëshmitarë, nuk kishte nxjerrë konkluzione për hetimet e kryera, si dhe nuk kishte zhvilluar hetime mbi analizat mjekësore apo pyetur ekspertët.

Duke qenë se një nga gjyqtarët (gjyqtari O'Connor) nuk ishte dakord me pretendimin se mbrojtja e ofruar kishte qene inefektive, gjykata, me qëllim që të mos përcaktonte detyrime specifike të mbrojtësit, u shpreh se çështjet që ngrinin pretendime mbi inefektivitetin e mbrojtësit, duhej të vlerësoheshin sipas standardit të "arsyeshmërisë sipas normave profesionale".[123] Me fjalë të tjera, gjykatat do të pranonin pretendimet për mbrojtje infektive, nëse një mbrojtës me njohuri e aftësi profesionale normale do të vepronte ndryshe nga mbrojtësi në çështjen objekt gjykimi.

Gjykata Supreme përcaktoi gjithashtu rregulla të detajuara për zbatimin e këtij standardi. Ajo u shpreh se, gjykatat që do të shqyrtojnë këto lloj pretendimesh duhet të prezumojnë se mbrojtësi ka qenë kompetent[124] dhe se gjykimi ka qenë i drejtë. Gjykatat

[122] ibid 1129.
[123] *Strickland v. Washington*, 466 U.S. 668 (1984), 688.
[124] ibid 689.

duhet t'i shohin veprimet e mbrojtësit sipas perspektivës së tyre për çështjen. Për të kuptuar perspektivën e mbrojtësit, gjykata duhet të ketë parasysh pengesat që mund të ketë hasur mbrojtësi si ato kohore, financiare, apo mbi informimin e klientit. Por, vetëm kaq nuk është e mjaftueshme. Nëse gjykata që shqyrton çështjen e inefektivtetit të mbrojtësit pranon këto pretendime, i akuzuari duhet të jetë i aftë të tregojë që, vendimi i jurisë ose gjyqtarit ishte paragjykuar për shkak të kësaj ineficence. I akuzuari duhet të jetë në gjendje të tregojë se, nëse avokati do të kishte qenë efiçient e të mos kishte bërë gabime, apo po të kishte vepruar siç duhej, rezultati i gjykimit do të kishte qenë i ndryshëm.

Mbrojtja nuk do të konsiderohet infektive thjesht për shkak se avokati mbrojtës kishte përdorur në gjykim disa taktika, të cilat nuk patën sukses. Taktikat e përdoruara nga avokati për realizimin e mbrojtjes hynë brenda diskrecionit të tij. Pretendimet e të akuzuarit se, mbrojtësi nuk arriti t'i siguronte mbrojtjen, pasi pretendimet e paraqitura ishin të pavlera, nuk do të konsiderohet si mbrojtje infektive.

Në mënyrë që të pranohet kërkesa për mbrojtje joefektive gjykata duhet të arrijë në konkluzionin që: 1) realizimi i mbrojtjes kishte të meta dhe se, 2) për shkak të këtyre të metave çështja është paraqitur në mënyrën e gabuar nga mbrojtja.[125] Ndërkohë që përcaktimi i kushtit të parë është relativisht i vështirë, përcaktimi i kushtit të dytë është pothuajse i pamundur, me përjashtim të rasteve kur kjo është shumë e qartë.

Jurisprudenca Europiane

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) është shprehur shpesh herë lidhur me rëndësinë e realizimit të një mbrojtjeje efektive, të parashikuar nga neni 6, paragrafi 3/b i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Sipas saj, gjykatat kombëtare duhet të marrin masat e nevojshme që të akuzuarit t'i garantohet një gjykim i drejtë, duke përfshirë këtu mundësinë e një mbrojtjeje efektive. Mbrojtësi duhet të ketë kohën dhe mundësitë e nevojshme për të studiuar çështjen, për përgatitjen e mbrojtjes e për këshillim me klientin. Shtetet duhet të marrin masat e nevojshme me qëllim që t'u mundësojnë mbrojtësve (të caktuar kryesisht) përmbushjen sa më mirë të detyrimeve të tyre.[126]

Megjithatë, një mbrojtës, edhe nëse është caktuar kryesisht, nuk mund të konsiderohet si organ shtetëror. Duke pasur parasysh pavarësinë e profesionit të tij nga shteti, mënyra se si ai e administron çështjen, është në thelb një çështje mes tij dhe klientit - të akuzuarit, pavarësisht se është përzgjedhur sipas një skeme ndihme ligjore

[125] *Strickland v. Washington*, 466 U.S. 668 (1984).
[126] *Goddi v. Italy* (Application no. 8966/80).

apo i financuar privatisht. Si rrjedhojë e kësaj pozite të mbrojtësit, përgjegjësia e shtetit për sigurimin e një mbrojtjeje efektive mund të ngrihet vetëm në rrethana të caktuara.[127]

GJEDNJ është shprehur se Konventa ka për qëllim garantimin, jo vetëm të atyre të drejtave që janë teorike dhe iluzore, por të të drejtave praktike dhe efektive, duke veçuar të drejtën për mbrojtje si një e drejtë e rëndësishme në garantimin e parimit të procesit të rregullt ligjor në një shoqëri demokratike.[128]

Neni 6/3/c i KEDNJ flet për "asistencë" dhe jo "emërim". Thjesht emërimi nuk garanton ndihmën efektive pasi mbrojtësi i emëruar për ndihmë ligjore mund të vdesë, të sëmuret rëndë, t'i ndalohet ushtrimi i profesionit për një periudhë të gjatë kohore ose t'u bëjë bisht detyrimeve të tij karshi klientit. Nëse vihen në dijeni për këtë situatë, autoritetet shtetërore duhet ta zëvendësojnë atë, ose ta detyrojnë të përmbushë detyrimet. Shpesh herë mund të rezultojë që ndihma ligjore falas të jetë e pavlerë.[129]

Përgjegjësia në përmbushjen e detyrimeve të shtetit, sipas parashikimeve të Konventës, është edhe pasojë e veprimeve të organeve shtetërore. Gjykatat duhet të marrin masa që, i lejojnë mbrojtësit e caktuar kryesisht, të realizojnë sa më mirë mbrojtjen e tyre, përmes dhënies së mjeteve dhe kohës së nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes. Megjithatë, shteti nuk mund të konsiderohet përgjegjës për çdo të metë të mbrojtësit të caktuar për dhënien e ndihmës ligjore falas. Nisur nga pavarësia që profesioni i avokatit gëzon nga shteti, çdo veprim i mbrojtësit është kryesisht çështje mes të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, pavarësisht nëse mbrojtësi është zgjedhur përmes skemës së ndihmës ligjore falas ose është financuar privatisht. Autoritetet kombëtare kompetente duhet të ndërhyjnë, sipas Nenit 6/3/c të KEDNJ, nëse dështimi në dhënien e ndihmës ligjore efektive provohet ose sillet në vëmendjen e tyre në një mënyrë tjetër.[130]

Kur problemet e përfaqësimit ligjor sillen në vëmendje të autoriteteve, shteti duhet të veprojë e të mos rrijë pasiv. Nëse mbrojtja ka qenë ose jo efektive, duhet parë në varësi të rrethanave të çështjes, duke i vlerësuar procedurat gjyqësore në tërësinë e tyre.[131]

---

[127] *Mađer v. Croatia* (Application no. 56185/07), pp 159-160.
[128] *Artico v. Italy* (Application no. 6694/74), pp 33.
[129] idib.
[130] *Daud v. Portugal*, (11/1997/795/997), pp 38.
[131] *Staroszczyk v. Poland*, (Application no. 59519/00), pp 121-122; *Ebanks v. the United Kingdom*, (Application no. 36822/06), pp 71-73

Jurisprudenca shqiptare

Në Shqipëri mund të flitet për inefiçencë të mbrojtësit në shumë raste. Megjithatë, shkak i kësaj inefiçence mund të jenë si veprimet ose mosveprimet e mbrojtësit, ashtu dhe veprimet ose mosveprimet e institucioneve shtetërore.

Ndërkohë që disa mbrojtës ofrojnë përfaqësim ligjor efektiv, shpesh herë mbrojtësit e caktuar nga gjykata apo dhe ata të marrë privatisht nuk përmbushin siç duhet detyrimet e tyre për mbrojtjen e klientit, duke ndikuar në dënimin e të akuzuarit për këtë shkak. Sigurisht që drejtësia në përgjithësi ka shumë drejtime e, si rrjedhojë, ka shumë aspekte për të studiuar, por kur bëhet fjalë për drejtësinë penale, ajo çka duhet pasur parasysh është se, dënimi i të akuzuarit shkakton kufizimin e një prej të drejtave themelore të individit, të drejtën për liri. Ashtu si në të gjitha shtetet e botës, edhe në Shqipëri aftësitë profesionale të mbrojtësit bëjnë dallimin mes një dënimi me burgim të përjetshëm dhe një dënimi më të ulët, mes një dënimi relativisht të lartë apo lirimit me kusht.[132] Detyrë e organit procedues, sipas rregullave të përgjithshme procedurale që lidhen me gjykimin, është që t'i krijojë të gjitha mundësitë të akuzuarit për t'u përfaqësuar në mënyrë efektive dhe njëkohësisht të sigurohet që avokati të zbatojë detyrat e tij, përndryshe ai duhet të zëvendësohet.

Sipas parimeve të rëndësishme kushtetuese e procedurale dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të RSH, në një proces gjyqësor, avokati mbrojtës duhet të veprojë në përputhje me ligjin, standardet dhe etikën e njohur profesionale për të mbrojtur të drejtat e klientit të tij. Kur avokati vepron në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrimeve të tij në mbrojtje të të drejtave të klientit, ai shkel njëkohësisht edhe të drejtën e individit për t'u mbrojtur me avokat.[133] Avokati ka për detyrë ta ushtrojë profesionin e vet me ndershmëri dhe dinjitet, të respektojë rregullat e etikës profesionale dhe të përdorë të gjitha mjetet e ligjshme për mbrojtjen me besnikëri të të drejtave dhe të interesave të personit që mbron ose përfaqëson. Kodi Etik i Avokatit parashikon se avokati, gjatë ushtrimin të profesionit, vepron në përputhje me ligjin, Statutin, Kodin e Etikës dhe interesat e ligjshme të klientit, duke i ofruar atij shërbimet profesionale të mbështetura në gjykimin e tij më të mirë. Ai duhet të veprojë gjithnjë për interesat më të larta të klientit të tij.[134]

Organit procedues duhet të krijojë mundësitë që avokati të zbatojë me korrektesë detyrat e tij, duke qenë figurë e respektuar procedurale, e aftë për të dhënë ndihmën e

[132] Në jurisprudencën shqiptare ka pasur raste kur e njëjta kërkesë është paraqitur dy herë në gjykatë, por e përgatitur dhe hartuar nga mbrojtës të ndryshëm. Ndërsa për kërkesën e parë gjykata është shprehur se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të pretenduara, për kërkesën e dytë, të hartuar nga tjetër avokat mbrojtës, gjykata është shprehur se ka pasur cenim të këtyre të drejtave dhe ka kthyer çështjen për rigjykim (Shih vendimet nr.22, datë 11.03.2011 dhe nr.16, datë 26.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Raste të tilla tregojnë për rëndësinë e realizimit të mbrojtjes dhe përgatitjes profesionale të avokatit.

[133] Vendim nr.222, datë 04.11.2002 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.

[134] Vendim nr.54, datë 03.05.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.

kualifikuar juridike, dhe të zhvillojë një debat konstruktiv.[135] Gjykatat, nga ana tjetër, duhet të krijojnë mundësitë që avokati të bëjë një mbrojtje sa më efektive. Vetëm caktimi i avokatit nuk siguron në vetvete efektivitetin e mbrojtjes që ai mund t'i japë një të akuzuari. Ndihma juridike që i jepet të akuzuarit, dhe që kërkohet në prizmin e interesit të drejtësisë e të rolit të rëndësishëm për një proces të rregullt ligjor në një shoqëri demokratike, duhet të jetë pa paragjykime, praktike e efikase dhe jo vetëm iluzore. Megjithatë, një shtet nuk mund të mbahet përgjegjës për çdo mangësi që i atribuohet një avokati të caktuar ose të zgjedhur nga i akuzuari. Si pasojë e pavarësisë nga shteti të profesionit të avokatit, realizimi i mbrojtjes është në thelb një çështje midis të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, qoftë ky i emëruar në bazë të një skeme të ndihmës juridike ose i financuar privatisht.[136]

Jurisprudenca shqiptare njeh dhe mbron të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës shqiptare dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Aspekte të rëndësishme për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor janë informimi i menjëhershëm dhe i hollësishëm për natyrën dhe shkakun e akuzave të ngritura,[137] si dhe krijimi i lehtësive të nevojshme për realizimin e mbrojtjes.[138]

Në ditët e sotme, për realizimin e drejtësisë penale vihet theksi në rëndësinë që kanë, për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, barazia e armëve dhe kontradiktoriteti. Gjykata Kushtetuese shqiptare, në jurisprudencën e saj, është shprehur, se në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe, lidhur ngushtë me këto, realizimi i mbrojtjes së të pandehurit, ..., përbëjnë në vetvete elementet më thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.[139]

Informimi i plotë dhe i saktë për akuzat e ngritura, si dhe për kualifikimin juridik të veprës penale, duhet të konsiderohet si kusht themelor për besueshmërinë e procesit dhe për përgatitjen e duhur të një mbrojtjeje efektive, e cila është një nga garancitë themelore për realizimin e të drejtës për një proces të rregull ligjor të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së.[140]

E drejta e të akuzuarit për t'u informuar për natyrën dhe motivet e akuzës duhet të konsiderohet në këndvështrimin e të drejtës së tij për të përgatitur mbrojtjen. Kështu, nëse gjyqtarët e themelit disponojnë, kur kjo e drejtë i është njohur në të drejtën e brendshme, mundësinë për të rikualifikuar faktet, ata duhet të sigurohen që të pandehurit kanë pasur oportunitetin të ushtrojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes në mënyrë korrekte dhe efektive. Kjo do të thotë që të pandehurit duhet të informohen në kohë të përshtatshme, jo vetëm

[135] Vendim nr.15, datë 10.11.2004 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.
[136] (n 134) pp 15.
[137] Neni 31/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
[138] Neni 31/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
[139] Vendim nr.37, datë 24.12.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.
[140] Vendim nr.4, datë 10.02.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.

për motivet e akuzës, pra me faktet materiale që i atribuohen dhe mbi të cilat bazohet akuza, por edhe, dhe në mënyrë të detajuar, me kualifikimin juridik të dhënë këtyre fakteve.[141]

Për respektimin e këtyre parimeve gjykatat duhet të përmbushin me rigorozitet një sërë detyrimesh... Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykatat, me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij. Është detyrë e shtetit që të marrë masat e duhura për të garantuar pjesëmarrjen në procesin penal të personit të akuzuar ose mbrojtësit ligjor, qoftë edhe atij të caktuar kryesisht.[142]

Një aspekt tjetër që vihet re në mbrojtjen në Shqipëri është prezantimi i çështjes para Gjykatës së Lartë apo Gjykatës Kushtetuese. Shpesh herë mbrojtësit paraqesin para këtyre gjykatave pretendime që kanë të bëjnë me faktet. Mbrojtësit duhet të jenë të aftë profesionalisht, në mënyrë që të fokusojnë pretendimet e tyre në cenimin e të drejtave procedurale të të akuzuarit dhe jo prezantimin e fakteve. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se interpretimi dhe vlerësimi i provave nga gjykatat e zakonshme, nuk përbën objekt kontrolli kushtetues, sepse kjo Gjykatë mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrat e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit. Në sferën e gjykimit nga Gjykata Kushtetuese nuk përfshihet mënyra e zbatimit të ligjit material dhe e vlerësimit të provave nga ana e gjykatave të zakonshme.[143]

Gjykata Kushtetuese ka evidentuar në një proces ligjor dallimin që ekziston ndërmjet mënyrës së marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre. Ajo është shprehur se vlerësimi i provave mbetet një çështje për t'u trajtuar nga vetë gjykatat e zakonshme dhe nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët dhe mënyrat e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor e aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete.[144]

Këto janë gabime të mbrojtjes që vihen re shumë shpesh në këto gjykata.

Vlen të theksohet se ligji nr.8577, datë 1002.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në nenin 39/4

[141] ibid pp 29.
[142] Vendim nr.50, datë 01.11.2011 i Gjykatës Kushtetuese të RSH, pp.8.
[143] Vendim nr.23, datë 17.05.2010 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.
[144] Vendime nr. 95, datë datë 27.07.2001; nr. 7, datë 27.04.2005; nr. 54, datë 16.07.2010 të Gjykatës Kushtetuese të RSH.

"Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues", parashikon: "Dhoma Kombëtare e Avokatisë cakton listën e avokatëve që mund të marrin pjesë në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese". Ekzistenca e një liste të tillë ngre debate. Disa mund të pretendojnë se përcaktimi i avokatëve që mund të marrin pjesë në gjykimin kushtetues ndihmon individët për akses efektiv në këtë gjykatë. Të tjerë mund të pretendojnë se një kategorizim i tillë, së pari, kufizon aksesin përmes kufizimit të numrit të avokatëve tek të cilët mund të drejtohen individët për të paraqitur ankim në Gjykatën Kushtetuese; së dyti, shkel të drejtën e avokatëve të licencuar për të ushtruar lirisht profesionin e tyre.

" ... e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, është një nga kriteret kryesore të gjykimit të drejtë.[145] Mbrojtja duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike dhe ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve.[146]

Në garantimin e një mbrojtjeje efektive, një rol të rëndësishëm, gjithashtu, luan vendosja e një balance financiare midis organit të ndjekjes penale dhe mbrojtjes. Sigurisht, burimet financiare që ka i akuzuari ndikojnë në llojin e mbrojtjes që ai arrin të sigurojë, nëse është në gjendje të sigurojë një të tillë. Në gjykimet penale, ndihma që i ofrohet organit të ndjekjes penale nga shteti, përmes pajisjeve, burimeve, mjeteve, etj. është e pakrahasueshme me burimet dhe mjetet që ka në dispozicion i akuzuari ose mbrojtësi i tij. Si rrjedhojë, mbrojtja e të drejtave të të akuzuarit dhe garantimi i mbrojtjes efektive në gjykim bëhen gjithnjë e më të rëndësishme. Për shkak të mundësive që ka në mjete e burime, organi i prokurorisë ka mundësi më të mëdha për të marrë të dhëna e informacione, se mbrojtja. E rëndësishme është që, këto informacione, që arrin të marrë organi i ndjekjes penale, t'i vihen në dispozicion dhe mbrojtësit të të akuzuarit, me qëllim që ai të ketë akses në dokumentacion si dhe lehtësi të nevojshme për realizimin e mbrojtjes.

Përfitimet që do të sillte ekzistenca e një standardi kushtetues. Sugjerime

Standardi për efiçencë në mbrojtjen e të pandehurit në procesin penal do të garantonte që vendimet penale të ishin sa më korrekte që të ishte e mundur. Ky standard do të siguronte që sistemi i drejtësisë penale të jepte drejtësi, në kuptimin literal të kësaj fjale. Kjo drejtësi garanton një proces të drejtë ligjor si dhe mbrojtje të barabartë. Procesi i rregullt ligjor duhet t'u garantojë individëve drejtësi, jo vetëm gjatë gjykimit të çështjes në gjykatë, por njëkohësisht dhe gjatë ndjekjes penale.

[145] Vendim nr.58, datë 24.12.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH, pp 32.
[146] Vendime nr.37, datë 19.09.2011; nr.25, datë 10.06.2011; nr.5, datë 17.02.2003 dhe nr.33, datë 24.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese të RSH.

Parimi i procesit të rregullt ligjor ka për qëllim të garantojë dhënien e dënimeve sa më të drejta. Përcaktimi i fakteve dhe dhënia e përgjegjësive penale është shpesh herë e vështirë. Kjo, jo vetëm për shkak të vështirësive në gjetjen e fajtorit, por njëkohësisht për shkak se, dhe kur i akuzuari pohon kryerjen e veprës penale, jo gjithmonë është fajtor. Si rrjedhojë, për shkak se pasojat e dënimit janë të rënda, një mbrojtës efektiv është shumë i rëndësishëm. Nëse një mbrojtës nuk ka aftësitë ose njohuritë e duhura, i akuzuari mund të dënohet për këtë shkak dhe jo se është vërtet fajtor.[147]

Dënimi i të pafajshmëve nuk është i vetmi problem. Gjykatat vendosin jo vetëm mbi fajësinë e të akuzuarit, por njëkohësisht dhe masën e fajit. Performanca e keqe e mbrojtësit mund të çojë në dhënien e një dënimi më të rëndë se ai që mund të merrte i akuzuari. Në vendet që aplikojnë vendimin me vdekje, mënyra se si zhvillohet gjykimi përsa i përket realizimit të mbrojtjes ndikon drejtpërsëdrejti, jo vetëm në dënimin, por në jetën e të akuzuarit.

Procesi i rregullt kërkon gjithashtu që të akuzuarit të trajtohen në mënyrë të njëjtë. Parimet e mbrojtjes së barabartë duhet të garantojnë që sistemi i drejtësisë, i cili varet shumë nga cilësitë e mbrojtësit si: aftësitë e tij, njohuritë, morali profesional, etj., i trajton njëlloj të akuzuarit për të njëjtin veprim kriminal. Ndaj të akuzuarve, të cilët kanë kryer vepra të njëjta penale, në të njëjtat rrethana, vendimet e dhëna nuk duhet të kenë shumë ndryshime, pavarësisht aftësive profesionale të mbrojtësve të tyre respektivë.

Trajtimi i barabartë i të akuzuarve për vepra penale të njëjta, të kryera në të njëjtat rrethana, ngre dy probleme: Së pari, të akuzuar të njëjtë (për të njëjtën vepër penale, të kryer në të njëjtat rrethana) mund të kenë përfaqësime të ndryshme e aftësitë profesionale të mbrojtësve të jenë të ndryshme; Së dyti, burimet për të financuar çështjen mund të jenë të ndryshme.

Në sistemet që pranojnë caktimin e mbrojtësit kryesisht, siç është dhe Shqipëria, siguritë për trajtimin e barabartë të akuzuarve të njëjtë, janë të pakta. Njëkohësisht edhe eficenca e avokatëve të caktuar kryesisht nuk është e njëjtë. Një të akuzuari mund t'i caktohet një avokat i aftë, një tjetri një avokat jo shumë i aftë ose i paaftë. Për më tepër, përgjithësisht mbrojtësit që janë të aftë profesionalisht preferojnë të punojnë në mënyrë të pavarur, por, edhe nëse pranojnë të kryejnë mbrojtjen kryesisht e mund të jenë të aftë profesionalisht, nuk kanë kohë ose burime të mjaftueshme për të investuar në çështje dhe për të qenë efektivë.

Shumica e mbrojtjeve inefektive janë pasojë, pak a shumë, e të njëjtave shkaqe: sistem i dobët në emërimin e avokatëve mbrojtës; sistem mbrojtjeje i dobët dhe i pafinancuar; mostrajnim i duhur dhe sistematik. Një sistem drejtësie efektive duhet të

[147] Gary Goodpaster, *The adversary system, advocacy, and effective assistance of counsel in criminal cases,* 14 N.Y.U. Review of law & social change (1986), 65.

marrë masa të parandalojë këto probleme sa më shumë të jetë e mundur, duke ofruar kështu drejtësi dhe trajtim të barabartë.

Mënyra se si një gjykatë mund ta trajtojë një çështje, në pamje të parë mund të duket e drejtë, nëse ajo shihet si çështje individuale, por mund të duket e padrejtë, nëse krahasohet me çështje të tjera të ngjashme, për të cilat gjykatat kanë dhënë një dënim më të ulët. Drejtësia nënkupton dhe një standard peshimi apo kategorizimi, i cili ka për qëllim krahasimin e çështjes me çështje të tjera të ngjashme. Kështu, vrasja me paramendim ka më shumë elementë faji se vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike, prandaj dhënia e të njëjtit dënim në të dy rastet do ishte disproporcionale. Për shkak të rëndësisë thelbësore që luan mbrojtësi në gjetjen e fakteve dhe perceptimin e gjyqtarit, apo jurisë mbi rrethanat e kryerjes së krimit, mbrojtjes efektive i duhet kushtuar rëndësi e veçantë.

Pretendimi se mbrojtja inefektive nuk është problem serioz i drejtësisë penale, ul rolin e gjykatës në dhënien e drejtësisë për shkak të mosefektivitetit të mbrojtësit. Jo vetëm kaq, por një pohim i tillë do të ndikonte negativisht në ndërmarrjen e hapave konkretë për të rritur kompetencën e mbrojtësit. Vendosja e një standardi mbi eficencën e mbrojtësit nuk tenton të zgjidhë problemet e trajtimit të barabartë, që mund të vijnë për arsye të diskriminimit financiar (një i akuzuar mund të jetë i aftë financiarisht të përballojë një avokat më të mirë), si dhe nuk zgjidh problemet, që ndeshen në shumicën e çështjeve penale kur i akuzuari pranon fajësinë, megjithatë ndihmon në përpjekjet për realizimin e një sistemin sa më demokratik të drejtësisë penale me qëllim mosdënimin e të pafajshmit.

KAPITULLI IV

REALIZIMI I MBROJTJES NË RASTE TË VEÇANTA

Gjykimi i shkurtuar, personat në pamundësi ekonomike për të realizuar mbrojtjen, vetëpërfaqësimi ligjor dhe mbrojtja ligjore e detyruar

Gjykimi i shkurtuar

Gjykimi i shkurtuar sipas modeleve anglo-saksone dhe modelit shqiptar

Rregullimet ligjore shqiptare, pas rënies së regjimit totalitar, u huazuan kryesisht nga vende të tilla si Franca dhe Italia. Si rrjedhojë, shumica e Kodeve shqiptare u hartuan në përputhje me Kodet përkatëse të këtyre shteteve. Kjo solli fillimisht paqartësi në mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të dispozitave të këtyre kodeve e, më pas, rregullime e ndryshime për përshtatjen e tyre me sistemin e drejtësisë penale shqiptare.

Ndryshime të tilla pësoi dhe instituti shqiptar i gjykimit të shkurtuar. Kështu, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë i vitit 1995,[148] në mënyrë indirekte, parashikonte gjykimin e shkurtuar si institucion që lidhej me pranimin e fajësisë. Ky Kod shprehej, në Seksionin për gjykimin e shkurtuar, se në rastet e pranimit të fajësisë, gjykata e ulte dënimin me burgim me një të tretën.[149] Në këtë drejtim, ky Kod ngjasonte me praktikat dhe jurisprudencat anglo-saksone të gjykimit të shkurtuar, të cilat praktikoheshin dhe vazhdojnë të praktikohen vetëm në rastet e pranimit të fajësisë nga autori i veprës penale *(guilty pleas)*. Sipas sistemit anglo sankson, në gjykimin e shkurtuar, palët në procesin penal - i akuzuari, përmes mbrojtësit të tij, dhe prokurori i çështjes, hyjnë në negocime paraprake *(plea bargaining)* për numrin e veprave penale të kryera nga i akuzuari (kur ka disa), për masën e dënimit, etj.. Kjo, gjithmonë, kur i akuzuari pranon fajësinë për veprën penale.

Në ndryshimet e mëvonshme që pësoi Kodi shqiptar i Procedurës Penale,[150] edhe ky parashikim ligjor u ndryshua. Tashmë instituti i gjykimit të shkurtuar nuk bazohej më me pranimin e fajësisë për kryerjen e veprës penale, por konsiderohej si një mjet i veçantë që përdorej për ekonomi gjyqësore, për shkak të thjeshtimit dhe shkurtimit të

[148] Ligj nr.7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë".
[149] ibid, neni 406, pika 1.
[150] Ligj nr. 8813, datë 13.06.2002 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë"".

procedurave, rritjes së shpejtësisë dhe efektivitetit të gjykimit dhe sillte si pasojë përfitimin e të pandehurit në uljen e dënimit me një të tretën.[151]

A ishte kjo një zgjidhje e drejtë? Humbiste apo fitonte i akuzuari përmes ndryshimit së kësaj dispozite? Cilat janë avantazhet e përdorimit të gjykimit të shkurtuar në sistemet anglo-sanksone? Sa të rëndësishme janë negocimet paraprake mes palëve, para gjykimit të çështjes?

Roli ndërmjetësues i mbrojtësit në gjykimin e shkurtuar

A ka mbrojtësi një rol ndërmjetësues në negocimet për gjykim të shkurtuar në çështjet penale?

Një skenar shumë i njohur në sistemet e *common law* është ai i mbrojtësit të një të akuzuari për vrasje, i cili paraqitet në zyrën e prokurorit të çështjes me qëllim që të mundësojë gjykim të shkurtuar të çështjes së klientit të tij. I akuzuari pretendon se nuk e ka therur viktimën, ndërkohë që prokurori pretendon se ka evidencë të mjaftueshme për të kundërtën. I akuzuari pretendon se është i pafajshëm dhe se duhet shfajësuar. Prokurori kërkon t'i jepet maksimumi i dënimit të parashikuar në ligj. Nga leximi i materialeve që përbëjnë evidencën e prokurorit, mbrojtësi kupton se evidencat që ka prokurori nuk janë të mjaftueshme për të dënuar klientin e tij me vdekje, megjithatë, për shkak të eksperiencës që ka në këtë profesion, kupton se dhe shanset e shfajësimit janë të pakta. Sipas mendimit të mbrojtësit, zgjidhja më e pranueshme është ajo e gjykimit të shkurtuar, përmes të cilit klienti i tij pranon kryerjen e veprës penale për një reduktim të dënimit, duke i dhënë mundësinë prokurorisë që të ndihet se ka "marrë hak" ndaj të akuzuarit për kryerjen e veprës penale. Me këtë qëllim në mendje mbrojtësi paraqitet në zyrën e prokurorit. Në këto rrethana, detyrë e mbrojtësit është gjithashtu të bindë klientin e tij se kjo është zgjidhja më e mirë.[152]

Në shumicën e rasteve, ky skenar është pjesë e praktikës standarde të avokatit mbrojtës. Roli i mbrojtësit në raste të tilla është pikërisht ai i ndërmjetësuesit, duke u përpjekur të bashkëkoordinojë pozicionin e të akuzuarit dhe atij të prokurorisë, përmes përdorimit të taktikave të influencës si dhe dhënies së përshtypjes së përdorimit të forcës. Është pikërisht mbrojtësi, dhe jo gjykata ose palët në gjykim, i cili luan këtë rol: ndërmjetësimin e palëve në gjykim.

Në shumë sisteme të huaja penale, e sidomos në sistemet ligjore anglo-amerikane, gjykimet e shkurtuara janë, gjithnjë e më tepër, pjesë e *modus operandi* në çështjet penale. Gjykimi i shkurtuar është rezultat i negocimeve, në shkallë të ndryshme të

[151] Vendim Unifikues nr.2, datë 29.01.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
[152] Gabriel Hallevy, *The Defense Attorney as mediator in plea bargains*, Yale Law Journal, Vol. 9, 2009.

procedimit, mes prokurorisë dhe të akuzuarit lidhur me fatin e çështjes penale. Gjykimi i shkurtuar mund të arrihet në shkallë të ndryshme të procedimit penal, që nga momenti kur prokuroria ka dërguar çështjen në gjykatë, gjatë gjykimit, ose madje dhe gjatë apelimit.[153]

Në gjykimin e shkurtuar pushteti për të përcaktuar fatin e çështjes i kalon palëve, të cilat përcaktojnë termat e "kontratës së tyre". Palët mund të arrijnë marrëveshje për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procedimin penal e që përfshihen brenda pushtetit të tyre, si p.sh.: për akuzat, seriozitetin e tyre, numrin e akuzave, masën e dënimit, etj. Prokuroria mundet, gjithashtu, të ulë pretendimet e saj lidhur me dënimin që kërkohet t'i jepet të akuzuarit, duke pranuar një dënim më të ulët se dënimi maksimal i parashikuar me ligj. I akuzuari i pranon këto ulje, bashkëpunon dhe pranon akuzat e ngritura ndaj tij. Megjithëse gjykatat nuk përfshihen në detajet e marrëveshjes për gjykim të shkurtuar, ato kanë të drejtë të refuzojnë kërkesën, pavarësisht se kjo mund të ndodhë rrallë.

Në sistemin e drejtësisë penale që zbatohet kryesisht në sistemet ligjore anglo-amerikane, seanca gjyqësore zhvillohet në formën e një konfrontimi ligjor mes palëve të përfshira në çështje, ndërkohë që gjykata është e detyruar të vendosë për argumentet e tyre respektivë. Palët luajnë një rol shumë të rëndësishëm gjatë procedurave, ndërkohë që roli i gjykatës është pasiv, i kufizuar kryesisht në përcaktimin e konfliktit mes tyre.

Zgjidhja e konfliktit mes prokurorisë dhe të akuzuarit, jashtë gjykatës, në sistemet ligjore anglo-amerikane realizohet përmes gjykimit të shkurtuar. Palët e marrin vetë përsipër zgjidhjen e këtij konflikti. Përmes veprimit në këtë mënyrë, palët "privatizojnë" procesin penal. Megjithatë, duke qenë se gjykimet e shkurtuara përfshijnë një interes publik substancial, gjykata është e detyruar të miratojë çdo marrëveshje, me qëllim që të mbrojë këto interesa si dhe të sigurohet që atyre t'u jepet rëndësia e duhur.[154]

Në gjykimet e shkurtuara të *common law* ka dy lloj negocimesh mes palësh: negocimi i mbrojtësit me klientin e tij dhe negocimi i mbrojtësit me prokurorin e çështjes.

Procesi i ndërmjetësimit ka katër karakteristika kryesore:

- autonomia e palëve dhe e drejta e tyre për vetëvendosje,
- pëlqimi me shkrim i palëve,
- drejtësia,
- neutraliteti.

Këto karakteristika rrjedhin nga një perceptim i përgjithshëm mbi karakteristikën e ndërmjetësimit, objekti i të cilit është zgjidhja e mosmarrëveshjeve mes palëve përmes kryerjes së veprimeve e marrjes së masave për arritjen e një konsensusi, gjithmonë

[153] ibid, 3. KPP shqiptare, në nenet 403-404, parashikon se kërkesa për gjykim të shkurtuar paraqitet nga i akuzuari ose mbrojtësi i tij i posaçëm derisa të mos jetë filluar shqyrtimi gjyqësor. Kur gjykata çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, vendos gjykimin e shkurtuar. Në të kundërtën refuzon kërkesën.

[154] ibid, 5.

përmes ndihmës së një pale të tretë, e cila nuk ka autoritetin ligjor për të paracaktuar rezultatin e marrëveshjes ose të detyrojë arritjen e saj.

Autonomia e palëve. Në vetvete, gjykimi i shkurtuar nuk është asgjë më shumë se një kontratë mes të akuzuarit dhe organit të ndjekjes penale. I akuzuari nuk është i detyruar të pranojë gjykimin e shkurtuar ose të marrë pjesë në negociatat për të. Gjykimi i shkurtuar është rrjedhojë e dëshirës së palëve. Autonomia që u jepet palëve në gjykimin e shkurtuar do të thotë liri në zgjidhjen, në mënyrë të pavarur, të mosmarrëveshjes. Megjithatë, kjo liri kufizohet për shkak të interesit publik. Duke qenë se prokuroria është përgjegjëse për interesin publik, ky organ duhet të marrë parasysh këtë interes gjatë negociatave për gjykimin e shkurtuar.

Palët në këtë ndërmjetësim zgjedhin, në mënyrë të pavarur, negocimin për gjykim të shkurtuar. Ato nuk janë të detyruara të zgjidhin konfliktet e tyre përmes negocimit. Mbrojtësi ose i akuzuari mund të mos pranojnë gjykimin e shkurtuar dhe të kërkojnë gjykimin normal të çështjes. Duke hyrë në negocime për gjykim të shkurtuar, palët shprehin vullnetin e tyre për këtë lloj gjykimi.

Pëlqimi me shkrim. Pëlqimi me shkrim është një element thelbësor i gjykimit të shkurtuar. Me qëllim që palët të vlerësojnë drejtë rreziqet dhe mundësitë e gjykimit të shkurtuar, ato duhet të njihen plotësisht me evidencat për çështjen.

Pëlqimi me shkrim si formë e ndërmjetësimit të mbrojtësit shpreh autonominë e palëve dhe të drejtën e tyre për vetëvendosje. Përmes pëlqimit me shkrim theksohen dy fakte të rëndësishme. Së pari, që palët kanë rënë dakord të zgjidhin konfliktin mes tyre përmes një procesi alternativ, duke rënë dakord mbi mënyrën e zgjidhjes së konfliktit. Kjo mënyrë ndryshon nga mënyra tradicionale e zgjidhjes së konfliktit përmes forcës detyruese që ka vendimi i gjykatës. Së dyti, thekson se kjo marrëveshje kryhet me pëlqimin e palëve. Pëlqimi me shkrim nënkupton që palët kanë në dispozicionin e tyre të gjithë informacionet e nevojshme për të vendosur për marrëveshjen. Ky pëlqim është një lloj marrëveshjeje mbi të gjitha pikat që vihen për diskutim nga palët. Mosdhënia nga palët e gjithë informacionit të nevojshëm, manipulimi ose dredhitë janë të papranueshme në gjykimin e shkurtuar. Në vendimin që marrin, palët duhet të jenë të sigurta që kanë marrë gjithë informacionin mbi çështjen.

Informacioni mund të përmbajë dhe të dhëna të tilla si: identitetin e gjyqtarit që do të gjykojë çështjen, pozicionin që ai ka mbajtur në çështje të ngjashme, politikën e organit të ndjekjes penale në raste veprash penale të njëjta ose të ngjashme, të dhëna statistikore mbi dënimin ose ashpërsinë e tij, statistika mbi numrin e dënimeve për çështje të tilla. Gjithsesi, lloji i evidencës për çështjen dhe interpretimi ligjor i saj janë faktet kryesore me të cilat palët duhet të njihen para se të fillojnë bisedimet për gjykim të shkurtuar.

Sigurisht, informacioni që jepet duhet të jetë i dyanshëm, pasi pabarazia në këtë drejtim do t'i jepte avantazh të padrejtë njërës palë në kurriz të palës tjetër. Pëlqimi me shkrim është një faktor i rëndësishëm në ndërmjetësimin për arritjen e marrëveshjes për gjykimin e shkurtuar. Roli i mbrojtësit në këtë rast është mundësimi i aksesit në informacione të rëndësishme për çështjen, sidomos në informacione të cilat ndihmojnë rolin e tij si ndërmjetësues, si dhe t'i sjellë ato në vëmendjen e palëve, nëse këto të fundit nuk kanë dijeni për këto informacione.

Një fakt i tillë ngre pyetjen nëse mbrojtësi plotëson kriteret e ndërmjetësuesit në negocimet për gjykimet e shkurtuara, sidomos kur bëhet fjalë për dhënie informacionesh organit të prokurorisë, informacione që kanë të bëjnë me mbrojtjen e klientit të tij.

Drejtësia. Karakteristikat e drejtësisë gjatë ndërmjetësimit janë të ndryshme nga karakteristikat e drejtësisë që duhet pasur parasysh e zbatuar gjatë gjykimit të çështjes. Kjo për shkak të natyrës së ndryshme të procesit të ndërmjetësimit nga ai i gjykimit. Ndërsa drejtësia gjatë procedurave gjyqësore ka të bëjë me garantimin e kushteve objektive dhe mungesën e subjektivizmit dhe favoreve, drejtësia në procesin e ndërmjetësimit ka të bëjë kryesisht me mundësinë e palëve që të realizojnë lirinë e tyre për të vendosur vetë, në mënyrë të pavarur.[155]

Drejtësia gjatë procesit të ndërmjetësimit ka për qëllim parandalimin e një zgjidhjeje të detyrueshme të çështjes. Si rrjedhojë, karakteristikat kryesore janë procedurale dhe kanë të bëjnë me mënyrën se si zhvillohet procesi i ndërmjetësimit. Vështirësia kryesore në zhvillimin e një procesi të drejtë ndërmjetësimi ka të bëjë me faktin se ky proces nuk bazohet në procedura formale strikte. Ka pasur madje dhe nga ata që kanë propozuar vendosjen e disa kritereve për garantimin e drejtësisë së këtij procesi, me qëllim që të lehtësohet mundësia e dialogut mes palëve, për të balancuar pikat e forta të secilës palë, për të garantuar mungesën e njëanshmërisë së ndërmjetësuesit si dhe të inkurajojë vendimmarrjen me pëlqimin e të dy palëve.

Drejtësia gjatë ndërmjetësimit është e ndryshme nga ajo gjatë gjykimit. Gjykimi i shkurtuar nuk është një marrëveshje objektive pasi reflekton negociata kontraktuale mes palëve. Megjithatë, gjykimi i shkurtuar paraqet, pjesërisht, mundësinë e palëve për të realizuar lirinë e tyre të zgjedhjes brenda kuadrit të autonomisë dhe lirisë së tyre për të vetëvendosur. E drejta e palëve për të vendosur në këtë rast është minimizimi i rreziqeve që mund të vijnë si rrjedhojë e zhvillimit të gjykimit, duke vepruar në favor të një zgjidhjeje të përbashkët të rezultatit të procesit. Pra, drejtësia në gjykimin e shkurtuar qëndron në lejimin e palëve për të realizuar të drejtën e tyre për vetëvendosje.

[155] Sarah R. Cole, Craig A. McEwen & Nancy H. Rogers, *Mediation: law, policy, practice* § 2:2 (2d ed., 2001); Joseph P. Stulberg, *Fairness and Mediation*, 13 Ohio State Journal on Dispute Resolution, (1998), 910-14.

Negociatat e zhvilluara nga palët gjatë gjykimit të shkurtuar kryhen përmes dialogut. Gjykimi i shkurtuar vepron për të balancuar marrëdhënien disproporcionale mes prokurorisë dhe të akuzuarit, përmes garantimit që asnjë nga palët të mos dalë "duarbosh" nga negociatat. Ky fakt, në vetvete, ka nevojë për kompromis. Megjithëse gjykimi i shkurtuar nuk garanton arritjen e një ekuilibri të plotë mes palëve, paraqet një hap substancial përpara në arritjen e këtij qëllimi. Pavarësisht se, gjatë procesit të ndërmjetësimi, njëra nga palët do të mbetet dominuese, për shkak të burimeve dhe mundësive më të mëdha që ka në krahasim me palën tjetër, procesi i ndërmjetësimit ndikon në neutralizimin e këtyre avantazheve.

Neutraliteti. Karakteristikat e paanshmërisë kanë të bëjnë me lidhjen direkte që ekziston mes ndërmjetësuesit dhe palëve në këtë proces. Që veprimet e ndërmjetësuesit të jenë të paanshme, është e nevojshme që ai të mos shfaqë njëanshmëri, të mos ketë konflikte interesi me palët, si dhe të mbajë një "distancë" të barabartë mes të dy palëve në procesin e ndërmjetësimit. Mbrojtësi, gjatë procesit të ndërmjetësimit, nuk duhet të kryejë asnjë veprim që mund të shihet si favorizues ose i njëanshëm nga njëra palë, nuk duhet të shfaqë paragjykime e nuk duhet të bëjë komente personale mbi karakteret e palëve dhe sjelljen e tyre. Në rast se ndërmjetësuesi nuk mund të jetë i paanshëm, ose në rast se objektiviteti i tij mund të vihet në rrezik për shkak të formimit të tij, eksperiencës ose marrëdhënies personale ose profesionale me njërën nga palët, ai duhet të japë dorëheqjen.

Neutraliteti ka të bëjë me formimin e ndërmjetësuesit dhe marrëdhënien e tij me palët, duke përfshirë çdo lloj shoqërimi të tij të mëparshëm me njërën nga palët, ekzistencën e interesave personale që ndërmjetësuesi mund të ketë nga procesi i ndërmjetësimit. Paanshmëria nënkupton objektivitet dhe drejtësi ndaj palëve gjatë procesit të ndërmjetësimit. Pra, paanshmëria duhet trajtuar si pjesë përbërëse e pazëvendësueshme e procesit të ndërmjetësimit, ndërsa neutraliteti duhet parë si një proces më pak absolut.

Efektiviteti i mbrojtësit në gjykimet e shkurtuara sipas jurisprudencës amerikane

Gjykimi i shkurtuar shihet si një institut i rëndësishëm i të drejtës penale, si mënyrë e veçantë procedimi, që ka në vetvete dy qëllime të rëndësishme:

- sigurimin e një prove të fortë: pohimin e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale;
- ekonominë gjyqësore, përmes shmangies së procedurave gjyqësore të tejzgjatura.

Shumë çështje penale zgjidhen përmes përdorimit të gjykimit të shkurtuar. Eksperienca shumëvjeçare ka treguar se ka pasur plot raste të pranimit të fajësisë dhe

gjykimit të shkurtuar nga persona që nuk kanë kryer veprën penale. Kjo ka sjellë nevojën e ekzistencës së një mbrojtjeje efektive dhe në rastet e gjykimeve të shkurtuara. Sigurisht që, vendosja e standardit të efiçencës së mbrojtësit në gjykimet e shkurtuara, nuk ndihmon shumë në zgjidhjen e problemit të inefiçencës dhe, njëkohësisht, është i vështirë të zbatohet në shumicën e rasteve penale. Kjo për shkak se nuk është e lehtë të provohet inefiçenca e mbrojtësit, pasi vetë dosja gjyqësore nuk ka shumë materiale, që mund të mbështesin një pretendim të tillë. Në gjykimet e shkurtuara mungon pyetja e dëshmitarëve dhe çështja zgjidhet në gjendjen që janë aktet që përmban dosja gjyqësore.[156]

Në rastet e gjykimit të shkurtuar, mbrojtësi duhet të vlerësojë, sipas njohurive që ka për çështjen, si dhe duke pasur parasysh tendencën që mund të ketë gjyqtari në vendimmarrje të tilla, zgjedhjen, ose jo, të gjykimit të shkurtuar në vend të një gjykimi normal. Në këto raste, një "vendim i drejtë" nënkupton një vendim të arsyeshëm në këto rrethana.

Jurisprudenca amerikane është e pasur me vendime që i kushtojnë rëndësi të veçantë mbrojtjes efektive në gjykimet e shkurtuara. Kështu, në vitin 1961, Clarence Earl Gideon kishte nevojë për mbrojtës, por nuk kishte mjete financiare për të marrë një të tillë. Pavarësisht kërkesës së tij për caktimin e një mbrojtësi kryesisht, gjyqtari i gjykatës së Florida-s mendonte se ligji e ndalonte mbrojtësin kryesisht për rastin e tij. Pavarësisht se Gideon realizoi mbrojtjen e tij në gjykim, ashtu siç do ta kishte realizuar çdo njeri i thjeshtë, juria e dënoi dhe gjyqtari vendosi burgimin e tij për pesë vjet.

Pas ankimit në Gjykatën Supreme të SHBA,[157] bazuar në Amendamentin e 6 të Kushtetutës amerikane për sigurimin e të drejtës së mbrojtjes, kërkesa e tij u pranua. Gjykimi për herë të dytë i çështjes së tij u krye në praninë e një mbrojtësi, i cili luajti një rol shumë të rëndësishëm.

Dyzet vjet më vonë, më 21 Mars 2012, GJS, për herë të parë në historinë e saj, pranoi se të akuzuarit kanë një të drejtë kushtetuese për një asistencë efektive në rastet e gjykimeve të shkurtuara *(guilty pleas)*. Interpretimi që i bëri Gjykata Supreme kësaj të drejtë ishte shumë i ndryshëm nga interpretimet e bëra më parë nga kjo Gjykatë rasteve të gjykimeve të shkurtuara. Gjykata shkoi dhe më tej, duke u shprehur se, nëse mbrojtësi ka vepruar në kundërshtim me etikën ose ka dhënë këshillim dukshëm të gabuar, duke nxitur klientin e tij për gjykim normal të çështjes, në përfundim të të cilit të akuzuarit i është dhënë një dënim më i rëndë se ai që mund t'i jepej nga gjykimi i shkurtuar, sipas kësaj Gjykate, të akuzuarit i duhet dhënë një shans i dytë për të kërkuar gjykim të shkurtuar.

GJS u shpreh për këtë në dy çështje. Në njërën çështje, Galin Frye, një student kolegji në Misuri ishte dënuar për herë të katërt për veprën penale të dhënies së makinës,

[156] Në analogji Kodi i Procedurës Penale të RSH, nenet 403-406.
[157] *Gideon v. Wainwright*, 372 U.S. 335, 342 (1964).

pa patentë, për shkak se i ishte hequr e drejta për t'i dhënë makinës.[158] Prokurori i dërgoi mbrojtësit të Frye një letër duke i ofruar uljen e dënimit, nëse pranonte fajësinë dhe dënimin e tij me 90 ditë burgim. Avokatit iu la një afat për t'u shprehur për ofertën. Pavarësisht nga kjo, mbrojtësi nuk ia bëri këtë të ditur klientit të tij. Pas kalimit të këtij afati, Fryer, i painformuar për ofertën, pranoi gjithsesi fajësinë pa përfituar nga ulja e dënimit dhe u dënua me tre vjet burgim, më shumë se dhjetë fishi i periudhës kohore të ofertës.

Në rastin e dytë, Anthony Cooper[159] u dënua për veprën penale të plagosjes, me qëllim vrasjen, pasi qëlloi katër herë një grua në kofshë. Prokuroria ofroi dy herë gjykim të shkurtuar me një dënim prej 4-7 vjet, por mbrojtësi i Cooper-it e këshilloi atë ta refuzonte ofertën, me pretendimin se legjislacioni i Miçiganit nuk jepte dënimin e tentativës për vrasjeje, nëse plagët ishin marrë poshtë belit. Këshilla ishte totalisht e gabuar dhe Cooper u dënua për një periudhë kohore tre fishi i asaj të ofruar.

Në të dy rastet, shtetet respektive pranuan se avokatët kishin kryer mbrojtje inefektive ndaj klientëve të tyre. Në Mars 2012, në një votim 5 me 4, GJS u shpreh se realiteti është se pjesa më e madhe e dënimeve të dhëna janë rezultat i gjykimeve të shkurtuara. E drejta për mbrojtje duhet garantuar dhe në gjykimet e shkurtuara. Në shumicën e rasteve, çështja se kush shkon në burg dhe për sa kohë përcaktohet nga ky lloj gjykimi.

GJS u bëri me dije gjykatave më të ulëta se, në përputhje me legjislacionet e secilit shtet, të akuzuarve u duhet dhënë një shans i dytë për të kërkuar gjykimin e shkurtuar dhe për të pranuar ofertën fillestare të prokurorisë, nëse të akuzuarit arrijnë të provojnë se do ta kishin pranuar që në fillim ofertën, se prokuroria nuk do ta kishte tërhequr atë dhe se gjyqtari do e kishte miratuar.

Galin Frye dhe Anthony Cooper nuk dëshironin gjykimin, por ashtu si Gideon kishin nevojë për asistencë efektive në mbrojtje. Ata dëshironin që të pranonin fajësinë dhe të merrnin dënimin më të preferueshëm të mundshëm. Që të dy kishin mbrojtës që dështuan në këtë drejtim. Mbrojtësi i Frye neglizhoi t'i tregonte atij për ofertën e gjykimit të shkurtuar. Mbrojtësi i Cooper i mbushi atij mendjen të refuzonte ofertën për gjykim të shkurtuar, duke i dhënë këshillim të gabuar në lidhje me shanset e tij në gjykim.

Gideon kishte nevojë për përfaqësim në gjykim. Vendimi për çështjen Gideon tregoi se edhe një njeri i thjeshtë, inteligjent dhe i edukuar, kishte pak ose aspak njohuri në shkencën e ligjit e, si rrjedhojë, garantimi i mbrojtjes është një element i rëndësishëm procedural. Në çështjet Frye dhe Cooper u ngrit nevoja e pasjes së një sistemi efektiv të gjykimeve të shkurtuara.[160]

---

[158] *Missuri v. Frye*, 132 S. Ct. 1399 (2012).
[159] *Lafter v. Cooper*, 132 S.Ct. 1376 (2012).
[160] Jenny Roberts, *Effective Plea Bargaining Counsel*, The Yale Law Journal , Vol 122, No.100 (2013), 102.

Jurisprudenca e fundit e GJS për gjykimin e shkurtuar tregon qartë se negocimet për gjykimin e shkurtuar janë fazë me rëndësi kritike në çështjet penale përsa i përket të drejtës për mbrojtje efektive. Jo vetëm kaq, por këto çështje tregojnë qartë se gjykimi i shkurtuar nuk është shtojcë e sistemit të drejtësisë penale, por vetë sistemi.[161] Kjo mbështetet nga fakti se shumica e çështjeve penale përfundojnë me gjykim të shkurtuar.

Lindin pyetjet: nëse negocimi është fazë kritike në një sistem që konsiston, në shumicën e rasteve, në gjykim të shkurtuar të çështjeve penale, a ka një të drejtë kushtetuese për mbrojtje efektive në gjykimet e shkurtuara? A është e mundur të përcaktohen konturet e kësaj të drejte, qoftë dhe në përgjithësi? Cilat janë standardet profesionale që duhen pasur parasysh kur bëhet fjalë për mbrojtje joefektive në gjykimet e shkurtuara?

Gjykata Supreme e SHBA ka shënuar një epokë të re në rregullimet kushtetuese të gjykimit të shkurtuar. Në çështjen *Padilla v. Kentucky*[162] u vendos se të akuzuarit kanë të drejtë kushtetuese për këshillim nga mbrojtësi i tyre lidhur me deportimin si pasojë e dënimit. Në çështjen *Missuri v. Frye* GJS u shpreh se mbrojtja ishte joefektive për shkak se nuk i komunikoi klientit të tij ofertën e prokurorisë për gjykim të shkurtuar. Në çështjen *Lafler v. Cooper* GJS u shpreh se të akuzuarit që, për shkak të këshillimit të keq të dhënë nga mbrojtësit e tyre, refuzonin ofertën për dënim më të ulët dhe pranonin gjykimin normal, i cili sillte si pasojë një dënim më të rëndë, kishin mundësinë e ndreqjes së këtij gabimi.

Këto çështje kanë të bëjnë me të drejtën e të akuzuarit për t'u informuar si dhe këshillimin e tij mbi ofertën e gjykimit të shkurtuar. Detyra e mbrojtësit është të negociojë e të bëjë marrëveshje efektive në mënyrë që të shmangë pasojat e padëshiruara nga klienti i tij/i akuzuari. Këto negocime janë thelbësore për funksionin kryesor të mbrojtjes, për shkak se dhe dënimet më të ulëta ndikojnë në jetën e përditshme si: në benefitet sociale, punësim, strehim, etj. Rekordet kriminale shpesh herë janë lehtësisht të aksesueshme përmes databazëve. Pra, çdo kontakt me drejtësinë penale ndikon jetët e individëve në mënyra të tilla që para 10 vjetësh ishin të paimagjinueshme.

Jose Padilla ishte qytetar i ligjshëm në SHBA. Ai u arrestua me një sasi të madhe marijuane në kamionin që drejtonte. Megjithëse kishte fëmijë që ishin shtetas amerikanë, kishte shërbyer si ushtar i SHBA në luftën kundër Vietnamit dhe se gjatë 40 vjetëve kishte udhëtuar vetëm një herë, për një periudhë dy javore, në vendin e tij të lindjes - Honduras, u gjend përballë deportimit për shkak të trafikimit të marijuanës si joshtetas amerikan. Në padijeni për pasojat, Padilla pranoi gjykimin e shkurtuar për shkak të këshillimit të gabuar që i dha mbrojtësi i tij se "nuk duhej të shqetësohej për statusin e tij

[161] Robert E. Scott & William J. Stuntz, *Plea Bargaining as Contract*, 101 Yale Law Journal (1992), 1909-12.
[162] *Padilla v. Kentucky*, 130 S. Ct. 1473 (2010).

të emigrantit, pasi kishte ndenjur në SHBA për një kohë kaq të gjatë". Për pasojë, ai u përball me situatën e deportimit të tij nga SHBA. Në vendimin *Padilla v. Kentucky*, GJS u shpreh se mbrojtësit kanë detyrimin kushtetues t'u japin këshillimin e duhur klientëve të tyre lidhur me pasojat e deportimit të menjëhershëm në rastet e pranimit të fajësisë.

Ky përbën pikërisht dhe standardin e parë për mbrojtjen efektive: të treguarit se veprimet ose ometimet e mbrojtësit ishin të paarsyeshme nga ana profesionale. Zgjidhja racionale e çështjes do të kishte qenë mospranimi i ofertës për gjykim të shkurtuar, çka do të lejonte atë të qëndronte në SHBA. Maksimumi i dënimit që mund të kishte marrë do të kishte qenë 10 vjet, ndër të cilat pesë vjet burgim e pesë lirim me kusht.

Në rastin e Frye, i akuzuari përballej me veprën penale të dhënies së makinës pa licencë, me një dënim maksimal prej katër vjetësh. Prokuroria i dërgoi mbrojtësit të Frye një letër oferte me dy mundësi zgjedhjeje: dënimin me 90 ditë në burg për kundravajtje penale ose 10 ditë burgim të shoqëruar me lirim me kusht. Kjo ofertë ishte e hapur deri në seancën tjetër të gjyqit. Mbrojtësi nuk i tha Fryer-it asgjë për ofertën dhe afati përfundoi. Pak para shfaqjes së tij para gjykatës, Fryer u riarrestua për të njëjtën vepër penale. Ai pranoi fajin, pa ditur për ofertën e mëparshme, dhe gjyqtari e dënoi me tre vjet burgim. GJS u shpreh për çështjen, se mos komunikimi nga ana e avokatit i ofertës për gjykim të shkurtuar, cenonte të drejtën e Frye për mbrojtje efektive.[163]

Në të njëjtën ditë GJS vendosi dhe për çështjen e Cooper, përmes të cilës u shpreh për mundësinë e riparimit të pasojave të ardhura si rezultat i këshillimit inkompetent, që çon një të akuzuar të refuzojë një ofertë favorizuese. Cooper u akuzua për plagosje me qëllim vrasjeje. Prokuroria i ofroi atij fillimisht 51-85 muaj burgim dhe shuarje të disa akuzave. Fillimisht Cooper u shpreh para gjykatës se ishte fajtor dhe shprehu dëshirën të pranonte ofertën, por pas diskutimeve me mbrojtësin e refuzoi atë, pasi mbrojtësi e këshilloi se do të ishte e vështirë për prokurorinë të provonte qëllimin për vrasje pasi viktima ishte goditur poshtë belit. Gjatë gjykimit Cooper refuzoi dhe një ofertë tjetër. Ai u dënua (pavarësisht se ku e kishte goditur viktimën, fakt që s'ishte aspak mbrojtje) me 185 - 360 muaj burgim.

Lidhur me këtë çështje GJS u shpreh se, nëse nuk do të kishte dëgjuar këshillimet e mbrojtësit, Cooper do të kishte pranuar ofertën e gjykimit të shkurtuar dhe do të kishte marrë një dënim 3 herë e gjysmë më të ulët se ai që i ishte dhënë nga gjykata. GJS i kërkoi organit të prokurorisë të riparaqiste ofertën origjinale.

Që të tre këto vendime analizuan kërkesat për mbrojtje joefektive, në kontekstin e drejtësisë penale që ka të bëjë me gjykimet e shkurtuara. Sistemet e sotme të drejtësisë penale janë sisteme me sanksione penale potencialisht të rënda dhe pasoja dytësore që lidhen me to. Në këto sisteme rol i mbrojtësit është gjithashtu negocimi efektiv. Sigurisht, rregullimi i negocimeve për gjykimin e shkurtuar mund të jetë i vështirë për t'u

[163] Jenny Roberts, *Effective Plea Bargaining Counsel*, The Yale Law Journal, Vol 122, No.100 (2013), 102.

rregulluar, megjithatë çështje të tilla tregojnë për mbështetjen që jurisprudenca i jep të drejtës për mbrojtje efektive.

Gjykimi i shkurtuar sipas sistemit shqiptar

Sipas jurisprudencës shqiptare, gjykimi i shkurtuar përbën një lloj të veçantë gjykimi. Kërkesa për gjykim të shkurtuar mund të bëhet derisa të mos jetë filluar shqyrtimi gjyqësor dhe nuk mund të riparaqitet më kur ai ka filluar. Kur shqyrtimi gjyqësor ka filluar me gjykim të zakonshëm, nuk mund të vazhdohet më tej me gjykim të shkurtuar.[164]

Kërkesa për gjykim të shkurtuar paraqitet në gjykatë nga i akuzuari. Gjyqtari i çështjes, pasi vlerëson nëse çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, vendos gjykimin e shkurtuar. Pra, gjykimi i shkurtuar realizohet përmes kërkesës së të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit. Gjyqtari, nëse për dhënien e drejtësisë konsideron të nevojshëm zhvillimin e një gjykimi normal, ka të drejtë të rrëzojë kërkesën e të akuzuarit për gjykim të shkurtuar.[165]

Gjykimi i shkurtuar, si gjykim i posaçëm, në thelb të tij ka pranimin e akteve të grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak dhe eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Ky gjykim eviton fazën e hetimit gjyqësor. Me pranimin e kërkesës për të vazhduar me gjykim të shkurtuar, dosja e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore dhe shërben për t'u bazuar në parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare të palëve dhe për dhënien e vendimit nga gjykata.

Gjykimi i shkurtuar dallon nga gjykimi i zakonshëm pasi i mungon faza e marrjes së provave dhe kërkesat lidhur me pavlefshmërinë e tyre. Në rast se palët kanë pretendime lidhur me pavlefshmërinë e akteve, qofshin pavlefshmëri absolute apo relative dhe kërkojnë konstatimin apo deklarimin e kësaj pavlefshmërie, gjykata revokon vendimin për gjykim të shkurtuar dhe urdhëron vazhdimin e procedimit me gjykim të zakonshëm. Përpara se të marrë vendimin për pranimin e kërkesës, gjykata duhet të shqyrtojë me imtësi aktet e dosjes. Në rast se konstaton paraprakisht pavlefshmëri të tyre

[164] Vendim Unifikues nr.2, datë 29.01.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
Edhe në sistemet anglosaksone negocimet për gjykimin e shkurtuar bëheshin para shqyrtimit të çështjes nga gjykata. Që nga viti 2012, GJS e SHBA ndryshoi jurisprudencën e saj duke lejuar mundësinë e dhënies së të akuzuarit të një shansi të dytë për përfitimin nga gjykimi i shkurtuar edhe gjatë gjykimit të çështjes, për aq kohë sa ka një ofertë nga ana e prokurorisë për këtë lloj gjykimi. Sipas këtyre sistemeve, organi i prokurorisë paraqet një ofertë që, në rast se i akuzuari pranon fajësinë dhe, si rrjedhojë, gjykimin e shkurtuar të çështjes, përfiton ulje të dënimit. Paraprakisht kjo ofertë vlerësohet nga i akuzuari. Pas pranimit të gjykimit të shkurtuar nga palët, pranimi ose jo i këtij lloj gjykimi vlerësohet gjithashtu dhe nga gjyqtari i çështjes.
[165] Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 404, pika 1.

dhe është, për këtë shkak, në pamundësi për të dhënë një vendim të bazuar, ajo refuzon që në fillim kërkesën për gjykim të shkurtuar.

Konsensusi i prokurorit nuk është kusht i domosdoshëm që gjykata të pranojë kërkesën e të akuzuarit për të proceduar me gjykim të shkurtuar. Kjo justifikon edhe të drejtën që ka prokurori për të bërë ankim kundër vendimit të gjykatës për pranimin e gjykimit të shkurtuar, ankim që mund të paraqitet së bashku me ankimin kundër vendimit përfundimtar.[166]

Gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore, sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin në uljen në një 1/3 e masës së dënimit dhe mosaplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm. Megjithatë, siç janë shprehur shpesh herë gjykatat shqiptare, ky përfitim nuk duhet të shkojë në dëm të dhënies të drejtësisë. Pra, kërkesën e të dënuarit dhe të mbrojtësit të posaçëm të tij, gjykata e pranon vetëm atëherë, kur ajo praktikisht bindet se mund të përfundojë çështjen në gjendjen që janë aktet, pa qenë nevoja për shqyrtimin gjyqësor.[167]

Sipas jurisprudencës shqiptare, gjykimi i shkurtuar është një gjykim i posaçëm i cili konsiston në heqjen dorë në mënyrë të vullnetshme nga i pandehuri nga disa aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të tilla si parimi i barazisë së armëve dhe i formimit të provës në kontradiktoritet, për të përfituar një ulje dënimi. Për këtë arsye, legjislatori, për këtë lloj gjykimi, ka parashikuar rregulla të veçanta, të cilave duhen t'u përmbahen gjyqtarët gjatë zbatimit të këtij gjykimi të posaçëm. Përdorimi i rregullave të përgjithshme të gjykimit të zakonshëm në gjykimin e posaçëm bëhet, në mënyrë taksative, vetëm në rastet kur këtyre rregullave u referohen në mënyrë eksplicite dispozitat e veçanta të gjykimit të shkurtuar.

Kjo procedurë gjithsesi është e shoqëruar me një lehtësim të garancive procedurale të ofruara nga e drejta e brendshme, në veçanti për sa i përket publicitetit të diskutimit si dhe mundësisë që të kërkohet paraqitja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve. Këto garanci përbëjnë aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar nga neni 6 i KEDNJ-së. Gjithsesi, as teksti dhe as fryma e kësaj dispozite nuk ndalojnë që një person të heqë dorë në mënyrë spontane dhe të shprehur nga kjo e drejtë. Por, që të merret në konsideratë ..., kjo heqje dorë duhet të jetë e shprehur në mënyrë eksplicite dhe duhet të jetë e shoqëruar me një minimum garancish.[168] Përmes kërkesës për gjykim të shkurtuar, aplikanti heq dorë në mënyrë eksplicite nga të drejtat e tij për një seancë publike, të thërrasë dëshmitarët e tij në gjykim, të paraqesë prova, etj. në këmbim të një sërë avantazheve, që i garantohen atij nga legjislacioni i brendshëm.

[166] ibid, neni 406, pika 3.
[167] Vendim nr.4, datë 10.02.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.
[168] ibid, pp 21.

Është kundër parimeve të sigurisë juridike dhe të mbrojtjes të besimit legjitim të personave që janë në gjykim që shteti, në mënyrë të njëanshme, të ulë avantazhet që rrjedhin nga heqja dorë e disa të drejtave që kanë të bëjnë me nocionin e procesit të rregullt. Nëse kjo heqje dorë bëhet në këmbim të avantazheve të lartpërmendura, nuk mund të konsiderohet e drejtë që, pasi autoritetet e brendshme të kenë pranuar të procedojnë me gjykim të thjeshtuar, një element themelor i marrëveshjes ndërmjet shtetit dhe të pandehurit të mund të modifikohet në disavantazh të këtij të fundit, pa konsensusin e tij. Shtete që aplikojnë procedura të thjeshtuara duhet të marrin gjithmonë parasysh që këto lloj procedurash të mos cenojnë parimet e procesit të rregullt ligjor.

Sipas jurisprudencës shqiptare, e drejta e individit për gjykim të shkurtuar, duhet garantuar dhe në procedurat ankimore. Gjykata Kushtetuese, lidhur me pretendimet se "*disponimi në lidhje me pranimin ose jo të gjykimit të shkurtuar është atribut i gjykatës së shkallës së parë,"* dhe se "*në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 29.1.2003, është unifikuar praktika gjyqësore për faktin se gjykata e apelit duhet t'i përmbahet llojit të gjykimit të ndjekur nga gjykata e shkallës së parë"* është shprehur, se qëndrime të tilla bëjnë që vendimet e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, të mos kontrollohen mbi bazë apelimi në shkallë të dytë.[169]

Gjykata Kushtetuese është shprehur se, lënia jashtë kontrollit juridiksional e vendimit të gjykatës së shkallës së parë që refuzon gjykimin e shkurtuar, shkel të drejtën e aksesit të kërkuesit për një gjykim në shkallë të dytë. Sipas neneve 407/3 dhe 422 të Kodit të Procedurës Penale, i pandehuri gëzon të drejtën e apelimit të vendimeve të gjykatës së shkallës së parë. Kjo e drejtë apelimi shtrihet si ndaj fajësisë, ashtu edhe ndaj masës së dënimit të dhënë nga kjo gjykatë. Kjo do të thotë se, lidhur me dënimin, i gjykuari mund të apelojë masën e dënimit të dhënë nga pikëpamja e respektimit të parimit të propocionalitetit. Ky parim shkelet edhe në rast se plotësohen kriteret për një gjykim të shkurtuar, me pasojën e uljes në një të tretën të dënimit (nenet 404 e 406/1 të Kodit të Procedurës Penale). Kjo, për arsye se realizimi i funksionit riedukues të dënimit kërkon që gjykata, në përcaktimin e këtij dënimi, të respektojë parimin e proporcionalitetit. Për rrjedhojë, në rast se në shkallë të parë është vazhduar me procedurën e gjykimit të zakonshëm, vendimi i gjykatës mund të apelohet për dhënien e një dënimi të paligjshëm, duke arsyetuar se refuzimi i gjykimit të shkurtuar është i pajustifikuar ose i gabuar. Në këtë rast, i pandehuri kërkon që gjykata e apelit të kontrollojë arsyet ku mbështetet vendimi i mospranimit të gjykimit të shkurtuar, duke e kundërshtuar këtë vendim për arsye se ka vënë në dyshim ligjshmërinë e dënimit të dhënë. Për pasojë, përcaktimi konkret i dënimit është i rivlerësueshëm nga gjykata e apelit, dhe nëse kjo gjykatë vlerëson se është i pajustifikueshëm refuzimi i gjykimit të shkurtuar, duhet të aplikojë dënim të reduktuar, edhe pse procedura e ndjekur nuk ka qenë ajo e gjykimit të shkurtuar. Pra, motivet e vendimit që refuzon gjykimin e shkurtuar, të cilat influencojnë mbi ligjshmërinë e dënimit që do të jepet, nuk mund të përjashtohen

[169] Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.21, datë 16.04.2012.

nga shqyrtimi thelbësor nga gjykata e apelit mbi ankim. E gjithë kjo, jo me qëllim të rikuperimit të ritit të posaçëm, por të apelimit, në rast dënimi, të dënimit të reduktuar.[170]

Mungesa e kontrollit në shkallë të dytë, të vendimit për mospranim të kërkesës për gjykim të shkurtuar, mohon aksesin për një gjykim në shkallë të dytë, lidhur me pretendimet për mosrespektimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e dënimit dhe cenon të drejtën kushtetuese të aksesit dhe të ankimit në një gjykatë më të lartë.

Personat në pamundësi ekonomike për të siguruar mbrojtjen

E drejta për mbrojtje efektive e personave në pamundësi ekonomike për të siguruar mbrojtjen, sipas jurisprudencës së huaj

Sigurisht që personat që kanë një nivel ekonomik relativisht të mirë ose shumë të mirë mund të përballojnë marrjen e avokatëve me eksperiencë dhe të aftë të realizojnë në mënyrën më të mirë të mundshme mbrojtjen e tyre. Problemi qëndron në rastet e personave në pamundësi ekonomike për të marrë avokat për realizimin e një mbrojtjeje efektive të çështjes së tyre.

Në vitin 1964 Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës u shpreh se "në sistemin e drejtësisë penale, çdo personi që paraqitet para gjykatës, i cili nuk ka mjete financiare për të marrë mbrojtës, nuk mund t'i sigurohet një gjykim i drejtë, nëse nuk i sigurohet mundësia e pasjes së një mbrojtësi".[171] Nëse e drejta për mbrojtje, e garantuar nga Kushtetuta, i shërben qëllimit, të akuzuarit nuk duhen lënë në mëshirën e mbrojtësve të paaftë, ndërkohë që gjyqtarët duhet të luftojnë për të pasur një standard performance për mbrojtësit që përfaqësojnë të akuzuarit për çështje penale.[172]

Megjithatë, problemi kryesor, që ndikon tek të akuzuarit në pamundësi ekonomike për realizimin e mbrojtjes, nuk është aq shumë paaftësia e mbrojtësve, por pamundësia e tyre për të pasur burimet e nevojshme financiare për realizimin adekuat të mbrojtjes.

Për shkak të jopopullaritetit politik, që gëzojnë të akuzuarit, si dhe, për shkak të mungesës së kapitalit financiar e politik, shumë legjislatura ngurrojnë ose heshtin t'i japin vëmendje ose fonde këtij grupi të akuzuarish, duke u lënë gjykatave detyrën e krijimit të një mjeti kushtetues për realizimin e kësaj mbrojtjeje.

---

[170] ibid
[171] *Gideon v. Wainwright*, 372 U.S. 335, 342 (1964).
[172] *McMann v. Richardson*, 397 U.S. 759 (1970), 771.

Pavarësisht se në çështjen *Strickland v. Washington*[173] Gjykata Supreme adresoi për herë të parë rëndësinë e mbrojtjes efektive si dhe vendosi kushte për përcaktimin e paaftësisë së avokatit në realizimin e mbrojtjes, nuk u shpreh për pamundësinë e realizimit të mbrojtjes për shkak fondesh. Vendimi i kësaj Gjykate *Gideon v. Wainwright*[174] u garantoi të gjithë të akuzuarve për krime të rënda të drejtën e mbrojtjes, çka u perceptua si hap i madh drejt barazisë para ligjit. Të njëjtin vit, GJS vendosi edhe për çështje të tjera që mbështesnin vendimin e dhënë për *Gideon v. Wainwright*, duke përfshirë këtu çështjen *Douglas v. California*[175] në të cilën GJS u shpreh se e drejta e mbrojtjes u duhet garantuar të akuzuarve në pamundësi ekonomike për realizimin e mbrojtjes dhe gjatë apelimit të çështjes. Në 1972, GJS shpjegoi dhe më tej të drejtën e mbrojtjes, duke u shprehur se, i akuzuari nuk mund të burgosej për asnjë vepër penale, nëse atij nuk i është garantuar mbrojtja në gjykim.[176]

Pavarësisht se e drejta për mbrojtje ekziston si doktrinë, mungesa e fondeve rrezikon këtë të drejtë. Kjo mungesë, e kombinuar me mungesën e kualifikimeve të nevojshme për realizim efektiv të mbrojtjes, problemet në sistemin e caktimit të mbrojtësve, përbëjnë shkaqe që ndikojnë në realizimin joefektiv të mbrojtjes, sidomos për të akuzuarit në pamundësi financiare. Këta të akuzuar, shpesh herë, përfaqësohen nga avokatë që kanë shumë çështje, që paguhen pak, pa një kualifikim adekuat e pa burime të nevojshme për realizimin e mbrojtjes.

Këta avokatë të paguar pak, tentojnë të marrin përsipër të mbrojnë më shumë klientë, çka çon në mosgjetjen e kohës së mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes për secilin prej tyre, nuk kanë fondet e nevojshme për marrjen e ekspertëve cilësorë, u këshillojnë klientëve të pranojnë fajësinë dhe nuk arrijnë të ndjekin drejtimet që mund të ndihmojnë në çështje për shkak të mungesës së burimeve investiguese.[177] Për më tepër, mungesa e fondeve ndikon në uljen e numrit të avokatëve, që marrin përsipër të realizojnë mbrojtjen e personave në pamundësi ekonomike, duke ndikuar njëkohësisht në cilësinë e kësaj mbrojtjeje.[178]

A duhet lënë mungesa e fondeve vetëm në dorë të shtetit? A mundet vetë avokati të kërkojë fonde për realizimin e mbrojtjes? Një rast që vlen të përmendet është *State of Louisiana v. Peart*[179], i cili kishte të bënte me realizimin e mbrojtjes së një të akuzuari për vjedhje me armë. Avokati kishte në ngarkim shumë çështje penale e nuk kishte as

[173] *Strickland v. Washington*, 466 U.S. 668 (1984).
[174] *Gideon v. Wainwright*, 372 U.S. 335 (1963).
[175] *Douglas v. California*, 372 U.S. 353 (1963).
[176] *Argersinger v. Hamlin*, 407 U.S. 25, 38 (1972).
[177] Richard Klein & Robert Spangenberg, *The indigent defense crisis*, American Bar Association, 26 n.16 (1993).
[178] Lauren Sudeall Lucas, *Effectively Ineffective: The Failure of Courts to Address Underfunded Indigent Defense Systems*, 118 Harvard Law Review (2005), 1731.
[179] *Louisiana v. Peart* , 621 So.2d 780 (La. 1993)

fonde të mjaftueshme për realizimin e mbrojtjes. Duke qenë i qartë për pozitën e tij, avokati i kërkoi gjykatës shërbime ndihmë, duke shpjeguar arsyet. Gjykata pranoi kërkesën e avokatit dhe u shpreh se statutet e shtetit lidhur me sistemin e mbrojtjes ishin antikushtetues, pasi nuk parashikonin fonde të mjaftueshme për të akuzuarit në pamundësi financiare. Gjykata vendosi, gjithashtu, marrjen e masave afatshkurtra dhe afatgjata. Në masat afatshkurtra, gjykata vendosi uljen e numrit të çështjeve të avokatit, urdhëroi legjislativin për krijimin e fondeve për një biblioteke të pasur të aksesueshme nga avokatët si dhe mundësoi një hetues për avokatin. Si mjet afatgjatë Gjykata urdhëroi legjislativin të krijonte fonde që avokatët e caktuar kryesisht të kishin mundësinë e marrjes së një stafi mbështetës, hetuesve, ekspertëve e madje dhe mbrojtësve të tjerë. Shteti apeloi vendimin e gjykatës. Gjykata Supreme e shtetit të Louizianës hodhi poshtë vendimin e gjykatës për antikushtetutshmëri të statuteve përsa i përket mbrojtjes efektive për shkak të fondeve, megjithatë pranoi se të akuzuarit në New Orleans nuk merrnin mbrojtje efektive. Gjykata Supreme këshilloi gjithashtu se, në rast se gjykatat e shkallëve të ulëta kishin dyshime lidhur me pamundësinë e realizimit të një mbrojtjeje efektive për shkak mungese fondesh, gjykimi duhej të ndërpritej deri në alokimin e këtyre fondeve.

Në çështjen *State v. Lynch*[180] Gjykata Supreme e shtetit të Oklahomas vendosi një parim barazie mes prokurorëve dhe mbrojtësve, sipas të cilit, pagesa për orë e avokatëve mbrojtës të caktuar për të akuzuarit në pamundësi financiare për të gjetur vetë mbrojtës, do të ishte e njëjtë me atë të prokurorëve lokalë. Gjykata vendosi gjithashtu dhe rimbursimin, brenda afateve të arsyeshme, të avokatëve për punën jashtë orarit dhe për shpenzimet që kishin përballuar nga xhepi i tyre, në mënyrë që mbrojtja të vihej në pozita të njëjta me ndjekjen penale.

Në çështjen *State v. Smith*,[181] Gjykata Supreme e Arizonës u përball me ankimin e Joe Smith, i dënuar për vjedhje e dhunë seksuale. Në vitin 1980, në Kontenë Mohave të shtetit të Arizonës, mbrojtja e të akuzuarve në pamundësi financiare për të paguar nuk kryhej përmes caktimit kryesisht të avokatëve mbrojtës, por përmes sistemit kontraktor, sipas të cilit, mbrojtësit kontraktoheshin nga shteti për të siguruar mbrojtjen e këtyre personave. Sipas sistemit të kësaj konteje, numri maksimal i çështjeve, që mund t'i jepeshin një mbrojtësi të kontraktuar, nuk ishte i përcaktuar. Si rrjedhojë, këta mbrojtës kishin në ngarkim një numër të madh çështjesh. I akuzuari Joe Smith ngriti padi kundër sistemit kontraktues të mbrojtjes në Konte, me pretendimin se ky sistem shkelte të drejtën e tij kushtetuese për një mbrojtje efektive.

Në kërkesën e bërë ai pretendonte se avokati i tij kishte shpenzuar vetëm dy orë për ta marrë në pyetje dhe, për shkak të numrit të madh të çështjeve në ngarkim, kishte shpenzuar vetëm tetë orë në studimin e çështjes së tij.

[180] *State v. Lynch*, 796 P.2d 1150, 1153 (Okla. 1990).
[181] *State v. Smith*, 681 P.2d 1374, 1382 (Ariz. 1984).

Gjykata Supreme e Arizonës, në vendimin e saj, u shpreh se procedura e Kontesë për emërimin e avokatëve të të akuzuarve në pamundësi financiare dhunonte të drejtat e këtyre të akuzuarve për një proces të rregullt ligjor e për mbrojtje efektive, të garantuara si nga Kushtetuta e Arizonës, ashtu dhe nga ajo e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Gjykata vendosi që, në raste të tilla duhej të ndiqeshin disa direktiva, të bazuara në rekomandimet e nxjerra nga Shoqata Kombëtare për Ndihmën Ligjore ndaj të Akuzuarve si dhe të ndiqeshin standardet e Shoqatës Amerikane të Avokatëve për Drejtësinë Penale. Mos zbatimi i këtyre parimeve çon në "shfuqizimin e çfarëdo vendimi të dhënë, të apeluar nga i akuzuari, në rast se shteti nuk arrin të provojë se gabimi ishte shumë i vogël".

Në një çështje tjetër, *State ex rel. Metropolitan Public Defender Services, Inc. v. Courtney,*[182] gjyqtari relator i çështjes u shpreh se "legjislativi ... nuk kishte siguruar fonde të nevojshme e, për rrjedhojë, gjyqësori po pengohej në ushtrimin e funksioneve të tij bazë (përfshirë gjykimin e çështjeve penale për të akuzuarit në pamundësi financiare për të siguruar mbrojtjen)".[183] Ai u shpreh, gjithashtu, se "për shkak të kufizimeve në buxhetin e caktuar për këta të akuzuar", gjyqësori ishte detyruar të kufizonte llojet e çështjeve për të cilat mund të caktohej avokat kryesisht. Për shkak të shkurtimeve të mëdha të fondeve, Departamenti Gjyqësor nuk do të kishte mundësi të kompensonte mbrojtësit e caktuar kryesisht, duke ndikuar në aftësitë e gjyqësorit për të vepruar si degë e pavarur e pushtetit shtetëror.

Alokimi i fondeve, për garantimin e mbrojtjes për të akuzuarit në pamundësi financiare, është shumë i rëndësishëm në garantimin e të drejtës së mbrojtjes e, për rrjedhojë, legjislativi duhet të marrë masa për ruajtjen e kësaj të drejte kushtetuese.

Në çështjet *State v. Craig* dhe *State v. Harris,*[184] Gjykata Supreme e Loiuzianës u shpreh se gjykatat e distriktit (qarkut) mund të urdhëronin qeverinë lokale në dhënien e këtyre fondeve, për të paguar hetuesit dhe ekspertët. Sipas kësaj Gjykate, "sistemi i mbrojtjes së këtyre të akuzuarve kishte nevojë për rishikim" dhe "hapi i parë për zgjidhjen e këtij problemi kishte të bënte me përcaktimin, sipas legjislacionit në fuqi, se kush është përgjegjës e deri në ç' masë. Duke qenë se kjo përfshin interpretim si të ligjit, ashtu dhe Kushtetutës, përgjegjësia për këtë bie mbi gjyqësorin. Gjykata u shpreh se ajo nuk po përpiqet të caktojë prioritetet buxhetore të legjislativit, por kërkon që qeveritë lokale të zbatojnë përgjegjësitë ligjore për mbulimin e këtyre shpenzimeve rast pas rasti.

Në çështjen *State v. Quitman County*[185] Gjykata Supreme e Misisipit u shpreh se, kontrollimi i shpenzimit të fondeve për realizimin e mbrojtjes së të akuzuarve në pamundësi financiare ishte çështje tipike e legjislativit, megjithatë, kur legjislativi nuk vepronte, gjykatat kishin autoritet për të vepruar. "Kur legjislativi, gjatë alokimit të

[182] *State ex rel. Met-ropolitan Public Defender Services, Inc. v. Courtney*, 64 P.3d 1138 (Or. 2003).
[183] ibid, 1139.
[184] *State v. Craig* dhe *State v. Harris* , 637 So. 2d 437 (La. 1994).
[185] *State v. Quitman County,* 807 So. 2d 401 (Miss. 2001).

fondeve për gjyqësorin, nuk arrin të përmbushë detyrimin e tij për t'i mundësuar gjyqësorit të veprojë në mënyrë të pavarur dhe efektive, atëherë ai ka cenuar mandatin e tij kushtetues e, për rrjedhojë, gjyqësori ka detyrimin të veprojë, në mënyrë që të mos cenohet dhënia e drejtësisë nga gjykatat"[186].

Ky cenim shkaktohet kur shteti kërkon nga organet përkatëse alokimin e fondeve për të akuzuarit në pamundësi financiare, ndërkohë që, mospërmbushja e këtij detyrimi shkakton mbrojtje infektive sistematike.

Edhe GJEDNJ i kushton një kujdes të veçantë të drejtës për asistencë ligjore falas, si një ndër mjetet primare përmes të cilave një i akuzuar në çështjet penale mund të sigurojë akses në gjykatë. Neni 6/3 i KEDNJ i garanton çdo individi të akuzuar për kryerjen e një vepre penale, të drejtën për përfaqësim ligjor, duke përfshirë të drejtën për akses në ndihmë ligjore falas, nëse individi "nuk ka mjetet e mjaftueshme" si dhe nëse "e kërkon interesi i drejtësisë". Përmes interpretimit të këtij neni, GJEDNJ ka theksuar se shtetet janë të detyruara të marrin masa për përfaqësim ligjor falas, nëse plotësohen dy kushte:

- i akuzuari nuk ka mjete të mjaftueshme (kushti financiar);
- ndihma ligjore falas kërkohet nga "interesi i drejtësisë" (kushti substancial).

Së pari, Konventa i kërkon një shteti të marrë masa për ndihmë ligjore falas për personat e akuzuar për një vepër penale, vetëm nëse ai person nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për të siguruar vetë, në mënyrë të pavarur, mbrojtjen e tij. As Konventa e as jurisprudenca e GJEDNJ nuk përcaktojnë sasinë e caktuar të të ardhurave, që duhet të ketë një person për t'u konsideruar në pamundësi financiare për të siguruar mbrojtjen.

Në përcaktimin nëse një person duhet të konsiderohet i tillë ose jo, GJEDNJ sheh rrethanat specifike të çdo rasti, megjithatë barra e provës për të provuar mungesën e mjeteve të mjaftueshme bie mbi personin e akuzuar. Të akuzuarit nuk i kërkohet të provojë mungesën e mjeteve financiare përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Përpjekjet e të akuzuarit për të provuar mungesën e mjeteve, kur mungojnë të dhëna për të kundërtën, janë të pranueshme në testin për përcaktimin e mjeteve financiare, sipas nenit 6/3 të KEDNJ-së.

Së dyti, sipas Konventës, një shtet është i detyruar të ofrojë ndihmë ligjore falas për një të akuzuar në pamundësi financiare, vetëm nëse kjo është e nevojshme për "interesin e drejtësisë". Në përcaktimin nëse interesi i drejtësisë ngre detyrime për shtetin, GJEDNJ ka marrë në konsideratë disa faktorë:

[186] Gjykata njohu të drejtën e mbrojtësit për të kërkuar fonde nga shteti, në mënyrë që të realizonte mbrojtje efektive.

- kompleksitetin e çështjes në këndvështrimin ligjor dhe atë faktik;
- aftësinë e të akuzuarit për të kuptuar çështjen kundër tij;
- aftësinë e të akuzuarit për të mbrojtur vetë veten.

Megjithatë, peshën më të madhe në vendimin e gjykatës e luan përgjigja e pyetjes "ç'është në lojë" për të akuzuarin? Ç'rrezikon ai? Ashpërsia e një dënimi të mundshëm është konsideruar në vetvete si faktor që ngre detyrimin e shtetit për sigurimin dhe garantimin e mbrojtjes ligjore falas.

Në çështjen *Quaranta v. Switzerland*[187], prokuroria kishte kërkuar dënimin e kërkuesit me tre vjet burgim për veprën penale të trafikimit të substancave narkotike. Megjithëse ishte dënuar me vetëm gjashtë muaj burgim, GJEDNJ u shpreh se "kërkuesit i duhej dhënë ndihmë ligjore falas" pasi rrezikonte shumë. Për më tepër, në çështjen *Benham v. The United Kingdom*[188], GJEDNJ u shpreh se në çështje që kanë të bëjnë me heqje të lirisë, interesi i drejtësisë, në parim, kërkon përfaqësim ligjor. Në këtë çështje kërkuesi ishte dënuar me 3 muaj heqje lirie për shkak të mospagesës së një detyrimi komunitar.

Nëse plotësohen të dy kushtet, ai financiar dhe ai substancial, shteti është i detyruar t'i japë të akuzuarit ndihmë ligjore falas. Sipas KEDNJ, shtetet janë të detyruara të garantojnë një të drejtë efektive për përfaqësim ligjor falas. Si rrjedhojë, mosdhënia, mbrojtësit të caktuar nga shteti, e kohës dhe lehtësive të nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes, përbën shkelje të Konventës. Megjithëse një shtet nuk mund të konsiderohet përgjegjës për çdo mangësi të mbrojtjes së avokatit të caktuar kryesisht, ai do të konsiderohet se ka shkelur Konventën, nëse nuk i ka siguruar të akuzuarit të drejtën për të përfituar, efektivisht, përfaqësim ligjor falas. Në çështjen *Artico v. Italy*[189], mosmarrja e masave nga ana e shtetit për të zëvendësuar avokatin, i cili nuk i kushtoi rëndësi dhe vëmendje çështjes, me një avokat tjetër, ose mungesa nga ana e shtetit e marrjes së masave, që do ta detyronin avokatin të përmbushte detyrimet e tij, u konsiderua si shkelje e KEDNJ-së për shkak të cenimit të së drejtës efektive të të akuzuarit për ndihmë ligjore falas.

Në çështjen *Croissant v. Germany*[190] GJEDNJ adresoi pyetjen e rimbursimit të shpenzimeve për mbrojtësin e caktuar kryesisht, pas dhënies së dënimit. Kërkesa e përgjithshme për rimbursimin e shpenzimeve të gjykimit, në vetvete, u konsiderua në përputhje me nenin 6/3 të KEDNJ. Procedurat e zbatimit të dënimit vijojnë pas procedurave gjyqësore e, si rrjedhojë, nuk ndikojnë në drejtësinë e gjykimit. Megjithatë, në këtë çështje nuk u diskutua mbi mundësinë e rimbursimit të shpenzimeve të mbrojtësit të caktuar kryesisht për të akuzuarin në pamundësi financiare, pas dhënies së dënimit.

[187] *Quaranta v. Switzerland*, (Application no. 12744/87).
[188] *Benham v. The United Kingdom*, (Application no. 19380/92).
[189] *Artico v. Italy* (Application no. 6694/74).
[190] *Croissant v. Germany*, (Application no. 13611/88).

GJEDNJ, përmes interpretimit të Konventës ka vendosur një sërë garancish në të drejtën për akses në gjykatë, duke i kushtuar rëndësi të drejtës për përfaqësim ligjor falas në çështjet penale, garanci të cilat kanë për qëllim sigurimin që parashikimet e gjykimit të drejtë do të zbatohen në mënyrë të barabartë ndaj kujtdo, pavarësisht situatës së tyre financiare.

Gjyqësori luan një rol të rëndësishëm në marrjen e masave për të siguruar zbatimin e interpretimeve kushtetuese të bëra për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve, madje edhe duke i kërkuar legjislativit të marrë masa në këtë drejtim. Është e rëndësishme të theksohet se, përmes vendimeve që marrin, gjykatat kërkojnë zbatimin e të drejtës kushtetuese për mbrojtje. Gjykatat nuk duhet të mënjanohen nga pozicioni i tyre si organe primare të realizimit të kësaj të drejte.

Problemi i mosfinancimit të mbrojtjes për të akuzuarit në pamundësi financiare për realizimin e mbrojtjes është i gjerë dhe kompleks. Zgjidhja e tij kërkon bashkëpunimin e shumë palëve. Zgjidhja efektive afatgjatë nuk mund të vijë vetëm nga gjykatat, megjithatë ato mund të kontribuojnë në zgjidhjen e tij përmes kombinimit të përafrimit pragmatik me një rol më aktiv të gjyqësorit.

Garantimi dhe zbatimi i të drejtës për mbrojtje efektive është detyrë e gjyqësorit, edhe kur një gjë e tillë ndërthuret me probleme legjislative të alokimit të fondeve. Gjykatat kanë përgjegjësi kushtetuese dhe duhet të bëjnë ç'është e mundur që realizimi i mbrojtjes të jetë efektiv.[191]

Për garantimin dhe marrjen e masave për zbatimin e kësaj të drejte, gjykatat mund të përgatisin disa rekomandime, me qëllim që të drejtojnë legjislativin në formulimin e disa standardeve për efektivitetin në mbrojtje. Por, edhe nëse gjyqësori arrin të vendosë direktiva të caktuara dhe të kërkojë rritje fondesh, përsëri ekziston rreziku se çfarëdo lloj zgjidhjeje që t'i gjendet këtij problemi, mund të mos jetë afatgjatë. Si rrjedhojë, me qëllim që rekomandimet e tyre të mos shkojnë dëm e të zbatohen, gjykatat duhet të krijojnë mekanizma të caktuar si p.sh. krijimin e grupeve të caktuara, që mbikëqyrin gjithë procesin e zgjedhjes së avokatit të caktuar kryesisht si dhe kompensimin e tyre në përfundim të gjykimit, deri në momentin e krijimit të një mekanizmi të tillë nga legjislativi.

Deri sa të arrihet krijimi me ligj i këtyre mekanizmave, impakti i vendimeve të gjykatave do jetë thjesht afatshkurtër dhe e drejta për një mbrojtje efektive do të mbetet një ëndërr për t'u realizuar.

[191] Lauren Sudeall Lucas, *Effectively Ineffective: The Failure of Courts to Address Underfunded Indigent Defense Systems*, 118 Harvard Law Review (2005), 1731.

E drejta për mbrojtje efektive për personat në pamundësi ekonomike në Shqipëri

E drejta për t'u mbrojtur është pjesë e rëndësishme e të drejtës për gjykim të drejtë në çështjet penale dhe ka për qëllim sigurimin e parimit të barazisë së armëve. Parimi i barazisë së armëve nënkupton që palëve u duhen dhënë mundësi të barabarta në paraqitjen e çështjes, duke mos i vendosur në dizavantazh substancial ndaj kundërshtarit.

Kushtetuta e Shqipërisë, neni 31/ç parashikon: "Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme." Ligji "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë" parashikon: "Në raste të veçanta të mbrojtjes së detyrueshme ose kur të interesuarit nuk janë në gjendje ekonomike për të siguruar mbrojtjen, me vendim të prokurorit ose të gjykatës, ndihma juridike jepet falas dhe shpenzimet përballohen nga fondi shtetëror i caktuar për këtë qëllim. Në të tilla raste shpërblimi i avokatit caktohet përkatësisht nga prokurori ose gjykata, sipas tarifave. Avokati i ngarkuar kryesisht duhet të njoftohet me shkrim nga organi përkatës. Njoftimi duhet të siglohet edhe nga vetë avokati."[192]

Organi i ndjekjes penale në Shqipëri ushtrohet nga Prokuroria. Siç dihet, të gjitha shtetet investojnë në pasjen e një policie e ndjekjeje penale efektive, në mënyrë që të sigurohen ruajtja e rendit dhe qetësisë. Ky investim vjen përmes dhënies së fondeve të mjaftueshme për një organizim sa më të mirë të ndjekjes penale, përmes trajnimit të tyre, dhënies së mundësive financiare për marrjen e ekspertëve me përvojë, të mjeteve dhe pajisjeve të fundit për zbulimin e të dhënave.

Parë nga aspekti i fondeve që shpenzohen në këto investime, duket sikur e drejta për mbrojtje efektive është thjesht një e drejtë e shkruar, e papraktikuar, çka vë të akuzuarit në dizavantazh ndaj organeve të ndjekjes penale, pra vë individin në dizavantazh me shtetin, duke e bërë më të lehtë cenimin e të drejtave dhe lirive të tij themelore.

Përveç kësaj, fakti që gjykatat dhe prokuroria janë organe shtetërore jep, gjithashtu, përshtypjen se këto organe punojnë së bashku, për një qëllim të përbashkët: mbrojtjen e interesave të shtetit.[193]

KEDNJ parashikon: "çdokush i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: ... c) Të mbrohet vetë ose përmes një ndihmësi ligjor të zgjedhur

[192] ligj nr. 7827, datë 31.05.1994 "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë", neni 36.
[193] Mari-Ann Roos, *Analysis of The Criminal Justice System of Albania*, Report by the fair trial development project, OSCE 2006, 67.

prej tij, ose, në rast pamundësie për të paguar për ndihmë ligjore, t'i jepet falas kur e kërkon interesi i drejtësisë".[194]

GJEDNJ, në një çështje kundër Shqipërisë,[195] është shprehur se, si parim i përgjithshëm, bazuar në nocionin e një gjykimi të drejtë, një personi të akuzuar për një vepër penale, i cili nuk dëshiron të mbrohet vetë, duhet t'i jepet mundësia për të pasur ndihmë ligjore nëpërmjet një mbrojtësi të zgjedhur prej tij. Nëse ai nuk ka burime të mjaftueshme për të përballuar këtë ndihmë, Konventa i njeh të drejtën që ta ketë këtë ndihmë falas, kur e kërkojnë interesat e drejtësisë. Duke pasur parasysh qëllimin e Konventës, për mbrojtjen e të drejtave që janë praktike dhe efektive, GJEDNJ ka konstatuar në mënyrë të vazhdueshme se, ndërsa shtetet nuk mund të jenë përgjegjëse për çdo të metë të avokatëve të caktuar për ndihmë ligjore, në rrethana të veçanta, autoritetet kompetente duhet të marrin masa për të siguruar që ankuesit të gëzojnë efektivisht të drejtën që u njihet.[196]

Sigurisht, një rol të rëndësishëm në ekzistencën e një sistemi ndihme ligjore efektive luan, pikësëpari, edukimi i duhur universitar në fushën e drejtësisë. Edukimi universitar i marrë nga mbrojtësit shqiptarë varion nga kurse 6-mujore, edukim katërvjeçar në Fakultetin e Drejtësisë, edukim sipas sitemit të Bolonjës (edukim universitar 3 vjeçar + master 1 vjeçar profesional ose master 2 vjeçar shkencor) dhe edukim i veçantë në Shkollën e Magjistraturës. Ndërkohë që sistemi universitar në Shqipëri lë për të dëshiruar, përsa i përket përgatitjes së mbrojtësve të ardhshëm të shtetit shqiptar sipas standardeve europiane,[197] duket se edukimi i marrë në Shkollën e Magjistraturës konsiderohet më i plotë dhe si hap përpara në dhënien e një trajnimi adekuat për gjyqtarët dhe prokurorët e ardhshëm.[198]

Kushtetuta e Shqipërisë parashikon: "Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme."[199]

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë parashikon: "I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas, me avokat. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin që t'i garantohen

[194] Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6/3/c.
[195] *Balliu v. Albania*, (Application no. 74727/01).
[196] ibid, pp 32.
[197] "Mijëra avokatë po shkollohen nga universitetet tona, të cilët kanë fare pak njohuri për Kushtetutën. Kur organizatat kërkojnë një avokat që t'i instruktojë për Kushtetutën, e kanë pothuajse të pamundur të gjejnë një avokat kompetent.", Raport i Komitetit të Qytetarisë Amerikane i paraqitur në takimin e Shoqërisë së Avokatëve Amerikanë (American Bar Association), Denver, Colorado, 14-16 Korrik 1926.
[198] *Analysis of The Criminal Justice System of Albania*, Report by the fair trial development project, OSCE 2006, 68.
[199] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 31/ç.

të drejtat procedurale dhe t'i ruhen interesat e tij ligjore."[200] Ky Kod i ka kushtuar mbrojtësit të të pandehurit një kapitull të tërë,[201] duke parashikuar proceduarat për zgjedhjen ose emërimin e avokatit mbrojtës, të drejtat dhe detyrimet e tij, garancitë për mbrojtësin dhe përgjegjësitë, duke theksuar rëndësinë e tij në proceset penale.

Ligji "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë"[202] detajon dhe më tej të drejtat dhe detyrimet e mbrojtësit. Lidhur me realizimin e mbrojtjes ky ligj parashikon: "Avokati ka për detyrë ta ushtrojë profesionin e vet me ndershmëri dhe dinjitet, të respektojë rregullat e etikës profesionale dhe të përdorë të gjitha mjetet e ligjshme për mbrojtjen me besnikëri të të drejtave dhe të interesave të personave që mbrohen ose përfaqësohen prej tij."[203] "... avokati është i detyruar të sigurohet se nuk vepron në konflikt me interesat e personit që mbrohet ose përfaqësohet prej tij. Kur avokati dyshon se është duke vepruar në konflikt interesash, ai duhet të marrë miratimin me shkrim nga palët, të cilat mendohet se preken nga ky konflikt interesash."[204] Avokati nuk ka të drejtë t'i kërkojë dhe t'i ofrojë ndihmë juridike një personi të ndaluar ose të arrestuar, pa kërkesën e këtij të fundit.[205]

Shpërblimi i avokatit për punën e kryer caktohet: me marrëveshje ndërmjet tij dhe palës së mbrojtur ose të përfaqësuar prej tij; nga gjykata ose prokuroria, kur ai është caktuar kryesisht ose kur personi i mbrojtur ose i përfaqësuar nuk ka mundësi financiare dhe ndihma ligjore për të është falas. Masa e shpërblimit për këto raste përcaktohet me vendim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë; me ligj. Në të gjitha rastet, avokatit nuk i lejohet të marrë shpërblim tjetër.[206]

Rregullimi dhe kontrolli i ushtrimit të profesionit të avokatit në Republikën e Shqipërisë ushtrohet nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, e cila është person juridik, që ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga shteti.[207] Dhoma Kombëtare e Avokatisë është përgjegjëse për themelimin e dhomave të avokatisë.[208] Organet drejtuese të kësaj Dhome dhe të dhomave të avokatisë janë, përkatësisht, Këshilli i Përgjithshëm dhe Këshilli Drejtues.[209] Kodi i Etikës së Avokatit përgatitet nga Këshilli Drejtues i

[200] Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 6.
[201] ibid, "Kreu V", nenet 48-57.
[202] ligj nr. 9109, datë 17.07.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 9795, datë 23.07.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9109, datë 17.07.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë"" dhe ligjin nr. 10047, datë 24.12.2008 ""Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9109, datë 17.07.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë"".
[203] ligj nr. 9109, datë 17.07.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", neni 9, pika 1.
[204] ibid, pika 9.
[205] ibid, neni 7, pika 3.
[206] ibid, neni 11.
[207] ibid, neni 17, pika 1.
[208] ibid, neni 17.
[209] ibid, neni 18.

Dhomës[210] dhe miratohet nga Këshilli i Përgjithshëm.[211] Kompetencë e Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë është gjithashtu caktimi i avokatit, që do të ndjekë çështjet gjyqësore, kur kjo kërkohet nga gjykata. Po kjo Dhomë cakton një avokat, që të marrë përsipër çështje, të cilat janë braktisur nga një avokat i mëparshëm dhe klienti nuk ka mundur të gjejë një tjetër.[212]

Kodi i Etikës së Avokatit parashikon rëndësinë e pavarësisë së avokatit në ushtrimin e veprimtarisë së tij, ruajtjen e dinjitetit profesional, detyrimin për përkushtim dhe për veprimin me aftësi profesionale në çështjet që merr përsipër të shqyrtojë. Sipas këtij Kodi, "Avokati në çdo kohë duhet të veprojë me përkushtim dhe gatishmëri kur përfaqëson një klient. Avokati ka për detyrë t'u shërbejë interesave të klientit në mënyrën më efikase të mundur. Ai duhet të ofrojë përfaqësim cilësor të klientit. Aftësia përfshin njohuritë ligjore dhe aftësitë profesionale, të cilat janë të nevojshme në çdo rast konkret. Avokati nuk duhet të trajtojë një çështje, për të cilën ai nuk ka aftësitë e nevojshme, përveç se kur bashkëpunon me një avokat, i cili është kompetent për ta trajtuar atë. Ai ka për detyrë të zhvillojë aftësitë e tij nëpërmjet përgatitjes së vazhduar profesionale."[213]

Krahas instrumenteve të përmendura më lart, ligjvënësi shqiptar ka miratuar gjithashtu ligjin "Për ndihmën juridike"[214], i cili parashikon përfituesit e kësaj ndihme, parimet themelore të dhënies së saj, administrimin e shërbimit të ndihmës juridike, shërbimet e dhe procedurat e dhënies së saj.

Sipas këtij ligji, të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e kanë personat, të cilët: kërkojnë të mbrohen me avokat në procesin penal në të gjitha fazat e tij dhe, për shkak të pamundësive financiare, nuk kanë mundur të zgjedhin një avokat apo kanë mbetur pa të; kanë nevojë për ndihmë juridike në çështjet civile ose administrative, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për ta paguar këtë ndihmë juridike apo çështjet janë tepër komplekse, nga ana e përmbajtjes dhe e procedurës. Në këtë rast, që të përfitojë ndihmën juridike, personi duhet të vërtetojë se përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t'u përfshirë në to. Ndihmën juridike e përfitojnë edhe të miturit, për të cilët mbrojtja në procedimin penal dhe në gjykim është e detyrueshme me ligj. Ndihma juridike mund të kërkohet para, gjatë dhe pas zhvillimit të procesit gjyqësor. Personi, i cili përfiton këtë ndihmë ka detyrimin të bashkëpunojë me avokatin që siguron ndihmën juridike, të japë informacion të vërtetë, për të cilin është kërkuar ndihma, si dhe të sigurojë në kohë çdo informacion për rrethanat dhe kushtet, që kanë ndryshuar shkakun e dhënies së ndihmës.[215]

---

[210] ibid, neni 20, pika 3/3.
[211] ibid, neni 19, pika 3/2.
[212] ibid, neni 22, pikat 6, 7.
[213] Kodi i Etikës së Avokatit, nenet 6-9, <http://www.dhka.org.al/#58831>, aksesuar më 09.02.2013.
[214] ligj nr. 10039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike".
[215] ibid, neni 13.

Dhënia e ndihmës juridike nga shteti për individët mbështetet në parimin e cilësisë, efiçencës dhe efektivitetit të shërbimit të ndihmës juridike.[216] Përcaktimi i kritereve për përzgjedhjen e avokatëve, i kritereve për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të dhënë nga avokatët që japin këtë ndihmë si dhe i masave disiplinore ndaj këtyre avokatëve kryhet nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.[217]

Të gjitha procedurat për dhënien e ndihmës juridike kontrollohen nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike (KSHNJ), i cili është një organ kolegjial dhe ka statusin e personit juridik publik. Ky Komision përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët njëri zgjidhet nga Ministri i Drejtësisë, njëri nga Ministri i Financave, njëri nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, i katërti nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe i pesti nga organizatat jofitimprurëse, që veprojnë në fushën e ndihmës ligjore. Anëtari nga organizatat jofitimprurëse zgjidhet prej 4 anëtarëve të zgjedhur më sipër, nga lista e kandidatëve të propozuar nga këto organizata. [218]

Ky Komision lidh kontratat e shërbimit me avokatët, zyrat e avokatisë dhe organizatat jofitimprurëse, që do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike, si dhe vendos masën e shpërblimit të avokatëve në ofrimin e ndihmës juridike ndaj individëve, pasi ka marrë më parë mendimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Drejtësisë. Në çdo rast, shpërblimet janë jo më të vogla se tarifat e miratuara për shërbimin e avokatisë.[219]

KSHNJ bashkëpunon, gjithashtu, me organizatat ndërkombëtare dhe organizatat jofitimprurëse, vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e ndihmës juridike; vendos kriteret, në bazë të të cilave do të vlerësohet cilësia e shërbimit të ndihmës juridike të dhënë; mban të dhëna për personat, që përfitojnë ndihmë juridike; merr vendim dhe urdhëron kryerjen e pagesës së avokatëve për dhënien e ndihmës juridike, pas paraqitjes së dokumenteve, që përcaktohen me vendim të veçantë; si dhe cakton përparësitë për çështjet, për të cilat ofrohet ndihmë juridike, me kufizimet e imponuara për shkak të burimeve dhe mjeteve financiare në dispozicion.[220]

Lista e avokatëve që autorizohen të japin ndihmë juridike, si dhe vendi i shtrirjes së veprimtarisë së tyre përcaktohen nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike. Nëse është e nevojshme, Komisioni dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë mund të organizojnë konkurs për përcaktimin e avokatëve që do të japin ndihmë juridike. Lista e avokatëve, që autorizohen për dhënien e kësaj ndihme, bëhet publike. [221] Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike mund të paraqitet gojarisht te personi i autorizuar për dhënien e ndihmës apo për caktimin e ofruesit të kësaj ndihme.[222]

---

[216] ibid, neni 2/ "c".
[217] ibid, neni 5.
[218] ibid, neni 6.
[219] ibid, neni 10, pikat d, dh.
[220] ibid, pikat f-i.
[221] ibid, neni 20, pikat 2, 3.
[222] ibid, nenin 16, pika 2.

Kontrolli i cilësisë së ndihmës juridike të ofruar realizohet nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike. Me kërkesë të të interesuarit, kryesisht apo me kërkesë të Ministrit të Drejtësisë, komisioni verifikon dhe kontrollon cilësinë e ndihmës juridike për një rast konkret dhe, në bazë të rezultateve, ka të drejtë të zgjidhë kontratën e shërbimit me avokatin e autorizuar për dhënien e ndihmës juridike. Forma dhe standardet e kontrollit miratohen me vendim të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike. Rezultatet e kontrollit i dërgohen Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe mund të shërbejnë si bazë për marrjen e masave disiplinore ndaj avokatëve.[223]

Në rast se, në përfundim të procesit gjyqësor, përfituesi i ndihmës juridike përfiton rimbursimin e shpenzimeve gjyqësore të parapaguara, ai detyrohet t'i kthejë Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike shpenzimet e kryera nga ky i fundit, për ofrimin e ndihmës juridike në çështjen përkatëse. Personi që ka përfituar ndihmë juridike, duke paraqitur të dhëna të rreme ose të pavërteta, përfshirë edhe të dhënat për gjendjen e tij financiare, është i detyruar të kthejë të gjitha shpenzimet e kryera për ofrimin e kësaj ndihme.[224]

Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike përcakton, gjithashtu, rregullat e caktimit të avokatëve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmën juridike. Për caktimin e tyre KSHNJ shpall njoftim publik, i cili botohet në tri gazeta kombëtare me tirazhin më të madh, për tri ditë rresht, si dhe në faqen e internetit të Komisionit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Njoftimi përmban afatin e dorëzimit të dokumentacionit, kërkesat dokumentare, si dhe kriteret për avokatët, zyrat e avokatisë dhe organizatat jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike[225]

Subjekti, i cili, me vendim të Komisionit, kualifikohet për të përfituar ndihmë juridike, ka të drejtë të zgjedhë avokatin në bazë të listës së vënë në dispozicion nga KSHNJ. Lista përmban emrat e avokatëve sipas fushës së kualifikimit profesional, si dhe dokumentet shoqëruese përkatëse. Avokati duhet të ndihmojë kërkuesin e ndihmës juridike që të plotësojë formularin për kërkimin e ndihmës juridike në formën e përfaqësimit në gjykatë për çështjet civile dhe administrative dhe të plotësojë vetë formularin e kërkimit të ndihmës juridike të llojeve të tjera, nëse ka.[226]

Ndër kriteret që duhen përmbushur nga avokatët ose zyrat e avokatisë që ofrojnë ndihmë juridike, ky udhëzim parashikon ushtrimin e profesionit të avokatisë për të paktën 2 vjet,[227] ndërsa për organizatat jofitimprurëse kërkohet të paktën 3 vjet përvojë në fushën e ofrimit të ndihmës juridike.

[223] ibid, neni 21.
[224] ibid, neni 14, pika 1, 2.
[225] ibid, nenet 3, 4
[226] ibid, neni 5.
[227] ibid, neni 4, pika 1.

Sigurisht që, ofrimi i kësaj ndihme për personat në pamundësi financiare për të paguar mbrojtësin, është shumë i rëndësishëm në mirëfunksionimin e shtetit demokratik. Për ofruesit e kësaj ndihme, të cilët janë kryesisht avokatë të rinj në ushtrimin e profesionit, kjo përbën një mënyrë të mirë për të fituar eksperiencë. Megjithatë, për shkak të pasjes dhe ruajtjes së parimit të mbrojtjes efektive, do të ishte e rëndësishme zgjatja e kësaj periudhe në të paktën 5 vjet përvojë. Jo vetëm kaq, por përcaktimi i kuotave në pagesat e këtyre mbrojtësve, të mjaftueshme për zhvillimin e një mbrojtjeje efektive, do të kishte gjithashtu rëndësi të veçantë.

Vetë përfaqësimi ligjor dhe mbrojtja ligjore e detyruar

Parimi se një i akuzuar nuk mund të dënohet pa një gjykim të drejtë është tashmë një parim themelor e universal i të drejtës. Po aq themelore dhe e rëndësishme është që gjykimi të jetë i drejtë. Ky parim njihet e zbatohet si në sistemin akuzator të *common law*, ashtu dhe në atë inkuizitor të *civil law*. Parimi se një i akuzuar ka të drejtën e një gjykimi të drejtë është reflektuar gjithashtu në të gjitha traktatet më të rëndësishme për të drejtat e njeriut, duke përfshirë Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike. Gjykimi i drejtë përfshin një sërë të drejtash, ku, që të gjitha synojnë t’i sigurojnë të akuzuarit një gjykim të drejtë.

Koncepti i drejtësisë përfshin jo vetëm këto të drejta. Ajo çka duhet pasur parasysh është se në të gjitha aspektet e gjykimit të çështjes penale duhet të ruhen të drejtat që i janë dhënë të akuzuarit. Këto të drejta quhen ndryshe “garanci minimale”, çka do të thotë se drejtësia gjatë gjykimit është një kërkesë themelore në procedurat penale. Shteti duhet të marrë masa për sigurimin e drejtësisë në procesin gjyqësor, në tërësinë e tij, përmes respektimit të plotë të të drejtave të të akuzuarit.

Gjykimi i drejtë duhet kryer në përputhje të plotë me rregullat e procedurës dhe marrjes së evidencës, duke respektuar të drejtat e të akuzuarit si dhe duke i kushtuar kujdes të veçantë mbrojtjes së dëshmitarëve.

Garancitë minimale që i janë dhënë të akuzuarit në gjykimin penal konsistojnë në:
- një gjykim të drejtë dhe publik;
- një gjykim të shpejtë e pa vonesa;
- një gjykim në prezencën e tij;
- një gjykim ku i akuzuari mund të mbrohet vetë ose përmes asistencës ligjore të zgjedhur nga vetë ai;
- të informohet për të drejtën për të zgjedhur mbrojtës;
- t’i caktohet asistencë ligjore falas, kur këtë e kërkon interesi i drejtësisë, si dhe kur i akuzuari nuk ka mjete të mjaftueshme për të realizuar vetë mbrojtjen e tij;

- të pyesë ose të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës si dhe të kërkojë thirrjen dhe pyetjen e dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me ato të akuzës.

Një ndër të drejtat e të akuzuarit është dhe e drejta e tij për t'u mbrojtur vetë ose përmes asistencës ligjore të zgjedhur nga ai vetë. Qëllimi i kësaj të drejte është sigurimi i të drejtës së të akuzuarit për mbrojtje, si parakusht i rëndësishëm i gjykimit të drejtë. Mbrojtja "vetë" ose "përmes ndihmës ligjore të zgjedhur nga ai" janë thjesht mjete që kanë për qëllim sigurimin e garancive minimale për mbrojtje.

Nëse vetë mbrojtja ngre probleme lidhur me drejtësinë e gjykimit, shteti duhet të marrë masa për sigurimin e një gjykimi të drejtë ndaj të akuzuarit, përndryshe garantimi i të drejtës së të akuzuarit për mbrojtje nuk do të kishte kuptim. Po aq e rëndësishme është që ai të ketë mundësitë dhe lehtësitë për paraqitjen e mbrojtjes së tij në mënyrë të plotë dhe efektive. Gjykatat, pavarësisht nëse i akuzuari dëshiron të kryejë vetë mbrojtjen e tij, kur vërejnë se mbrojtja që ai realizon paraqet probleme dhe ekziston rreziku material i një gjykimi jo të drejtë të çështjes së tij, nuk duhet të mbështesin dëshirën e të akuzuarit për vetëpërfaqësim.

Nëse, në cilëndo fazë të gjykimit, gjykata vëren se ekziston një rrezik i mundshëm ndaj integritetit të gjykimit, çka ndikon në gjykimin e drejtë, gjykatat duhet të marrin masa për shmangien e këtij rreziku. Nëse vetëprezantimi përbën një rrezik të tillë, gjykatat duhet të marrin masa për caktimin e një mbrojtësi kryesisht, nëse i akuzuari nuk e zgjedh vetë atë. Probleme të tilla në gjykim, pavarësisht rrethanave, përbëjnë rrezik për dështim në dhënien e drejtësisë pasi procedurat, në tërësinë e tyre, nuk zhvillohen drejtësisht. Në rastet kur ekziston një rrezik i tillë është e nevojshme të merren masat e duhura për shmangien e tij.

Nëse një i akuzuar, që mbrohet vetë, pengon, përmes veprimeve të tij, zhvillimin e gjykimit, gjykata mund të vendosë largimin e tij nga salla dhe caktimin e një mbrojtësi kryesisht për të. Kjo masë e tillë ka për qëllim mbrojtjen e integritetit të gjykimit dhe sigurimin e një gjykimi të drejtë.[228]

Në cenimin e integritetit të gjykimit, në parim, nuk ka dallim mes veprimeve të qëllimshme, që pengojnë zhvillimin e gjykimit, dhe rrethanave të tjera, që çojnë në të njëjtin rezultat. Këto janë disa shembuj rrethanash në të cilat e drejta për gjykim të drejtë ka përparësi ndaj të drejtës për vetë-përfaqësim. Megjithatë, ka dhe rrethana të tjera kur e drejta për gjykim të drejtë ka përparësi ndaj të drejtave të tjera, si p.sh. kur ushtrimi i të drejtës për vetë-mbrojtje bëhet pengesë për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, parim

[228] Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 344: " … I pandehuri që me sjelljen e tij pengon zhvillimin e rregullt të seancës, edhe pse i është tërhequr vëmendja, largohet nga salla me urdhër të kryetarit. I pandehuri i larguar quhet i pranishëm dhe përfaqësohet nga mbrojtësi. Ai mund të ripranohet në sallë në çdo kohë. Mungesa e të pandehurit që largohet nga salla dhe nuk ka pranuar të ketë mbrojtës, nuk e pengon zhvillimin e gjykimit. Në këtë rast caktohet një mbrojtës kryesisht dhe vazhdon gjykimi. I pandehuri ose mbrojtësi i caktuar prej tij mund të pranohet në sallë në çdo kohë".

ky i rëndësishëm për garantimin e të drejtave minimale të krijuara, *inter alia*, për garantimin e integritetit dhe drejtësisë në gjykim. Mosgjykimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm vë në rrezik garantimin e procesit të rregullt ligjor, çka lind nevojën që shteti të marrë masa për shmangien e problemeve të tilla.

Pra, e drejta e të akuzuarit për t'u mbrojtur vetë është e drejtë e rëndësishme gjatë shqyrtimit të çështjeve penale, por kjo e drejtë mund të humbasë nëse qëllimi i të akuzuarit, përmes përdorimit të kësaj të drejte, është të pengojë zhvillimin e gjykimit dhe marrjen e vendimit. Si rrjedhojë, gjykatat kanë të drejtë që, në rrethana të caktuara, të caktojnë mbrojtës kryesisht nëse i akuzuari nuk zgjedh vetë mbrojtës, pavarësisht dëshirës së të tij për tu mbrojtur vetë.

Vihen re katër forma përfaqësimi në gjykim për realizimin e mbrojtjes:

- një i akuzuar kryen ekskluzivisht mbrojtjen e tij;
- lë kryerjen e mbrojtjes ekskluzivisht avokatit të tij;
- kryen mbrojtjen në bashkëpunim me avokatin, në përputhje me ndarjen e përgjegjësive për të cilat kanë rënë dakord më parë;
- kryen ekskluzivisht mbrojtjen e tij personalisht para gjykatës, ndërkohë që jashtë saj ndihmohet nga mbrojtës me eksperiencë, të cilët nuk marrin pjesë gjatë gjykimit të çështjes.

Në rastet kur mbrojtësi është caktuar kryesisht, gjykata duhet të lejojë pjesëmarrjen aktive të të akuzuarit në prezantimin e çështjes së tij, përmes ekzaminimit dhe riekzaminimit të dëshmitarëve për çështje të veçanta, si dhe t'u bëjë pyetje shtesë që nuk u janë bërë nga mbrojtësi i caktuar kryesisht. Ajo çka gjykata duhet të ketë gjithmonë parasysh është që procedurat duhet të kryhen në përputhje me ligjin në mënyrë që gjykimi, në tërësinë e tij, të jetë i drejtë.

Ajo çka vlen të përmendet është se marrëshënia mbrojtës - klient është një marrëshënie besimi, ku i akuzuari i beson avokatit të tij realizmin e mbrojtjes dhe pret që mbrojtësi të gjejë të metat në procedurat e ndjekura për çështjen, ose në ligj, të meta të cilat mund të shpëtojnë të akuzuarin nga dënimi ose mund të reduktojnë dënimin e mundshëm.

Gjykatat, në rast se veprimet e të akuzuarit pengojnë dhënien e drejtësisë, përmes zvarritjes së procedurave në një masë të tillë që vë në dyshim gjykimin e drejtë të çështjes, mund të vendosin detyrimin e të akuzuarit për t'u përfaqësuar me avokat, pavarësisht dëshirës së tij për vetëpërfaqësim. Në rastin kur mbrojtja e të akuzuarit detyrohet nga gjykata, elementët themelorë të mbrojtjes mund të mungojnë. Imponimi i mbrojtjes ndaj një të akuzuari, pa pëlqimin e tij, mund të ndryshojë rrënjësisht mënyrën e mbrojtjes, duke ndikuar në të drejtat e të akuzuarit jo vetëm për mbrojtje, por dhe në zhvillimin e procedurave. Në procedimet penale, një ndër elementët thelbësorë të zhvillimit të mbrojtjes është udhëzimi, që i akuzuari i jep mbrojtësit, mbi strategjinë dhe

mënyrën e mbrojtjes si dhe mbi detajet thelbësore që shfaqen ditë pas dite në gjykim. Të vepruarit pa marrë më parë këto instruksione kufizon në mënyrë kritike aftësinë e mbrojtjes për të mbrojtur efektivisht të akuzuarin.[229]

Përveç problemeve që ngrihen në rastet e vetëpërfaqësimit të të një akuzuari që refuzon mbrojtjen e caktuar kryesisht, lind pyetja nëse shteti mund të detyrojë një mbrojtës të kryejë mbrojtjen e një të akuzuari që asnjë avokat nuk dëshiron të mbrojë, p.sh. të një personi të akuzuar për krime të tmerrshme kundër njerëzimit?

Krimet e rënda krijojnë urrejtje në publikun e gjerë e shpesh herë ndodh që kjo urrejtje pasqyrohet dhe ndaj mbrojtësve të këtyre krimineleve. Si rrjedhojë, në shumë raste mbrojtësit refuzojnë të marrin përsipër çështje të tilla.

Gjykatat mund të detyrojnë mbrojtjen e të akuzuarit edhe kundër dëshirës së vetë mbrojtësit. Në raste të tilla ngrihen një sërë problemesh të natyrës etike, lidhur me pozicionin në të cilin gjendet avokati i detyruar për të siguruar mbrojtjen. Probleme të tilla etike u ngritën në çështjet kundër *Milosevic*-it gjatë shqyrtimit të saj nga Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ish Jugosllavinë. Mbrojtësit e *Milosevic*-it Stephen Kay dhe Gillian Higgins, avokatë të caktuar kryesisht, paraqitën dorëheqje nga mbrojtja me pretendimin se, përfaqësimi i një të akuzuari, që nuk dëshironte të mbrohej me avokat, kompromenton integritetin e tyre profesional dhe nuk ishte në interes të drejtësisë.[230] Pas marrjes në konsideratë të këtyre pretendimeve, gjykata, unanimisht, vendosi se në interesin më të mirë të drejtësisë do të ishte vazhdimi i mbrojtjes, pavarësisht dëshirës për t'u tërhequr. Në përfundim, gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës së mbrojtjes për dorëheqje.

[229] Gideon Boas, James L. Bischoff, Natalie L. Reid, B. Don Tayler, *International Criminal Procedure*, Cambridge University Press, (2011), 165.
[230] ibid

KAPITULLI V

E DREJTA PËR NJË GJYKIM TË DREJTË NË ÇËSHTJE PENALE

Hyrje

Çfarëdolloj mosmarrëveshjeje që mund të ekzistojë mbi kuptimin e frazës "proces i rregullt ligjor", nuk ka dyshim që përfshin konceptin themelor të gjykimit të drejtë, me të drejtën për t'u dëgjuar.[231]

Ligj dhe rregull, gjykim i drejtë. Shumë njerëz i shohin këto slogane në drejtime të kundërta të spektrit ideologjik, por, në të vërtetë, që të dyja janë pjesë e asaj çka presim nga një shoqëri demokratike. Gjatë historisë sonë kemi mësuar se ato mbështeten tek njëra-tjetra. Drejtësia në procesin penal dhe respekti për të drejtat e të akuzuarit na bëjnë të zbatojmë ligjin, i cili, në këmbim, na siguron rregullin për të cilin kemi nevojë për të jetuar të lirë e pa frikë. Të drejtat tona janë garancia më e mirë e lirisë dhe sigurisë sonë. Përmes respektimit të tyre, edhe kur është shumë e vështirë për të bërë një gjë të tillë, ne vetë bëhemi mbrojtësit më të mëdhenj të lirisë dhe shërbëtorë të idealeve tona më të larta për drejtësi.[232]

E drejta për një proces të rregullt ligjor është një parim i krijuar për mbrojtjen e individëve nga ndërhyrjet e paligjshme ose arbitrare në të drejtat dhe liritë themelore të tyre, ku më të rëndësishmet janë e drejta për jetë dhe për liri. Këto të drejta mbrohen dhe garantohen nga një sërë instrumentesh ndërkombëtarë, si: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ)[233], Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP)[234], Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës,[235] KEDNJ, etj.

---

[231] *Malinski v. New York*, 324 U.S. 401 (1945).

[232] David J. Bodenhamer, *Our Rights*, The right to a fair trial, Oxford University Press (2006), 106.

[233] DUDNJ, Neni 10: "Gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale."

[234] KNDCP, neni 14: "Çdokush ka të drejtën për një gjykim të drejtë e publik, nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj."

[235] Kushtetuta e SHBA, Amendamenti i 6-të: "Në të gjitha ndjekjet penale, personi i akuzuar gëzon të drejtën që ndaj tij të zhvillohet një proces gjyqësor i shpejtë dhe i hapur, i kryesuar nga një juri e paanshme, e atij shteti apo distrikti ku është kryer krimi dhe ku janë zhvilluar më parë hetime në rrugë ligjore. Personi i akuzuar gëzon gjithashtu të drejtën që të njoftohet për llojin dhe arsyen e akuzës, të ballafaqohet me dëshmitarët që deklarojnë kundër tij, t'i lejohet detyrimisht të thërrasë dëshmitarë që dëshmojnë në mbrojtje të tij, si dhe të ketë ndihmën e një avokati mbrojtës"; Amendamenti 14, paragrafi 1: "Të gjithë personat që kanë lindur ose që kanë marrë shtetësinë në Shtetet e Bashkuara dhe që i nënshtrohen juridiksionit të tyre, janë shtetas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të shtetit në të cilin banojnë. Asnjë shtet nuk mund të nxjerrë apo zbatojë asnjë ligj që cenon të drejtat dhe liritë e shtetasve të Shteteve të Bashkuara. Asnjëri prej shteteve nuk mund të privojë asnjë person nga jeta, liria ose pasuria pa

E drejta për gjykim të drejtë në çështje penale gjen zbatim në gjykimet për përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë për akuzat penale të paraqitura kundër një personi. Standardet që duhen pasur parasysh në përcaktimin e një gjykimi të drejtë janë të shumtë, kompleksë dhe në zhvillim të vazhdueshëm. Ato gjenden si në dokumente marrëveshjesh të ratifikuara nga shtetet, ashtu dhe në dokumente, të cilat pavarësisht se formalisht mund të mos kenë natyrë detyruese, merren parasysh, pasi shprehin tendencat e fundit për zhvillimet e legjislacionit.

Në çështjet penale gjykimi i drejtë e procesi i rregullt ligjor janë të një rëndësie jetike pasi vihen në lojë jeta, liria dhe pasuria e të akuzuarit. Në përballjen me shtetin, të akuzuarit i duhen garantuar disa të drejta, me qëllim që të sigurohet dhënia e drejtësisë.

Në mënyrë që të shmangen sa më shumë problemet e natyrës ligjore, lidhur me vlerësimin se çka përbën një gjykim të drejtë, në përgjithësi, duhen pasur parasysh disa aspekte: ligjet e vendit në të cilin kryhet gjykimi si dhe traktatet për të drejtat e njeriut, në të cilat shteti është palë. Në raste të veçanta duhen marrë parasysh dhe normat e të drejtës zakonore ndërkombëtare.

Përcaktimi i materialeve kryesore që përbëjnë legjislacionin e brendshëm të një shteti, shpesh herë është e vështirë, pasi sisteme të ndryshme ligjore kanë rregulla të ndryshme si dhe faza të ndryshme të gjykimit të çështjeve. Megjithatë, nëse do të mund t'i listonim, më kryesorët do të ishin: 1) Kushtetuta e shtetit, kryesisht në parashikimet mbi të drejtat e njeriut dhe sistemin gjyqësor 2) Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale dhe legjislacionet për organizimin dhe funksionimin e gjykatave e organeve të ndjekjes penale; 3) vendimet më të rëndësishme të gjykatave, sidomos ato që u përkasin të drejtave të njeriut. Qëllimi i kryerjes së një vlerësimi të tillë është përcaktimi nëse parashikimet ligjore garantojnë të drejtën për një gjykim të drejtë, dhe, nëse po, deri në ç'pikë.

Siç dihet, Kushtetuta dhe ligjet parashikojnë masat që duhen marrë për garantimin e një gjykimi të drejtë. Vënia në zbatim e tyre bëhet nga gjykatat, të cilat, jo pak herë e cenojnë këtë parim.

Parimi i gjykimit të drejtë (njohur në jurisprudencën shqiptare si "proces i rregullt ligjor") në çështjet penale në jurisprudencën amerikane njihet me termin *"due process"* ose "procesi i duhur", ndërsa në jurisprudencën europiane si *"fair trial"* - "gjykim i drejtë". Mbrojtja që garantohet në të dy rastet është e njëjtë.

E drejta për një proces të rregullt ligjor ka për qëllim të mbrojë parimin e shtetit të së drejtës, mbi të cilin ndërtohet një shoqëri demokratike, si dhe rolin e padiskutueshëm

---

zhvillimin e një procesi të rregullt gjyqësor apo t'u mohojë, personave nën juridiksionin e vet, të drejtën për t'u mbrojtur njëlloj nga ligjet."

të gjyqësorit në administrimin e drejtësisë. Ajo garanton të drejtat procedurale të palëve në proces.

E drejta për proces të rregullt ligjor garantohet nga neni 6 i KEDNJ (sidomos përsa i përket realizmit të mbrojtjes gjatë procedimeve penale), i cili parashikon:

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, ose në rast akuzash të ngritura ndaj tij, çdokush gëzon të drejtën për një gjykim të drejtë dhe publik të çështjes së tij, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj. Vendimi duhet të jepet publikisht, por shtypi dhe publiku mund të përjashtohen nga të gjitha pjesët e gjykimit në interes të moralit, rendit publik dhe sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur interesi i të miturve dhe mbrojtja e jetës private të palëve e kërkojnë një gjë të tillë, ose në raste të veçanta, kur gjykata mendon se publiciteti i çështjes mund të paragjykojë interesin e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për kryerjen e një vepre penale do të prezumohet i pafajshëm deri sa të provohet fajësia e tij sipas ligjit.

3. Çdo person i akuzuar për kryerjen e një vepre penale ka këto të drejta minimale:

- të informohet siç duhet në një gjuhë, të cilin ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme për natyrën dhe shkakun e akuzave të ngritura ndaj tij;
- të ketë kohën dhe lehtësitë e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij;
- të mbrohet vetë ose përmes një përfaqësuesi ligjor të zgjedhur prej tij ose, nëse është në pamundësi për të kryer mbrojtjen ligjore, t'i jepet ajo falas, kur një gjë të tillë e kërkon interesi i drejtësisë;
- të pyesë ose të kërkojë të pyeten dëshmitarët e akuzës si dhe të kërkojë thirrjen dhe pyetjen e dëshmitarëve në favor të tij, në të njëjtat kushte me dëshmitarët e akuzës;
- të këtë ndihmën falas të një përkthyesi nëse ai nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjykatë.

Gjyqtarët kombëtarë të shteteve ku KEDNJ përbën pjesë të legjislacionit të brendshëm, vërejnë përdorimin e mbrojtjes që ofron neni 6 i KEDNJ kryesisht gjatë:
- gjykimit dhe procedurave parapërgatitore, (pyetjes së dëshmitarëve, përjashtimit të fakteve, shtyrjes së seancës, etj.) ose, përgjithësisht, kur krijohen probleme të natyrës procedurale;
- gjatë apelimit të vendimit në gjykatë më të lartë, kur kësaj i kërkohet të vendosë mbi mangësi proceduare të kryera në gjykimin në shkallët më të ulëta;

Momenti i fillimit të mbrojtjes së ofruar nga parimi i procesit të rregullt ligjor

Pyetjet që ngrihen janë: Në çështjet penale, kur fillon e drejta e të akuzuarit për mbrojtje? Në ç'moment të procedimit penal i akuzuari ka të drejtë të kërkojë mbrojtjen me avokat? Si duhet vepruar në rastet e pamundësisë financiare për të marrë avokat mbrojtës?

Në çështjet që kanë të bëjnë me "padi penale" mbrojtja e procesit të rregullt ligjor fillon që në momentin e njoftimit zyrtar të dyshimeve personit që supozohet se ka kryer veprën penale,[236] por mund të fillojë dhe në momentin e marrjes së masave paraprake, si gjatë kontrollit, moment kur personi preket fillimisht nga "akuza".[237] Në rastet kur personi pyetet nga policia, në rrethana që lënë të besojnë se ai është i dyshuari kryesor, dhe përgjigjet e tij përdoren më pas kundër tij në gjykim, parimi i procesit të rregullt ligjor zbatohet dhe ndaj kësaj marrjeje në pyetje, pavarësisht se individi nuk është njoftuar formalisht për akuzën.[238]

Sipas *common law*, momenti i parë i paraqitjes së të akuzuarit para një gjyqtari magjistrat[239], moment kur ai mëson për akuzën ndaj tij dhe liria e tij i nënshtrohet kufizimeve, përbën dhe momentin e nisjes së procedurave gjyqësore, që sjellin detyrimin për garantimin e të drejtës së mbrojtjes. Garantimi i kësaj mbrojtjeje nuk kërkon që prokurori të jetë gjithashtu në dijeni për inicimin e procedurave ose të jetë i përfshirë në këto procedura.[240] Në momentin e paraqitjes së kërkesës për mbrojtës nga i akuzuari, shteti ka detyrimin t'i caktojë një mbrojtës, brenda një kohe të arsyeshme. E drejta për mbrojtës fillon që në momentin e paraqitjes për herë të parë para një polici gjyqësor, moment në të cilin i akuzuari informohet për aktakuzën ndaj tij e kur mund të vendosen kufizime të lirisë së tij.[241]

Sipas KEDNJ, çdo i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai kupton për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.[242] Çdo i akuzuar ka të drejtën të informohet në mënyrë të hollësishme për natyrën dhe shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij; t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes; të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij dhe, në qoftë se nuk ka mjete për të shpërblyer mbrojtësin, t'i

[236] *Eckle v. Germany*, (Application no. 8130/78), pp 73-75.
[237] *Foti and othersv. Italy*, (Application no. 7604/76; 7719/76; 7781/77; 7913/77), pp 52-53.
[238] *Zaichenko v. Russia*, (Application no. 33720/05), pp.41-60.
[239] Roli i tij është pak a shumë i ngjashëm me atë të *Investigating Judge* në Francë.
[240] *Rothgery v. Gillespie County*, 554 U.S. 191 (2008).
[241] *Michigan* v. *Jackson*, 475 U. S. 625 (1986), 629.
[242] KEDNJ, neni 5/2.

mundësohet ndihma ligjore falas nga një avokat i caktuar kryesisht, kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë.[243]

Sipas Kushtetutës shqiptare, kushdo, të cilit i është hequr liria, ka të drejtën të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin e tij, si dhe t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij.[244]

Sipas KPP, merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. Ky akt i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.[245]

Pra, e drejta për proces të rregullt ligjor në çështjet penale fillon jo thjesht në momentin e njoftimit formal të akuzës, por në momentin kur veprimet shtetërore cenojnë substancialisht situatën e personit të prekur. Kjo mund të përkojë dhe me momentin e arrestit, në varësi të rrethanave të çështjes. Garancitë e gjykimit të drejtë duhen parë që nga momenti kur fillojnë hetimet kundër të akuzuarit, deri në përfundim të të gjitha shkallëve të mundshme të ankimit kundër vendimeve të dhëna. Këto garanci nuk lindin nëse nuk fillon procedimi penal.[246]

Çështjet më të rëndësishme, në të cilat Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është shprehur se mbrojtja e ofruar nga standardi i procesit të rregullt ligjor fillon që në momentin e arrestimit, janë: *Mapp v. Ohio*, 1961,[247] *Gideon v. Wainwright*, 1963,[248] dhe *Escobedo* v. *Illinois*, 1964.[249] Kjo Gjykatë, jo vetëm përcaktoi bazat e standardit të "drejtësisë në gjykim", por, përmes këtyre vendimeve, u dërgoi një mesazh të qartë forcave policore dhe zyrtarëve të drejtësisë penale. Dënimet e dhëna në raste procedurash të kryera në kundërshtim me standardin e procesit të rregullt, do të shfuqizoheshin. Garancitë kushtetuese të procesit të rregullt ligjor duhej të respektoheshin. Në 1966 GJS vendosi për çështjen *Miranda v. Arizona*[250], përmes të cilit ajo përmblodhi të gjitha standardet themelore të drejtësisë në gjykim, në një standard të vetëm, atë të procesit të rregullt ligjor për mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarit. Që atëherë këto standarde u bënë të njohura për të gjithë me emrin "Të drejtat *Miranda*".

---

[243] KEDNJ, neni 6/a-c.
[244] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 28/1.
[245] KPP, neni 34/1. Pavarësisht se KPP shqiptare nuk parashikon shprehimisht momentin kur lind e drejta e të akuzuarit për mbrojtje dhe procedurat që ndiqen për garantimin e kësaj të drejte, e lë këtë të nënkuptuar, duke parashikuar si moment të tillë njoftimin e aktakuzës.
[246] *McNeil v. Wisconsin*, 501 U. S. 171, 175 (1991); *Moran v. Burbine*, 475 U. S. 412, 430 (1986); *Rothgery v. Gillespie*, 554 U.S. 191 (2008).
[247] *Mapp v. Ohio*, 367 U.S. 643 (1961).
[248] *Gideon v. Wainwright*, 372 U.S. 335 (1963).
[249] *Escobedo v. Illinois*, 378 U.S. 478 (1964).
[250] *Miranda v. Arizona*, 384 U.S. 436 (1966).

GJEDNJ është shprehur, gjithashtu, se mbrojtja e ofruar nga parimi i procesit të rregullt ligjor shtrihet gjatë gjithë fazës së gjykimit. Neni 6 i KEDNJ, në vetvete, nuk parashikon që shtetet të krijojnë gjykata apeli dhe kasacioni, por nëse këto lloj gjykatash ekzistojnë në sistemin gjyqësor të brendshëm të shtetit, atëherë mbrojtja e ofruar nga ky nen shtrihet dhe në këto lloj gjykimesh, për aq kohë sa legjislacioni kombëtar parashikon ankimin në një gjykatë më të lartë si mjet për vendosjen në vend të të drejtave të shkelura.[251]

Garancitë e ofruara nga neni 6 nuk zbatohen njëlloj në gjykimet në apel si në gjykimet në shkallë të parë. Kështu, nëse ishte siguruar prania e një pale në gjykimin në shkallë të parë, prania e saj në gjykimin në apel mund të mos jetë e nevojshme, për aq kohë sa mbrojtësi është i pranishëm, për aq kohë sa marrja në pyetje nuk është e nevojshme dhe për aq kohë sa nuk ngrihet për shqyrtim çështja e karakterit dhe personalitetit të të akuzuarit.[252]

Zbatimi i këtij neni në faza të ndryshme të apelimit varet nga faktorët e veçantë që ndikojnë në gjykim. Rëndësi u duhet kushtuar tërësisë së procedurave të kryera sipas sistemit të brendshëm ligjor, pasi shkeljet e kryera në një shkallë mund të konstatohen në shkallën tjetër. Gjithashtu, një rëndësi e veçantë duhet tu kushtohet veprimeve të kryera në faza kyçe të gjykimit, si p.sh. realizimi i përfaqësimit ligjor e efektiv gjatë marrjes së të dyshuarit në pyetje për herë të parë[253] ose gjatë fazës përfundimtare[254] të gjykimit, pasi mungesa e këtij përfaqësimi çon në përfundimin se gjykimi, në tërësinë e tij, ka qenë i padrejtë.

Pra, përgjithësisht, mbrojtja që ofron neni 6 i Konventës zbatohet që nga momenti kur individit i bëhet e ditur se ai akuzohet për kryerjen e një vepre penale dhe kjo mbrojtje vazhdon të jetë aktive deri në momentin e dhënies së vendimit të fundit nga gjykatat. Megjithatë, kërkesat e nenit 6 për procedurë ligjore nuk mbulojnë fazën para akuze, pra hapat që ndërmerr prokuroria për përpilimin e akuzës ndaj individit, dhe në veçanti fazën e kryerjes së hetimeve para akuzimit. Një gjë e tillë është konfirmuar nga Gjykata në çështjen *Escoubet v. Belgium*[255], çështje e cila kishte të bënte me heqjen patentës një motoristi, i cili, pas një aksidenti rrugor, dyshohej nga policia se i kishte dhënë motoçikletës së tij në gjendje të dehur.

Masat parandaluese që merren para përcaktimit të "akuzës" dhe masat e marra para dhënies së vendimit për akuzën në fjalë, si p.sh. arrestimi mbi dyshime për kryerjen e një vepre penale ose masat e marra për mbrojtjen e publikut, si në rastin e *Escoubet*, nuk janë të një natyre të tillë, që të bëjnë të mundur përdorimin e garancive procedurale të ofruara nga neni 6 i Konventës. Me fjalë të tjera, neni 6 mund të përdoret vetëm nëse

[251] *Chatellier v. France*, (Application no. 34658/07), pp 34-43.
[252] *Sobolewski v. Poland (No. 2)*, (Application no. 19847/07), pp 37-44.
[253] *Panovits v. Cyprus*, (Application no. 4268/04), pp 66-77.
[254] *Guvec v. Turkey*, (Application no. 70337/01), pp125-133
[255] *Escoubet v. Belgium* , (Application no. 26780/95).

individi është subjekt i një "akuze penale" (ose është dënuar për kryerjen e një vepre penale sipas terminologjisë së nenit 6/2 dhe /3) dhe i aplikueshëm vetëm ndaj procedurave të ndërmarra për dhënien e vendimit për këtë akuzë.

Megjithëse neni 6 nuk garanton, shprehimisht, të drejtën për apelim, procedurat e apelimit, nëse e lejon legjislacioni vendas, trajtohen si zgjatje e procesit gjyqësor e, për rrjedhojë, i nënshtrohen mbrojtjes që garanton neni 6 i Konventës. Por, kërkesat për gjykim të drejtë mund të mos jenë të njëllojta me ato në shkallë të parë. Apelimi para gjykatave Angleze të Apelit bëhet pa praninë e të akuzuarit, mbrojtësit të tij ose prokurorisë. GJEDNJ është shprehur lidhur me këtë, se një sistem i tillë apelimi nuk përbën shkelje të nenin 6 të KEDNJ dhe se ky sistem duhet parë në tërësinë e tij.[256] GJEDNJ është shprehur se mungesa e një seance publike para një gjykate të shkallës së dytë apo të tretë mund të justifikohet nga karakteristikat e veçanta të apelimit apo rishikimit.[257] Për sa kohë që gjykatat zbatojnë parimin e barazisë së armëve (mes mbrojtjes dhe ndjekjes penale), procesi konsiderohet i drejtë, por, nëse u duhet të ekzaminojnë krahas ligjeve, edhe faktet e çështjes, atëherë duhet të marrin masa për dëgjimin e palëve në seancë plenare.[258]

Në shumicën e sistemeve ligjore, neni 6 nuk zbatohet ndaj gjykimeve kushtetuese kur bëhet fjalë për gjykime *in abstrakto* të ligjit, por zbatohet në të gjitha ato raste kur vendimi i Gjykatës Kushtetuese ndikon në rezultatin e një konflikti ndaj të cilit zbatohet neni 6.[259] Ky nen nuk zbatohet për çështje ndaj të cilave gjykatat kanë vendosur mospranim të kërkesës për riçelje të gjykimit, p.sh. për shkak të gjetjes së provave të reja, e as në rastet kur kërkesa për riçelje ka ardhur për shkak të një vendimi gjykate që kishte konstatuar shkelje të Konventës.[260] Por, nëse gjykimi riçelet, atëherë procedurat e gjykimit të ri i nënshtrohen garancive të procesit të rregullt ligjor.[261]

Garancitë e nenit 6 nuk zbatohen as në fazat e e tjera të gjykimeve që kryhen pas dhënies së vendimit përfundimtar për çështjen, si p.sh. në gjykimet për lirim me kusht,[262] kërkesat për rigjykim,[263] kërkesat për ulje të dënimit,[264] procedurat për përcaktimin e burgut në të cilin do të kryhet dënimi,[265] etj.

Procesi i rregullt ligjor në çështjet penale është një parim i përgjithshëm, i cili mbulon dhe garancitë më specifike të parashikuara në paragrafët 2 dhe 3 (paragrafë të cilët detajojnë të drejtat e mbrojtjes në gjykimet penale). Duhet thënë gjithashtu se këto

[256] *Monnell and Morris v. United Kingdom*, (Application no. 9562/81; 9818/82).
[257] *Ekbatani v. Sweden*, (Application no. 10563/83).
[258] ibid
[259] *Olujić v. Croatia*, (Application no. 22330/05), pp 31-43.
[260] *Franz Fischer v. Austria*, (Application no. 37950/97).
[261] *Vanyan v. Russia*, (Application no. 53203/99), pp 56-58.
[262] *X v. Austria*,(Application no. 2676/65).
[263] ibid *Franz Fischer v. Austria*.
[264] ibid *X v. Austria*, dec., 1967.
[265] ibid

paragrafë nuk shterojnë nocionin e gjykimit të drejtë, por janë elementë përbërës, mes të tjerësh. Në mënyrë që të përcaktohet nëse standardi i "procesit të rregullt ligjot" është respektuar, gjykimi duhet parë në tërësinë e tij, në mënyrë që të metat e vendimeve të një shkalle mund të rregullohen nga masat ose vendimet vijuese, p.sh. në gjykimin në apel. Nga ana tjetër, nëse vërehen një sërë të metash, të cilat po të merren individualisht janë të parëndësishme, po të merren së bashku mund të ndikojnë në të drejtën e individit për proces të rregullt ligjor[266].

"Akuza penale" si koncept autonom

Lind pyetja: Ç' është akuza penale?

Çka përbën akuzë penale, pa dyshim, është e ndryshme në shtete të ndryshme. Por, do të ishte e padrejtë dhe diskriminuese nëse mundësia e përdorimit të garancive të ofruara për një proces të rregullt ligjor në çështje penale, garanci të cilat janë krijuar me qëllim që të jenë universale, do të varej nga përcaktimet që u japin atyre ligjet kombëtare.

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, në jurisprudencën e saj, është shprehur se kuptimi i qartë i termit "penale"[267] për qëllimet e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut nuk kufizohet në kuptimin që secili shtet anëtar i Konventës i jep këtij termi. Ashtu si dhe terma të tjerë të përdorur në KEDNJ, fjalës "krim" i është dhënë një kuptim autonom nga GJEDNJ dhe Komisioni Europian. Për rrjedhojë, kjo nënkupton se, pavarësisht nga përcaktimi ose jo i një veprimi si "penal" nga legjislacionet e shteteve të ndryshme anëtare të KEDNJ, sipas Konventës, në vlerësimin nëse një veprim klasifikohet ose jo si i tillë duhet të mbahen parasysh disa faktorë. Fakti se disa procedura nuk klasifikohen si penale sipas legjislacioneve të brendshme, nuk i përjashton ato nga nënshtrimi kontrollit të GJEDNJ.

Në përcaktimin e këtij fakti duhen pasur parasysh: nëse dispozita në fjalë zbatohet në shumicën e rasteve, nëse qëllimi i ndëshkimit ka karakter dëmshpërblyes apo ndëshkues, nëse ndëshkimi përfshin burgosje apo është i tillë në disa aspekte të tjera (si p.sh. pagesa e një shume të konsiderueshme parash). Zbatimi i këtyre kritereve është përdorur në disa çështje të GJEDNJ, që kishin të bënin me vendosjen e masave disiplinore nga institucionet e vuajtjes së dënimeve penale; për shkak të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor; apo dhe në rastet e vendosjes, si ndëshkime "penale", të taksave shumë të larta. GJEDNJ është shprehur se, për klasifikimin e tyre si të tilla, është e nevojshme të shihet mënyra se si ato janë trajtuar nga organet shtetërore.[268]

---

[266] *Barberà, Messegué and Jabardo v. Spain,* (Application no. 10588/83, 10589/83, 10590/83).

[267] 'criminal'

[268] *Human rights and criminal procedure*, The case law of the European Court of Human Rights, Jeremy McBride, Council of Europe Publishing, (2009), 11.

Në përcaktimin e një veprimi si "penal" GJEDNJ ka vendosur disa kritere të rëndësishme:[269]

- *klasifikimi i veprës sipas sistemit ligjor vendas,*
- *lloji/karakteri i veprës,*
- *shkalla e ashpërsisë së dënimit.*

Kriteri i parë ka një rëndësi të veçantë pasi shërben si pikënisje. Nëse një shtet e konsideron një veprim si "penal", atëherë rrjedhimisht procedurat e ndjekura i nënshtrohen shqyrtimit nga GJEDNJ. Nëse jo, atëherë GJEDNJ shikon përtej klasifikimit vendas dhe ekzaminon thelbin e procedurës së ndjekur.

Në vlerësimin e kriterit të dytë, i cili konsiderohet më i rëndësishëm,[270] merren në konsideratë disa faktorë:

- nëse rregulli ligjor në fjalë i drejtohet ekskluzivisht një numri të caktuar individësh, apo ka karakter detyrues të përgjithshëm;
- nëse procedurat janë kryer nga një autoritet publik me pushtet ligjor detyrues;
- nëse dispozita ose ligji ka qëllim ndëshkues apo parandalues;
- nëse dhënia e ndëshkimit bazohet në konstatimin e fajësisë;
- si janë procedurat e Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës në raste të ngjashme;
- fakti që kryerja e një vepre nuk çon në krijimin e dosjes penale mund të merret parasysh, megjithatë nuk është vendimtar, pasi shpesh herë është thjesht reflektim i klasifikimit të brendshëm të shtetit mbi veprimin e kryer.

Kriteri i tretë përcaktohet duke iu referuar dënimit maksimal të mundshëm që legjislacioni vendas jep për çështjen në fjalë.

Kriteri e dytë dhe i tretë janë alternativë dhe jo domosdoshmërisht kumulativë. Që neni 6 të zbatohet mjafton që vepra në fjalë, për nga natyra, të konsiderohet nga pikëpamja e Konventës si "penale" , ose që vepra të ketë bërë që personi t'i nënshtrohet një sanksioni i cili, për nga natyra dhe shkalla e ashpërsisë së tij, i takon në përgjithësi sferës "penale".

Në çështjen e ushtarëve hollandezë[271], e ngritur nga ushtarë rekrutë, të ndëshkuar për kryerjen e disa kundravajtjeve disiplinore ushtarake, GJEDNJ u shpreh se, ndërsa (a) klasifikimi i kundravajtjes, sipas sistemit ligjor vendas, përbën një tregues fillestar, (b) natyra e kundravajtjes dhe/ose (c) natyra dhe shkalla e ashpërsisë së dënimit të dhënë, mund ta bëjnë një kundravajtje "penale" për qëllimet e Konventës, pavarësisht se legjislacioni i zbatueshëm vendas e cilëson atë thjesht si masë disiplinore, p.sh. ligji

[269] *Engels and others v. The Netherlands,* (Application no. 5100/71; 5101/71; 5102/71; 5354/72; 5370/72).
[270] *Jussila v. Finland,* (Application no. 73053/01), pp 38.
[271] ibid, *Engel and others v. The Netherlands.*

ushtarak ose rregullat e burgut. GJEDNJ, në një çështje të vitit 1984 kundër Mbretërisë së Bashkuar, u shpreh se *"drejtësia nuk mund të ndalohet në kangjellat e burgut"*[272]. Për sa i përket natyrës së kundravajtjes, sjellja jo e drejtë, që ka të bëjë kryesisht me disiplinën e brendshme, si p.sh. raportimi me vonesë i largimit, nuk e kthejnë një kundravajtje disiplinore në "penale", ndërsa veprime të tilla si: shfaqje të rënda të dhunës dhe rebelimi mund të thuhet se kanë natyrë "kriminale". Përsa i përket kriterit (c), natyrës së dënimit, heqja për një kohë të gjatë e lirisë një ushtaraku[273] dhe humbja serioze e të drejtës për shlyerje të dënimit nga ana e një të burgosuri,[274] janë shembuj të disa dënimeve të cilat bëjnë që, një procedurë disiplinore, të futet në sferën "penale" të mbrojtjes që garanton neni 6 i KEDNJ. Sipas ligjit administrativ francez, mospagimi i taksave të parashikuara nga, kur taksapaguesi nuk kishte vepruar në mirëbesim, duhej dënuar, sipas gjykatës franceze, me ndëshkim dhe jo kompensim dhe, në rast të mospagimit të çmimit shtesë (gjobës për mospagim të tyre në kohë), taksapaguesi mund dhe të burgosej. GJEDNJ u shpreh se në një rast të tillë bëhej fjalë për një "akuzë penale"[275].

Dy çështje gjermane të vitit 1980 ngritën problemin nëse ato që konsideroheshin deri sot si vepra penale, mund të hiqeshin nga sfera e aplikimit të nenit 6 të KEDNJ përmes riklasifikimit të tyre nga legjislacioni vendas, si vepra "rregullatore", me qëllim dekriminalizimin e kundravajtjeve të vogla penale të trafikut rrugor.[276] Gjykata e Strasburgut u shpreh se kundravajtja në fjalë, megjithëse e lehtë, kishte karakteristika që i përkisnin një vepre penale dhe, si e tillë, ajo gëzonte mbrojtjen e nenit 6 (kriteri b). Dënimi që rrezikonte të merrte motoristi, sipas Gjykatës, ishte i papërfillshëm. Nëse, pas përfundimit të procedurave rregullatore, individi i akuzuar do të ishte i pakënaqur, ai kishte të drejtë, sipas përmbajtjes së nenit 6/1, të kërkonte shqyrtimin e plotë të çështjes së tij nga një gjykatë. Përveç kësaj, mundësia e burgimit (maksimumi 3 muaj) për mospagim të taksës së votimit në Mbretërinë e Bashkuar, bënte që kjo masë shtrënguese të konsiderohej "penale" për qëllimet e KEDNJ, ndonëse sipas ligjit të brendshëm, konsiderohej më tepër si masë me karakter civil (kriteri "c")[277].

Akuza penale sipas konceptit shqiptar

[272] *Campbell and Fell v. UK*, (Application no. 7819/77; 7878/77), pp. 69.
[273] Burgimi për tre muaj në një repart disiplinor (penale) krahasuar me dy ditë arrest (disiplinore). *Engel and others v. The Netherlands*, ibid.
[274] 6 muaj humbje e të drejtës për shlyerje të dënimit (penale). ibid *Campbell and Fell v. United Kingdom* (1984).
[275] *Bendenoun v. France*, (Application no. 12547/86).
[276] *Özturk v. Germany*, (Application no. 8544/79); *Lutz v. Germany*, (Application no. 9912/82).
[277] *Benham v. United Kingdom*, (Application no. 19380/92). Lëvizja kundër pagimit të taksës së votimit në Mbretërinë e Bashkuar bashkoi një grup të madh njerëzish, të cilët, më 31 Mars 1990, u mblodhën dhe demonstruan kundër vendosjes së kësaj takse në Sheshin Trafalgar. Mendohet se kjo lëvizje çoi në rënien e Margaret Thatcher, e cila dha dorëheqjen nga detyra e Kryeministres në Nëntor të po atij viti.

Neni 27, pika 1 e Kushtetutës shqiptare parashikon: "Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj", ndërsa neni 28, pika 1 parashikon: "Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. ...".

Neni 34 i Kodit të Procedurës Penale parashikon: "1. Merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. Ky akt i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Kur pas marrjes së një personi si të pandehur dalin të dhëna të reja që ndryshojnë akuzën e paraqitur ose e plotësojnë atë, prokurori merr vendim, të cilin ia njofton të pandehurit. 2. Cilësia e të pandehurit ruhet në çdo gjendje dhe shkallë të procesit derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose i dënimit. 3. Cilësia e të pandehurit rimerret kur prishet vendimi i pushimit ose kur vendoset rishqyrtimi i procesit. 4. Dispozitat, që zbatohen për të pandehurin, zbatohen edhe për personin nën hetim, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe. Ndaj këtij personi shtrihen edhe të drejtat dhe garancitë që janë parashikuar për të pandehurin."

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, në tërësinë e dispozitave të tij, i njeh të drejtën organit të prokurorisë që, në vartësi të të dhënave që disponon, të marrë në cilësinë e të pandehurit[278] personin që dyshohet se është autor i një vepre penale.

Në ushtrimin e të drejtës, për të marrë personin si të pandehur, prokurori, në çdo rast, është i detyruar të veprojë në përputhje me kërkesat e nenit 34, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale. Sipas kësaj dispozite, "Merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhëna të mjaftueshme për marrjen si të pandehur…". Pra, sipas legjislacionit shqiptar, personi e merr cilësinë e të pandehurit vetëm atëherë kur ai njoftohet, me akt të shkruar, në formën e vendimit, nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, i autorizuar nga prokurori.

Në këtë akt procedural, mbi bazën e të cilit personi merr cilësinë e të pandehurit, parashtrohen të dhënat e grumbulluara deri në atë fazë të hetimit paraprak, të cilat janë vlerësuar të mjaftueshme për të konkluduar si për natyrën kriminale të veprës së kryer, ashtu dhe për autorin e saj dhe fajësinë e tij. Njoftimi i akuzës, me akt të shkruar, si veprim procedural, nënkupton përfundimin paraprak, të arritur nga organi i prokurorisë, se vepra penale është kryer dhe se autor i saj është personi të cilit i bëhet ky njoftim.[279]

Prokurori marrjen e personit në cilësinë e të pandehurit, nëpërmjet njoftimit të akuzës me akt të shkruar, mund ta realizojë në çdo fazë të procedimit penal, përfshirë

[278] Terminologjia e përdorur ("i pandehuri" dhe "jo i akuzuari" - që përdoret në të gjithë materialin) është ruajtur për shkak të referimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, nr.03, datë 27.09.2002.
[279] Vendimi Unifikues nr.03, datë 27.09.2002 i Gjykatës së Lartë.

këtu dhe kohën përpara se personit t'i hiqet liria. Përpilimi i aktit, për marrjen e personit në cilësinë e të pandehurit dhe njohja e tij, në mënyrë të detyrueshme dhe të hollësishme, me faktet dhe rrethanat, që organi i akuzës ka mundur të grumbullojë kundër tij, ka lidhje me të drejtën e personit për t'u mbrojtur, pavarësisht nëse është në gjendje të lirë apo ndaj tij është vendosur masë sigurimi.

Sipas dispozitave të Titullit V, Seksioni I dhe II, të Kodit të Procedurës Penale, kur personit i është hequr liria në formën e ndalimit apo arrestimit në flagrancë, ose kur ndaj tij është caktuar masë sigurimi personal, organi i prokurorisë nuk është i detyruar që, përpara marrjes së këtyre masave ose përpara se të paraqitet në gjykatë, për vleftësimin apo caktimin e masës së sigurimit personal, t'i njoftojë personit aktakuzën. Pra, në këto raste, personi nuk është në cilësinë e të pandehurit.

Sipas nenit 256 të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet rregulli që personi, të cilit i është hequr liria, për shkak të ndalimit apo arrestimit në flagrancë, në çdo rast, duhet të merret në pyetje nga prokurori, i cili, pas kryerjes së këtij veprimi, është i detyruar ta njoftojë atë, në prani të mbrojtësit të zgjedhur ose të caktuar kryesisht, lidhur me "… faktin për të cilin procedohet dhe arsyet e marrjes në pyetje, duke i treguar të dhënat në ngarkim të tij dhe, kur nuk i shkaktohet dëm hetimeve, edhe burimet". Prokurori është i detyruar të kryejë veprimet e përcaktuara në këtë dispozitë, në çdo rast që personit i hiqet liria.[280]

Marrja në pyetje e personit, të cilit i është hequr liria, nuk nënkupton marrjen nga ana e tij të cilësisë së të pandehurit. Veprimet që kryen prokurori, në bazë të nenit 256 të Kodit të Procedurës Penale, nuk janë të njëjta me ato të parashikuara në nenin 34 të këtij Kodi. Sipas nenit 256 të Kodit të Procedurës Penale, marrja në pyetje e personit, nga prokurori, realizohet pas zbatimit të ndalimit apo arrestimit. Përpara marrjes në pyetje, prokurori ka detyrimin të njoftojë personin lidhur me shkakun për të cilin atij i është hequr liria, duke i treguar akuzën, veprën penale konkrete, të cilën dyshohet se ka kryer, si dhe të dhënat apo faktet, që janë mundur të grumbullohen kundër tij deri në atë fazë. Pasqyrimi i veprimeve të kryera nga prokurori, sipas nenit 315 të Kodit të Procedurës Penale, bëhet me procesverbal.

Pavarësisht kryerjes së veprimeve të mësipërme nga ana e prokurorit, personi merr cilësinë e të pandehurit vetëm në momentin e përpilimit të aktakuzës nga ana e prokurorit. Njoftimi i personit të ndaluar apo të arrestuar në flagrancë nga prokurori, lidhur me shkaqet dhe kushtet, për të cilat është bërë ndalimi apo arrestimi në flagrancë i tij, si dhe, njoftimi me të dhënat që disponohen se ai është autor i një vepre penale, bëhet në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime.

Caktimi i masës së sigurimit nuk lidhet me njoftimin e akuzës dhe pyetjen e të pandehurit. Masat e sigurimit, si rregull, caktohen përpara se të bëhet njoftimi i akuzës

[280] ibid

dhe kanë si qëllim, që të plotësohen nevojat e sigurimit ndaj personit në procedim. Vetëm pas zbatimit të tyre bëhet njoftimi i akuzës dhe vazhdohet me marrjen në pyetje. Mendimi, sipas të cilit, masa e sigurimit mund të caktohet vetëm pasi personi të jetë marrë i pandehur, është i gabuar. Kështu, në nenin 307 të Kodit të Procedurës Penale bëhet e qartë se masat e sigurimit mund të caktohen e të zbatohen pa qenë nevoja që personi të jetë marrë i pandehur. Sipas këtij neni: "Ai që ka marrë dijeni se ndaj tij zhvillohen hetime, ka të drejtë të paraqitet te prokurori dhe të bëjë deklarime. Kur ai që paraqet vetë e kundërshton faktin për të cilin procedohet dhe lejohet të parashtrojë shfajësimet e tij, veprimi i kryer barazohet me marrjen në pyetje. Paraqitja vetë nuk pengon zbatimin e masave të sigurimit". Pra, masa e sigurimit mund të caktohet para se personi, të cilit i atribuohet vepra penale, të pyetet si i pandehur dhe paraqitja e tij nuk pengon masën e sigurimit që është marrë më përpara.

Personi, ndaj të cilit merret masa e sigurimit, jo domosdoshmërish është i pandehur. Pra, i arrestuari jo domosdoshmërisht është i pandehur. Kjo gjë ndeshet edhe në legjislacionet procedurale të shteteve që kanë rregullin e marrjes si të pandehur në fund të hetimeve, kur vendoset dërgimi i çështjes në gjykatë, pra shumë kohë më vonë se caktimi i masës së sigurimit.[281]

Masat e sigurimit mund të merren ndaj çdo personi që plotëson kushtet për të qenë subjekt i veprës penale. Terminologjia e përdorur nga Kodi i Procedurës Penale për subjektet e veprave penale ndryshon nga fillimi i çështjes penale e deri në dërgimin e saj për gjykim. Emërtimi i autorëve të veprave penale fillon me termin "personi, të cilit i atribuohet vepra penale" (neni 287 i KPP), "person ndaj të cilit zhvillohen hetime" (nenet 293/1, 295/1, 296/1 e 2, 302, 303/2 – "b" e "d" dhe 308 etj. të KPP) dhe "i pandehur", që ndeshet në shumë dispozita të tjera të Kodit të Procedurës Penale. Autori i mundshëm i veprës penale, i merr këto emërtime në faza të ndryshme të procedimit penal. Ato nuk përfaqësojnë të njëjtën gjë dhe nuk kanë të njëjtin kuptim.

Termi "person të cilit i atribuohet vepra penale" gjendet në nenin 287 të KPP që bën pjesë në Kreun II të Titullit VI të Kodit, dhe që flet për mënyrën si njoftohen e marrin dijeni për veprën penale prokurori dhe policia. Kur njoftuesi mendon se e di se kush është autori i veprës penale, prokurori shënon në regjistrin që mbahet për njoftimin e veprave penale, emrin e personit që, sipas kallëzuesit, është ose mund të jetë autor i veprës penale. Nuk ka asnjë dyshim se ky emërtim i përket fazës fillestare të procedimit penal. Termi "person të cilit i atribuohet vepra penale", i parë në kontekstin e nenit 287 të KPP duke pasur parasysh dhe momentin procedural në të cilin përdoret, kuptohet se nuk mund të barazohet as me termin "person ndaj të cilit zhvillohen hetime" dhe as me termin "i pandehur". Emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale shënohet në regjistër vetëm në ato raste kur kallëzuesi mendon se e di se kush është autori i krimit. Por kjo nuk do të thotë se ai është vërtet autor i veprës penale. Nëse personi, të cilit i atribuohet vepra

[281] ibid

penale, është ose jo autor i veprës penale, kjo do të dalë nga një hetim i plotë i gjithanshëm e në përputhje me ligjin.

Në fazën e hetimeve paraprake kuptohet se ndryshon dhe gjendja juridiko-procedurale penale e autorit të mundshëm të veprës penale, nga "person që i atribuohet vepra penale", në "person ndaj të cilit zhvillohen hetime". Këtë emërtim e mbajnë vetëm personat që dyshohen si autorë të mundshëm të veprës penale. Edhe ky emërtim i dytë, që merr autori i mundshëm i veprës penale gjatë hetimeve paraprake, nuk mund të barazohet me termin "i pandehur". Personi ndaj të cilit zhvillohen hetime është një figurë procedurale e përkohshme, që qëndron midis asaj që KPP quan "person të cilit i atribuohet vepra penale" dhe "të pandehurit", si një figurë më e avancuar procedurale dhe relativisht më e qëndrueshme, e cila ruhet e pandryshuar në çdo gjendje dhe shkallë të procesit penal, derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose fajësisë sipas nenit 34/1 të KPP.

Figura procedurale e autorit të mundshëm të veprës penale, që nga momenti i njoftimit të saj prokurorit e deri në momentin e përfundimit të hetimeve, evoluon nga "person të cilit i atribuohet vepra penale" në "person ndaj të cilit zhvillohen hetime" dhe së fundi në "i pandehur", pavarësisht nëse çështja pushohet apo dërgohet për gjykim. Si rregull, statusi i të pandehurit merret në përfundim të hetimeve, përpara se të depozitohet fashikulli i gjykimit, por ky status mund të merret edhe më përpara. Kjo është në çmimin e prokurorit. Prokurori mund ta bëjë këtë në çdo fazë të hetimit, deri në përfundimin e tyre. Këtë veprim prokurori e kryen vetëm pasi të ketë siguruar të dhënat e mjaftueshme.

Caktimi i masave të sigurimit kundrejt autorëve të veprave penale nuk kushtëzohet me marrjen e cilësisë së të pandehurit. Kjo del edhe nga neni 5 i Kodit të Procedurës Penale ku thuhet: "Liria e personit mund të kufizohet me masa sigurimi vetëm në rastet dhe mënyrat e përcaktuara me ligj". Rregulli i përcaktuar në nenin 5 plotësohet dhe sqarohet, gjithashtu, nga pika 4 e nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale ku thuhet: "Dispozitat, që zbatohen për të pandehurin, zbatohen edhe për personin nën hetim, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe. Ndaj personit në hetim shtrihen edhe të drejtat dhe garancitë që janë parashikuar për të pandehurin".

Ajo që vlen të theksohet dhe të vihet më shumë në dukje është përcaktimi i përmbajtjes së akuzës që duhet të njoftohet dhe dhënia e mundësisë personit të akuzuar për t'u mbrojtur.

Pra, organi procedues mund ta bëjë njoftimin e akuzës si përpara pyetjes së personit nën hetim, ashtu edhe përpara marrjes së personit në cilësinë e të pandehurit dhe pyetjes së tij. Masat e sigurimit mund të caktohen edhe pa u marrë personi më parë si i pandehur, me kusht që të jetë vënë në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet dhe për të drejtat e tij, sipas parashikimeve të nenit 31 të Kushtetutës.[282]

[282] ibid

E drejta për t'iu drejtuar një gjykate

E drejta për akses në gjykatë rrjedh nga parimi i legjislacionit ndërkombëtar, i cili ndalon mohimin e drejtësisë. Ai zbatohet si në çështje penale, ashtu dhe civile. Neni 6 i KEDNJ nuk parashikon, shprehimisht, të drejtën për apelim në gjykatat e nivelit më të lartë, por në rastet kur legjislacionet vendase e parashikojnë një të drejtë të tillë, atëherë ky nen zbatohet dhe ndaj këtyre gjykimeve. E drejta për vendim të arsyetuar, ekzaminuar shpesh herë nga GJEDNJ në kuadër të "drejtësisë" në gjykim, bie brenda konceptit të së drejtës për t'iu drejtuar një gjykate, pasi kërkon dhënien përgjigje nga gjykata të pyetjeve të ngritura nga kërkuesi ose mbrojtësi i tij rreth fakteve ose problemeve ligjore në çështjen konkrete.[283]

Neni 42, paragrafi 2 i Kushtetutës së RSH parashikon se, kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj.

Neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ sanksionojnë, në vetvete, jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses.[284] E drejta e aksesit në gjykatë mund t'i nënshtrohet kufizimeve deri në atë masë sa ato të mos cenojnë thelbin e kësaj të drejte. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i të drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës.[285]

Me qëllim zbatimin e nenit 6 të KEDNJ si dhe mbrojtjen reale dhe efektive të të drejtave, si dhe që garantimi i tyre të mos jetë thjesht teorik, GJEDNJ krijoi disa standarde për të kuptuar "të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës":

- e drejta për akses në gjykatë;[286]
- dhënia e vendimit të formës së prerë;[287]
- ekzekutimi i vendimeve brenda një afati të arsyeshëm;[288]

Cenimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës në çështjet penale shfaqet në disa drejtime kryesore:

---

[283] *Chevrol v France*, (Application no. 49636/99).
[284] Vendime nr. 5 datë 06.03.2009 dhe nr. 17, datë 19.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese të RSH.
[285] Vendim nr. 18, datë 08.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.
[286] *Golder v. The United Kingdom*, (Application no. 4451/70).
[287] *Brumarescu v Romania*, (Application no. 28342/95.
[288] *Hornsby v. Greece*, (Application no. 18357/91.

- pamundësinë e apelimit;[289]
- pengesa procedurale në aksesin në gjykatë, si vendosja e kufizimeve kohore[290] apo pagimi i taksave gjyqësore[291].
- mungesë e ndihmës ligjore;

Në parim, vendosja e kufizimeve kohore dhe kërkesave për mirëadministrimin e drejtësisë, lejohet; por ato nuk duhet të cenojnë thelbin e të drejtës së aksesit. Shpesh herë gjykatat kërkojnë që përpilimi i kërkesave, dhënia e argumenteve faktikë dhe ligjorë, të bëhet në një formë të caktuar. E rëndësishme është që, këto kërkesa të mos kthehen në formalitet të tepruar, pasi gjykatat mund të marrin vetë disa lloj informacionesh, në mënyrë që të vendosin për kërkesën, pavarësisht se ajo mund të mos jetë formuluar në një formë precize dhe të qartë.[292]

Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e të drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor.[293]

Gjykata e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj

Një ndër problemet me të cilat përballet drejtësia penale është dhe gjykimi nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj. Shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj reflekton parimin e shtetit të së drejtës, i cili është element i sistemit të mbrojtjes të krijuar nga KEDNJ dhe Protokollet e saj. "Ligji" përfshin në mënyrë të veçantë legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e organeve gjyqësore. Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion për të gjykuar të pandehurin në përputhje me dispozitat në fuqi, ajo nuk është "e krijuar me ligj", sipas parashikimeve të KEDNJ-së.[294]

Shprehja "e krijuar me ligj" përfshin jo vetëm bazën ligjore për ekzistencën e gjykatës, por , në çdo rast, dhe përbërjen e formimit të saj.[295] Një gjykatë karakterizohet, në kuptimin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që nënkupton shqyrtimin e çështjeve

[289] *Papon v. France*, (Application no. 54210/00, pp 99-100.
[290] *Hadjianastassiou v. Greece*, (Application no. 12945/87).
[291] *Kreuz v. Poland*, (Application no. 28249/95).
[292] *Dattel (No. 2) v. Luxembourg*, (Application no. 18522/06), pp 36-47.
[293] Vendime nr.14 datë 3.6.2009 dhe nr. 7 datë 11.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese të RSH.
[294] *Jorgic v. Germany*, (Application no. 74613/01).
[295] *Shabanov and Tren v. Russia*, (Application no. 5433/02, *Fedotova v. Russia*, (Application no. 73225/01).

brenda kompetencës së saj, sipas rregullave në fuqi si dhe kryerjes së procedurave sipas parashikimeve ligjore. Megjithatë, një gjykatë duhet të përmbushë dhe një sërë kushtesh të tjera, ku përfshihen pavarësia e anëtarëve të saj, kohëzgjatjen e tyre në detyrë, pavarësinë dhe ekzistencën e garancive procedurale.[296]

Sipas kuptimit autonom të nenit 6 të KEDNJ, edhe një organ disiplinor ose administrativ që zgjidh një konflikt, ka atributet e një gjykate, pavarësisht se mund të mos jetë emëruar si e tillë (gjykatë) nga legjislacioni vendas. Sipas GJEDNJ një organ i tillë konsiderohet "gjykatë" sipas qëllimit të nenit 6 të Konventës.[297] Nuk është e nevojshme që ky organ të jetë pjesë e gjyqësorit dhe, fakti se ai kryen dhe funksione të tjera përtej atij gjyqësor, nuk e përjashton nga koncepti i "gjykatës".

Mbrojtja e garantuar nga nenin 6 përfshin si ato gjykata ku gjykimi i nënshtrohet vlerësimit të jurisë, ashtu dhe ato gjykata në të cilat gjykimet kryhen nga një ose një trupë gjyqtarësh profesionistë. GJEDNJ është shprehur se përcaktimi i vetë termit "gjykatë", sipas kuptimit të nenin 6/1 të KEDNJ, nuk është i thjeshtë. Si e tillë do të konsiderohet çdo organ me pushtet vendimmarrës.

GJEDNJ u ka atribuar funksionet e një *"gjykate"* edhe institucioneve që në fakt nuk kanë funksione të tilla, siç ishte "Bordi i Vizitorëve" në çështjen *Campbell dhe Fell* kundër Mbretërisë së Bashkuar.[298] GJEDNJ pasi vlerësoi rolin gjykues dhe kontrollues të "Bordit të Vizitorëve", mënyrën dhe kohëzgjatjen e caktimit të anëtarëve të tij, arriti në përfundimin se Bordi ishte një *gjykatë, e pavarur* dhe *e paanshme*. Gjykata analizoi me kujdes, jo vetëm tiparet strukturore të "Bordit të Vizitorëve" për qëllimet e konsiderimit të tij si gjykatë, por sidomos garancitë procedurale që një organ duhet të plotësojë për t'u konsideruar *gjykatë* për qëllimet e nenit 6.

Termi "Gjykatë e pavarur, e paanshme, e krijuar me ligj" përfshin tre karakteristika kryesore, të cilat shpesh herë, përfshijnë njëra-tjetrën:

- gjykatë "e krijuar me ligj";[299]
- gjykatë "e pavarur";[300]
- gjykatë "e paanshme".[301]

A. E krijuar me ligj

[296] *Coëme and others v. Belgium*, (Applications nos. 32492/96, 32547/96, 32548/96, 33209/96 and 33210/96).
[297] *Didier v. France*, (Application no. 58188/00).
[298] *Campbell and Fell v. United Kingdom* , "Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut", Ledi Bianku, 261.
[299] *H. v. Belgium*, (Application no. 8950/80).
[300] ibid *Campbell and Fell*, pp 78-82.
[301] *Piersack v. Belgium*, (Application no. 8692/79), pp 30-32.

Termi "e krijuar me ligj" ka për qëllim të sigurojë që organizimi i gjyqësorit nuk varet nga diskrecioni i ekzekutivit, por rregullohet me ligj të nxjerrë nga parlamenti. Anëtarët e këtij organi jo domosdoshmërish duhet të jenë juristë ose gjyqtarë. Më e rëndësishmja është që ky organ ka pushtetin të marrë vendime të detyrueshme për zbatim dhe jo thjesht të këshillojë apo japë opinione. Termi "e krijuar me ligj" mbulon jo vetëm bazën ligjore për ekzistencën e gjykatës, por njëkohësisht përbërjen e trupit gjykues në çdo çështje.[302]

Juridiksioni i gjykatës duhet të përcaktohet me ligj. [303] Nuk është e nevojshme që ligji të rregullojë çdo detaj të organizimit gjyqësor, por roli dhe pozicioni i gjyqtarit duhet të jenë të qartë.[304] Përcaktimi i nocionit "e krijuar me ligj" përfshin një ekzaminim të përgjithshëm të strukturës mbi të cilën ngrihet e ushtron veprimtarinë ky organ.

"Gjykatë e caktuar me ligj" konsiderohet ajo gjykatë, e cila është krijuar me ligj të posaçëm në kuptimin formal (parashikimet ligjore) dhe material (përbërja e formimit të saj), ku të jenë përcaktuar çështjet për të cilat ajo ka kompetencë lëndore dhe tokësore. Rregullimi ligjor i saj duhet të përcaktojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit, e njëkohësisht dhe kompetencën e saj. Ajo duhet të veprojë në përputhje me dispozitat që rregullojnë veprimtarinë e kësaj gjykate.

Një gjykatë karakterizohet në thelb nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë zgjidhja e çështjeve brenda kompetencës së saj në bazë të dispozitave ligjore dhe sipas një procedure të parashikuar ... ajo duhet të përmbushë gjithashtu një sërë kërkesash të tjera: pavarësi, sidomos nga ekzekutivi; paanësi, kohëzgjatje të mandatit të anëtarëve të

[302] *Fatullayev v Azerbaijan,* (Application no. 40984/07).

[303] Në çështjen *Schlesinger v. Councilman*, 420 U.S. 738 (1975), një officer ushtrie në detyrë i ishte dërguar gjykatës ushtarake për gjykim, nën akuzën se kishte dhunuar Kodin Uniform të Drejtësisë Ushtarake, përmes shitjes, transferimit dhe posedimit të marijuanës. Oficeri, në çështjen në fjalë, nuk vuri në diskutim ligjshmërinë e gjykatës ushtarake, as procedurat e tyre, dhe as se, si ushtarak, ai i nënshtrohej gjykatës ushtarake. Argumenti i tij i vetëm kundër ishte se çështja e tij nuk përfshihej në autoritetin e gjykatës ushtarake, pra qëllimin për të cilin ajo ishte krijuar. Gjithashtu, në çështjen *Hamdan v. Rumsfeld*, 548 U.S. 557 (2006), aplikanti Hamdan, i akuzuar për pjesëmarrjen në grupet terroriste Al-Qaeda, që organizuan sulmin ndaj World Trade Center në New York, mbi bazën e urdhrit të Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës të datës 13 Nëntor 2001 "Për arrestimin, trajtimin dhe gjykimin e disa Jo-Shtetasve në luftën kundër terrorizmit", u dërgua në Guantanamo Bay dhe iu nënshtrua gjykimit nga komisionet ushtarake. Në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës së Lartë (Supreme) të Shteteve të Bashkuara, ai shrehej se të drejtën për të shqyrtuar çështjen e tij nuk e kishin komisionet ushtarake, por gjykata ushtarake, e krijuar në përputhje me Kodin Uniform të Drejtësisë Ushtarake (UCMJ). Kjo për dy arsye: Së pari: as Akti Kongresial e as *common law* i luftës nuk mbështesnin gjykimin nga ky komision për krimin e komplotit, një vepër që, sipas Hamdan, nuk përbënte dhunim të ligjit të luftës. Së dyti: Hamdan u shpreh se procedura që Presidenti kishte ndërmarrë për gjykimin e tij, dhunonte parimet themelore të ligjit ushtarak dhe atij ndërkombëtar, duke përfshirë dhe parimin se një i dënuar duhet të shohë dhe dëgjojë evidencat kundër tij. Gjykata vendosi, se komisioni ushtarak i krijuar për gjykimin e tij, nuk kishte kompetencë për të gjykuar çështjen, pasi struktura dhe procedurat e tij dhunonin si Kodin Uniform të Drejtësisë Ushtarake, ashtu dhe Konventën e Gjenevës. Krimi për të cilën akuzohej Hamdan nuk ishte një "krim që sipas … ligjit të luftës, mund të shqyrtohej nga komisionet ushtarake".

[304] *Pandjikidze and others v. Georgia,* (Application no. 30323/02), pp103-111.

saj; garanci procedurale, disa nga të cilat figurojnë dhe në vetë paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)[305]. Parimi i "një gjykate të caktuar me ligj" është një parim që lidhet ngushtë me procesin e rregullt ligjor dhe kryesisht me pavarësinë dhe paanshmërinë e "gjykatës së caktuar me ligj".

Pra, karakteristikat e një gjykate, që të konsiderohet e krijuar me ligj, duhet të jenë: 1) pushteti vendimmarrës, 2) juridiksioni dhe kompetenca, 3) organizimi dhe funksionimi sipas rregullave të caktuara me ligj, 4) pavarësia, 5) paanshmëria, 6) kohëzgjatja në detyrë, 7) ofrimi i garancive procedurale.

Neni 42 i Kushtetutës shqiptare parashikon: "1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. 2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një *gjykatë* e pavarur dhe e paanshme *e caktuar me ligj*".

B. E pavarur dhe e panashme

Termi "e pavarur" është interpretuar nga GJEDNJ si pavarësi nga ekzekutivi dhe legjislativi. Disa nga faktorët që merren parasysh, për të parë nëse ky kusht përmbushet, janë emërimi i gjyqtarëve apo vendimmarrësve[306], kohëzgjatja e detyrës, garancitë kundrejt presioneve të jashtme dhe shfaqja e pavarësisë në vendimmarrje[307]. Pavarësia ndaj palëve është çështje që i nënshtrohet analizës.[308]

Thelbi i nocionit të "pavarësisë në gjykim" qëndron në faktin se një gjyqtar duhet të jetë i lirë të marrë vendime lidhur me çështjet, pa u vënë nën presion, ose pa u influencuar nga jashtë (autoritete, agjenci apo dhe individë). Një gjyqtar nuk duhet të detyrohet apo shtrëngohet (as nëpërmjet ligjit e as në praktikë), për të ndjekur urdhrat e organeve apo personave të tjerë, të qeverisë, autoriteteve të ndjekjes penale, shërbimeve të sigurimit apo grupimeve private politike apo fetare. Nuk mund të ketë një gjykim të drejtë civil apo penal, nëse gjykata nuk plotëson këto kushte (pavarësi dhe paanshmëri). Një gjykatë, për të qenë e tillë, duhet të përmbajë elementët *subjektivë* dhe ato *objektivë* të pavarësisë dhe paanësisë së saj në një proces gjyqësor. Elementi *subjektiv* ka të bëjë

[305] Ledi Bianku, *Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut*, Qendra Europiane (2005), 302, pp 23. Alastair Mawbray, *Cases and Materials on the European Convention on Human Rights*, Oxford University Press, 2-nd edition, (2007), 374.
[306] Jo në çdo rat organi me pushtet vendimmarrës për çështje penale quhet "gjykatë". Ndodh që organi të ketë një emërtim krejt të ndryshëm, por funksionet që ai ka dhe ushtron kanë karakter vendimmarrës.
[307] *Gregory v. United Kingdom*, (Application no. 22299/93).
[308] Paul Mahoney, *Right to a fair trial in criminal matters under article 6 E.C.H.R.*, Judicial Studies Institute Journal, 117.

me hetimin, nëse një gjyqtar ka qenë i përfshirë personalisht në një çështje të caktuar, gjë që ngre dyshime lidhur me pavarësinë dhe paanshmërinë e tij në gjykim. Konsiderohet se një gjyqtar është i paanshëm në gjykim deri në rastin kur provohet e kundërta[309]. Rastet e anshmërisë subjektive të gjyqtarit në gjykime janë të pakta, pasi një gjë e tillë është e vështirë të provohet. Elementi *objektiv* përfshin përcaktimin nëse, për nga pamja e jashtme apo struktura, dyshimet e të akuzuarit për paanshmërinë dhe pavarësinë e gjykatës janë të bazuara, pra të ligjshme.[310]

Megjithëse, në pamje të parë, duket se kuptimi i termit "gjykatë e caktuar me ligj" është i qartë, interpretimi i garancisë "e caktuar me ligj" është shumë më i gjerë. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme gjithashtu dhe nga legjislativi, parlamenti apo grupime të tjera. Gjithmonë duhet bërë dallim mes *paanshmërisë subjektive* (ekzistencës së paragjykimit nga një gjyqtar ose gjykatë) dhe *paanshmërisë objektive* (nëse një gjyqtar ofron garanci të mjaftueshme që e përjashtojnë atë nga çdo dyshim lidhur me çështjen). Paanshmëria e gjyqtarit prezumohet deri kur ka prova për të kundërtën.

GJEDNJ ka ekzaminuar një sërë sistemesh lidhur me emërimin në detyrë të gjyqtarëve dhe, për këtë, i ka kushtuar rëndësi pozicionimit të gjyqtarit pas emërimit të tij në detyrë. Ajo ka pranuar se emërimi i gjyqtarëve nga ekzekutivi apo legjislativi nuk përbën në vetvete mungesë pavarësie. Kështu, në çështjen *Filippini v. San Marino*[311], GJEDNJ është shprehur se, ndonëse simpatitë politike luajnë rol në procesin e emërimit, kjo është e pamjaftueshme për të ngritur dyshime lidhur me pavarësinë dhe me paanshmërinë e gjyqtarëve. Ajo që ka rëndësi për GJEDNJ është fakti, se nuk duhet të ketë orvatje për të influencuar gjyqtarët pas emërimit të tyre.

Në çështjen *Sacilor-Lormines*, GJEDNJ konkludoi se: "emërimi i gjyqtarëve nga një anëtar i ekzekutivit, apo Parlamenti, në vetvete nuk krijon lidhje vartësie, me kusht që pas emërimit të tyre, mbi ta nuk ushtrohet presion në ushtrimin e funksioneve të tyre gjyqësore". GJEDNJ thekson se sigurimi i kohëzgjatjes së detyrës së gjyqtarit përbën një garanci në mbrojtjen e pavarësisë dhe paanshmërisë së tij. Madje, GJEDNJ njeh, si një tregues të fortë të pavarësisë, të drejtën e gjyqtarit për të mos u hequr nga detyra deri në daljen e tij në pension. Kjo nuk do të thotë që heqja e tyre duhet të jetë e pamundur, por ajo duhet të bëhet për arsye të përcaktuara mirë, si paaftësi apo pamundësi e kryerjes së detyrave të tij dhe një gjë e tillë të bëhet sipas procedurave të përcaktuara.

Probleme të mëdha ngrihen në rastet kur një gjyqtar luan role të ndryshme procedurale në vazhdën e procedurave; kur përbërja e gjykatës përkon me atë të një gjykate tjetër, e cila ka qenë e përfshirë në disa aspekte të çështjes; ose kur gjykata nuk përbëhet nga anëtarë me karrierë ligjore apo juridike. Kemi të bëjmë me konflikt rolesh kur një gjyqtar ka pasur më parë një rol investigativ (p.sh. prokuror) lidhur me

[309] Alastair Mawbray, *Cases and Materials on the European Convention on Human Rights*, Oxford University Press, 2-nd edition, 437, pp 25.
[310] Brunilda Bara, *Gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj*, Jeta Juridike Nr.1, Mars 2010.
[311] *Filippini v. San Marino*, (Application no. 10526/02).

çështjen.[312] Megjithatë, që një gjykatë të konsiderohet e paanshme është e nevojshme që gjyqtari të ketë qenë i përfshirë në vendimmarrjeje përpara gjykimit të çështjes nga gjykata ose të ketë qenë i përfshirë, përsa i përket çështjes objekt shqyrtimi nga gjykata, në cilësinë e prokurorit[313].[314] Fakti se një gjyqtar ka dijeni paraprake lidhur me çështjen nuk është i mjaftueshëm për t'u shprehur lidhur me anshmërinë e tij në gjykim, megjithatë u duhet dhënë rëndësi qëllimit dhe natyrës së masave të marra para fillimit të gjykimit. Nuk përbën problem rasti kur një gjyqtar mund të ketë qenë drejtues i ndjekjes penale në kohën kur aplikanti merrej në pyetje nga policia lidhur me një vepër tjetër penale[315]. Nuk ka dyshime lidhur me paanshmërinë e gjyqtarit, përveçse nëse ai ka marrë pjesë në "hartimin" ose përpilimin e akuzave[316].

Çështja e paanshmërisë së gjykatës u adresua për herë të parë nga GJEDNJ në çështjen *Piersack v. Belgium*[317]. Në këtë çështje nuk u vu në dyshim pavarësia personale e gjyqtarit, e quajtur shpesh herë pavarësi subjektive, por pavarësia e tij funksionale, e quajtur pavarësi objektive. Gjyqtari kishte ushtruar më parë funksionin e prokurorit me përvojë[318], si drejtues i një grupi prokurorësh, që ishin marrë me çështjen e të akuzuarit në fjalë. GJEDNJ u shpreh se paanshmëria e tij ngrinte dyshime. Gjykata u shpreh se testi që duhej bërë në këto raste ishte nëse dyshimet mbi paanshmërinë i ngre jo vetëm i akuzuari, pasi ai është gjithmonë i pakënaqur, por dhe një njeri normal, i arsyeshëm.

Parimi i shfaqjes së paanshmërisë së gjykatës zbatohet dhe në rastet e gjykimit me juri. E tillë ishte çështja angleze *Pullar v. United Kingdom*[319]. Një përfaqësues i zgjedhur i një autoriteti lokal dhe një zyrtar i këshillit të qytetit u ndoqën penalisht për korrupsion, për shkak se i kishin kërkuar ryshfet një arkitekti, në mënyrë që ky të përfitonte kontrata publike. Arkitekti mori pjesë në gjykim si dëshmitar i prokurorisë. Një nga anëtarët e jurisë kishte punuar më parë për arkitektin, si ndihmës i tij, para se të largohej nga puna për shkak të shkurtimit të vendeve të punës. Anëtari i jurisë informoi për këtë punonjësit e gjykatës, por ata nuk e informuan gjyqtarin e çështjes, e si rrjedhojë, anëtari i jurisë qëndroi si i tillë në këtë gjykim. Pavarësisht nga kjo, GJEDNJ u shpreh se nuk kishte cenim të nenit 6/1 të Konventës, pasi anëtari i juristë s'kishte dijeni më parë për rrethanat e çështjes.

Vendimi i njëqindtë i Gjykatës së Strasburgut ishte rrjedhojë e një kërkesë paraqitur kësaj Gjykate nga një kasap i dënuar për kundravajtje penale sipas Kodit të

[312] *De Cubber v.Belgium*, (Application no. 9186/80).
[313] *Piersack v. Belgium*,(Application no. 8692/79). Gjyqtari kishte qenë më parë kryetari i grupit të prokurorëve që kishin ndjekur çështjen. *Meznaric v Croatia*, (Application no. 71615/01), Gjyqtari kishte qenë më parë avokat i palës tjetër.
[314] *Hauschildt v. Denmark*, (Application no. 10486/83).
[315] *Mellors v UK*, (Application no. 57836/00). Situata do të kishte qenë ndryshe nëse gjyqtari nuk do të kishte lënë postin e prokurorit para se kërkuesi të akuzohej, arrestohej apo paditej për akuzën e vrasjes.
[316] *Tedesco v France*, (Application no. 11950/02).
[317] *Piersack v. Belgium*, (Application no. 8692/79).
[318] *'Senior deputy public prosecutor'*.
[319] *Pullar v. United Kingdom*, (Application no. 22399/93).

Higjenës Ushqimore Austriake, pas konstatimit se mishi i tymosur, i prodhuar nga kompania e tij, përmbante sasi të madhe uji si dhe një substancë që provokonte sëmundjen e kancerit[320]. Çështja e kërkuesit ishte dëgjuar në shkallë të parë dy herë nga i njëjti gjyqtar dhe ishte thirrur në të dy rastet i njëjti ekspert, çka ngrinte dyshime mbi anshmërinë e gjykatës. GJEDNJ u shpreh se kishte pasur trajtim të padrejtë të palëve e si rrjedhojë një gjykim të padrejtë.

Në çështjen *Remli v. France*[321] i akuzuari ishte afrikano-verior. Një nga anëtarët e jurisë ishte dëgjuar të thoshte në korridorin jashtë dhomës së gjykimit: "Jam racist. Nuk më pëlqejnë arabët". Gjykata franceze u shpreh se, sipas legjislacionit në fuqi, nuk kishte pushtet për të vendosur për një gjë të tillë dhe se juria duhej të qëndronte siç ishte. GJEDNJ u shpreh se kishte shkelje të nenin 6/1 përsa i përket paraqitjes së paanshmërisë së gjykatës. Sipas GJEDNJ, Franca duhej të merrte masat e nevojshme legjislative që të parandalonte rënien e gjykatave në situata të tilla.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë është shprehur: "Neni 7 i Kushtetutës parashikon se sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve: ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Ky sistem nuk i njeh epërsi një pushteti ose organi kushtetues në raport me pushtetet e tjera të shtetit. Ndonëse renditen njëri pas tjetrit, tri pushtetet e përmendur nuk qëndrojnë në varësi hierarkike nga njëri-tjetri dhe as nuk dominojnë apo i nënshtrohen ndikimeve reciproke *extra-ligjore*. Demokracia kushtetuese e vendosur me këtë Kushtetutë, bazohet në shtetin e së drejtës, parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kuvendi është njëri nga organet e autoritetit të shtetit dhe për pasojë, kompetencat dhe sfera e veprimtarisë së tij është përcaktuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligje."[322]

GJK, në jurisprudencën e saj, ka konfirmuar se gjykatat kanë të drejtën ekskluzive për dhënien e drejtësisë. Asnjë institucion tjetër shtetëror apo zyrtar publik, përveç gjykatave të pavarura, nuk mund ta ushtrojë këtë detyrë. Ky funksion i gjykatave përcakton vendin e gjyqësorit në sistemin e institucioneve të pushtetit shtetëror dhe statusin e gjyqtarëve.[323] Pavarësia dhe kompetenca e gjyqësorit, si një e tërë, janë të pandara nga pavarësia e gjyqtarit si individ dhe e gjykatës si institucion.

Në nenin 145 të Kushtetutës deklarohet se gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Roli i gjyqtarit dhe gjykatave është që, ndërsa ushtrojnë funksionin e drejtësisë, ata duhet të sigurojnë zbatimin e normave kushtetuese dhe të akteve të tjera ligjore për të garantuar shtetin e së drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në funksion të rregullimit kushtetues, të parashikuar në nenin 145, pika 1, që njeh pavarësinë e gjyqtarëve dhe nënshtrimin e tyre

[320] *Bönisch v. Austria,* (Application no. 8658/79).
[321] *Remli v. France* (Application no. 16839/90).
[322] *Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 20.05.2008.*
[323] *Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 02.04.2008.*

vetëm ndaj Kushtetutës dhe ligjeve, pika 3 e kësaj dispozite, në të njëjtën kohë, ka sanksionuar një tjetër rregullim, që ndalon ndërhyrjen në veprimtarinë e gjykatave dhe të gjyqtarëve. Një formulim i tillë është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me veprimtarinë e dhënies së drejtësisë nga gjykatat dhe gjyqtarët. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh përmbajtjen e neneve 7, 42, 144 dhe 145 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka çmuar se edhe roli i administratës gjyqësore nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor.[324]

Në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese të RSH, pavarësia e gjyqësorit kuptohet si: *pavarësi substanciale,* që do të thotë "liri e gjykatave për të dhënë vendime, të cilat nuk bazohen në interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit"; *pavarësi strukturale,* që lidhet me parashikimin në Kushtetutë apo në ligj të ekzistencës së institucionit, të mënyrës së formimit të përbërjes së tij; *pavarësi organizative,* që përfshin strukturimin e brendshëm administrativ të gjykatave; *pavarësi financiare,* që nënkupton autonomi në hartimin e buxhetit nga vetë institucioni dhe miratimin nga legjislativi, si një zë i veçantë i buxhetit të shtetit, fonde të përshtatshme e të mjaftueshme për të realizuar qëllimin dhe detyrat e institucionit e sovranitet në lidhje me administrimin e fondeve të akorduara; si dhe *pavarësi personale,* që kërkon emërim në bazë të kritereve objektive, imunitet, garanci ekonomike, garanci për karrierën, sistem të transferimit dhe një sistem disiplinor.[325]

Pra, pavarësia e gjyqësorit përbën një parim të rëndësishëm, jo vetëm në ruajtjen e rendit ligjor, por dhe në garantimin e lirive dhe të drejtave të të akuzuarve, të cilët përballen me një sistem gjyqësor të korruptuar, të njëanshëm apo të varur nga institucione ose individë gjatë dhënies së drejtësisë penale.

Afati i arsyeshëm për shqyrtimin e çështjes

Përcaktimi i afatit të arsyeshëm, brenda të cilit duhet shqyrtuar një çështje, është i vështirë. Cilat data të fillimit dhe mbarimit duhen marrë në konsideratë? Ç'kuptojmë me afat të arsyeshëm?

Neni 6 i KEDNJ përdor termat "afat" dhe "i arsyeshëm". "Afati" "i arsyeshëm" është periudha kohore mes njoftimit të akuzës dhe dhënies së vendimit. Mes shteteve anëtare të KEDNJ ka dallime se kur "akuza" i komunikohet formalisht "të akuzuarit". Sipas jurisprudencës së GJEDNJ, "akuza", në kuptimin e saj autonom për qëllimet e nenit 6 të KEDNJ, është njoftimi zyrtar që i bëhet individit, nga autoriteti kompetent, për pretendimin se ai ka kryer një vepër penale.[326]

[324] *Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 03.05.2007.*
[325] *Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 06.04.2010.*
[326] *Foti and othersv. Italy, (Application no. 7604/76; 7719/76; 7781/77; 7913/77*)).

E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm rrjedh si nga interpretimi literal i nenit 6 të KEDNJ, ashtu dhe nga parimi i efektivitetit. Neni 6 është tërësisht një nen autonom nga kuptimi që i japin atij legjislacionet vendase. Edhe afati i arsyeshëm përbën një term autonom nga mënyra se si legjislacionet vendase përcaktojnë gjatësinë e procedurave gjyqësore. Shkelja e parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, sipas legjislacionit të një shteti, jo domosdoshmërish do të konsiderohet e tillë sipas nenit 6. Në ndryshim nga shumë sisteme ligjore vendase, sipas jurisprudencës së GJEDNJ, nuk ka një afat ligjor të përcaktuar për lloje të caktuara gjykimesh. Të gjitha çështjet shqyrtohen sipas rastit. [327]

Ky afat nuk fillon me ndalimin për marrje në pyetje, pasi në të shumtën e rasteve ky veprim i paraprin njoftimit të akuzës. Afati i përfundimit nënkupton gjithë procedurat gjyqësore për çështjen, duke përfshirë dhe procedurat e apelimit. Si rrjedhojë, nuk ka një përcaktim të këtij afati, për sa kohë nuk është dhënë një vendim përfundimtar për çështjen.[328]

Afati i arsyeshëm i procedurave gjyqësore duhet parë lidhur me rrethanat e veçanta të çështjes, si dhe duke pasur parasysh kompleksitetin e saj, sjelljen e të akuzuarit dhe të autoriteteve të ndjekjes penale e atyre gjyqësore. Kur ka vonesa, shteti duhet të japë shpjegime. Në rastet kur i akuzuari është i arrestuar, ky standard është dhe më i ashpër. Ky është një aspekt i nenit 6 të KEDNJ që gjykatat duhet të kenë parasysh kur vendosin shtyrje të seancës.

Përfundimi i "afatit të arsyeshëm" nënkupton datën e njoftimit të vendimit të fundit të sistemit të brendshëm gjyqësor, duke përfshirë këtu dhe gjykimin kushtetues, kur ky gjykim prek direkt rezultatin e mosmarrëveshjes.[329]

Për të përcaktuar, nëse afati i gjykimit të një çështje ka qenë ose jo i arsyeshëm, duhen pasur parasysh tre kritere:

- *Natyra dhe kompleksiteti i çështjes.* Kompleksiteti i çështjes shpesh herë ka të bëjë me detyrimin e gjykatave për t'u dhënë përgjigje shumë elementëve të çështjes, si p.sh. kur ka një numër të madh akuzash në çështje penale të bashkuara[330] ose kur në një çështje ka shumë bashkëtëpandehur.

- *Veprimet e kërkuesit.* GJEDNJ merr në konsideratë vetëm ato vonesa që kanë ardhur për shkak të veprimeve të autoriteteve. Vonesat e shkaktuara nga i akuzuari, qëllimisht ose jo, nuk merren parasysh në përcaktimin e "afatit të arsyeshëm". Shtetet

[327] Dovydas Vitkauskas, Grigoriy Dikov, *Protecting the right to a fair trial under the European Convention on Human Rights*, Council of Europe, (2012),73.
[328] *Eckle v. Germany* (Application no. 8130/78).
[329] *Buchholz v. Germany*, (Application no. 7759/77), pp 46-63.
[330] *Vaivada v. Lithuania*, (Applications no. 66004/01 and 36996/02).

nuk mund të paraqesin si argument për gjatësinë e procedurave gjyqësore ankimin në apel, rekursin apo çdo lloj kërkese tjetër të paraqitur nga ai gjatë gjykimit, me kusht që këto të mos jenë abuzive. I akuzuari nuk mund të konsiderohet fajtor thjesht për shkak të përfitimit nga burimet dhe mjetet që i ofrohen nga legjislacioni vendas për përgatitjen e mbrojtjes.[331]

- *Veprimet e autoriteteve.* Veprimet e autoriteteve kanë rëndësi të veçantë në përcaktimin e afatit të arsyeshëm. Mosmarrëveshjet juridiksionale mes gjykatave për zgjidhjen e çështjes,[332] ndryshimet e shumta të trupit gjykues,[333] koha e gjatë mes dëgjimit të palëve dhe marrjes së vendimit,[334] ose periudha e gjatë nga marrja e vendimit deri në zbardhjen e tij,[335] të gjitha këto konsiderohen si veprime të autoriteteve që ndikojnë negativisht në zgjidhjen e çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

Sigurisht që, nuk ka një përcaktim të qartë të afatit të arsyeshëm, pasi shpesh herë ky afat varet dhe nga tërësia e shkallëve gjyqësore që parashikohen në legjislacionin e një vendi. Megjithatë, GJEDNJ është shprehur se vazhdimi i procedurave gjyqësore penale për 10 vjet del jashtë kuptimit të "afatit të arsyeshëm".[336]

[331] *Kolomiyets v. Russia*, (Application no. 76835/01), pp 25-31.
[332] *Gheorghe v. Romania*, (Application no. 19215/04).
[333] *Simonavicius v Lithuania*, (Application no. 37415/02).
[334] *Martins Moreira v. Portugal*, (Application (no. 11371/85).
[335] *B. v. Austria*, (Application no. 11968/86).
[336] *Milasi v. Italy*, (Application no. 10527/83).

KAPITULLI VI

PREZUMIMI I PAFAJËSISË

Historia e prezumimit të pafajësisë

Një element thelbësor i të drejtës për një proces të rregullt ligjor është prezumimi i pafajësisë së të akuzuarit deri në momentin kur provohet e kundërta, përmes një procesi të rregullt ligjor.

Asnjë parim tjetër i legjislacionit penal dhe procedurës penale nuk ka krijuar më shumë interes dhe debate se parimi i prezumimit të pafajësisë. Si rrjedhojë e këtij parimi, një individ nuk mund të detyrohet të pranojë fajësinë ose të japë prova kundër personit të tij. Detyrimi për provimin e fajësisë (barra e provës) bie mbi organet shtetërore, e pikërisht mbi organin që ushtron ndjekjen penale. Është detyrë e shtetit të provojë kryerjen e veprës, për të cilën ngre akuzë, dhe jo e individit të provojë pafajësinë. Heshtja e të dyshuarit nuk duhet konsideruar si pranim i fajit.

Për të kuptuar qartë parimin e prezumimit të pafajësisë është e rëndësishme të kuptojmë origjinën e këtij parimi. Duke qenë se një individ mund të akuzohet për kryerjen e një vepre penale pa e kryer realisht atë, një parim i rëndësishëm i drejtësisë penale është që paditësit të provojnë pretendimet e tyre dhe i akuzuari të konsiderohet i pafajshëm gjatë gjithë intervalit nga njoftimi i akuzës e deri tek dhënia e vendimit përfundimtar.

Një vështrim historik tregon që të dy këto rregulla u zhvilluan pak a shumë në të njëjtën periudhë kohore, ku njëri shihej si shtojcë logjike e tjetrit. *Actori incumbit probation*, pra parimi sipas të cilit barra e provimit të fajësisë së të akuzuarit bie mbi akuzuesin, pra personin që ngre akuzën, i ka rrënjët thellë në antikitet.[337] Një nga kodet më të vjetra në histori, *Kodi i Hamurabit* (1792-1750 Para Erës Sonë) përkrahte gjithashtu këtë parim.[338] Sipas këtij Kodi, kushdo, që paraqiste akuzë penale, ishte i detyruar të provonte se i akuzuari ishte fajtor. Në rastet e akuzave falso, ndaj të cilave dënimi i parashikuar ishte kapital, akuzuesi dënohej me vdekje. Në rastet kur paditësit pretendonin se i akuzuari posedonte pasuri të vjedhura, sipas Kodit, ata duhej të

[337] John Sassoon, *Ancient Laws and Modern Problems: The Balance Between Justice and a Legal System*, Third Millenium Publication, (2011), 42.
[338] François Quintard-Morénas, *The Presumption of Innocence in the French and Anglo-American Legal Traditions*, The American Journal of Comparative Law, 58.1 (2010), 111.

thërrisnin dëshmitarë, të cilët duhej të ishin në gjendje t'i identifikonin si pasuri të akuzuesit, në të kundërt, akuzuesi dënohej me vdekje.[339]

Edhe Kushtetuta e perandorit Antonine e vitit 212 Pas Erës Sonë parashikonte: "Ai që dëshiron të ngrejë akuza duhet të ketë prova".[340] Pamundësia e akuzuesit të provonte pretendimet e tij çonte në shfajësimin e të akuzuarit *(actore non probante, reus absolvitur)*, pavarësisht nëse i akuzuari heshtte ose mohonte pretendimet e ngritura, pasi barra e provës binte mbi ata që pohonin dhe jo ata që mohonin. Vetëm nëse fajësia provohej me fakte të mjaftueshme, atëherë i akuzuari kishte të drejtë të ndërhynte për të provuar pafajësinë e tij.

Në çështjet penale, provimi i fajësisë kishte karakter detyrues, sidomos në çështje ku vihej në rrezik jeta e të akuzuarit. Konsiderohej më e udhës shfajësimi i fajtorit sesa rreziku i dënimit me vdekje të një personi të pafajshëm *(satius enim esse impunitum relinqui facinus nocentis quam innocentem damnari)*. Përdorimi i reputacionit, të mirave materiale dhe statusit shoqëror për dënimin e një personi, pa pasur prova, konsiderohej vepër e rëndë penale.

Kushtetuta e perandorëve Gratian, Valentinian dhe Theodhose, e vitit 382 Pas Erës Sonë, parashikonte se akuzuesit mund të ngrenë akuza vetëm nëse ato mbështeteshin nga dëshmitarë të besueshëm, prova shkresore ose fakte të padyshimta. Nëse provat ishin të paplota ose jopërfundimtare, të akuzuarit i jepej benefiti i dyshimit *(in dubio pro reo)*. Pra çdo dyshim shkonte në favor të të dyshuarit. Siç shprehej dhe oratori grek Demosthenes, në vitin 352 Para Erës Sonë, deri në momentin e përcaktimit të fajësisë, përmes provave bindëse, shoqëria nuk ka asnjë të drejtë ta trajtojë një të akuzuar si kriminel *(non statim qui accusatur reus est*), pasi asnjeri nuk konsiderohet i tillë, nëse nuk është gjykuar dhe dënuar si fajtor. Dënimi duhet të jepet vetëm pas një gjykimi të drejtë, pasi "ndërgjegjja na lejon të japim dënim pas zbulimit të rrethanave dhe fakteve për çështjen, e jo më parë". Mohimi ndaj të akuzuarit i procesit të ndërmjetëm, mes akuzimit dhe dënimit, dhunon një ndër parimet bazë të drejtësisë.[341]

Kushtetuta e perandorëve Honorius dhe Theodose, e vitit 423 Pas Erës Sonë, u kërkonte konsujve, senatorëve dhe tribunës së popullit që, të akuzuarit për krime që dënoheshin me vdekje, të mos konsideroheshin menjëherë fajtorë, thjesht për faktin se ishin akuzuar për këtë krim. Qëllimi kryesor ishte që i pafajshmi të mos vuante padrejtësisht.

Edhe në periudhat e mëvonshme, kur filloi të zhvillohej *common law*, burgosja bëhej pa u gjykuar çështja dhe shpesh herë përdorej arbitrarisht nga monarkët anglezë.

---

[339] ibid
[340] Code Justinian 2.1.4 (Antonine 212).
[341] François Quintard-Morénas, *The Presumption of Innocence in the French and Anglo-American Legal Traditions*, The American Journal of Comparative Law 58.1 (2010), fq. 113.

Për rrjedhojë, abuzimet e vazhdueshme nga monarku të këtyre parimeve bënë që parlamenti të merrte masa për garantimin e tyre.

Magna Carta qe një ndër dokumentet më të rëndësishme që vendosi kufizimin e pushtetit të mbretit, si dhe u dha individëve mundësinë e gjykimit të drejtë të çështjes së tyre para burgosjes apo ndëshkimit.[342] Në shekujt që pasuan nënshkrimin e Magna Carta, procesi i rregullt ligjor dhe prezumimi i pafajësisë u bënë parime të rëndësishme në *common law*. Kalimi i Atlantikut nga kolonistët çoi në mbartjen e këtyre parimeve dhe në Amerikë.

Parimi i prezumimit të pafajësisë

Ky parim garantohet nga një sërë dokumentash si: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut[343], Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike[344], Kushtetuta Amerikane[345], nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut[346], etj. Që të gjithë këto dokumente mbrojnë prezumimin e pafajësisë si parim i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

Si rrjedhojë e pasojave serioze që vijnë nga dënimi, pasoja që çojnë në kufizimin e të drejtave themelore, siç është e drejta për liri, organet shtetërore janë të detyruara të provojnë fajësinë përtej çdo dyshimi. Nëse fajësia nuk është provuar mjaftueshëm për të shmangur çdo dyshim, të akuzuarit i duhet dhënë benefiti i dyshimit *(in dublo pro reo)* dhe të lirohet për këtë shkak.

Prezumimi i pafajësisë është një prezumim relativ, me një regjim të veçantë. Ky prezumim mund të vërtetohet përmes provave e hidhet poshtë gjithashtu përmes një vendimi të gjykatës, të formës së prerë, që dënon veprimin e kryer. Në fushën penale ky prezumim ka një rëndësi të veçantë e nuk duhet të jetë as teorik e as iluziv.

---

[342] Shima Baradaran, *Restoring the Presumption of Innocence*, Ohio State Law Journal Vol. 72, No. 4 (2011), 727.

[343] Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Neni 11/1: "Çdokush i akuzuar për një vepër penale ka të drejtën të prezumohet i pafajshëm deri në momentin e të provuarit të fajësisë, sipas ligjit, në një gjykim publik në të cilin ai ka pasur të gjitha garancitë e nevojshme për realizimin e mbrojtjes."

[344] Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Neni 14/2: "Çdo person i akuzuar për një vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht."

[345] Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Amendamenti i 5-të dhe Amendamenti i 14-të, "Askush nuk mund të gjykohet dy herë për të njëjtën shkelje të ligjit, as nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes në një çështje penale, as të privohet nga jeta, liria dhe pasuria pa u zhvilluar një proces i rregullt gjyqësor.'; 'Asnjë prej shteteve nuk mund të privojë asnjë person nga jeta, liria ose pasuria pa zhvillimin e një procesi të rregullt gjyqësor apo t'u mohojë personave nën juridiksionin e vet të drejtën për mbrojtje të barabartë ligjore."

[346] Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 6/2, "Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht."

Qëllime të përgjithshme të këtij parimi janë mbrojtja e të akuzuarit gjatë procesit penal, në mënyrë që të garantohet barazia e palëve gjatë gjykimit, si dhe vendosja e garancive për mbrojtjen e individit nga konsiderimi fajtor pa një procedurë të përcaktuar ligjore. Gjatë analizës së prezumimit të pafajësisë konstatohen disa aspekte të rëndësishme që kanë për qëllim përcaktimin e kufijve për mbrojtjen e këtij parimi: garancitë e ofruara, qëllimi, rrethi i personave të detyruar për mbrojtjen e garantimin e këtij prezumimi.

Termi "i pafajshëm deri në momentin e provimit të fajësisë" është kthyer tashmë në klishe, por koncepti vazhdon të ketë të njëjtën rëndësi. Prezumimi i pafajësisë përbën një koncept përmes të cilit akuzuesi duhet të provojë fajësinë e të akuzuarit përmes provave të qarta. Ky proces quhet ndryshe dhe "barra e provës". E drejta e të akuzuarit për t'u prezumuar i pafajshëm deri në momentin e dhënies së një vendimi fajësie, kërkon përdorimin dhe zbatimin e një sërë rregullash procedurale, të cilat përcaktojnë se ç'lloj provash lejohen të merren për provimin e fajësisë, mënyrën e marrjes së këtyre provave, etj. Në rast se gjykata, pas paraqitjes së këtyre provave, vazhdon të ketë akoma dyshime për fajësinë e të akuzuarit, çdo dyshim duhet të shkojë në favor të këtij të fundit. Gjykata duhet të vendosë pafajësinë e tij dhe i akuzuari të lihet i lirë.

Prezumimi i pafajësisë paraqet, para së gjithash, një garanci procedurale për mënyrën e kryerjes së vetë gjykimit. Gjykatat duhet të operojnë duke menduar se i akuzuari nuk ka kryer veprën për të cilën akuzohet. Ky prezumim i pafajësisë së të akuzuarit është kyç për procesin e marrjes së provës, për faktin se barrën e provës ia ngarkon organit të prokurorisë dhe i jep të akuzuarit benefitin e dyshimit. Pra, prezumimi i pafajësisë ka një shtrirje të gjerë. Ky parim ka për qëllim që të ndalojë organet shtetërore që të trajtojnë një të akuzuar si fajtor, për aq kohë sa fajësia e tij nuk është vendosur nga një organ gjyqësor.

Gjykimet penale, në sisteme të ndryshme ligjore (*civil law* ose *common law)* mund të kryhen nga një gjyqtar ose nga një juri. Në rastet kur gjykimi kryhet nga një juri, është gjyqtari ai që vendos mbi rregullat ose problemet ligjore procedurale ose statusore. Në rast se gjyqtari lejon prova që s'kanë rëndësi për çështjen ose që paragjykojnë të akuzuarin, juria mund të mos fokusohet në faktet e çështjes, por në thashetheme, ose gjëra fare pa rëndësi për çështjen. Dënimi për këtë shkak përbën shkelje të procesit të rregullt ligjor.

Jurisprudenca amerikane

Një ndër çështjet më të hershme të Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përmes së cilës u vu theksi në rëndësinë e padiskutueshme të prezumimit të

pafajësisë, ishte çështja *Coffin* v. *United States*[347] e vitit 1895, në të cilën GJS u shpreh: "Parimi i prezumimit të pafajësisë në favor të të akuzuarit është ligj i padyshimtë, aksiomatik dhe thelbësor. Zbatimi i tij qëndron në themel të administrimit të drejtësisë sonë penale. Ky prezumim është në favor të të akuzuarit dhe mbrohet me ligj. "Dyshim i arsyeshëm" është ajo gjendje mendore që krijohet nga procesi i të provuarit të provave të paraqitura për çështjen. Ai është rezultat i të provuarit e jo vetë provë, ndërsa prezumimi i pafajësisë është instrument i të provuarit, provat kundër të cilit lindin dyshime të arsyeshme. Pra njëri është qëllim, ndërsa tjetri pasojë. Të pohosh se njëri është ekuivalent i tjetrit, është të pohosh se prova ligjore mund të mos i bëhet e ditur jurisë, dhe se ky përjashtim mund të rregullohet duke i udhëzuar ato (jurinë) saktë në lidhje me metodën e nevojshme që duhet të zbatojnë për të arritur në konkluzion mbi evidencat që kanë. Me fjalë të tjera, përjashtimi i një prove të rëndësishme mund të justifikohet duke informuar saktë mbi këtë provë. Evolucioni i parimit të prezumimit të pafajësisë dhe rezultati i saj, doktrina e dyshimit të arsyeshëm, bëjnë më të dukshme korrektësinë e këtyre pikëpamjeve dhe tregojnë nevojën e zbatimit të njërës në mënyrë që të tjera mund të vazhdojë të ekzistojë."

Në çështjen *Estelle v. Williams*[348], GJS vuri në dukje se prezumimi i pafajësisë është një element bazë i gjykimit të drejtë në çështjet penale. Madje kjo Gjykatë është shprehur se ky parim konsiderohet si "evidencë në favor të të akuzuarit"[349]. Megjithatë, kjo evidencë përbën thjesht një prezumim, i cili duhet të provohet.

Nisur nga këto pikëpamje mund të mendohet i lehtë përcaktimi se ç'është prezumimi i pafajësisë, kur dhe ku zbatohet në procedurat penale, kush i nënshtrohet dhe ç'lidhje ka me doktrina të tjera të rëndësishme si: dyshimin e arsyeshëm, barrën e provës, benefitin e dyshimit dhe procesin e rregullt ligjor në përgjithësi. Por, ky përcaktim nuk është aq i lehtë sa ç'mendohet.

Nëse bëjmë pyetjen se në ç'moment procedural fillon prezumimi i pafajësisë dhe ndaj cilëve persona zbatohet ai, një përgjigje e thjeshtë, e pamenduar gjatë, do të ishte: "Që nga momenti i paraqitjes së akuzës penale nga organet përkatëse e deri në momentin e dhënies së një vendimi të gjykatës", çka nënkupton se të gjithë personat e përfshirë në vendimmarrje për të akuzuarin (prokurori, gjyqtari, juria, etj.) kanë detyrimin të prezumojnë pafajësinë e tij. Ndërkohë që një përcaktim i tillë jepet teorikisht nga shumë shtete, GJS është shprehur se në procedurën penale amerikane ky prezumim zbatohet vetëm në gjykim e vetëm ndaj prokurorit, jurisë ose personave të tjerë që marrin vendim për çështjen.

Në 1979 GJS u përball me padinë e shumë individëve, të cilët ishin arrestuar e u ishte mohuar lirimi me kusht, ndërkohë që çështjet e tyre nuk ishin gjykuar akoma nga

[347] *Coffin* v. *United States*, 156 U.S. 432 (1895).
[348] *Estelle v. Williams*, 425 U.S. 501 (1976), 503.
[349] *Coffin* v. *United States*, 156 U.S. 432 (1895), Justice White, 460.

gjykatat. Ata kundërshtonin para GJS, ndër të tjera, shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese, ndër të cilat dhe të së drejtës për prezumim të pafajësisë deri në dhënien e një vendimi nga gjykata. GJS, në një opinion të shumicës, të shkruar nga Justice Rehnquist, u shpreh se: "Pa dyshim, prezumimi i pafajësisë luan një rol të rëndësishëm në sistemin tonë të drejtësisë penale ... Por nuk zbatohet në përcaktimin e të drejtave gjatë periudhës së paraburgimit, pra para se gjykimi i çështjes të ketë filluar"; "Prezumimi i pafajësisë është një doktrinë që ka për qëllim përcaktimin e barrës së provës në çështjet penale, por që, gjithashtu, shërben si një paralajmërim ndaj jurisë, për të gjykuar fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit vetëm mbi bazën e provave të paraqitura në gjykim dhe jo në bazë të dyshimeve që mund të lindin nga fakti i arrestimit të tij, akuzimit, ose ndalimit, apo mbi bazën e fakteve të tjera, që nuk janë paraqitur si provë në gjyq."[350]

Prezumimi i pafajësisë është një udhëzues për gjyqtarin ose jurinë. Nëse do të ishte absolut dhe të zbatohej në çdo shkallë të procedimit, i akuzuari nuk do të burgosej kurrë deri në momentin e dhënies së vendimit të dënimit. Ky prezumim ka për qëllim të mbrojë të akuzuarin kundër dënimeve dhe jo kundër arrestit".[351]

Pavarësisht nga kjo, ka nga ata që mund të debatojnë këto ndalime si shkelje të prezumimit të pafajësisë duke e lidhur këtë me dyshimin e arsyeshëm. Arrestimi ose ndalimi i një individi nga organet shtetërore, nën akuzën e kryerjes së një vepre penale, ngre dyshime nga ana e këtyre organeve mbi këtë individ, dyshime që parimisht mund të reflektohen dhe tek organet vendimmarrëse si gjyqtari ose juria. Pra, sipas tyre, gjykimi i çështjes, kur personi është ndaluar për kryerjen e veprës, fillon me dyshimin se personi e ka kryer veprën penale, pasi është ndaluar ose arrestuar për këtë shkak, duke u vënë në diskutim në këtë mënyrë prezumimi i pafajësisë së tij.

Megjithatë, tashmë kjo praktikë është e konsoliduar. Prezumimi i pafajësisë fillon në momentin e gjykimit të çështjes dhe zgjat gjatë gjithë këtij gjykimi, deri në momentin e dhënies së një vendimi nga gjykata.

Është e mundur e madje e rëndësishme të dallohen dy nocione të qarta të fajësisë dhe pafajësisë:

Pafajësia materiale (këtej e tutje: Pafajësia$_m$), sipas së cilës i dyshuari në gjykim është i pafajshëm, pasi nuk e ka kryer krimin.

Pafajësia e provuar (këtej e tutje: Pafajësia$_p$), sipas të cilës i akuzuari është i pafajshëm pasi organi i akuzës nuk arrin të provojë çështjen kundër të akuzuarit, pra "fajësinë" e tij.

Fajësia materiale (këtej e tutje: Fajësia$_m$), sipas së cilës i akuzuari ka kryer krimin.

[350] *Bell v. Wolfish*, 441 U.S. 520 (1979), fq 533.
[351] Louisiana Supreme Court, *State v. Green*, 275 So. 2d 184, 186 (La., 1973) .

Fajësia e provuar (këtej e tutje: Fajësia$_p$), sipas së cilës akuzat e ngritura ndaj të akuzuarit janë provuar në gjykim.

Në fakt mes dy llojeve të dallimeve ka një asimetri të dukshme. Kjo konsiston në faktin se provimi i fajësisë$_p$ mbështet (paksa) pohimin e fajësisë$_m$ (çka nënkupton se sistemi ligjor prezumon se dikush, ndaj të cilit është provuar fajësia, është realisht fajtor). Provimi i pafajësisë$_p$ (një vendim "jo fajtor"[352]) nuk jep konkluzion për pafajësinë$_m$. Kjo është pikërisht arsyeja që në gjykimet me juri, këto të fundit nuk shprehen për "pafajësi" *(innocent)*, por për "jo fajësi" në rastet e dhënies së vendimit për çështjen, çka do të thotë se "jo fajësia" ka ardhur si rezultat i mungesës së provave të mjaftueshme për dhënien e dënimit nga gjykata.[353]

Në fakt gjyqtarëve, jurisë, etj., gjatë shqyrtimit të një çështjeje penale, u kërkohet që të prezumojnë të akuzuarit "të pafajshëm", çka nënkupton "pafajësinë$_m$". Pra termi që përdoret është "i pafajshëm" e nuk përdoret termi ta prezumojnë atë "jo fajtor". Por atyre u duhet të vendosin nëse i akuzuari është "fajtor" ose "jo fajtor", çka prezumon "pafajësinë$_p$", e cila është tërësisht e ndryshme nga "pafajësia$_m$".[354]

Nga kjo kuptohet se, kur bëhet fjalë për mbrojtje dhe garantim të parimit të prezumimit të pafajësisë, ajo që kërkohet nga gjyqtari apo juria është prezumimi i pafajësisë$_m$, që nënkupton se i akuzuari nuk e ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Megjithatë, gjatë gjithë procedurave të zhvilluara, edhe në rastet kur një prokuror vendos të mos ngre akuza, kur një gjyqtar vendos pushimin e çështjes, në rastin e një vendimi apeli që rrëzon dënimin e dhënë, etj., në asnjë nga këto raste nuk merret parasysh pafajësia$_m$. Refuzimi i një gjyqtari për lëshimin e një urdhër ndalimi reflekton, në vetvete, thjesht një mendim të gjyqtarit mbi çështjen, pra jo që personi është i pafajshëm$_m$, por që evidencat e paraqitura për të justifikuar këtë arrest nuk përbëjnë dyshim të arsyeshëm. Pranimi nga gjyqtari i lirimit me kusht të të akuzuarit do të thotë që shteti ka qenë i paaftë të paraqesë prova të mjaftueshme për të justifikuar qëndrimin e tij në burg.

E vetmja mënyrë, përmes së cilës një i akuzuar mund të siguronte një vendim që nënkupton pafajësinë$_m$ të tij, do të ishte nëse, pas fitimit të çështjes, përmes vendimit të gjykatës, lidhur me çështjen penale të ngritur ndaj tij, të paraqiste dhe fitonte akuzë ndaj organit të ndjekjes penale për ndjekje penale të padrejtë e dashakeqe.

Një trajtim i tillë i bërë nga jurisprudenca amerikane lidhur me fajësinë ose pafajësinë e një të akuzuari në një çështje penale duhet marrë në konsideratë dhe nga gjykatat shqiptare. Fakti që një person konsiderohet, sipas jurisprudencës shqiptare, "i pafajshëm" nga gjykata, nënkupton një pafajshmëri materiale të tij për kryerjen e veprës penale, çka sjell në përfundimin se në sytë e shoqërisë ky individ rezulton se nuk e ka

[352] "not guilty".
[353] Larry Laudan, *The Presumption of Innocence: Material or Probatory*, Legal Theory Cambridge Journals, Volume 11, Issue 4, (2005), 340.
[354] ibid 344.

kryer veprën për të cilën akuzohet, pavarësisht se kjo "pafajësi" mund të ketë ardhur si rrjedhojë e mungesës së provave të mjaftueshme nga organet e prokurorisë për heqjen e çdo dyshimi të arsyeshëm dhe dhënien e një vendimi fajësie nga organi gjyqësor.

Jurisprudenca Europiane

Edhe sipas GJEDNJ, në çdo ndjekje penale prezumimi i pafajësisë vë barrën e provës mbi organet e prokurorisë. Kjo nënkupton se i akuzuari nuk mund të detyrohet të fajësojë veten dhe se duhet të ketë prova për të mbështetur një dënim ndaj tij. Në të njëjtën kohë, kërkesa që një i akuzuar të shpjegojë një situatë të caktuar, jo domosdoshmërisht do të përjashtohet, për aq kohë sa ekzistojnë garancitë e nevojshme për mbrojtjen e të akuzuarit. Megjithatë, në prezumimin e pafajësisë luajnë rol e duhen parë gjithashtu deklaratat e zyrtarëve përpara gjykimit, sjellja e gjyqtarit gjatë gjykimit të çështjes dhe trajtimin e individit pas dhënies së vendimit të pafajësisë apo ndërprerjes së procedurave.[355]

Çështja e parë në të cilën GJEDNJ theksoi rëndësinë e mbrojtjes së këtij parimi ishte *Minelli v. Zvicrës*[356], përmes së cilës u vendos se ka dhunim të parimit të prezumimit të pafajësisë, nëse "një vendim gjyqësor reflekton mendimin se i akuzuari do të konsiderohet fajtor, pa u kryer më parë një procedurë gjyqësore për përcaktimin e fajësisë si dhe pa iu dhënë mundësia të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes". Në çështjen *Adolf v. Austrisë*[357] kërkuesi u raportua në polici pasi goditi një grua me çelësa. Procedurat penale përfunduan në shkallë të parë përmes një vendimi, arsyetimi i të cilit kuptohej si shpallje fajësie. Gjykata e rrethit u shpreh se "faji" i të akuzuarit ishte "i papërfillshëm". Megjithatë, Gjykata e Lartë e liroi të akuzuarin nga çdo akuzë fajësie, duke u shprehur se për vepra penale të vogla, për shkak të ekonomisë gjyqësore, disa veprime nuk është e nevojshme që të konsiderohen si të tilla e që personat të ndiqen penalisht. GJEDNJ nuk gjeti shkelje të prezumimit të pafajësisë.

Si rrjedhojë, shpesh herë, varet nga fjalët e përdorura në vendim, për të përcaktuar nëse ka pasur një prezumim fajësie apo jo ndaj të akuzuarit para dhënies së vendimit dhe para se i akuzuari të kishte pasur mundësinë të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes.

Neni 6/2 i KEDNJ nuk mund të ndalojë autoritetet të informojnë publikun lidhur me hetimet penale, që po kryhen për një çështje të caktuar, por kërkohet që ata të bëjnë

[355] Jeremy McBride, *Human rights and criminal procedure, The case law of the European Court of Human Rights*, Council of Europe Publishing (2009), 14-15.
[356] *Minelli v. Switzerland*, (Application no. 8660/79).
[357] *Adolf v. Austria*, (Application no. 8269/78); *Lutz v. Germany*, (Application no. 9912/82).

këtë me gjithë diskrecionin dhe maturinë e nevojshme, që kërkohet për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.[358]

Prezantimi publik i çështjes nga ana e zyrtarëve të lartë shtetërorë, si vepër penale e kryer nga personi, për të cilën ai duhet të ndëshkohet nga gjykata, ndërkohë që çështja akoma nuk është shqyrtuar nga kjo e fundit, përbën shkelje të prezumimit të pafajësisë.[359]

Ekzistenca e një rreziku, që individi i akuzuar mund të ndikojë në evidencat e paraqitura e të pengojë dhënien e drejtësisë, thjesht për faktin se nuk ka pranuar fajësinë, nuk përbën justifikim të mjaftueshëm për zgjatjen e periudhës së tij të paraburgimit. Arsyetimi i tyre në vendim tregon shkelje të prezumimit të pafajësisë e nuk mundet, në asnjë rast, të konsiderohet i ligjshëm për heqjen e lirisë.[360]

Marrja e masave shtrënguese të pajustifikueshme dhe poshtëruese, si vendosja e të akuzuarit brenda një kafazi metalik, rrethimi i tij me forca të shumta policore, transmetimi i këtij gjykimi, përgjigja e pyetjeve nga gjyqtari i seancës apo riformulimi nga ana e tij i pyetjeve të prokurorit në mënyrë më avantazhuese për prokurorin, të gjitha këto veprime përbëjnë shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë.[361] Në çështjet penale, marrja e provave duhet të shikohet nën dritën e nenit 6/2 të KEDNJ dhe kërkon, *inter alia*, që barra e provës të bjerë mbi prokurorinë.[362]

Përdorimi në vendimin e gjykatës i termave që lënë të kuptojnë se gjykata ka qenë e bindur, që përpara gjykimit të çështjes, se i akuzuari kishte kryer veprën penale, përbën cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë. [363]

Jurisprudenca shqiptare

Prezumimi i pafajësisë është një nga elementët përbërës të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata Kushtetuese e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që, gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë

[358] *Karakas and Yesilımak v. Turkey*, (Application no. 43925/98), pp 50.
[359] *Khuzhin and others v. Russia*, (Application no.13470/02), pp 96.
[360] *Kauczor v. Poland*, (Application no. 45219/06), pp 46.
[361] *Ramishvili and Kokhreidze v. Georgia*, (Application no. 1704/06), pp.132-133.
[362] *Capeau v. Belgium*, (Application no. 42914/98), pp 25.
[363] *Panteleyenko v. Ukraine*, (Application no. 11901/02), pp.70.

në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza.[364]

Prezumimi i pafajësisë është trajtuar gjerësisht edhe nga GJEDNJ, e cila ka theksuar se "prezumimi i pafajësisë është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor që parashikohet në nenin 6 par.2 të KEDNJ-së. Ky parim konsiderohet i shkelur nëse një vendim gjyqësor, që i përket një individi të akuzuar penalisht, reflekton një opinion që ai është fajtor, përpara se të jetë provuar fajësia e tij sipas ligjit. Edhe nëse nuk ka ndonjë konkluzion formal, mjafton të ekzistojë një arsyetim, i cili lë të kuptohet se gjykata e konsideron të akuzuarin fajtor, si edhe kur barra e provës kalon nga prokurori te mbrojtja.[365]

Kuptimi dhe zbatimi i drejtë në praktikë i parimit të prezumimit të pafajësisë është garancia kryesore për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit, sepse ky parim detyron akuzën që të provojë fajësinë e të pandehurit, e çliron këtë të fundit nga barra për të provuar pafajësinë e tij, i jep të drejtë të zgjedhë mbrojtjen më të përshtatshme për të, të bëjë ose jo deklarime, të kërkojë prova dhe të marrë pjesë aktivisht në shqyrtimin e tyre, duke kërkuar që provat e dyshimta të interpretohen gjithmonë në favorin e tij.[366]

Marrja si e mirëqenë e akuzës nga gjykata cenon parimin e prezumimit të pafajësisë, të parashikuar nga neni 6, pika 2 e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe nga neni 4 i Kodit të Procedurës Penale. Këto dispozita parashikojnë, se çdo person i akuzuar për një shkelje të ligjit prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. Cenimi i këtij parimi të rëndësishëm procedural nga ana e gjykatave tregon se nuk është zhvilluar një proces i rregullt ligjor ...[367]

Paraburgimi dhe prezumimi i pafajësisë

KEDNJ mbron të drejtën e individit për liri.[368] Periudha e paraburgimit konsiderohet, me disa kufizime, si përjashtim i ligjshëm i të drejtës për liri. GJEDNJ ka zhvilluar një tërësi rregullash dhe kufizimesh mbi legjitimitetin e këtyre përjashtimeve. Megjithatë, në qendër të kuadrit të saj vlerësues, GJEDNJ vendos prezumimin e pafajësisë. Në jurisprudencën e saj, kjo Gjykatë është shprehur se autoritetet kombëtare duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar që periudha e paraburgimit të mos e kalojë kohën e arsyeshme. Për këtë qëllim, ata duhet të ekzaminojnë të gjitha

[364] Vendim nr.9, datë 28.04.2004 i Gjykatës Kushtetuese të RSH; Vendim nr.23, datë 23.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese të RSH; Vendim nr.8, datë 16.03.2011 i Gjykatës Kushtetuese të RSH; Vendim nr.57, datë 21.12.2012 i Gjykatës Kushtetuese.
[365] Vendim nr.19, datë 02.204.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.
[366] Vendim nr.50, datë 01.11.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.
[367] Vendim nr.4, datë 07.02.2001 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.
[368] Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, neni 5.

faktet, "pro" ose "kundër" ekzistencës së një interesi të justifikuar publik, duke i kushtuar rëndësi parimit të prezumimit të pafajësisë, përmes garantimit të parimit të respektimit të lirisë individuale, si dhe t'i paraqesin këto në vendimin e tyre të dhënë ndaj kërkesës për lirim.[369]

Është e qartë se e drejta për liri dhe prezumimi i pafajësisë janë konsideruar si pikat kyçe për vendimet e marra gjatë periudhës para gjykimit. Megjithatë GJEDNJ nuk e lidh në mënyrë eksplicite prezumimin e pafajësisë me kritere specifike kufizuese.

Ndalimi i një të dyshuari është në fakt heqje e të drejtës së tij për liri, pa u zhvilluar më parë një proces i rregullt ligjor dhe pa dhënien e një vendimi fajësie për çështjen nga gjyqtari. Si rrjedhojë, kur masa e paraburgimit jepet shumë lehtë, shumë shpesh ose për një kohë shumë të gjatë, kërkohet që paraburgimi të mos cenojë prezumimin e pafajësisë.[370] Ky prezumim kërkon që shteti të trajtojë të dyshuarin si të ishte i pafajshëm. Kjo kërkesë nuk është detyruese dhe e parashikuar në kushtetutë e ligje. Është një parim moral dhe politik bazuar në konceptin e përbashkët se si një shoqëri duhet të ushtrojë pushtetin e saj ndëshkimor.

Sigurisht që shteti ka shumë më tepër pushtet e mjete për të hetuar, gjykuar e ndëshkuar. Në një shoqëri demokratike kërkohet që këto pushtete të ushtrohen duke respektuar autonominë dhe dinjitetin e çdo personi.[371] Prezumimi i pafajësisë mbron individin nga veprimet arbitrare të shtetit. Kur një të dyshuari i hiqet liria, duhet të ketë një arsye të fortë për këtë. Prezumimi i pafajësisë nënkupton gjithashtu se, pavarësisht se paraburgosja përmban një element ndëshkues, nuk duhet të ketë si qëllim ose të rezultojë në ndëshkim faktik.

Edhe në raportin e Komisionit Europian "Mbi njohjen reciproke të masave mbikëqyrëse të paragjykimit" i hartuar me qëllim të reduktimit të përdorimit për kohë shumë të gjata të masave ndaluese paragjykimore, një rëndësi e veçantë i kushtohet prezumimit të pafajësisë, si një parim me rëndësi thelbësore.[372] Pretendohet gjerësisht se prezumimi i pafajësisë tenton të reduktojë sa më shumë të jetë e mundur ndalimin para gjykimit.

Por, a përbën cenim të këtij prezumimi përdorimi i shpeshtë i paraburgimit në çështjet penale? Gjatë hartimit të legjislacionit, por njëkohësisht dhe gjatë vendimmarrjes së gjykatës për ndalimin e një të dyshuari, prezumimi i pafajësisë peshohet ndaj parimeve dhe interesave të tjerë. Paraburgosja, për shkak të rrezikut të largimit, përsëritjes së

[369] *Letellier v. France*, (Application no. 12369/86), pp 35; *Clooth v. Belgium*, Application no. 12718/87), pp.36; *Labita v. Italy*, (Application no. 26772/95), pp 152-153.
[370] S. Trechsel, *Human Rights in Criminal Proceedings*, Oxford University Press, (2005), 180.
[371] A. Ashworth, *Four Threats to the Presumption of Innocence*, International Journal of Evidence and Proof 10 (2006), 249.
[372] Rekomandim i Komitetit të Ministrave të Këshillit Europian Rec (2006)13.

veprës penale apo prishjes së rendit publik, është konsideruar në përputhje me prezumimin e pafajësisë.

Disa autorë si Lobet Rodriquez, Albrecht, and Den Hartog kanë kritikuar përdorimin e rrezikut të ripërtëritjes së krimit dhe prishjen e qetësisë e rendit publik si shkaqe për marrjen e masave paraprake. Sipas tyre, me qëllim të respektimit të prezumimit të pafajësisë, paraburgosja duhet lejuar vetëm për shkaqe që kanë të bëjnë me vetë procedurën. Rreziku i përsëritjes dhe i prishjes së rendit publik i shërbejnë interesit të përgjithshëm penal, dhe jo vetë procedurës. Si rrjedhojë, paraburgosja e bazuar në këto shkaqe konsiderohet ndëshkuese e si rrjedhojë cenon prezumimin e pafajësisë. [373]

GJEDNJ, në jurisprudencën e saj, ka përcaktuar disa standarde për paraburgimin. Së pari, Gjykata thekson se pasja e dyshimeve të arsyeshme përbën një *conditio sine qua non* për ligjshmërinë e vazhdimit të ndalimit. Megjithatë, pas kalimit të një kohe të caktuar, ky dyshim nuk është më i mjaftueshëm e, si rrjedhojë, ndalimi duhet bazuar në shkaqe të tjera, të rëndësishme e të mjaftueshme. Ky standard është sqaruar më mirë duke përcaktuar katër arsye (ose interesa publike) të pranuara për paraburgosjen: rreziku i mosparaqitjes së të akuzuarit në gjykim, rreziku që i akuzuari të marrë masa që ndikojnë në dhënien e drejtësisë, rreziku që i akuzuari të kryejë krime të tjera dhe rreziku se, nëse lihet i lirë, mund të shkaktojë prishje të rendit publik.[374] Gjatë shqyrtimit të këtyre shkaqeve, vendimi duhet marrë duke pasur parasysh rastin në fjalë dhe këto shkaqe nuk duhet të çojnë në vendimmarrje të njëllojta. Krahas kësaj, autoritetet kombëtare duhet t'i kushtojnë rëndësi të veçantë zhvillimit të gjykimit. Gjykatat kombëtare janë të detyruara të marrin parasysh dhe masat alternative, kur vendosin nëse një person duhet liruar ose ndaluar. Interesi i publikut mund të ruhet edhe përmes vendosjes së të dyshuarit në vëzhgim të vazhdueshëm ose përmes lirimit të tij me kusht.[375]

Pra, GJEDNJ ka theksuar rëndësinë e të drejtës për liri. Interesi publik mbi bazën e të cilit mund të kufizohet kjo liri është i përcaktuar. Autoriteteve vendase u kërkohet të motivojnë vendimet e tyre si dhe të shikojnë për alternativa të tjera ndaluese.

Evidenca dhe prova

Zbulimi i të vërtetës në drejtësinë penale përfshin katër elementë kryesorë:
- faktet dhe rrethanat e ngjarjes;

[373] Lonneke Stevens, *Pre-Trial Detention: The Presumption of Innocence and Article 5 of the European Convention on Human Rights Cannot and Does Not Limit its Increasing Use*, European Journal of Crime,Criminal Law and Criminal Justice 17 (2009), 169.
[374] *Smirnova v. Russia*, (Applications no. 46133/99 and 48183/99), pp 59.
[375] *Latasiewicz v. Poland*, (Application no. 44722/98), pp 59; *G.K v. Poland*, (Application no. 38816/97), pp. 85; *Jabloński v. Poland*, (Application no. 33492/96), pp 83; *Neumeister v. Austria*, (Application no. 1936/63), pp 3-4.

- elokuencën e mbrojtësit;
- ligjet;
- mençurinë e gjyqtarit.

Nisur nga faktet, siç janë, mbrojtësi do të përpiqet, përmes elokuencës së tij, në përputhje me ligjet në fuqi, të bindë gjyqtarin mbi "të vërtetën" për personin që ai përfaqëson. Brenda këtij kuadri, ajo çka synohet të arrihet është zbulimi i saktë i rrethanave të ngjarjes. Vetëm nëse arrihet kjo, mund të shpresohet se është zbuluar e vërteta.

Për shkak të faktit se shumicën e kohës faktet i fshihen syrit dhe njohurive të gjyqtarit, mbrojtësit e madje dhe palëve, pyetja që lind është se si këto fakte mund të nxirren në dritën e drejtësisë penale? Përgjigjja ofrohet nga dallimi që ekziston mes *evidencës* dhe *provës*.[376]

E vërteta juridike bazohet në paraqitjen e duhur të fakteve për çështjen dhe një paraqitje e saktë e tyre mbështetet në *evidenca* dhe *prova*. Që të arrihet në një vendimmarrje të drejtë për çështjen, çdo gjykatë duhet të ketë mënyrat e duhura për përdorimin e evidencës, me qëllim të zbulimit të së vërtetës rreth ngjarjes si dhe të të provuarit të fakteve.

Nga pikëpamja logjike, mund të thuhet se *prova* është ajo çka ndihmon në zbulimin nëse një fakt, deklarim, etj. është i vërtetë ose i gabuar. Në doktrinën ligjore romano-gjermane, ekziston vetëm një fjalë[377] për evidencat dhe provat, e cila nënkupton një fakt të caktuar material (ose një situatë të caktuar), çdo lloj prove ligjore të paraqitur në gjykim, si: ekspertizë, deklarim, etj., ose të dhënat që dalin nga evidenca (një fakt provohet).[378]

Sipas avokatit francez Jean Domat, *prova* është ajo që bind mendjen për ekzistencën e të vërtetës. Për Mbretin reformist grek Solomon, *provat* ishin qëllimet racionale për të pohuar ose mohuar një fakt. Për Ambroise Colin dhe Henri Capitant, të provosh diçka do të thotë të përcaktosh realitetin e presupozuar. Sipas Gerard Conru, prova është demonstrim i një fakti ose akti, përmes mjeteve të parashikuara në ligj. Në sistemin *common law*, edhe pse ato mund të përdoren si sinonime,[379] ka një dallim të qartë mes *evidencës* dhe *provës*. E para konsiderohet, në këndvështrimin procedural, si

[376] *Evidence and proofs from the perspective of the European Court of Human Rights,* <http://www.ejtn.eu/Documents/Themis/Written%20paper%20Italie/Themis%20written%20paper%20RomaRom%202.pdf>, aksesuar 07.02.2014.
[377] Ital. *prove*, Frën. *Preuves.*
[378] ibid (n 376)
[379] Për sistemin ligjor amerikan, *American Jurisprudence: a modern comprehensive text statement of American law: State and federal [...]: Evidence*, editors GS Gulick, RT Kimbrough and OC Sattinger ... [et al.], The Lawyers Co-Operative Publishing, New York, (1967), 36.

"çdo lloj e dhëne e marrë në përputhje me ligjin dhe që paraqitet në gjykim"[380] dhe në këndvështrimin "substancial" "konfirmim i fakteve përmes evidencës"[381].

Si rrjedhojë, nisur nga sa më lart, si dhe nga shprehja latine *da mihi factum, dabo tibi jus* (me jep faktet dhe do të të jap të vërtetën), i akuzuari duhet të paraqesë vetëm aktet ose faktet. Është gjyqtari ai që do të përcaktojë pasojat ligjore për to.

Edivenca dhe *prova* janë dy institute shumë të rëndësishme të procesit gjyqësor. Evidenca përbën sot pjesë procedurale të çdo institucioni në çdo sistem ligjor dhe rrjedh nga kohët kur rrëfimi ishte *regina probationum*[382] ose kur ai pranohej dhe përmes përdorimit të torturës. Në ditët e sotme sistemi i evidencës është i mirëorganizuar, të paktën në vendet ku zbatohet shteti i së drejtës dhe ku liritë e të drejtat themelore të individit respektohen.

Qëndrimi i GJEDNJ lidhur me nocionet e *evidencës* dhe *provës* është i veçantë. Për shkak të pikëpamjeve të ndryshme të shteteve anëtare lidhur me sistemin e evidencës, si dhe duke pasur parasysh dhe qëllimin e saj për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, kjo Gjykatë ka zhvilluar qasje të sajën lidhur me këtë. Nocioni i *evidencës* dhe *provës* që kjo Gjykatë përdor,[383] janë koncepte autonome dhe kanë një kuptim të veçantë në jurisprudencën e saj. Ashtu siç ka evidencë dhe prova të paraqitura para sistemeve kombëtare, ka evidencë dhe prova të paraqitura dhe para GJEDNJ.

Shtetet janë të detyruara të hetojnë dhe gjykojnë çështjen, në përputhje me ligjet e tyre kombëtare si dhe me parashikimet e KEDNJ. GJEDNJ ndalet vetëm në përcaktimin nëse këto garanci janë ruajtur. Nëse një fakt është provuar përmes një procesi të rregullt (neni 6 i KEDNJ), ose nëse një hetim është kryer siç duhet (sipas garancive procedurale të neneve 2 dhe 3). GJEDNJ nuk merret me analizimin e fakteve, përveçse nëse situatat e paraqitura janë haptazi në shkelje arbitrare të të drejtave të njeriut.[384] Në këtë rast, GJEDNJ merret vetëm me shqyrtimin nëse, në nivel kombëtar, janë zbatuar rregullat, duke përfshirë këtu dhe marrjen e evidencës.[385] Nga ana tjetër, me qëllim që të përcaktojë nëse ka pasur cenim të të drejtave të parashikuar nga Konventa, GJEDNJ duket të marrë parasysh evidencat, që i paraqiten asaj nga i akuzuari. Kështu, nëse ka pretendime për cenim të nenit 5/3 të KEDNJ, Gjykata duhet të përcaktojë nëse kishte dyshime të arsyeshme për arrestin, pavarësisht konkluzioneve të nxjerra për këtë në nivel kombëtar. Me fjalë të tjera, para GJEDNJ paraqiten evidenca për cenim të një të drejtë të parashikuar nga KEDNJ, të cilat i nënshtrohen procesit të të provuarit.

---

[380] <http://legal-dictionary.thefreedictionary.com/evidence>, aksesuar 07.02.2014.
[381] <http://legal-dictionary.thefreedictionary.com/proof>, aksesuar 07.02.2014.
[382] Mbretëreshë e evidencës.
[383] Në frëngjisht: *"la notion des preuves"*.
[384] Louis-Edmond Petitti, Emanuel Decaux, Pierre-Henri Imbert, *La Convention Europeenne des Droits de l'Homme. Commentaire article par article*, Edition Economica, Paris, (1995), 247.
[385] *Doorson v. the Netherlands*, (Application no. 20524/92), pp 67.

Në jurisprudencën e saj, GJEDNJ është shprehur vazhdimisht se neni 6 i Konventës nuk kërkon zbatimin e rregullave të veçanta për evidencën, pasi kjo çështje i përket legjislacionit vendas. Në lidhje me *evidencën* dhe *provat*, në çështjen *Van Mechelen and Others v. the Netherlands*,[386] GJEDNJ u shpreh se: "pranueshmëria e evidencave të paraqitura është, pikësëpari, çështje që duhet rregulluar nga legjislacioni kombëtar dhe, si rregull i përgjithshëm, gjykatat kombëtare duhet vlerësojnë evidencën e paraqitur para tyre". Detyra e Gjykatës, sipas Konventës, "nuk është të vendosë nëse dëshmitë ishin pranuar si evidencë, por të provojë nëse gjykimi, si i tërë, përfshirë dhe mënyrën e marrjes së evidencës, ishte i drejtë".[387] Për këtë qëllim, GJEDNJ ekzaminon nëse evidenca është paraqitur në seancë publike, në prezencë të të akuzuarit, nëse ka pasur argumente kundërshtuese, nëse është ruajtur barazia e armëve, etj.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm, që lidhet me nenin 2 të KEDNJ, ka të bëjë me barrën e provës. GJEDNJ, ashtu si dhe gjykatat kombëtare, analizon evidencën e paraqitur nga shteti, ku ky i fundit duhet të *provojë*[388] se pasoja ka ardhur si rezultat i shkeljes së kushteve të parashikuara në Konventë.[389]

Sa i përket barrës së provës në lidhje me nenin 3 të Konventës, kërkuesi duhet të paraqesë *evidenca*, në kuptimin se ai duhet të *provojë* se ndaj tij është ushtruar torturë, trajtim ose ndëshkim çnjerëzor ose poshtërues, sipas shprehjes latine *"actori incumbit probatio"*. Në rastet kur një person, gjatë lirimit të tij nga gjendja e arrestit ose nga burgu, ka plagë, ndërkohë që nuk i ka pasur ato kur është arrestuar ose çuar në burg, është shteti ai që duhet të paraqesë evidenca, ose të paktën një shpjegim të pranueshëm, se plagët nuk kanë ardhur për shkak të trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues të individit.[390]

Neni 5/1/c i KEDNJ lejon arrestimin ose ndalimin e një personi kur ka dyshime të arsyeshme se personi ka kryer veprën penale, është i nevojshëm parandalimi i kryerjes së veprës ose kur ekziston rreziku i largimit të autorit të veprës. Pra, nëse një personi i është cenuar liria e tij, shteti duhet të provojë para Gjykatës se kjo është bërë për dyshime të arsyeshme. Një dyshim i arsyeshëm për kryerjen e një krimi duhet analizuar në dritën e legjislacionit penal. Nëse dikush kryen një veprim, i cili nuk parashikohet si vepër penale në legjislacionin vendas, arrestimi ose ndalimi për këtë shkak i personit do të konsiderohej shkelje.[391] "Arsyeshmëria" e dyshimit mbi të cilin do të bazohet arresti formon pjesë thelbësore të garancisë kundër arrestimit ose ndalimit arbitrar, të parashikuar në nenin 5/1 të KEDNJ. Të pasurit e një dyshimi "të arsyeshëm" nënkupton

[386] *Mechelen and Others v. the Netherlands*, (Applications nos. 21363/93, 21364/93, 21427/93 and 22056/93).
[387] Ibid, pp.50.
[388] *Tanrikulu v. Turkey*, (Application no. 23763/94), pp 97; *Velikova v. Bulgaria*, (Application no. 41488/98), pp 70.
[389] *McCann and others v. Great Britain*, (Application no. 18984/91), pp 148 – 150, shkelje e nenit 2/2 të KEDNJ.
[390] *Selmouni v. France* [GC], (Application no. 25803/94), pp 87; *Berktay v. Turkey*,(Application no. 22493/93), pp 167; *Altay c. Turkey*, (Application no. 22279/93), pp 50.
[391] *Wloch v. Poland*, (Application no. 27785/95)

ekzistencën e fakteve ose pjesëve të informacionit, të cilat bëjnë që një njeri i zakonshëm të mendojë se personi në fjalë mund të ketë kryer veprën penale. Megjithatë, "arsyeshmëria" varet nga rrethanat. GJEDNJ shqyrton vetëm nëse thelbi i garancive të parashikuara në nenin 5/1/c të KEDNJ është ruajtur. Autoritetet shtetërore duhet të japin të paktën disa fakte ose informacione, të cilat kënaqin GJEDNJ se ndaj personit të arrestuar ekzistonin dyshime të arsyeshme për kryerjen e veprës penale.

Edhe sa i përket nivelit të "dyshimit", ky nuk nënkupton që autoritetet hetuese të kenë mbledhur evidenca të mjaftueshme për të ngritur një akuzë penale. Faktet që ngrenë dyshime nuk është e nevojshme të jenë të të njëjtit nivel me ato për të cilat mund të justifikohet ngritja e akuzës penale apo dënimi, pasi këto përbëjnë pjesë të fazës së dytë hetimore.[392] Pra, kjo nuk nënkupton se organet policore duhet të kenë mbledhur evidenca të mjaftueshme për të ngritur akuzë penale. Megjithatë, si në rastin e ekzistencës së rrezikut të kryerjes së veprës penale, ashtu dhe në rastin e rrezikut të largimit të personit, shteti palë i KEDNJ duhet të provojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm. Pra, me fjalë të tjera, shteti palë duhet të jetë në gjendje të provojë, se të dhënat që ka mbledhur janë në gjendje të bindin dhe një njeri normal, që nuk ka dijeni mbi çështjen, se kryerja e këtyre veprimeve nga personi nën hetim ose i akuzuar, është e pashmangshme.

Ajo çka është e rëndësishme të theksohet në dallimin mes evidencës dhe provës, qëndron në faktin se pavarësisht se ndaj një personi të caktuar mund të ketë evidenca të mjaftueshme për kryerjen, nga ana e tij, të një vepre penale, duhet pasur parasysh se këto fakte duhen provuar para gjykatës. Fakti i të provuarit përfshin në vetvete, ndër të tjera, dhe mënyrën e marrjes së evidencës. Kështu, në çështjen *Khan v. United Kingdom*[393] i akuzuari ishte dënuar mbi bazën e një pajisjeje përgjimi të vendosur në kundërshtim me nenin 8 të Konventës. GJEDNJ u shpreh se i akuzuari ka qenë në pamundësi për të kundërshtuar si përdorimin, ashtu dhe autenticitetin e regjistrimeve. Kërkuesi pretendoi si shkelje të nenit 8 të KEDNJ, ashtu dhe të nenit 6, pasi e vetmja evidencë kundër tij ishte marrë në kundërshtim me nenin 8. Ndërsa GJEDNJ u shpreh se kishte pasur ndërhyrje në jetën private të kërkuesit dhe cenim të nenit 8, nuk kishte pasur dhe nuk ka shkelje të nenit 6/1 të Konventës, pra të së së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, për aq kohë sa të akuzuarit i jepet mundësia e kundërshtimit, para gjykatës, të marrjes së kësaj evidence.

Le t'i kthehemi, për këtë çështje, legjislacionit penal shqiptar. Neni 149 i Kodit tonë të Procedurës Penale parashikon: **Kuptimi i Provës** - "1. Prova janë *njoftimet* mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhjes së saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij". Neni 150 parashikon: **Objekti i provave** - "1. Janë objekt prove faktet që kanë lidhje me akuzën, fajësinë e të

[392] *Brogan and others v. United Kingdom,* (Application nos. 11209/84 11234/84 11266/84)
[393] *Khan v. United Kingdom,* (Application no. 11987/11)

pandehurit, caktimin e masave të sigurimit, dënimin dhe përgjegjësinë civile, si dhe faktet nga të cilat zbatimi i normave procedurale".

Nisur nga kuptimi i dispozitës së parë, provat janë *"njoftime"*. Po t'i referohemi Fjalorit të Shqipes së Sotme,[394] "njoftimi" përkufizohet si: "Kumtim a lajm për diçka. Të dhëna që na bëhen të njohura, njohuri rreth një çështjeje; dijeni.". Lind pyetja: A përbëjnë të dhënat *prova* në kuptimin që duhet të merren të mirëqena, apo *prova* në kuptimin që, duhet t'i nënshtrohen procesit të të provuarit?

Edhe po t'i referohemi nenit 150, "Janë objekt prove faktet ...". Ç' duhet kuptuar me shprehjen "objekt prove"? Kjo shprehje duhet kuptuar si "përbëjnë provë" apo "i nënshtrohen procesit të të provuarit"?

Legjislacioni ynë penal duhet të jetë në gjendje të bëjë dallimin gjuhësor mes "provës" së marrë nga organet e ndjekjes penale, dhe "provës" që i nënshtrohet procesit të të provuarit gjatë gjykimit. Sigurisht, që shpesh herë, qoftë për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit penal në fuqi, qoftë dhe për shkaqe të tjera, organet e ndjekjes penale marrin prova të cilat, gjatë gjykimit të çështjes para gjykatës, hidhen poshtë nga kjo e fundit, për shkak se janë marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Ka raste dhe kur mjaft të dhëna për çështjen nuk paraqiten para gjykatës. Një gjë e tillë bën që këto "prova" të mos konsiderohen më të tilla. Për këtë shkak, lind nevoja e përcaktimit të terminologjisë së duhur.

Nëse termi i përdorur nga Kodi ynë i Procedurës Penale në nenin 149 "provë" duhet ndryshuar në termin "evidencë", "të dhëna", "fakte", "informacione" apo në ndonjë term tjetër, kjo nuk përbën objekt të këtij punimi, megjithatë qëndron fakti se një përcaktim i tillë është i nevojshëm. Pavarësisht se Fjalori i Shqipes së Sotme përkufizon "evidencën" si shënime ose të dhëna që mbahen në një fletë letre a në një regjistër, të cilat pasqyrojnë gjendjen e punëve a të veprimtarisë së njerëzve, të ndërmarrjeve, të institucioneve etj. ....; për qëllimet e këtij punimi termi "evidencë" nënkupton të gjitha ato të dhëna mbi të cilat bazohet akuza penale, si dhe çdo të dhënë tjetër që merret për të zbuluar mënyrën, rrethanat, autorin e veprës penale, etj., të cilat akoma nuk i janë nënshtruar procesit të të provuarit.

Sipas konceptit të këtij punimi, përbëjnë provë vetëm ato evidenca, të paraqitura në gjykim dhe të provuara si të tilla po gjatë gjykimit të çështjes. Përjashtim është bërë vetëm në rastet e referimit të legjislacionit penal shqiptar ose të vendimeve gjyqësore të gjykatave shqiptare.

[394] Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, *Fjalor i Shqipes së Sotme*, Botimet Toena (2002), 887.

Barra e Provës *(Onus probandi)*

Qëllimi i gjykimit është rindërtimi i fakteve mbi një ngjarje që ka ndodhur, në mënyrë që gjyqtari ose juria, duke u bazuar tek ato të zbatojnë ligjin duke vendosur për çështjen dhe dënuar ose jo të akuzuarin. Rindërtimi i ngjarjes bazohet pikërisht në evidencat dhe pretendimet e palëve në gjykim. Megjithatë, pyetja që lind është: "Si procedohet në rastet kur është e vështirë ose e pamundur të jepet një përgjigjeje mbi faktet? Kush ka barrën e provës? Në rast se gjykata e ka të pamundur të vendosë mbi rrjedhjen e ngjarjeve, kush e ka fajin? Dhënia e këtyre përgjigjeve është e rëndësishme për të arritur në një vendimmarrje mbi ngjarjen.

Përgjigja e këtyre pyetjeve mbështetet në parimin *Ei qui affirmat non ei qui negat incumbit probabtio*, sipas të cilit, ai që kërkon ndihmën e ligjit është ai që ka detyrimin e të provuarit të fakteve përmes evidencës dhe argumenteve. Në çështjet penale është organi i ndjekjes penale, përmes prokurorit, që inicion procedimin. Për rrjedhojë, barra e të provuarit dhe e rindërtimit të fakteve e rrethanave të ngjarjes bie mbi të. Jo vetëm kaq, por ai është i detyruar që, faktet që paraqet, të arrijnë të bindin gjykatën përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, çka përbën garantim e mbrojtje të prezumimit të pafajësisë. Pra, për shkak të nevojës për rindërtimin e fakteve përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, organi i ndjekjes penale është i ngarkuar me detyrën e rindërtimit të fakteve të shkuara, ndërsa i akuzuari ka shumë pak për të bërë gjatë gjykimit, përveçse nëse paraqet një mënyrë tjetër të ndodhjes së ngjarjes.

Kështu, nëse i akuzuari pranon rindërtimin e ngjarjes dhe faktet e sjella nga prokurori, e njëkohësisht justifikon veprimet e tij, për shkaqe të përcaktuara në ligj, atëherë barra e të provuarit të këtyre shkaqeve bie mbi të akuzuarin. Ky transferim i barrës së provës, përmes procesit të të provuarit ose hedhjes poshtë të fakteve, mund të ndodhë shpesh herë gjatë procesit penal, si p.sh. kur i akuzuari kundërshton pranueshmërinë e disa evidencave. Në këtë rast është i akuzuari, dhe jo prokurori, i cili duhet të provojë pretendimet e tij.

Në çështjet penale, si organi i ndjekjes, ashtu dhe mbrojtja përfaqësohen nga individë të aftë profesionalisht. Është detyrë e tyre, që nëpërmjet një personi tjetër të parashikuar me ligj – gjyqtarit, të kërkojnë marrjen e të gjitha atyre informacioneve që mund të provojnë pretendimet që ata kanë. Gjyqtarit i është dhënë pushteti për zhvillimin e drejtë të gjykimit.

Në shumicën e gjykimeve penale barra e provës bie mbi prokurorinë, e cila është e detyruar të provojë akuzat e saj përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Çdo dyshim shkon në favor të të akuzuarit. Si rrjedhojë, përgjegjësia e organit të ndjekjes penale, për të hequr çdo dyshim për kryerjen ose jo të veprës penale nga i akuzuari, është shumë e madhe.

Në eliminimin e çdo dyshimi të arsyeshëm mbi kryerjen e veprës penale një rëndësi të veçantë merr dhe prezantimi i çështjes nga ana e avokatit mbrojtës. Kështu, nëse avokati do të niste mbrojtjen e tij duke vënë në dukje faktin se klienti i tij nuk konsiderohet fajtor deri në momentin që arrihet të provohet e kundërta, atëherë mendimi që krijohet nga gjyqtari ose juria që gjykon çështjen do të ishte: "I akuzuari edhe mund ta ketë kryer veprën penale, por duhet shpallur "jo fajtor", pasi organi i ndjekjes penale nuk ka arritur të provojë fajësinë e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm."[395]

Barra e provës ka në vetvete tre elementë përbërës: barrën ligjore, barrën e të provuarit të evidencës, si dhe barrën e përcaktimit të pranueshmërisë ose jo të evidencës.

Barra e të provuarit të evidencës përbën atë lloj barre prove që konsiston në paraqitjen e evidencës, e njihet njëkohësisht me termin "barra taktike". Kjo lloj barre kërkon provimin e fakteve nga prokuroria, në mënyrë të tillë, që të bindë gjykatën në marrjen e një vendimi që dënon të akuzuarin. Kjo lloj barre ka për qëllim të drejtojë vëmendjen drejt disa evidencave të caktuara që kanë për qëllim të provuarit e akuzës së prokurorisë.

Përveç prokurorisë, barra e të provuarit të evidencës mund të bjerë dhe mbi të akuzuarin, p.sh. për fakte ose rrethana që s'kanë të bëjnë me evidencën e paraqitur nga prokuroria, si në rastin e vetëmbrojtjes, kryerjes së veprës penale nën ushtrimin e dhunës, intoksikimit, çmendurisë, për shkak aksidenti, etj.

Për nga vetë natyra, barra e të provuarit të evidencës është shumë e paqëndrueshme dhe mund të zhvendoset vazhdimisht gjatë gjykimit, në varësi të llojit të evidencës dhe epërsisë së një evidence ndaj evidencave të tjera.

Evidencat e paraqitura në gjykim mund të ndahen në tre kategori:

- Evidencë që ka epërsi;

[395] Jim McElhaney, *The Burden of Reasonable Doubt When a Standard Designed to Protect Defendants Actually Hurts them*, ABA Journal, October 2011 Issue, <http://www.abajournal.com/magazine/article/the_burden_of_reasonable_doubt_when_a_standard_designed_to_protect_defendan> aksesuar 07.10.2013. Për të kuptuar më mirë dyshimin e arsyeshëm le të marrim një shembull të thjeshtë: Le të supozojmë se kemi një mi dhe e fusim në një kuti. Marrim dhe një mace e e fusim dhe atë në kuti së bashku me miun. Kutisë i vëmë kapakun dhe e mbulojmë. Largohemi për një orë. Kur kthehemi heqim mbulesën, e më pas kapakun e shohim brenda. S'ka mi, por ka një mace të lumtur. Ç'ndodhi? Nuk ishim të pranishëm. Nuk ka dëshmitarë. Gjithçka kemi është evidencë e varur nga rrethanat. Megjithatë, e dimë, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, se ç'i ndodhi miut.

Përsërisim shembullin. Vendosim miun në kuti, fusim dhe macen gjithashtu. Kutinë e mbyllim me kapak dhe e mbulojmë. Largohemi për një orë. Rikthehemi. Heqim mbulesën, heqim kapakun dhe shohim brenda. Macja është në kuti, miu jo. Por, po të shohim kutinë me kujdes vëmë re që në një qoshe të kutisë ka një vrimë të vogël, e mjaftueshme për një mi për tu larguar. Kjo vrimë përbën dyshim të arsyeshëm.

Pikërisht këto vrima përbëjnë dyshimin e arsyeshëm në një çështje penale, vrima të cilat prokuroria duhet t'i mbyllë. Çdo pretendim i prokurorisë përbën, për gjyqtarin e çështjes ose jurinë, një vrimë, pra dyshim të arsyeshëm.

- Evidencë e qartë dhe bindëse;
- Evidencë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Në kategorinë e parë futet ajo evidencë, që është më e besueshme se evidencat kundër saj. Në rast se të dy palët paraqesin evidenca, që e bëjnë të pamundur marrjen e një vendimi për çështjen, atëherë pala që kishte barrën e provës, humbet.

Në kategorinë e dytë futet ajo evidencë, për shkak të së cilës gjyqtari ose juria krijojnë bindjen se ka shumë gjasa që e vërteta të jetë e tillë.

Në kategorinë e tretë hyn çdo evidencë, përmes së cilës provohen faktet e rrethanat e çështjes, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në çështjet penale, parimisht, barra e provës së kësaj evidence, gjatë gjithë gjykimit, bie mbi prokurorinë. Kjo barrë prove, parimisht, nuk kalon asnjëherë tek i akuzuari, që ky të provojë pafajësinë e tij.

Pavarësisht se, gjatë gjykimit të çështjes, barra e të provuarit të elementëve të krimit nuk kalon asnjëherë tek i akuzuari, barra e provës në rastet e pohimit të kryerjes së krimit nga i akuzuari për shkak vetëmbrojtjeje mund të bjerë mbi këtë të fundit. Kjo varet nëse çështja trajtohet si mbrojtje apo si kundërshtim i provave të paraqitura nga prokurori. Në rast se bëhet fjalë për kundërshtim të provave të paraqitura nga prokurori, barra e provës nuk kalon tek i akuzuari, ndërsa, nëse bëhet fjalë për kryerjen e veprës penale për shkak mbrojtjeje, atëherë barra e provës bie mbi të akuzuarin.

Ka disa raste specifike kur barra e provës mund të kalojë tek i akuzuari. Kështu, në rastet e *alibisë*, barra e provës bie mbi të akuzuarin përmes kundërshtimit të evidencës së prokurorisë, për të treguar se alibia e tij qëndron mbi evidencat e paraqitura nga organi i ndjekjes penale. E njëjta gjë mund të thuhet dhe në rastet e kryerjes së veprës penale për *vetëmbrojtje*. Në rastet kur i akuzuari pretendon se ka kryer veprën penale në kushtet e *papërgjegjshmërisë për shkak të gjendjes mendore*[396], barra e provës bie mbi të akuzuarin/mbrojtësin e tij për të provuar këtë papërgjegjshmëri. Kjo papërgjegjshmëri duhet argumentuar me prova bindëse. Pikëpamjet për barrën e provës në rastet e papërgjegjshmërisë mendore janë të ndryshme. Sipas disa autorëve, i akuzuari duhet të ngrejë pretendime e të paraqesë prova të besueshme për papërgjegjshmëri mendore, megjithatë është organi i prokurorisë, i cili duhet të provojë se i akuzuari ishte ligjërisht i përgjegjshëm në kohën e kryerjes së krimit.

[396] Kodi Penal i RSH, neni 17: "Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale. Personi që në kohën e kryerjes së veprës penale vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik, që ka ulur ekuilibrin e tij mendor për të kuptuar dhe kontrolluar plotësisht veprimet apo mosveprimet e tij, është i përgjegjshëm, por kjo rrethanë mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e masës dhe llojit të dënimit."

Llojet e provës

Neni 6/1 i KEDNJ nuk përcakton zbatimin e rregullave të veçanta lidhur me evidencën. Kjo është çështje e ligjeve të brendshme të shteteve. Kështu p.sh. nuk përjashtohet mundësia që evidencat e marra në kundërshtim me ligjin, të konsiderohen si të pranueshme, pa e bërë gjykimin të padrejtë, me përjashtim të paligjshmërisë së evidencës së marrë përmes nxitjes. Ajo që kërkon neni 6 është se, në të gjitha rrethanat e çështjes, duke përfshirë dhe mënyrën e marrjes/zbulimit të evidencave, gjykimi si një i tërë duhet të jetë i drejtë.

Në çështjen *Khan v. United Kingdom*[397], i akuzuari ishte dënuar për shpërndarje substancash narkotike mbi bazën e provave të marra me anë të një pajisjeje sekrete dëgjimi, të instaluar nga policia. Kërkuesi dhe kushëriri i tij N. ishin ndaluar dhe pyetur nga policia për posedim dhe shpërndarje droge në momentin e mbërritjes së tyre nga Pakistani në Aeroportin e Manchesterit. Kushëriri i kërkuesit ishte ndaluar dhe arrestuar nga policia, ndërsa kërkuesi, duke qenë se nuk kishte pasur drogë, ishte pyetur dhe më pas lënë i lirë. Më 26 Janar të 1993 kërkuesi i kishte bërë vizitë shokut të tij B. në Sheffield, i cili ishte nën hetim nga policia për shpërndarje heroine. Më 12 Janar të 1993 në banesën e B., me autorizim të Shefit të Policisë së Yorkshire-it të Jugut, ishte vendosur një pajisje përgjimi, me idenë se mundësia e marrjes së të dhënave përmes metodave konvencionale të përgjimit ishte shumë e vogël. Nuk ishte parashikuar dhe as nuk mund të dihej që kërkuesi do të vizitonte shtëpinë e B. As kërkuesi dhe as B. nuk ishin në dijeni të ekzistencës së pajisjeve të përgjimit në shtëpinë e B. Përmes pajisjeve të përgjimit, policia arriti të regjistronte një bisedë, në të cilën kërkuesi pranonte se kishte qenë, së bashku me N., pjesëtar i grupit që importoi drogë në Shtator të 1992. Kërkuesi u arrestua dhe u dënua në zbatim të ligjit "Mbi Menaxhimin e Doganave dhe Akcizës" të vitit 1979. Gjykimi u zhvillua në vitin 1993. Gjykata e shkallës së parë e dënoi kërkuesin me 3 vjet burgim. Ai apeloi në gjykatën e apelit, me pretendimin se prova e marrë duhej të konsiderohej e papranueshme nga gjykata. Dhoma e Lordëve (Gjykata e Lartë), vërejti se para saj ngriheshin dy pyetje: së pari, nëse regjistrimi duhej të pranohej nga gjykata dhe së dyti, nëse ishte e pranueshme, a duhej të ishte përjashtuar gjithsesi në gjykimin në shkallë të parë? Përsa i përket pyetjes së parë Dhoma e Lordëve (DHL) u shpreh se në legjislacionin anglez nuk kishte ligj për ruajtjen e privatësisë, por edhe nëse një e drejtë e tillë do të ekzistonte, të dhënat e marra nga pajisjet e përgjimit do të ishin të pranueshme. Lidhur me pyetjen e dytë, DHL u shpreh se, fakti që evidenca ishte marrë në kundërshtim me nenin 8 të Konventës, ishte i rëndësishëm, por jo vendimtar, përsa i përket të drejtës së gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë për të pranuar ose përjashtuar evidencën e marrë. E drejta e gjyqtarit për të vendosur për këtë duhej parë në drejtim të procesit të drejtë, pra nëse pranimi i kësaj evidence nga gjyqtari do ta bënte procesin të parregullt. Gjykatat angleze të të tre shkallëve u shprehën se regjistrimi i bisedave nuk ishte i paligjshëm, në kuptimin se nuk ishte në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm, pasi

[397] *Khan v. United Kingdom*, (Application no. 35394/97).

në atë kohë në Mbretërinë e Bashkuar nuk kishte një sistem ligjor që rregullonte përdorimin e pajisjeve të fshehura dëgjimore nga policia, por GJEDNJ u shpreh se kjo binte në kundërshtim me nenin 8 të KEDNJ (e drejta për respektim të jetës private, familjare dhe korrespondencës), e pikërisht me paragrafin 2 të tij.

Gjykata e Strasburgut vërejti se i akuzuari kishte pasur mundësi të mjaftueshme për të kundërshtuar, si vërtetësinë, ashtu dhe përdorimin e regjistrimit, dhe kishte kundërshtuar në fakt përdorimin e regjistrimit, por jo vërtetësinë e tij. Në çdo nivel juridiksioni (gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit, Dhoma e Lordëve), gjykatat vendase kishin vlerësuar efektin e pranimit të kësaj evidence në drejtësinë e gjykimit dhe kishin diskutuar bazat jostatutore për këtë përgjim. Përdorimi në gjykim i materialit të marrë nga përgjimet sekrete, u shpreh Gjykata e Strasburgut, nuk binte në konflikt me kërkesat e nenit 6/1.

Ajo që ka konkluduar GJEDNJ në interpretim të nenit 6/1 të Konventës është se, në zbatim të parimit të "barazisë së armëve", prokuroria duhet t'i bëjë të ditur mbrojtjes të gjitha provat që ajo disponon pro ose kundër të akuzuarit.

Vështirësitë që i shkaktohen mbrojtjes nga kufizimi i të drejtave lidhur me provën, si p.sh. në rastet kur provat i fshihen mbrojtjes (rastet e mbrojtjes së identitetit të informatorëve ose policëve të infiltruar), duhet të balancohen përmes procedurave të ndjekura nga autoritetet gjyqësore. Një gjë e tillë u vendos në çështjet *Rowe dhe Davis v. United Kingdom*[398] dhe *Fitt v. United Kingdom*[399]. Në çështjen e parë, në përputhje me ligjin e kohës, ishte organi i ndjekjes penale, i cili, pa dijeninë apo miratimin e gjyqtarit të shkallës së parë, vendosi të mos bëjë të ditura evidencat në ngarkim të të akuzuarit. Gjykata e Strasburgut u shpreh se kjo binte në kundërshtim me të drejtën për një gjykim të drejtë, pavarësisht se gjykata e apelit kishte marrë në konsideratë materialin e mbajtur të fshehtë dhe ishte shprehur se dënimi kishte qenë i rregullt. Në çështjen e dytë, ligji kishte ndryshuar dhe organit të akuzës iu kërkua të paraqesë një kërkesë para gjyqtarit të çështjes, me qëllim mosbërjen të ditur të evidencës në fjalë. Në këtë rast, Gjykata e Strasburgut ishte e kënaqur pasi mbrojtja ishte mbajtur e informuar, aq sa ishte e mundur, pa bërë të ditur materialin që prokuroria kërkonte të mbahej sekret për shkak të interesit publik. Në këtë rast GJEDNJ u shpreh se gjyqtari i shkallës së parë kishte respektuar parimin e gjykimit të drejtë, të kërkuar nga neni 6/1 i Konventës, pavarësisht mosbërjes së ditur të evidencave mbrojtjes.

Ndërkohë, në Shqipëri, Kodi shqiptar i Procedurës Penale, në Titullin IV, parashikon rregulla të përgjithshme mbi provat: kuptimin, objektin, marrjen e çmuarjen e tyre. Një proces hetimor përfundon në akuzë kur baza e të dhënave të mjaftueshme mbështetet në prova[400], që përbëjnë akuzën. Organi procedues procedon me aktin e

[398] *Rowe and Davis v. The United Kingdom,* (Application no. 28901/95).
[399] *Fitt v. The United Kingdom,* (Application no. 29777/96).
[400] Vlen të përmendet dhe një herë ndryshimi terminologjik i fjalëve "evidencë" dhe "provë". Ndërkohë që legjislacioni shqiptar përdor vetëm termin "provë" për të gjitha faktet/rrethanat/materialet që hedhin dritë

njoftimit të akuzës. Personi, të cilit i është njoftuar akuza, i nënshtrohet debatit gjyqësor për provueshmërinë e fajësisë së tij.[401]

E drejta e provës është shprehje e të drejtës për mbrojtje. Për të bërë të mundur, në mënyrë fiktive, të drejtën e mbrojtjes ... në proces, palës i duhet dhënë e drejta të provojë rrethanat e caktuara.[402]

Në Kodin shqiptar të procedurës penale nuk ka një dispozitë konkrete që të parashikojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë e shterruese, llojet e provave. Megjithatë, llojet e provave, sipas legjislacionit shqiptar, mund të dallohen për shkak të parashikimit konkret në Kod të secilës prej tyre. Kështu, sipas legjislacionit penal shqiptar, llojet e provave janë:

- dëshmia,
- pyetja e palëve,
- pyetja e të pandehurit,
- ballafaqimi,
- njohja,
- eksperimenti,
- ekspertimi,
- provat materiale,
- dokumentet.

Në gjykim provat merrem me kërkesën e palëve. Megjithatë, kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund të vendosë marrjen e saj, në qoftë se ajo vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnetit të personit. Gjykata vendos për marrjen e provës pasi dëgjon palët mbi mënyrën e marrjes së saj.[403]

Në çështjet penale, ndjekja e procedurave të rregullta për marrjen e provës janë kusht primar për gjykimin e drejtë. Si rrjedhojë, rëndësia që u kushtohet atyre është e një karakteri të veçantë.

---

mbi ngjarjen, jurisprudenca amerikane dhe ajo e GJEDNJ përdorin termat "evidencë" dhe "provë". Të gjitha materialet e grumbulluara nga organi i ndjekjes penale, të cilat i paraqiten gjykatës për të marrë një vendim për çështjen, përbëjnë "evidencë". Çdo evidencë e provuar si e vërtetë gjatë gjykimit përbën "provë".
Për të pasur njëtrajtshmëri me legjislacionin shqiptar, termi i përdorur në rastet e referimeve në këtë legjislacion është "provë".

[401] Elizabeta Imeraj, *Provat në procesin penal*, MIRGEERALB (2010), 14.

[402] ibid, 15.

[403] Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 151/3.

Kurthi

Në çështjen e vitit 1998 *Teixeira de Castro v. Portugal*[404] u vendos parimi se, në rastet kur policët e infiltruar kishin kaluar cakun e hetimit pasiv të aktivitetit penal të një të dyshuari dhe kishin influencuar atë në kryerjen e krimit, kërkuesit i shkelej e drejta e gjykimit të drejtë. Në rastin konkret, kërkuesi ishte dënuar me 6 vjet burgim për shpërndarje substancash narkotike. Ai kishte kundërshtuar vendimin duke pretenduar se policët e infiltruar kishin vepruar si "*agent provocateur*" në kryerjen e krimit prej tij. Si gjykata e apelit, ashtu dhe ajo e Lartë u shprehën se legjislacioni vendas nuk e ndalonte një gjë të tillë, se policët kishin vepruar si hetues dhe se, si të tillë, kishin të drejtë të merrnin informacione rreth veprave penale, të identifikonin kriminelët si dhe të merrnin çdo masë të nevojshme, urgjente e të domosdoshme për ruajtjen e provës. Në pretendimet e saj para Gjykatës Europiane, qeveria portugeze u shpreh se dy policët e çështjes nuk kishin vepruar si "*agent provocateur*" dhe se, duhej bërë dallim mes rasteve kur policët e infiltruar kishin ndikuar në krijimin e qëllimit për kryerjen e veprës penale, me ato raste kur i akuzuari ishte i predispozuar për kryerjen e saj.

GJEDNJ u shpreh se nuk u arrit të shpjegohej se ndërhyrja e policisë ishte bërë në vazhdën e operacioneve kundër trafikimit të drogës (të urdhëruara dhe mbikëqyrura nga një gjyqtar), e se nuk kishte arsye të dyshohej se Z. Teixeira ishte trafikues droge. Kështu, ai nuk kishte dosje penale në ngarkim dhe ndaj tij nuk kishte pasur hetime paraprake, droga nuk ishte në shtëpinë e tij, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk tregonte nëse në momentin e arrestit kërkuesi kishte pasur më shumë drogë nga sa i ishte kërkuar atij nga policët e infiltruar dhe nuk kishte argumente të Qeverisë që të provonin se kërkuesi ishte i predispozuar të kryente këtë krim. Gjykata u shpreh se, në rastin konkret, ishin veprimet e policëve, që kishin nxitur dhe ndikuar në kryerjen e veprës penale nga kërkuesi dhe, si rezultat, gjykimi i kësaj çështjeje, që nga fillimi, kishte qenë i padrejtë.

Sipas Gjykatës, mënyra e marrjes së evidencës është çështje kryesisht e vetë shteteve, e rregulluar nga ligjet e brendshme dhe janë gjykatat vendase, të cilat bëjnë vlerësimin e evidencave të paraqitura. Roli i GJEDNJ është që të vlerësojë nëse gjykimi, si i tërë, ka qenë i rregullt. Përdorimin e agjentëve të fshehtë duhet të jetë i kufizuar dhe të drejtat duhet të ruhen edhe në rastet e luftës kundër trafikut të drogës. Rritja e krimit të organizuar kërkon, padyshim, ndërmarrjen e masave të duhura, por njëkohësisht dhe e drejta për administrimin e drejtësisë zë një vend të rëndësishëm.[405] Kërkesat e përgjithshme të gjykimit të drejtë, të mishëruara në nenin 6, zbatohen për gjykime të të gjitha llojeve të veprave penale, nga më të thjeshtat tek ato më komplekset. Interesi publik nuk mund të justifikojë përdorimin e provave të marra si rezultat i nxitjes së policisë. Interesi publik në dënimin e personave, që kryejnë vepra penale të rënda, siç është trafikimi i drogës, nuk mund të justifikojë përdorimin në gjykim të provave të marra si rezultat i nxitjes së policisë.

[404] *Teixeira de Castro v. Portugal,* (Application no. 25829/94).
[405] *Delcourt v. Belgium*, (Application no. 2689/65), pp 25.

Dëshmitarët anonimë

Në çështjen *Windisch v. Austria*[406] dënimi u bazua kryesisht në dëshmitë e dy dëshmitarëve anonimë, në mungesë të të akuzuarit dhe pa praninë e avokatit, dëshmi të marra nga policia dhe jo nga gjyqtari gjatë shqyrtimit të çështjes. Gjykata u shpreh se kërkuesit i ishte mohuar e drejta për të kundërshtuar besueshmërinë e dëshmitarëve. Në çështjen holandeze *Doorson v. The Netherlands*[407], që kishte të bënte me gjykimin e një personi të dënuar për shpërndarje droge, në dhënien e dënimit gjykata kishte marrë për bazë provat anonime të klientëve të tij, të cilët nuk donin t'u bëheshin të ditur emrat, pasi kishin frikë se mund të ndëshkoheshin për këtë nga kërkuesi. Gjykata e Strasburgut u shpreh se gjykimi i drejtë nuk është një nocion absolut. Sistemi penal duhet të mbrojë dhe dëshmitarët e, për rrjedhojë, duhet të ketë garanci të mjaftueshme për balancimin e disavantazheve që mund t'i shkaktohen mbrojtjes. në rastet e marrjes së provave nga dëshmitarët anonimë. Këto prova nuk duhet të jenë të vetmet apo vendimtare për dhënien e vendimit. Në çështjen në fjalë, GJEDNJ arriti në përfundimin se, mbrojtjes i ishin garantuar të drejtat e saj.

[406] *Windisch v. Austria* , (Application no. 12489/86).
[407] *Doorson v. The Netherlands*, (Application no. 20524/92).

KAPITULLI VII

E DREJTA PËR TË HESHTUR DHE PRIVILEGJI KUNDËR VETËINKRIMINIMIT

(nemo tenetur prodere seipsum) ose (nemo tenetur se ipsum accusare)

E drejta për të heshtur, e quajtur ndryshe dhe privilegji kundër vetëinkriminimit, është një parim i pazëvendësueshëm i të drejtave të akuzuarit në sistemet moderne të drejtësisë penale. Ky parim ndalon qeveritë të detyrojnë individët të japin dëshmi që mund t'i inkriminojnë ata gjatë procedimit penal të një çështjeje. Kjo e drejtë lejon të akuzuarin të refuzojë dhënien e dëshmisë në gjykimet penale, si dhe i jep atij privilegjin që të mos u përgjigjet pyetjeve të organeve të policisë ose ndjekjes penale, të cilat mund ta inkriminojnë atë në çështjen konkrete, ose në çështje penale të ardhme. Kjo thjesht për faktin se një individ nuk mund të dëshmojë kundër vetes së tij. [408]

E drejta për të heshtur dhe privilegji kundër vetëinkriminimit bazohen mbi parimin e prezumimit të pafajësisë. Provimi i fajësisë nuk është detyrë e të akuzuarit, por e akuzuesit, pra e organeve që ushtrojnë ndjekjen penale.

E drejta për të heshtur është e drejta e të dyshuarit që të mos u përgjigjet pyetjeve të policisë dhe justifikohet si mbrojtje kundër vetëinkriminimit. Kjo e drejtë njihet ndryshe si e drejtë "reale" për të heshtur.[409] E drejta për të heshtur, para gjykimit të çështjes, është pjesë e të drejtës kundër vetëinkriminimit. Sipas kësaj të drejte, një person që, për shkaqe të arsyeshme, beson se është i dyshuar ose se konsiderohet bashkëpunëtor në një vepër penale, ka të drejtën të heshtë gjatë pyetjeve që i drejtohen nga çdo person ose autoritet publik, përmes të cilave i kërkohet të japë informacion mbi rrjedhën e ngjarjeve, identitetin e pjesëmarrësve, rolin e tyre, etj.

E drejta për të heshtur ka të bëjë me të drejtën që kjo heshtje të mos përdoret kundër personit gjatë gjykimit të çështjes në gjykatë. Duke qenë se shpesh herë heshtja konsiderohet si bashkëshoqëruese e fajësisë, kjo heshtje mund të përdoret në gjykim për

[408] Oxford Dictionary of Law, 5th Edition, 436. "E drejta për të heshtur - E drejta për të heshtur është e drejta e një personi të akuzuar ose që gjykohet për një vepër penale për të mos bërë deklarata ose për të mos dhënë evidenca. Shpesh herë kjo e drejtë shihet si pikënisja e gjykimit të drejtë dhe ka për qëllim të mbrojë të pafajshmin. Është kritikuar dhe si pengesë për dënimin e fajtorit, e si rrjedhojë është modifikuar. Nëse një i dyshuar, në kohën e arrestimit ose njoftimit të akuzës, nuk përmend fakte/të dhëna të cilat përdoren më pas për realizimin e mbrojtjes së tij, këto të dhëna mund të përdoren për një gjykim tjetër. Në rast se një i dyshuar mbi 14 vjeç e lart nuk përgjigjet lidhur me sendet, shenjat, ose substancat që i gjenden në trup ose veshje në kohën e arrestimit do të konsiderohet se i ndaluari është i dyshuar dhe do të informohet si i tillë sipas ligjit. Pamundësia e të dyshuarit për të shpjeguar praninë e tij në një vend të caktuar do të çojë në të njëjtat konkluzione."

[409] A Palmer, *Principles of Evidence*, Cavendish Pub. Australia, (1998), 160.

të hedhur dyshime mbi fajësinë e individit. E drejta për të heshtur ka për qëllim të mbrojë individin dhe kundër këtyre paragjykimeve.

Historia e zhvillimit të së drejtës për të heshtur

Historia e këtij parimi është e hershme. Kjo histori është e rëndësishme, pasi përmes saj, arrihet të kuptohen perspektivat dhe pozicionet e ndryshme të mbajtura lidhur me të drejtën për të heshtur dhe privilegjin kundër vetëinkriminimit në juridiksione të ndryshme. Shprehja latine *nemo tenetur prodere seipsum* ka origjinën në kohët romake dhe do të thotë se asnjë person nuk mund të detyrohet të shesë ose tradhtojë veten e tij në publik. Pra, sipas saj, askush nuk mund të detyrohet të betohet se do t'i përgjigjet drejt pyetjeve që kanë të bëjnë me fajësinë e tij, nëse ai thjesht dyshohet dhe nuk është akuzuar formalisht për krim.

Në kohët romake ky privilegj kishte më tepër për qëllim të kontrollonte zyrtarët e tejzellshëm sesa atë të mbrojtjes subjektive të një personi të akuzuar për krim. Ky parim garantonte që, një personi mund t'i kërkohej t'u përgjigjej pyetjeve që mund ta inkriminonin, vetëm nëse kishte arsye të forta se ky person kishte shkelur ligjin.

Në fushatën e Kishës Katolike të Romës kundër herezisë në kontinentin Europian në fund të Mesjetës, gjykatat kishtare përdornin betimin *ex officio*, përmes të cilit të akuzuarve u kërkohej të betoheshin se do t'u përgjigjeshin me sinqeritet pyetjeve që mund t'u bëheshin, pa ditur akuzuesin, akuzën ose evidencat. Refuzimi i kryerjes së këtij betimi çonte në dënimin si fajtor. Heshtja konsiderohej vetëinkriminim e ndëshkohej.

Kjo krijoi atë që u quajt trilema mizore. Sipas saj, të akuzuarit duhej të zgjidhnin mes: kryerjes së mëkatit mortor të "dëshmisë së rreme" (nëse gënjenin, nën betim, për të mbrojtur veten e tyre), ndëshkimit të ashpër për përbuzje të gjykatës (nëse refuzonin të përgjigjeshin), ose heqjes dorë nga detyrimi i tyre natyror për vetëpërmbajtje (përmes thënies së të vërtetës për të nderuar betimin).

Zhvillime të qarta të këtij parimi u vunë re në Angli rreth shekujve 17-18.[410] Ato erdhën si rrjedhojë e debateve që shoqëruan gjykatat e Star Chamber dhe High Commission, të cilat nuk duheshin nga populli, pasi ato shtypnin çdo lloj kundërshtimi fetar ose politik dhe procedurat e tyre shiheshin si shtypëse. Gjyqtarët kishin pushtet të merrnin në pyetje të akuzuarit, të cilët betoheshin mbi thënien e të vërtetës. Të dyshuarit mund të ndëshkoheshin nëse refuzonin t'u përgjigjeshin pyetjeve dhe shumica e marrjeve

[410] Autorë të ndryshëm pretendojnë se zhvillimet e këtij parimi datojnë dhe më herët, në fillimet e shekullit 15, John H. Langbein, *The Historical Origins of the Privilege Against Self-incrimination at Common Law*, Michigan Law Review, Vol 92, (1994), 1048.

në pyetje bëhej përmes përdorimit të torturës. Pyetja e të akuzuarve bëhej shpesh herë para njoftimit të akuzës dhe pa njoftimin e individit mbi veprimin penal që pretendohej se kishte kryer.[411] Ishin pikërisht këto masa që nxitën urrejtjen e popullit ndaj inkuizicioneve të papërmbajtshme të këtyre gjykatave.[412]

Ky parim u zhvillua më shumë gjatë periudhës së Restaurimit Anglez (1600 e tutje). Në 1640 u nxor një ligj, i cili i dha fund praktikës së pyetjes së dëshmitarëve nën betim. Një vit më vonë, këto dy gjykata u hoqën dhe betimi *ex officio* u hoq gjithashtu. Megjithatë, të akuzuarit në *common law* përballeshin përsëri me agresivitet gjatë marrjes në pyetje nga prokurori ose gjyqtari, gjatë gjykimit. Pas heqjes së betimit, të akuzuarit nuk i kërkohej e as lejohej më të bënte betim, megjithatë, fjalët që ata mund të thonin, mund të përdoreshin kundër tyre. Praktika e asaj kohe nuk lejonte të akuzuarin të përfaqësohej nga një mbrojtës. Në shekullin e 17 i akuzuari nuk lejohej të prezantohej në gjykim nga mbrojtësi, por ishte i detyruar të realizonte vetë mbrojtjen e tij, çka nënkuptonte se e vetmja mënyrë që të mbrohej, ishte të fliste për veten e tij. E drejta e tij për të thirrur dëshmitarë, nën betim, në favor të tij, ishte gjithashtu mjaft e kufizuar. Ekzaminimi i dëshmitarëve nga mbrojtësi ishte i ndaluar deri në mes të shekullit të 18. E drejta e tij për t'iu drejtuar jurisë ishte e ndaluar deri në fillim të shekullit të 19.

E drejta efektive për të heshtur filloi të shfaqej në Angli në fund të shekullit të 18, kur procedurat e gjykimit filluan të revolucionarizohen dhe u nxorën ligje për përjashtimin e rrëfimeve të pavullnetshme, ndër të tjera, edhe për faktin se këto rrëfime mund të ishin të pavërteta. Megjithatë, e drejta për të heshtur nuk ishte gjithmonë një realitet praktik për të akuzuarit në gjykatat angleze për një periudhë të gjatë. Kufizimi i aksesit në mbrojtje (që shpesh herë varej nga statusi social i të akuzuarit), ekzistenca e një standardi të të provuarit që kalonte sa nga njëra palë tek tjetra, si dhe ekzistenca e një sistemi që përbëhej përgjithësisht nga të akuzuar që refuzonin të flisnin, të gjitha këto ishin në dëm të të akuzuarit.

Në Angli, praktika e marrjes së të akuzuarit në pyetje gjatë gjykimit (në dallim nga marrja në pyetje para gjykimit), nuk u hoq plotësisht deri nga mesi i shekullit të 18. Në 1898 u miratua ligji për Evidencën Penale, që e bënte të akuzuarin dëshmitar, por jo të besueshëm. Kjo nënkuptonte që i akuzuari kishte të drejtë të dëshmonte nën betim, por jo detyrim. Ky akt i lejoi gjyqtarët (jo prokurorët) që t'i komentonin jurisë kur i akuzuari vendoste të heshtte. Ky koment, në përgjithësi, kufizohej vetëm në aspektin që i lejonte gjyqtarit t'i drejtohej jurisë, me qëllim që kjo (juria) të mos supozonte se i akuzuari ishte fajtor thjesht për faktin se ai heshtte gjatë gjykimit. E drejta e heshtjes gjatë pyetjes nga policia u zhvillua më tej me vendosjen e policisë profesionale në Angli, në vitin 1829. Zhvillimi i këtij parimi i atribuohej dyshimeve mbi mënyrën se si merreshin rrëfimet nga ana e policisë. E drejta e një të dyshuari për të refuzuar që t'i përgjigjej policisë u pranua

[411] <http://www.criminalcle.net.au/attachments/Right_To_Silence_paper.pdf>, aksesuar më 09.06.2013.
[412] John Henry Wigmore ishte ndër juristët e parë që u shpreh mbi të drejtën për të heshtur. Sipas tij "asnjë njeri nuk duhej të detyrohej të inkriminonte veten e tij, për asnjë akuzë e në asnjë gjykatë.

ligjërisht në Angli në vitin 1912 përmes futjes së këtij rregulli në *Rregulloren e Gjyqtarëve*, me qëllim që të vendoste drejtime mbi marrjen në pyetje të të dyshuarve nga ana e policisë. Një vendim i gjykatave angleze i 1914 vendosi se, pranimi i kryerjes së veprës ose rrëfimi i të akuzuarit policisë, do të pranohej si evidencë në gjykim, nëse prokuroria do të mund të tregonte se ky rrëfim kishte qenë vullnetar e në ushtrim të së drejtës së të akuzuarit për të vendosur lirisht për të folur ose heshtur.[413]

Shumica e kolonive angleze adoptuan parimin e të drejtës për të heshtur gjatë marrjeve në pyetje para gjykimit, si pjesë të sistemit të tyre të procedurës penale. Në shekujt e fundit, e drejta për të heshtur u kthye në një të drejtë bazë për të akuzuarin dhe filloi të zbatohej e t'i jepej gjithnjë e më shumë rëndësi.

Në Mbretërinë e Bashkuar dhe vendet që kishin qenë koloni të Perandorisë Britanike, siç ishin vendet e Commonwealthit, Shtetet e Bashkuara dhe Republika e Irlandës, e drejta për të heshtur është bërë pjesë e traditës së *common law* të trashëguar nga Anglia. Në SHBA kjo e drejtë ekzistonte para Revolucionit Amerikan. Ajo konsiderohej si një ndër garancitë më të rëndësishme që mbronte shtetasit ndaj veprimet arbitrare të shtetit dhe mbrohej nga Amendamenti i Pestë i Kushtetutës Amerikane, përfshirë në termat "proces i duhur ligjor", përmendur për herë të parë në një statut të Eduardit III në 1354, i cili kishte përmbajtje të ngjashme me Amendamentin e Pestë.

E drejta për mbrojtës, e cila u bë gjithashtu shumë e rëndësishme pas Revolucionit Amerikan, u dha të akuzuarve një metodë praktike mbrojtjeje përmes heshtjes. Zhvillimi i një policie moderne në fillimet e shekullit 19, paraqiti rëndësinë e të drejtës për të heshtur, gjatë marrjes në pyetje para gjykimit. Çështja, që i hapi rrugën shtrirjes së të drejtës për mbrojtës dhe në fazën para gjykimit, ishte *Bram v US*[414], ndërsa paralajmërimi Miranda u vendos në SHBA dhe gjetkë pas shqyrtimit të çështjes *Miranda v. Arizona*, në vitin 1966.

Ishin pikërisht këto ndryshime në procedurën penale të *common law*, së bashku me prezumimin e pafajësisë, të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe zhvillimet në rregullat procedurale për evidencën, që krijuan parimin kundër vetëinkriminimit në çështjet penale.

E drejta për të heshtur ishte e huaj për sistemin inkuizitor të drejtësisë penale deri në fundet e shekullit të 20. Zhvillimet në legjislacionin ndërkombëtar sollën një universalizim në rritje të mbrojtjes së procesit të rregullt ligjor, përmes njohjes së tij në dokumente ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut si: Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.

[413] *Ibrahim v R* [1914] AC 599.
[414] *Bram v. United States*, 168 U.S. 532 (1897).

Ç'është e drejta për të heshtur?

E drejta për të heshtur mund të mendohet si dredhi ose taktikë. Kjo mund të rrjedhë nga fakti se i akuzuari vendos të heshttë në mënyrë që të shmangë marrjen në pyetje. Megjithatë, i akuzuari nuk ka për të provuar asgjë. Barra e provës bie mbi prokurorinë. Është ky organ, që duhet të provojë fajësinë, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Pra, ç'është e drejta për të heshtur?

Kjo e drejtë në vetvete përbëhet nga një grup garancish, që i jepen personit nën dyshim ose të akuzuar për kryerjen e veprës penale. Këto garanci kanë natyra e rëndësi të ndryshme. Ndër to mund të përmenden:

- e drejta që gëzon çdo individ për t'u përjashtuar nga detyrimi për t'iu përgjigjur pyetjeve të bëra nga persona ose organe, përmes dhunës ose ndëshkimit;
- e drejta që gëzon çdo individ për t'u përjashtuar nga detyrimi për t'iu përgjigjur pyetjeve, përgjigjet ndaj të cilave mund ta vetëinkriminojnë;
- imunitet i veçantë, i të gjithë personave të dyshuar për veprime kriminale, që, gjatë pyetjes nga policia ose nga persona të tjerë në pozita autoritare të ngjashme, të përjashtohen nga detyrimi për t'iu përgjigjur pyetjeve të çdo lloji;
- e drejta e personave të akuzuar që të mos japin dëshmi gjatë gjykimit dhe përjashtimi i tyre nga detyrimi për t'iu përgjigjur pyetjeve, që mund t'i vënë ata në bankën e të akuzuarve;
- e drejta e personave të akuzuar për vepër penale për të mos iu përgjigjur asnjë lloj pyetësori me shkrim të organeve të policisë, ose organeve të tjera me autoritet të ngjashëm;
- e drejta e të akuzuarit që, gjatë gjykimit, të mos i përgjigjet asnjë pyetjeje që i drejtohet mbi shkaqet e heshtjes për pyetjet që i bëhen para gjykimit, ose pyetjeve gjatë gjykimit për shkaqet e mosdhënies së evidencës.

Pra, këto të drejta, të thjeshtuara janë:

1) e drejta e çdo individi - jo të dyshuar, për të heshtur;
2) e drejta e të dyshuarit për të heshtur, para gjykimit të çështjes nga gjykata;
3) e drejta e të akuzuarit për të heshtur gjatë gjykimit të çështjes nga gjykata, si dhe për të mos iu përgjigjur asnjë pyetjeje ose komenti lidhur me shkaqet e heshtjes.

Vlen të theksohet se, pavarësisht rëndësisë që i kushtohet të drejtës për të heshtur dhe privilegjit kundër vetëinkriminimit, dështimi i të akuzuarit për t'iu përgjigjur pyetjeve të prokurorisë, e cila ka evidenca të forta kundër tij, dhe mosdhënia e

evidencave, për të cilat mund të jetë në dijeni vetëm i akuzuari, përforcon dhe më tepër dyshimet e prokurorisë se shpjegimet vetëm mund të fajësojnë të akuzuarin.[415]

Jurispudencat e huaja mbi të drejtën për të heshtur dhe privilegjin kundër vetë-inkriminimit

Jurisprudenca amerikane

Në jurisprudencën amerikane e drejta për të heshtur mbrohet nga Kushtetuta, sipas të cilës: "asnjë person ... nuk do të detyrohet të dëshmojë kundër vetes së tij në çështjet penale".[416] E drejta për të heshtur dhe privilegji kundër vetëinkriminimit janë pjesë përbërëse të njëra - tjetrës.

Një ndër çështjet më të rëndësishme, në të cilat GJS e Shteteve të Bashkuara të Amerikës vendosi se e drejta e të akuzuarit për të heshtur ishte po aq e rëndësishme sa të drejtat e tjera, që garantoheshin e mbroheshin nga Kushtetuta, ishte çështja *Miranda v. Arizona*[417]. Çështja kishte të bënte me të akuzuarin Ernesto Miranda, i cili u arrestua më 13 Mars 1963 nga policia e Feniksit, mbi evidencën e kësaj policie, që e lidhte të akuzuarin me veprën penale të rrëmbimit dhe përdhunimit të një vajze 17 vjeçare. Pas marrjes në pyetje për dy orë nga policia, Miranda nënshkroi rrëfimin e tij për akuzën e përdhunimit. Forma e rrëfimit ishte shkrim i shtypur, në të cilin thuhej: "Betohem se bëj këtë deklaratë vullnetarisht, pa kërcënime, shtrëngime ose premtime imuniteti, me dije të plotë për të drejtat e mia, duke kuptuar se çdo deklaratë që bëj mund të përdoret kundër meje". Megjithatë, në asnjë moment, Miranda nuk u informua mbi të drejtën e tij për të marrë mbrojtës dhe as nuk u vu në dijeni mbi të drejtën e tij për të heshtur apo se deklaratat e dhëna mund të përdoreshin kundër tij gjatë marrjes në pyetje, para se t'i jepej për nënshkrim letra, përmes së cilës ai pranonte kryerjen e veprës penale.

Në gjykim, kur prokurorët kërkuan përdorimin e këtij rrëfimi si evidencë, mbrojtësi i Mirandës, i zgjedhur nga gjykata, kundërshtoi se, për shkak të këtyre fakteve, rrëfimi nuk kishte qenë tamam vullnetar dhe se duhej përjashtuar. Kundërshtimi i avokatit nuk u pranua nga gjykata. Bazuar në këtë rrëfim dhe evidenca të tjera, Miranda u u dënua për përdhunim dhe rrëmbim, me 20-30 vjet burgim për secilën akuzë. Mbrojtësi apeloi në Gjykatën Supreme të Arizonës, duke pretenduar përsëri se rrëfimi nuk kishte qenë tërësisht vullnetar dhe nuk duhej të ishte pranuar nga gjykata. Gjykata Supreme e

[415] I Dennis, *Codification and Reform of Evidence Law in Australia*. Criminal Law Review, (1996), 477.
[416] Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Amendamenti i 5të.
[417] *Miranda v. Arizona*, 384 U.S. 436 (1966).

Arizonës la në fuqi vendimin e gjykatës së parë për pranimin e rrëfimit.[418] Në vendimin e saj, Gjykata Supreme theksoi fort faktin se Miranda nuk kishte kërkuar specifikisht mbrojtës.

Në vendimin e saj, Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës hodhi poshtë vendimin e Gjykatës Supreme të Arizonës, duke u shprehur se, për shkak të vetë natyrës shtrënguese të marrjes në pyetje nga policia gjatë arrestit, dhe bazuar në parimin kundër vetëinkriminimit, të parashikuar në Amendamentin e Pestë i Kushtetutës amerikane, si dhe në parimin e të drejtës për mbrojtës, të parashikuar në Amendamentin e Gjashtë, rrëfimet nuk duhet të pranohen në gjykim, përveçse nëse i dyshuari është vënë në dijeni për të drejtat e tij dhe, me dijeni e vullnet të plotë, heq dorë nga këto të drejta.

Gjykata Supreme u shpreh, gjithashtu, se çdo person i ndaluar, para marrjes në pyetje, duhet të informohet qartë se ka të drejtën për të mos folur dhe se, çdo gjë që do të thotë, do të përdoret kundër tij në gjykim. Ai duhet të informohet, gjithashtu, se ka të drejtën të konsultohet me avokat, të kërkojë pjesëmarrjen e mbrojtësit gjatë marrjes në pyetje dhe se, nëse është në pamundësi financiare për të marrë mbrojtës privatisht, do t'i caktohet një mbrojtës kryesisht.

GJS bëri gjithashtu të qartë se, nëse individi shprehet, në çfarëdolloj mënyre, para ose gjatë marrjes në pyetje, se dëshiron të heshtë, marrja në pyetje duhet të pushojë. Nëse individi shprehet se kërkon mbrojtës, marrja në pyetje duhet të pushojë derisa të sigurohet prania e mbrojtësit. Në këtë moment i akuzuari ka të drejtë të këshillohet me mbrojtësin dhe ta ketë atë prezent gjatë marrjes në pyetje. Megjithatë, nëse marrja në pyetje vazhdon, shteti ngarkohet me një barrë të rëndë prove, atë të të provuarit se i akuzuari me dije dhe vullnet të plotë hoqi dorë nga privilegji kundër vetëinkriminimit.

Qëllimi i kësaj vendimmarrjeje të GJS ishte që të vendoste një balancë mes interesave të forcave policore për të pasur një rrëfim nga i akuzuari dhe të drejtës së këtij të fundit për të mos inkriminuar veten. Kjo balancë është e rëndësishme pasi i jep të akuzuarit mundësinë që të ushtrojë njëfarë kontrolli mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së marrjes në pyetje.

Privilegji kundër vetëinkriminimit zbatohet vetëm ndaj personave fizikë. Ai mund të ngrihet në gjykim si nga dëshmitari, ashtu dhe i akuzuari. Korporatat, shoqatat dhe entitete të tjera nuk mund të kërkojnë mbrojtjen e këtij privilegji, megjithatë një pronar i vetëm mundet.

E drejta për të heshtur cenohet nëse qeveria detyron një person, përmes dhunës fizike ose mendore, të japë evidencë ose të dëshmojë gojarisht apo me shkrim kundër vetes së tij.

[418] *State v. Miranda*, 401 P.2d 721 (Ariz. 1965).

Në çështjet penale privilegji kundër vetëinkriminimit mund të ngrihet gjatë gjithë procedimeve, formale ose informale, p.sh.: marrjes në pyetje nga policia, seancave administrative, gjykimeve, në rast se deklaratat që mund të jepen mund të përdoren për të inkriminuar personin që lëshon këto deklarata, në një çështje tjetër, që mund të ngrihet për këtë shkak.[419] Ky privilegj ekziston vetëm atëherë, kur për shkak të deklaratave inkriminuese, personi mund të ndiqet penalisht. Ky privilegj nuk mund të përdoret si mburojë kundër turpërimit personal, humbjes së punës ose kufizimeve të mundshme, që mund t'i vihen një personi, i cili ka kryer dënimin për një vepër penale të caktuar, psh. t'i qëndrojë larg personit që ka sulmuar.

Një person konsiderohet dëshmitar kundër vetes, nëse ai paraqet evidencë inkriminuese. Kjo evidencë mund të jepet përmes dëshmisë ose në mënyra të tjera komunikuese. Kjo evidencë konsiderohet e tillë nëse shpreh, direkt ose indirekt, pohim faktik të mendimeve të personit për kryerjen e një krimi.[420] Komunikimi mund të jetë verbal, psh. përmes pranimit gojarisht të kryerjes së veprës penale, ose jo verbal, psh. përmes pohimit me kokë ose gjesteve të tjera, që tregojnë mendime ose fakte.

Në disa rrethana, përgjigja e pasaktë ndaj një deklarate joinkriminuese, mund të konsiderohet si dëshmi. Në çështjen *Pennsylvania v. Muniz*,[421] që kishte të bënte me dhënie makinës në gjendje të pirë, GJS u shpreh se përgjigja e pasaktë e pyetjes së gjashtë që iu bë, lidhur me datëlindjen e të dyshuarit, konsiderohej dëshmi që mbështeste faktin se kapacitetet mendore të të akuzuarit ishin prekur.

Privilegji zbatohet ndaj evidencave të dokumentuara si dhe nëse dokumentet inkriminojnë vetë personin që ka krijuar këto evidenca. Duke qenë se privilegji kundër vetëinkriminimit është personal, nuk mund të kërkohet nga një palë e tretë (p.sh. llogaritari i të dyshuarit), e cila është e detyruar të japë dokumente që inkriminojnë dikë tjetër.

Privilegji kundër vetëinkriminimit nuk ndalon qeverinë të detyrojë një person të japë evidencë reale dhe fizike,[422] (psh. pranohet marrja e kampioneve të gjakut me qëllim testimi të alkoolit në gjak, pasi i akuzuari është arrestuar për drejtim automjeti në gjendje të dehur).

Në SHBA, nëse gjatë gjykimit të çështjes, një gjyqtar konsideron se një dëshmitar në një çështje penale, me të drejtë, ka kërkuar mbrojtjen që ofrohet nga parimi kundër vetëinkriminimit, organi i ndjekjes penale nuk mund të detyrojë dëshmitarin të dëshmojë për çështjen, përveçse nëse organi i ndjekjes penale arrin të marrë një urdhër imuniteti. Përmes tij, dëshmitarit i kërkohet të dëshmojë, duke i mundësuar atij po aq mbrojtje sa dhe vetë privilegji.

[419] *Lefkowitz v. Turley*, 414 U.S. 70 (1973).
[420] *Doe v. United States*, 487 U.S. 201 (1988).
[421] *Pennsylvania v. Muniz*, 496 U.S. 582 (1990).
[422] *Schmerber v. California*, 384 U.S. 757 (1966).

Privilegji kundër vetëinkriminimit zbatohet në situata, kur deklaratat e dhëna mund të përdoren në procedime penale. Si rrjedhojë, dëshmia, edhe nëse inkriminuese, mund të detyrohet në një sërë kontekstesh jo kriminale. Kështu, disa lloj dokumentesh detyrohen të jepen me ligj. Kështu, në çështjen *Shapiro v. United States*[423], GJS u shpreh për kushtetutshmërinë e rregullimeve federale të nxjerra në kuadër të Ligjit për Urgjencën në Kontrollin e Çmimeve, i cili u kërkonte disa bizneseve të liçensuara të mbanin të dhëna mbi aktivitetet e biznesit të tyre dhe t'ua vinin ato në dispozicion inspektorëve të qeverisë, kur këta të fundit i kërkonin. Në çështjen *California v. Byers*[424], GJS mbështeti statutin e shtetit të Californias i cili u kërkonte drejtuesve të automjeteve që, në rast aksidenti, të ndalonin në vendin e kryerjes së aksidentit dhe të raportonin emrin dhe adresën.

Gjatë zbatimit të privilegjit kundër vetëinkriminimit ngrihen disa pyetje. Kush përcakton nëse ky privilegj do të zbatohet ose jo? Ç'standarde duhen përdorur për të rregulluar mbrojtjen e këtij privilegji? Në çështjen *United States v. Burr*[425] gjyqtari Marshall deklaroi se, ishin gjykatat ato që do të përcaktonin nëse përgjigja ndaj një pyetjeje mund të inkriminonte dëshmitarin. Privilegji shtrihet, jo vetëm ndaj përgjigjeve që mund të inkriminojnë personin drejtpërsëdrejti, por, gjithashtu, ndaj përgjigjeve që mund të krijojnë lidhje me evidenca të tjera, të mjaftueshme për të mbështetur ndjekjen penale.

Jurisprudenca europiane

Pavarësisht se nuk përmendet shprehimisht në nenin 6 të KEDNJ, nuk ka asnjë dyshim se e drejta për të heshtur gjatë marrjes në pyetje nga policia dhe privilegji kundër vetëinkriminimit janë standarde ndërkombëtare të njohura, që qëndrojnë në themel të nocionit të gjykimit të drejtë, të parashikuar nga neni 6. Përmes mbrojtjes së të akuzuarit ndaj detyrimit ose shtrëngimit jo korrekt, që mund t'i ushtrohet nga ana e autoriteteve shtetërore, ky imunitet ka për qëllim shmangien e gabimeve të drejtësisë dhe sigurimin e qëllimit të nenit 6.[426]

GJEDNJ njeh dy forma të ndryshme mbrojtjeje të personit të akuzuar për vepër penale: të drejtën për të heshtur gjatë marrjes në pyetje si dhe të drejtën kundër vetë-inkriminimit. Të dy këto forma lidhen ngushtë si me parimin e prezumimit të pafajësisë, ashtu dhe me parimin se barra e provës bie mbi prokurorinë.

[423] *Shapiro v. United States*, 335 U.S. 1 (1948).
[424] *California v. Byers*, 402 U.S. 424 (1971).
[425] Dean s. Daskal, *Assertion of the Constitutional Privilege Against Self-Incrimination in Federal Civil Litigation: Rights and Remedies*, Marquette Law Review, Volume 64, Issue 2, Winter, (1980), 247.
[426] *John Murray v. UK*, (Application no. 18731/91), pp 45.

Në çështjen *Funke v. France*[427], shtëpia e kërkuesit u kontrollua nga oficerët e doganës së Strasburgut, të cilët po hetonin për vepra të mundshme penale të kryera në kundërshtim me Kodin Doganor francez. Ata konfiskuan të gjitha dokumentet e të akuzuarit, duke përfshirë dhe statementet-et e tij të bankës. Gjatë kërkimit oficerët doganorë i kërkuan kërkuesit të jepte stetementet-t e tjera të bankës si dhe dokumentet, që tregonin për investimet e tij. Ai refuzoi. Për shkak të refuzimit të kërkuesit për të bashkëpunuar, ndaj tij filloi ndjekja penale. Ai u gjobit për mosvënie në dispozicion organeve shtetërore të dokumenteve të kërkuara.

Në këtë çështje, GJEDNJ u shpreh se privilegji kundër vetëinkriminimit është pjesë implicite e nenit 6 të KEDNJ-së. Sipas kësaj Gjykate, e drejta kundër vetë-inkriminimit, në veçanti, presupozon që prokuroria, në një rast penal, duhet të provojë çështjen kundër të akuzuarit pa përdorimin e provave të marra nëpërmjet metodave shtrënguese ose shtypjes, apo në kundërshtim me vullnetin e të akuzuarit. Në këtë kuptim, kjo e drejtë është e lidhur ngushtë me prezumimin e pafajësisë të parashikuar në nenin 6, paragrafin 2 të Konventës.[428]

GJEDNJ nuk ndalet në përcaktimin e "masave shtrënguese". Është e rëndësishme që këto imunitete të jenë absolute, në kuptimin që ushtrimi nga një i akuzuar i të drejtës për të heshtur, në asnjë rrethanë, nuk mund të përdoret kundër tij në gjykim ose, informimi paraprakisht i të akuzuarit se, në rrethana të caktuara, heshtja do të përdoret kundër tij, konsiderohet si masë shtrënguese.

Nga njëra anë, është më se e qartë se, dënimi i personit bazuar vetëm në heshtjen e tij, është në kundërshtim me parimin e të drejtës për të heshtur. Megjithatë, nga ana tjetër, GJEDNJ e konsideron po aq të rëndësishme që kjo e drejtë nuk mund e nuk duhet të ndalojnë që heshtja e të akuzuarit, në situata të cilat kërkojnë shpjegim nga ana e tij, të merret në konsideratë në krijimin e bindjes për evidencat e paraqitura nga prokuroria.[429] Pra e drejta për të heshtur nuk është absolute. E drejta e të akuzuarit për të heshtur gjatë gjykimit penal ndikon në vendimin përfundimtar të çështjes, kur gjykata i konsideron të nevojshme përgjigjet e të akuzuarit në vlerësimin e evidencës kundër tij. Edhe vetë standardet ndërkombëtare në këtë fushë, gjatë parashikimit të së drejtës për të heshtur dhe privilegjin kundër vetëinkriminimit, heshtin në këtë drejtim.

Vlerësimi nëse nxjerrja e konkluzioneve, bazuar në heshtjen e të akuzuarit, shkel ose jo nenin 6 të KEDNJ-së duhet parë në tërësinë e rrethanave të çështjes, duke i kushtuar rëndësi të veçantë situatave që çojnë në nxjerrjen e konkluzioneve, rëndësisë që u jepet atyre gjatë vlerësimit të evidencës nga gjykatat kombëtare, si dhe nëse ndaj të

[427] *Funke v. France*, (Application no. 10828/84).
[428] *Saunders v. UK*, (Application no. 19187/91).
[429] Alistair Mowbray, *Cases and materials on the European Convention on human rights*, Oxford University Press [2007], 408.

akuzuarit janë përdorur masa shtrënguese për lëshimin e deklaratave ose pohimeve mbi veprën penale.[430]

Një sistem i drejtësisë penale që e paralajmëron të akuzuarin, i cili në fazën e marrjes në pyetje nuk ka mbrojtës, se në mungesë të dhënies së shpjegimeve mbi prezencën e tij në vendin e ngjarjes, do të nxirren konkluzione kundër tij, përbën një sistem i cili, në mënyrë indirekte, detyron e shtrëngon të akuzuarin të heqë dorë nga e drejta e tij për të heshtur. E njëjta gjë mund të thuhet nëse të akuzuarit i kërkohet të dëshmojë gjatë gjykimit të çështjes së tij.

Ajo çka është e rëndësishme të mbahet parasysh është se, përpara nxjerrjes së konkluzioneve mbi çështjen, i akuzuari duhet të jetë vënë në dijeni mbi efektet ligjore të heshtjes. Pyetja që shtrohet në çdo rast është nëse evidencat e mbledhura nga prokuroria janë aq të forta sa kërkojnë përgjigje. Gjykatat nuk duhet të arrijnë në përfundimin se i akuzuari është fajtor thjesht për faktin se ai hesht. Vetëm në rast se evidenca kundër të akuzuarit "kërkon" për shpjegime, të cilat i akuzuari duhet të jetë në gjendje t'i japë, mosdhënia e tyre, logjikisht, çon në nxjerrjen e konkluzioneve se nuk ka sqarime dhe se i akuzuari është fajtor.

Nëse argumentet e paraqitura nga prokuroria kanë vlerë evidenciale shumë të vogël, çka bën të panevojshme dhënien e përgjigjeve nga i akuzuari, nxjerrja e konkluzioneve për shkak të mosdhënieve të këtyre përgjigjeve, do të konsiderohet si e pajustifikueshme. Pra, konkluzionet që nxirren nga gjyqtarët e çështjes gjatë gjykimit të një vepre penale duhen parë duke marrë në konsideratë rëndësinë e evidencave të paraqitura kundër të akuzuarit nga organi i ndjekjes penale. Vetë i akuzuari duhet të jetë në gjendje të kuptojë paralajmërimet që i bëhen gjatë ndalimit ose arrestimit, si dhe të mos ketë dyshime për to.

Në çështjen *Saunder v. United Kingdom*[431], Z. Saunder ishte drejtor dhe shef ekzekutiv i Guiness Plc. Departamenti i tregtisë dhe Industrisë kreu një investigim, gjatë të cilit z. Saunders u mor në pyetje. Nëse z. Saunders do të refuzonte marrjen në pyetje, ai do të konsiderohej fajtor për këtë vepër penale, sipas Ligjit për Kompanitë të vitit 1985. Për më tepër, ky ligj parashikonte se përgjigjet e dhëna do të përdoreshin kundër tij. Transkripetet e intervistave të tij iu dhanë organeve të policisë dhe formuan pjesë të evidencës kundër tij në një procedim tjetër penal. Z. Saunder u dënua.

Para GJEDNJ, ai pretendoi se dënimi i tij ishte kryer në kundërshtim me të drejtën e tij për gjykim të drejtë, por nuk kundërshtoi cenimin e nenit 6 të KEDNJ për shkak të përdorimit të forcave shtrënguese për marrjen e informacionit. Ashtu siç kishte theksuar dhe më parë në çështjen *Fayed v United Kingdom*[432], GJEDNJ u shpreh se kryerja e

[430] ibid, 409, pp 47.
[431] ibid, *Saunder v. United Kingdom.*
[432] *Fayed v United Kingdom,* (Application no. 17101/90).

hetimeve nga inspektorët nuk përbënte në vetvete ngritjen e një akuze penale, megjithatë, përdorimi në gjykim penal i intervistave të z. Saunders, të dhëna në situata detyruese (mosdhënia përbënte vepër penale), përbënte cenim të së drejtës së tij për të mos inkriminuar veten.

GJEDNJ vendosi kufij të rëndësishëm në shtrirjen e këtij privilegji. Ajo u shpreh se: "E drejta për të mos inkriminuar veten ka të bëjë së pari ... me respektimin e dëshirës së një të akuzuari për të heshtur. Ashtu siç kuptohet gjerësisht nga shtete palë të Konventës dhe gjetkë, kjo e drejtë nuk shtrihet në përdorimin, gjatë procedimeve penale, të materialeve që mund të jenë marrë nga i akuzuari përmes përdorimit të forcës shtrënguese, pavarësisht dëshirës së të akuzuarit si, *inter alia*, marrja përmes një urdhri e dokumenteve, gjakut, kampionëve të urinës ose indeve trupore, me qëllim kryerjen e testimeve për ADN".

Pra, privilegji kundër inkriminimit përdoret për të parandaluar përdorimin në gjykim të materialeve të marra kundra dëshirës së të akuzuarit, siç ishte rasti i intervistave të z. Saunders. Çdo material tjetër i cili "ekziston pavarësisht nga dëshira e të akuzuarit", si: marrja e kampionëve të urinës, gjakut, indeve trupore, etj.[433], bie jashtë qëllimit të këtij parimi.

Jurisprudenca shqiptare

Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe në referim të asaj GJEDNJ, garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së gjejnë zbatim edhe në fazën që i paraprin procesit gjyqësor, pra në atë të hetimeve paraprake.

Ligjet kombëtare parashikojnë pasoja të veçanta për sjelljen e një të akuzuari në fazat e marrjes në pyetje nga policia, të cilat janë vendimtare për perspektivën e mbrojtjes në çdo procedim penal pasues. Në të tilla kushte, neni 6 i KEDNJ normalisht kërkon që i akuzuari të përfitojë nga asistenca e mbrojtësit që në fazën e marrjes në pyetje. Këto parime janë në përputhje edhe me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të pranuara përgjithësisht, të cilat qëndrojnë në themel të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe logjika e të cilave lidhet veçanërisht me mbrojtjen e të akuzuarit nga presioni që ushtrojnë autoritetet në mënyrë abuzive. Ato, gjithashtu, kontribuojnë në parandalimin e keqadministrimit të drejtësisë dhe përmbushjen e qëllimeve të nenit 6, veçanërisht, barazia e armëve midis autoriteteve hetimore ose proceduese dhe të akuzuarit.

I akuzuari, në fazën e hetimeve paraprake, shpesh, e gjen veten në një pozicion të pambrojtur, efekti i të cilit shtohet nga fakti se legjislacioni i procedurës penale tenton të bëhet shumë kompleks, veçanërisht për sa i përket rregullave të mbledhjes dhe përdorimit

[433] ibid (n 428), pp 69.

të provave. Në të shumtën e rasteve, kjo pozitë e dobët e të akuzuarit mund të kompensohet në mënyrën e duhur përmes asistencës së një mbrojtësi, detyra e të cilit është, përveç të tjerash, të sigurojë respektimin e të drejtës së të akuzuarin për të mos inkriminuar veten. Kjo e drejtë presupozon që prokuroria në një çështje penale të mos përdorë prova të marra përmes metodave të detyrimit apo të shtypjes në kundërshtim me vullnetin e të akuzuarit. Këto parime kërkohen veçanërisht në rastet e dënimeve të rënda, pasi janë pikërisht këto raste ku respekti i të drejtës për një proces të rregullt ligjor duhet të sigurohet në shkallën më të lartë të mundur nga shoqëritë demokratike.[434]

[434] Vendim nr. 44, datë 11.04.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.

KAPITULLI VIII

PARIMI N*E BIS IN IDEM* DHE RËNDËSIA E TIJ NË ÇËSHTJET PENALE

Një ndër parimet e rëndësishme të së drejtës penale është dhe parimi i *non* ose *ne bis in idem*. Ky parim është një instrument kryesor juridik, një garanci thelbësore e individit, e përfshirë në dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut,[435] i cili rregullon marrëdhëniet në fushën penale të brendshme dhe atë ndërkombëtare. Ky parim nënkupton se asnjë individ nuk mund të gjykohet apo dënohet përsëri për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është shpallur i pafajshëm ose është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e ligjshme. Nga pikëpamja funksionale, qëllimi i këtij parimi është krijimi i një stabiliteti juridik, i fokusuar tek besimi i individit se pushteti gjyqësor nuk do të ushtrohet në mënyrë arbitrare.

Në nivel ndërkombëtar ky parim gjen pasqyrim në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP)[436], në Protokollin 7 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)[437], Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian (KDTHBE)[438], Konventën Amerikane për të Drejtat e Njeriut (KADNJ)[439], Konventa për Implementimin e Marrëveshjes Shengen (KIMSH),[440] etj. Në nivel kombëtar,

[435] Shih nenin 4, Protokolli 7 të KEDNJ; nenin 14, § 7 të Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike; nenin 50 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian.

[436] Neni 14/7 i KNDCP, i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, Res. 2200 A (XXI), 16 Dhjetor 1966, hyrë në fuqi më 23 Mars 1976: "Askush nuk mund të ndiqet ose të ndëshkohet për një vepër për të cilën ai është dënuar ose shfajësuar një herë në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të çdo vendi" .

[437] Neni 4 i Protokollit 7 i KEDNJ-së, ndryshuar sipas Protokollit 11, miratuar në Strasburg më 22 Nëntor 1984, hyrë në fuqi më 1 Nëntor 1988: "Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksionet e të njëjtit Shtet për një vepër për të cilën ai më parë ka qenë deklaruar i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të këtij Shteti. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit në fjalë, në rast se fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, ose një mangësi themelore në procedurën e mëparshme janë të një natyre të tillë, që mund të cenojnë vendimin e dhënë".

[438] Neni 50 i KDTHBE: "Askush nuk do të gjykohet ose ndëshkohet për një vepër penale për të cilën ai është konsideruar i pafajshëm ose është dënuar me vendim të formës së prerë, brenda Bashkimit, në përputhje me ligjin".

[439] Neni 8/4 i Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut, miratuar në San José më 22 Nëntor 1969, hyrë në fuqi më 18 Korrik 1978. Ky parim gjendet në Kapitullin e Dytë, dedikuar të drejtave civile dhe politike: "Një person i akuzuar, i shpallur i pafajshëm me vendim të formës së prerë, nuk mund t'i nënshtrohet një gjykimi të ri, për të njëjtën çështje".

[440] Neni 54 i Konventës për Implementimin e Marrëveshjes Shengen: "Një person, gjykimi ndaj të cilit ka përfunduar në një nga Shtetet Kontraktuese, nuk mund të ndiqet penalisht në një Shtet tjetër Kontraktues, për të njëjtën vepër, nëse ndaj tij është vendosur gjobë, është zbatuar, është në proces zbatimi ose nuk mund të zbatohet, sipas ligjeve të Shtetit Kontraktues që ka dënuar këtë person".

sanksionohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se, askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj.[441]

Ky parim përbën një mekanizëm mbrojtës të të drejtave të njeriut në sistemet ligjore të shumicës së shteteve. Në vendet e traditës *common law* njihet si *double jeopardy* ose *autrefois acquit (i shfajësuar më parë), autrefois convict (i dënuar më parë)*. Ky parim gjendet dhe në formën e *res judicata pro veritate habitur* e njohur në traditën franceze si *autorité de chose jugée (autoritet i gjësë së gjykuar)* dhe në atë gjermane si *erledigungsprinzip* dhe *Anrechnungprinzip*.

Vlerësimi mbi cenimin ose jo të parimit *ne bis in idem* lidhet me plotësimin e dy kritereve, që janë: a) ekzistenca e së njëjtës vepër penale; b) ekzistenca e një vendimi pafajësie apo dënimi të formës së prerë që përbën *res judicata*.

Ne bis in idem, në vetvete ka disa qëllime. Së pari, të pengojë shtetin të përndjekë penalisht një person për të dytën herë për një krim për të cilin ai është gjykuar dhe shpallur i pafajshëm. Së dyti, pengon shtetin të përndjekë një person për të dytën herë për një veprim për të cilin ai është dënuar, dhe së treti, ka për qëllim të pengojë shtetin të ndëshkojë disa herë një person, për të njëjtën vepër e të njëjtat fakte, në procedime të ndryshme.[442] Ai konsiderohet si një e drejtë e individit, garanci që i ofrohet të akuzuarit, përmes garantimit të lirisë personale brenda kufijve territorialë kombëtarë, mbron të akuzuarin nga abuzimet e mundshme të *ius puniendi* të shtetit, duke shmangur mundësinë që individi të jetë subjekt i ndjekjeve të vazhdueshme në lidhje me të njëjtin veprim, të njëjtat fakte e të njëjtën vepër penale, e për rrjedhojë, konsiderohet pjesë e rëndësishme e procesit të rregullt ligjor. Ky parim ka gjithashtu për qëllim të garantojë respektin për gjykatën dhe mbrojtjen e sigurisë juridike, duke përcaktuar se vendimi i gjykatës është përfundimtar.[443]

Historikisht ai është konsideruar si parim, i cili zbatohet vetëm brenda territorit të një shteti dhe vetëm në çështjet penale. Zbatimi i tij nuk nënkupton se çështjet nuk mund të rihapen në favor të personit të dënuar dhe as se një person, që i nënshtrohet një procedimi penal, nuk mund t'i nënshtrohet një procedure tjetër, siç mund të jetë ajo civile, për kompensim.[444]

---

[441] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 34.
[442] David S. Rudstein, A *brief history of the fifth amendment guarantee against double jeopardy*, William & Mary Bill of Rights Journal, (2005), Volume 14, Issue I, 193-94.
[443] B. van Bockel, *The ne bis in idem principle in EU law, A conceptual and jurisprudential analysis*, Ipskamp Drukkers, Amsterdam (2005), 28.
[444] Clare Ovey, Robin C. A. White, *European Convention Human Rights*, Oxford University Press 3rd Edition, (2006), 195-196.

Historia e *ne bis in idem*

Parimi *ne bis in idem* është një parim shumë i rëndësishëm, i cili ka për qëllim mosndjekjen e të akuzuarit disa herë për të njëjtën vepër penale. Ky parim ka një histori të lashtë dhe shfaqet në sistemet ligjore në forma të ndryshme. Referenca më e lashtë që i është bërë këtij parimi daton rreth viteve 355 Para Erës Sonë., kur Demosteni, orator grek dhe folës në gjykatat e ligjit, është shprehur, në një fjalim kundër Leptinit, se "ligji ndalonte dënimin dy herë të të njëjtit person, për të njëjtën çështje". Në Republikën Romake, shfajësimi i të akuzuarit nga një magjistrat, ndalonte çdo lloj procedure të mëtejshme kundër tij. Iulius Paulus, jurist romak me zë i fundit të shekullit të tretë, është shprehur se "pas shfajësimit publik, një i akuzuar mund të ndiqej përsëri penalisht brenda 30 ditësh, por pas kalimit të këtij afati, një gjë e tillë nuk mund të bëhej". Doracaku i Justinianit, një përmbledhje shkrimesh juridike për legjislacionin romak të atëhershëm, i përpiluar nga perandori bizantin Justiniani I dhe i publikuar në vitin 533, parashikonte se "guvernatori nuk duhet të lejonte një njeri të akuzohej për të njëjtën vepër, për të cilën ai ishte shfajësuar" dhe se "një person nuk mund të akuzohej për të njëjtin krim nga statute/ligje të ndryshme". Legjislacioni romak përmbante parimin *nemo debet bis puniri pro uno delicto*, sipas të cilit askush nuk mund të dënohej dy herë për të njëjtën vepër penale.

Në vendet e *common law* ky parim njihet si "rrezik/dënim i dyfishtë"[445] dhe mendohet se ky parim është po aq i lashtë sa dhe vetë *common law*.[446] Ai u shfaq dukshëm gjatë luftës mes Mbretit Henri II dhe St. Thomas Beckett në shekullin 12 Pas Erës Sonë. Mbreti Henri miratoi një sërë procedurash legjislative, të ashtuquajtura Kushtetuta e Klaredon-it, të cilat, ndërmjet të tjerash, lejonin ish klerikët e dënuar para gjykatave të kishës, të gjykoheshin e dënoheshin dhe nga gjykatat e zakonshme. Sistemi inkuizitor i gjykimit, i cili kishte për qëllim kryesor "zbulimin e gjithë të vërtetës", u fut në Europë në fund të shekullit të 12. Barra e rëndë e të provuarit të të gjithë së vërtetës bëri që të shtyhej në pafundësi dhënia e vendimeve përfundimtare. Kjo gjendje, shpesh herë, shoqërohej me masa shtrënguese, të vendosura ndaj subjekteve për një kohëzgjatje të pacaktuar. Zbatimi i këtyre masave gjeti zbatim të madh në Europë deri në mesin e shekullit të 18, çka çoi dhe në protesta të shumta. Kërkesat që procedurat gjyqësore të kishin një fund dhe ndalimi i organeve të ndjekjes penale që të hapnin procedurat, pasi të ishte marrë vendim për çështjen, përbënë disa nga idetë kryesore të Revolucionit Francez. Si rrjedhojë, në shumicën e juridiksioneve në Europë, ndryshimi i rregullave, që rregullonin marrëdhëniet mes shtetit dhe qytetarëve të tij, i dha shtysë përdorimit të parimit *ne bis in idem* duke ngritur rëndësinë e këtij parimi në nivel ligjor e kushtetues.[447]

[445] Termi i përdorur në vendet e *common law* për këtë parim është "double jeopardy".
[446] Bas van Bockel, *Two perspectives on the realization of the European ne bis in idem principle*, <http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2071312>, aksesuar 29 Maj 2013; David S. Rudstein, A *brief history of the fifth amendment guarantee against double jeopardy*, William & Mary Bill of Rights Journal, (2005), Volume 14, Issue I, 198.
[447] ibid

Në vendet e traditës *common law,* zakonisht, bëhet dallim mes rolit të këtij parimi si një e drejtë e individit, me funksionin e tij si garanci për rolin përfundimtar të vendimeve gjyqësore. Sipas kuptimit të parë, ky parim mbron individët nga abuzimet e mundshme të pushtetit të shtetit. Sipas kuptimit të dytë, parimi mbron autoritetin e gjykimit në tërësi, përmes dhënies së një vendimi përfundimtar. Pra, *racionale* e këtij parimi përputhet me funksionin kryesor të drejtësisë penale: mbrojtjen e individit dhe garantimin e rendit ligjor.

Megjithëse me kalimin e kohës ka pasur dallime në interpretimin e këtij parimi, *ne bis in idem*, përgjithësisht, përfshin dy elementë thelbësorë: *bis* dhe *idem*.

Elementi *bis* i referohet pyetjes se kur mund të konsiderohet që një person është gjykuar dy herë. Në këtë rast kemi të bëjmë me procedura të cilat kanë përfunduar dhe për të cilat është dhënë një vendim *(res judicata).* Një vendim gjyqësor është përfundimtar kur është i parevokueshëm, çka nënkupton se, sipas legjislacionit vendas, individi i ka shteruar të gjitha mjetet e vëna në dispozicion për vendosjen në vend të së drejtës që pretendon se i është shkelur, ose kur afati për riparimin e shkeljeve ka përfunduar.

Sa i përket elementit *idem* ka dy trajtime të pyetjes se kur kemi të bëjmë me "të njëjtin" veprim. Trajtimi i parë i referohet veprimit/faktit të kryer, ndërsa i dyti cilësimit ligjor të tij. Dallimi mes trajtimit "faktik" dhe atij "ligjor" për përcaktimin e *idem*-it është tërësisht hipotetik. Lidhur me përcaktimin të kuptimit të saktë të këtyre nocioneve, në aktet ndërkombëtare, ka pasur interpretime të shumta.[448]

Kështu, interpretimi i nocionit "të njëjtat veprime", i parashikuar në nenin 54 të Konventës për Implementimin e Marrëveshjes Shengen i referohet vetëm natyrës së veprimeve dhe jo klasifikimit ligjor të tyre. Nocioni "vepër penale" i parashikuar në nenin 4 të Protokollit 7 të KEDNJ, nënkupton se kriteri i klasifikimit ligjor të veprimit si "penal" është kusht i domosdoshëm për zbatimin e *ne bis in idem*.[449]

Forma dhe substanca e parimit. Origjina e tij në ligjin romak

Pavarësisht ndryshimeve që mund të ekzistojnë ndërmjet shteteve të ndryshme përsa i përket *ne bis in idem* origjina e këtij parimi rrjedh nga ligji romak. Shprehja e plotë është "*bis de eadem re ne sit actio*" që rrjedh nga legjislacioni romak civil, megjithatë gjendet dhe në formën e një shprehjeje tjetër "*bis de eadem re agree non*

[448] John A.E.Vervaele, *The transnational ne bis in idem principle in the EU, Mutual recognition and equivalent protecyio of human rights,* Utrecht Law Review (2005).
[449] *Sergey Zolotukhin v. Russia,* (Application no 14939/03).

licet", e cila rrjedh nga legjislacioni i të drejtës romake private. Shprehja më e përdorur në Europën kontinentale është *"ne (ose: non) bis in idem"*. [450]

Ajo çka duhet pasur parasysh është dallimi ndërmjet ndjekjes penalisht dy herë për të njëjtën vepër dhe ndëshkimit dy herë për të njëjtën vepër. Ndërsa e para ka natyrë procedurale, e dyta ka natyrë substanciale. Shprehjet "*nemo debet bis vexari*", "*bis de eadem re ne sit actio*", dhe shkurtimi "*ne bis in idem*" të gjitha mund të shihen si shprehje të ndalimit të përndjekjes penale dy herë për të njëjtën vepër, çka do të thotë se ndjekja penale, që fillon për shkak të një veprimi penal, është "konsumuar" ose "përdorur" me fillimin e procedurave të para të ndjekjes penale. Si rrjedhojë, një përndjekje e dytë do të ishte e papranueshme, megjithatë, në legjislacionet kombëtare ekzistojnë disa përjashtime, si p.sh. në rast të evidencave të reja, një gjykimi të pavlefshëm ose gabimeve të tjera gjatë procedurave të shqyrtimit të çështjes së parë. *Ne bis in idem* ndalon çdo lloj procedurash nëse vendimi për çështjen e parë ka marrë formë të prerë. Ai nuk përjashton, në parim, dhënien e dënimeve të ndryshme ndaj personit për veprimin e kryer, për aq kohë sa këto dënime jepen në kuadër të të njëjtit procedim. Në këtë mënyrë, ky parim respekton *res iudicata (pro veritate habitur)* përmes garantimit të formës së prerë të gjykimit të parë, çka çon rrjedhimisht në papranueshmërinë e gjykimit të dytë.

Nemo debet bis puniri pro uno (delicto) ndalon dënimin e dyfishtë. Ky parim është i ndryshëm në sisteme të ndryshme ligjore. Në shumicën e vendeve ai nuk përjashton mundësinë e një dënimi të dytë, nëse një veprim i vetëm ose disa veprime përbëjnë disa vepra penale. Ai nënkupton vetëm se, dënimit të përgjithshëm për veprat e kryera duhet t'i hiqet dënimi i dhënë, çka do të thotë se ndaj individit zbatohet vetëm dënimi më i rëndë i dhënë.

Shumë autorë kanë pasur mendime të ndryshme nëse *ne bis in idem* do të mbrojë individin kundër përndjekjes dy herë për të njëjtën vepër penale, apo ndaj dënimit të dy herë për të njëjtën vepër. Kështu p.sh., sipas Schomburg, në referim të *ne bis in idem*, konceptet për mbrojtjen kundër përndjekjes dy herë për të njëjtën vepër dhe kundër dënimit dy herë për të njëjtën vepër janë përdorur, në praktikë, si njëri ashtu dhe tjetri. Wils vëren se *ne bis in idem* konsiston si në mbrojtjen kundër dënimit të dyfishtë, ashtu dhe kundër përndjekjes së dyfishtë,[451] ndërsa Fletcher thekson më shumë problemin e përndjekjeve të shumëfishta se sa atë të dënimeve të shumëfishta.

Neni 4 i Protokollit 7 të KEDNJ shprehet se "askush nuk mund të gjykohet ose ndëshkohet" dy herë për të njëjtën vepër, por nuk shprehet nëse ky nen zbatohet dhe në rastet e ndjekjes penale më shumë se një herë për të njëjtën vepër. Ajo që duhet pasur parasysh është se neni 4 i Protokollit 7 është hartuar duke pasur parasysh sistemet e ndryshme penale të shteteve të ndryshme. Në secilin sistem *ne bis in idem* ekziston të

[450] Willem Bastiaan van Bockel, *The ne bis in idem principle in EU law - A conceptual and jurisprudential analysis, Kluwer Law International Publishing* (2010), 33.
[451] idid 37.

paktën në njërën nga format: mos ndjekje penalisht ose mos dënim dy herë për të njëjtën vepër. Si rrjedhojë, kuptohet qartësisht se hartuesit e Konventës janë përpjekur të krijojnë një standard minimal, që përfshin të dy këto parime, pa krijuar detyrim të drejtpërdrejtë për shtetet anëtare për të ndryshuar, për këtë qëllim, sistemin e tyre të brendshëm penal dhe të procedurës penale.

Ne bis in idem v. Res judicata

Rationale e parimit *ne bis in idem*

Në sisteme të ndryshme ligjore, parimi i *ne bis in idem* trajtohet në mënyra të ndryshme, çka çon në dallime në mënyrën e interpretimit të këtij parimi. Këto dallime përbëjnë problem kryesor kur bëhet fjalë për zbatimin e tij në nivel ndërkombëtar, kjo për shkak të natyrës së veprës si dhe mungesës së një përcaktimi ndërkombëtar të saj.

Ne bis in idem, në vetvete, përfshin parime të rëndësishme si: lirinë individuale, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mbrojtjen e individit nga abuzimet e pushtetit, drejtësinë, proporcionalitetin, shtetin e së drejtës, sigurinë juridike, procesin e rregullt ligjor, respektin për *res judicata*, efiçencën procedurale, interesin e shoqërisë për paqe dhe drejtësi.[452]

Ky parim përbën jo vetëm një të drejtë të individit, por njëkohësisht garanci për ruajtjen e sigurisë juridike, përmes garantimit të zbatimit të vendimeve të formës së prerë. Si një e drejtë e individit, ky parim mbron shtetasit nga abuzimet e mundshme të *ius puniendi* të shtetit. Në rolin e tij si garanci për ruajtjen e sigurisë juridike, ai ka për qëllim të garantojë autoritetin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Neni 4 i Protokollit 7 të KEDNJ nuk e trajton këtë parim si aspekt ose element të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, por e parashikon atë si garanci më vete. Kështu, në çështjen *Ponsetti and Chensel v. France*,[453] GJEDNJ theksoi se parimi *ne bis in idem* gjendet i shprehur vetëm në nenin 4 të Protokollit 7, parashikimet e tjera të Konventës nuk përcaktojnë, as në mënyrë të shprehur e as të nënkuptuar, garantimin e tij.

Ne bis in idem ka për qëllim të mbrojë shoqërinë e, si rrjedhojë, ekziston një lidhje mes tij dhe ligjshmërisë, çka nënkupton se një individ nuk mund të përndiqet ose dënohet penalisht nëse nuk ekziston një parashikim ligjor penal për veprën. *Ne bis in idem* ka lidhje njëkohësisht dhe me shtetin e së drejtës, sipas të cilit shteti, i cili ka iniciuar procedim penal ndaj një individi, duhet të respektojë vendimin e dhënë në përfundim të procedurave.

[452] ibid *The ne bis in idem principle in EU law - A conceptual and jurisprudential analysis*, 29.
[453] *Ponsetti and Chensel v. France*, (Applications nos. 36855/97 and 41731/98).

Ndonjëherë ky parim konsiderohet si sanksion ndaj autoriteteve për neglizhencë gjatë gjykimit të parë, çka nënkupton se ky parim kërkon zbatimin me efikasitet të ligjit, pasi autoritetet shtetërore kanë vetëm një shans. Nëse ata e humbasin këtë shans kjo shkon në favor të të akuzuarit.

Në jurisprudencën e saj GJEDNJ ka konstatuar, shpesh herë, cenim të *ne bis in idem* në rastet e vendosjes së sanksioneve të dyfishta për të njëjtën vepër, p.sh. sanksione administrative dhe penale. Kjo Gjykatë ka konstatuar se pavarësisht përcaktimit, në legjislacionin vendas, të një sanksioni si administrativ, në thelb sanksione të tilla kanë pasur karakter ndëshkues penal. Për këtë qëllim, në përcaktimin e një veprimi si "penal" GJEDNJ ka vendosur disa kritere të rëndësishme:[454]

- *klasifikimi i veprës penale sipas sistemit ligjor vendas,*
- *lloji/karakteri i veprës penale,*
- *shkalla e ashpërsisë së dënimit.*

Kriteri i dytë dhe i tretë janë kritere alternative dhe jo domosdoshmërish kumulative, megjithatë nuk përjashtohet mundësia e një përqasjeje kumulative, kur analizimi i secilit kriter më vete bën të pamundur arritjen në një përfundim për pasjen ose jo të një akuze penale. Një përcaktim i tillë i GJEDNJ luan një rol të rëndësishëm për të parë nëse ka pasur ose jo shkelje të *ne bis in idem* nga ana e Shteteve. Kështu, GJEDNJ është shprehur se, pavarësisht klasifikimit të veprës në legjislacionin vendas (p.sh. sanksioni "mbipagesë takse" i vendosur për veprime që përbëjnë evazion fiskal, si p.sh. mosdeklarim të ardhurash, të cilat mund të mos konsiderohen si sanksione penale nga legjislacioni vendas), një rëndësi e veçantë i kushtohet karakterit të veprës penale dhe faktit nëse masa e marrë nga shteti, ndaj veprimeve të paligjshme, ka qëllim ndëshkues.

Krahas kësaj, GJEDNJ, pas përqasjeve të ndryshme lidhur me atë se ç'duhet kuptuar me "vepër të njëjtë", në çështjen *Zolotukhin v Russia,* u shpreh se përqasja e saj e mëparshme lidhur me klasifikimin ligjor të dy veprimeve të paligjshme ishte shumë e ngushtë. Nëse Gjykata do të kufizohej vetëm në përcaktimin ligjor të veprës, garancitë e parashikuara në nenin 4 të Protokollit 7 të KEDNJ, në vend që të ishin praktike dhe efektive, rrezikohej të cenoheshin. Neni 4 i Protokollit 7 duhej kuptuar se ndalonte përndjekjen ose gjykimin për një "vepër" të dytë, për aq kohë sa kjo vepër rridhte nga të njëjtat fakte ose fakte substancialisht të njëjta. Për rrjedhojë, është e rëndësishme të fokusohet në ato fakte, të cilat përbëjnë një tërësi rrethanash konkrete faktike, që përfshijnë të njëjtin të akuzuar, dhe të lidhura pandashmërisht së bashku në kohë e hapësirë, ekzistenca e të cilave duhet provuar, me qëllim që të iniciohet procedimi penal ose të sigurohet një dënim penal për veprën. [455]

[454] *Engels and others v. The Netherlands,* (Application no. 5100/71; 5101/71; 5102/71; 5354/72; 5370/72); *Häkkä v Finland* (Application no. 758/11), pp 38.
[455] ibid, *Häkkä v Finland,* pp 41.

Elementët e *ne bis in idem*

Përgjigja e pyetjes se kush mund të mbështetet në parimin *ne bis in idem* është e thjeshtë: vetë ai që ka qenë subjekt i një ndjekjeje penale të mëparshme (dhe i cili është shpallur i pafajshëm apo është dënuar, ose gjykimi i të cilit është pushuar sipas në një mënyrë ose tjetër).[456] Përcaktimi i saktë ligjor i dallimit mes gjykimit të parë dhe të dytë, të bazuar në të njëjtat fakte, ngre dy pyetje të rëndësishme: kur kemi të bëjmë me gjykim të dytë dhe kur kemi të bëjmë me të njëjtat fakte? Këto dy pyetje korrespondojnë me dy elementët e *ne bis in idem*: *bis* dhe *idem*. Pavarësisht se të dy këto elementë ngrenë, në rang ndërkombëtar, një sërë pyetjesh, problemet me të mëdha ngrihen kur përpiqemi t'i japim përgjigje pyetjes së dytë.

Gjykimi i parë: *bis*.

Shteti i së drejtës parashikon që, shteti, i cili ka iniciuar procedim kundër një prej shtetasve të tij, duhet të respektojë rezultatin përfundimtar të gjykimit. Në këtë mënyrë *ne bis in idem* garanton respektin për *res iudicata*. Ndalimi i një përndjekjeje të dytë *(bis)* kërkon që procedimi për çështjen e parë të ketë përfunduar me një vendim të formës së prerë *(res iudicata)*. Një vendim gjyqësor është përfundimtar kur nuk ka më mjete ankimi kundër këtij vendimi. Pamundësia e ankimimit mund të vijë për disa shkaqe: kur nuk parashikohet me ligj; kur janë ezauruar të gjitha mjetet e ankimit; kur kanë kaluar afatet kohore për të apeluar; kur ankimi është tërhequr nga pala; ose kur personi vetë, me dëshirën e tij, ka hequr dorë nga e drejta për ankim.[457]

Në shumicën e shteteve *ne bis in idem* përdoret ekskluzivisht vetëm në çështjet penale. Vetëm vendimet e formës së prerë të një gjykate penale konsiderohen përfundimtare dhe se sjellin efekte *ne bis in idem*. Pavarësisht pamundësisë për ta ankimuar, vendimi i formës së prerë presupozon se gjykata ka arritur në një konkluzion për meritat/themelin e çështjes. Vendimet paraprake, zakonisht, nuk ndalojnë kryerjen e

[456] ibid *The ne bis in idem principle in EU law - A conceptual and jurisprudential analysis*, 43.

[457] idid 46. Edhe pse jo një çështje vendimtare, çështje *Gutmann v Commission* (*EAEC* [1966] ECR 103) e Gjykatës Europiane të Drejtësisë ishte çështja e parë e shqyrtuar nga kjo Gjykatë që trajtoi parimin e *ne bis in idem*. Z. Gutmann, një zyrtar Komunitetit Europian për Energjinë Atomike (EAEC) ishte akuzuar për ngarkimin në kurriz të Komunitetit të shpenzimeve personale për rregullim të një aparati fotografik që i përkiste atij si dhe për kryerjen e telefonatave personale përmes përdorimit të telefonave të punës. Vendimi i arritur për çështjen në ngarkim të Gutmann përfundoi me qortim dhe, si rrjedhojë, hetimet për çështjen përfunduan. Pas disa kohësh, në ngarkim të Gutmann u iniciuan hetime të reja, me pretendimin se ishin zbuluar parregullsi të reja dhe mbi bazën e një ankimi të paraqitur nga drejtuesi i departamentit, por pa specifikuar nëse këto përbënin fakte të reja. Në vendimin e saj GJED u shpreh se, nga dosja që i ishte paraqitur asaj nga Komisioni, nuk rezultonte qartë se mbi ç'baza ishte mbështetur procedimi i parë dhe i kërkoi Komisionit të paraqiste dosjen e plotë. Në përfundim, GJED u shpreh se nuk kishte të dhëna se dy hetimet mbështeteshin në veprime të ndryshme e, si rrjedhojë, hetimi i dytë për çështjen ishte i pajustifikueshëm.

procedurave të mëtejshme të ndjekjes penale. Sipas disa autorëve, vendimi i një gjykate se një vepër penale është parashkruar, në vetvete, përbën një vendim për veprën penale, e si rrjedhojë, ka efekt *ne bis in idem*.[458] Por, një vendim i një gjykate sipas të cilit ndjekja penale është parashkruar, në thelb, ka natyrë paraprake, pasi për këtë shkak akuzat nuk do të merren fare në konsideratë nga gjykata. Si rrjedhojë, një vendim i tillë nuk duhet konsideruar i njëjtë me një vendim mbi meritat/themelin e çështjes.

Një pyetje e rëndësishme është nëse një vendim i prokurorit për të mos ndjekur penalisht sjell efekte *ne bis in idem*. Në terma të përgjithshëm, këto vendime nuk janë përfundimtare. Megjithatë, ujditë, ndërmjetësimet, marrëveshjet e subjektit me prokurorinë jashtë gjykatës, si dhe mënyrat e tjera për ndërprerjen e ndjekjes penale, zakonisht, sjellin si pasojë heqjen e akuzës penale në ngarkim të subjektit, në kuptimin se prokuroria nuk mund të rifillojë ndjekjen penale nëse janë përmbushur kushtet e marrëveshjes. Në çështjen *Gözütok and Brügge*,[459] Gjykata Europiane e Drejtësisë u shpreh se, në rastet e një marrëveshjeje jashtë gjykate, "ndjekja e mëtejshme penale është e ndaluar, çështja e personit ndaj të cilit ekzistonte një akuzë penale duhet konsideruar e njëjtë me të një personi çështja penale ndaj të cilit ka përfunduar", për qëllimet e nenit 54 të Konventës për Implementimin e Marrëveshjes Shengen. Po për qëllimet e këtij neni, në momentin që i akuzuari ka përmbushur detyrimet e tij, dënimi i parashikuar duhet të konsiderohet si i dhënë.[460]

Ndjekja penale mund të pezullohet ose pushohet për shumë arsye të tjera si: për shkak të nxjerrjes së ligjeve të reja, të ndryshimit të jurisprudencës kushtetuese ose të gjykatave të larta, të debateve publike, ose nxitjeve sociale. Njëlloj si në vendimet paraprake, pezullimi i ndjekjes penale nuk çon në zbatimin e *ne bis in idem*.[461]

Gjykimi i dytë: *idem*

Ndalimi i përndjekjes penale dy herë për të njëjtën vepër mbron individin nga ndjekjet e tjera penale që bazohen në të njëjtat fakte (*idem*) si ato të procedimit të parë. Për të përcaktuar nëse ndjekja e dytë penale mbështetet në të njëjtat fakte si ajo e parë ka dy mënyra: 1) duke iu referuar "veprimit" të kryer dhe 2) duke iu referuar cilësimit të tij ligjor ("veprës penale") në të dy (ose më shumë) rastet e ndjekjes penale të individit. Interpretimi i ngushtë i të njëjtave fakte, bazuar në cilësimin e tyre ligjor (veprën penale) do të cenonte mbrojtjen e këtij parimi. Garantimi për mos përndjekje dy herë për të njëjtën vepër penale do të mund të anashkalohej përmes përndjekjes penalisht për një

[458] Vander Beken, T., Vermeulen, G., Ongena, T., *'Concurrent National and International Criminal Jurisdiction and the 'Principle ne bis in idem' in Belgium'*, Revue Internationale de Droit Penale (2004), 813.
[459] *Gözütok and Brügge* [2003] ECR I-1345.
[460] Pavarësisht se i akuzuari mund të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor.
[461] *Smirnova and Smirnova v. Russia* (Appl. Nos. 46133/99 and 48183/99).

tjetër akuzë (të ngjashme me të parën), nëse do i referoheshim cilësimit ligjor të fakteve.[462]

Një arsye tjetër e rëndësishme pse i vihet theksi më shumë veprimit të kryer, sesa cilësimit ligjor të veprës, është ruajtja e sigurisë juridike. Në realitet, nuk ka një dallim të qartë mes veprimit të kryer dhe cilësimit ligjor të tij. Dallimi mes qasjes "ligjore" dhe "faktike" të fakteve të njëjta mund të shihet më qartë nëse i referohemi veprimit/ngjarjes. Sipas Trenchel, veprimi i të shtënit me armë ndaj një personi konsiston në të paktën dy elementë: drejtimin e armës dhe tërheqjen e këmbëzës. Për qëllim të ndjekjes penale, këto dy veprime merren së bashku, në unitet, dhe emërtohen vepër penale e "vrasjes". Kjo vepër, në thelb, përcaktohet nga rezultati - vdekja e personit - dhe jo nga tërësia e rrethanave dhe mënyra se si ka ndodhur ngjarja. Rrethanat e ngjarjes, gjatë ndjekjes penale, i nënshtrohen një filtrimi i cili merr më tepër për bazë cilësimin ligjor të veprës. Kështu, disa fakte përzgjidhen, prezantohen dhe theksohen, ndërsa të tjera ometohen, çka, në vetvete, përbën një cilësim (paraprak) ligjor të veprës. Trenchel e krahason këtë proces me atë të fotografimit: pika e vrojtimit, specifikimi i lentes, ndriçimi, si dhe një tërësi faktorësh të tjerë ndikojnë në rezultatin përfundimtar - foton. Vetë fotoja reflekton vetëm një segment të ngjarjes. Në momentin e procedimit penal (e sidomos në momentin e një procedimi të dytë penal) situata (ngjarja) ka përfunduar së ekzistuari. Ajo çka ka mbetur është thjesht një reflektim historik i saj, i kapur nga aparati fotografik ligjor në vazhdën e procedimeve. Fillimi i një procedimi të dytë penal për ngjarjen nuk bën asgjë tjetër përveçse një filtrim të dytë të saj e, si rrjedhojë, shtrembërim të mëtejshëm. Për nevoja të *ne bis in idem,* shkalla e shtrembërimit mund të reduktohet nëse do t'i referoheshim ngjarjes së ndodhur dhe historikut të saj se sa po t'i referoheshin përcaktimit ligjor të veprës. Si rrjedhojë, shumica e shteteve theksojnë rëndësinë e historisë së ngjarjes dhe rrethanave se si ka ndodhur ajo, si element vendimtar në përcaktimin e *idem*.[463]

Të pakta janë vendet që theksojnë rëndësinë e përcaktimit ligjor të veprës. E tillë është p.sh. Kina. Në Gjermani, *idem* i referohet historikut të ngjarjes, në Francë, në nenin 368 të Kodit të Procedurës Penale u shtuan fjalët "edhe përmes një cilësimi të ndryshëm të veprës" të cilat i dhanë fund pasigurisë që rridhte nga ky nen. Që nga 1963, Gjykata Supreme Holandeze ka pasur një përqasje të mesme, duke marrë në konsideratë si historikun e ngjarjes, ashtu dhe cilësimin ligjor të veprimit të kryer. Në Belgjikë, përcaktimi i *idem* mbi bazën e fakteve kufizohet në çështjet e brendshme, ndërsa në situata ndërkombëtare rëndësi merr përcaktimi ligjor i veprës.

Në ndryshim me shumicën e rregullimeve kombëtare mbi *ne bis in idem*, neni 14/7 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 4 Prot.7 i KEDNJ, neni 50 i Konventës së të Drejtave Themelore në Bashkimin Europian, të gjithë i referohen të njëjtës "vepër penale". Vetëm neni 54 i Konventës për Implementimin e

[462] Willem Bastiaan van Bockel, The *ne bis in idem* principle in EU law - A conceptual and jurisprudential analysis, Kluwer Law International Publishin (2010), 48.
[463] ibid 49.

Marrëveshjes Shengen i referohet "të njëjtave veprimeve/akteve". Formulimi jo i qartë i nenit 4 të Protokollit 7 të KEDNJ çoi në probleme në zbatimin e këtij neni në çështje konkrete. Për shumë vite GJEDNJ hasi probleme në interpretimin e "të njëjtës vepër" sipas nenit 4 të Prot. 7. Megjithatë, Dhoma e Madhe e kësaj Gjykate i dha fund këtyre problemeve dhe paqartësive në çështjen *Zolotukhin v. Russia*, në të cilën u shpreh se "Neni 4 i Protokollit 7 duhet kuptuar se ndalon ndjekjen penale ose gjykimin e një "vepre" të dytë, nëse bëhet fjalë për fakte identike ose fakte të cilat, substancialisht, janë të njëjta".[464]

Edhe kur parimi i *ne bis in idem* zbatohet duke iu referuar vetëm fakteve, përsëri, në praktikë, mund të lindin probleme lidhur me klasifikimin ligjor të veprës penale. Kështu, një problem i mundshëm mund të jetë se një ngjarje e vetme mund të përbëjë disa vepra penale. Një tjetër fenomen mund të jetë se ngjarje të ndryshme mund të jenë të lidhura në unitet mes tyre. Kështu p.sh., disa goditje të njëpasnjëshme mund të përbëjnë veprën penale të "rrahjes". Gjithashtu, një fenomen i përhapur në shumë shtete është përfshirja e individëve në organizata kriminale ose në veprimtari terroriste, veprimtari të cilat shqyrtohen në unitet. Një problem tjetër rezulton nga parimi i *ne bis in idem* në rang ndërkombëtar. Kështu, "të njëjtat fakte" në rang ndërkombëtar nuk kuptohen si "të njëjtat fakte" në nivel kombëtar. Jo vetëm kaq, por dhe dënimet e dhëna, për të njëjtën vepër penale, nga shtete të ndryshme janë të ndryshme. Në shumicën e shteteve, legjislacionet kombëtare penale dhe të procedurës penale shprehen se, në një tërësi procedimesh penale, ndaj individit do të zbatohet vetëm dënimi maksimal i dhënë. Megjithatë, ka dhe përjashtime. Jurisprudenca e SHBA njeh dhe dhënien e dënimeve me 500 vjet burgim. Pikërisht për këtë arsye GJEDNJ u ka lënë shteteve të përcaktojnë vetë sistemin e tyre për ekzekutimin e dënimit penal, duke kufizuar në këtë mënyrë ndërhyrjen (më tepër se ç'duhet) në çështje të tilla.

Interpretimi autonom që GJEDNJ i ka bërë, në jurisprudencën e saj, konceptit të "akuzës penale" ka ngritur probleme brenda sistemeve kombëtare, për shkak se veprat penale dhe ato administrative, zakonisht, kanë çuar në procedime të veçanta. Për shkak të kohëzgjatjes dhe kompleksitetin të procedimit penal, dënimet administrative janë vendosur ndaj individit shumë më parë se ato penale, duke çuar në këtë mënyrë në ndalimin e procedimit të mëtejshëm penal.[465]

Pavarësisht nga sa më lart, ndalimi i përndjekjes dy herë për të njëjtën vepër nuk është absolut. Në disa raste të veçanta mund të ketë dhe riçelje të procedurave për çështjen, p.sh. në rast të zbulimit të evidencave të reja *(novum)*, të një gjykimi të pavlefshëm ose pasaktësive të tjera procedurale. Arsyeja kryesore e riçeljes është interesi i drejtësisë dhe ka për qëllim të rregullojë gabimet që mund të kenë ndodhur gjatë procedimit të parë. Neni 4 i Prot. 7 të KEDNJ parashikon shprehimisht mundësinë e

[464] *Sergey Zolotukhin v. Russia*, (Application No.1493/03), pp 83.
[465] Willem Bastiaan van Bockel, The *ne bis in idem* principle in EU law - A conceptual and jurisprudential analysis, Kluwer Law International Publishin (2010), 52.

këtyre përjashtimeve. *Novum* shihet si kusht i domosdoshëm për riçeljen e procedurave. Në rast se s'kemi të bëjmë me evidenca të reja, atëherë mund të thuhet se kjo riçelje do të përbënte cenim të *ne bis in idem*.

Ndërkombëtarizimi i *ne bis in idem*

Ne bis in Idem është parim i rëndësishëm i së drejtës penale, i cili është i detyrueshëm për zbatim nga organet shtetërore dhe që përbën një garanci të rëndësishme procedurale për mbrojtjen e të drejtave të personave të akuzuar. Procedimi dy ose më shumë herë për të njëjtën vepër i individit sjell pasoja të rënda për vetë individin, në drejtime të ndryshme. Kështu, i akuzuari përballet me gjykime të shumta. Për këtë shkak ai ngarkohet me barrën psikologjike që sjellin këto gjykime, duhet të përballojë shpenzime të shumta për të siguruar mbrojtjen e, madje, mund dhe t'i duhet të vuajë dënim të ri për të njëjtin veprim.

Shumë shtete kanë kodifikuar *ne bis in idem* si një të drejtë kushtetuese. Ai njihet si një e drejtë themelore e individit dhe nga instrumentet ligjore ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Ky parim, historikisht, është konsideruar se aplikohet vetëm në rang kombëtar dhe kufizohet vetëm në drejtësinë penale. Sa i përket thelbit së tij, bëhet dallim mes *nemo debet bis vexari pro una et eadem causa* (askush nuk duhet të përballet me ndjekje penale dy herë për të njëjtën vepër) dhe *nemo debet bis puniri pro uno delicto* (askush nuk duhet të ndëshkohet dy herë për të njëjtën vepër). Disa vende kufizojnë zbatimin e këtij parimi, duke pranuar vetëm mos dënimin dy herë për të njëjtën vepër. Qëllim i parimit *ne bis in idem* është mbrojtja e individëve nga *ius puniendi* i shtetit. Nga ana tjetër, respekti për *res judicata (pro veritate habitur)* i vendimeve të formës së prerë është me rëndësi për legjitimitetin e shtetit dhe sistemin ligjor.[466]

Krahas rëndësisë së *ne bis in idem* në rang kombëtar, një rëndësi e veçantë i kushtohet këtij parimi në rang ndërkombëtar.

Në terma të përgjithshëm, ky parim zbatohet vetëm në fushën e legjislacionit penal dhe ndaj vendimeve të formës së prerë për çështje penale. Kjo nënkupton se në shumë shtete lejohet ndjekja penale dy herë për të njëjtën vepër si dhe kombinimi i masave ndëshkuese administrative me ato penale. Disa vende, madje, njohin kombinimin e sanksioneve penale me ujditë e bëra mes organit të prokurorisë dhe të akuzuarit, jashtë sallës së gjyqit. Zbatimi i *ne bis in idem* në shtete të ndryshme është i ndryshëm dhe shtetet nuk kanë një standard të përbashkët lidhur me qëndrimet që mbahen për këtë parim. Si rrjedhojë, zbatimi i tij në fushën ndërkombëtare ngre disa probleme: Zbatimi i tij do të bëhet kur kemi të bëjmë me të njëjtën "vepër penale" apo të njëjtat "fakte"?

[466] John A.E. Vervaele, *The transnational ne bis in idem principle in the EU, Mutual recognition and equivalent protection of human rights*, Utrecht Law Review, Volume 1, Issue 2 (December), 2005.

Zbatimi i tij varet nga qëllimi për të cilin një veprim i caktuar është konsideruar "penal" apo nga vlerat e shoqërisë që ia ka për qëllim të mbrojë? A ka dallime mes zbatimit të tij ndaj individëve dhe personave juridikë? A janë të gatshme shtetet të pranojnë zbatimin ndërkombëtarisht të *ne bis in idem*?

Shtetet, që pranojnë vlefshmërinë e vendimeve penale të huaja brenda territorit të tyre, janë të pakta. Kjo për shkak se shtetet e konsiderojnë *ius puniendi*-n e tyre si pjesë të rëndësishme të ushtrimit të sovranitetit të tyre. Edhe zbatimi i *res judicata* në lidhje me vendimet penale të huaja, është problematik. Kjo, mbase, për shkak se shtetet nuk kanë shumë besim në mënyrën e administrimit të drejtësisë nga shteti tjetër. Njohja e *res judicata* në rang ndërkombëtar nënkupton se individi nuk mund të ndiqet penalisht nga një shtet, për një vepër penale për të cilën ai ishte ndjekur penalisht ose dënuar nga një shtet tjetër (efekti negativ) ose marrjen parasysh të vendimit penal të huaj në rastet e shqyrtimit të çështjes nga një shtet (efekti pozitiv). Refuzimi i njohjes së vendimit penal të huaj çon në ndjekje penale të shumëfishta, çka, sigurisht, sjell probleme e shqetësime të mëdha jo vetëm për individin, por dhe në kuadër të marrëdhënieve mes shteteve. Shumica e shteteve të *common law* njohin efektin *res judicata* të vendimeve penale të huaja, madje, Kodi Penal Holandez, p.sh., njeh zbatimin e *ne bis in idem* jo vetëm në rang kombëtar, por gjithashtu dhe ndërkombëtar,[467] pavarësisht shtetit në të cilin mund të jetë kryer vepra penale. Në legjislacionin ndërkombëtar (*ius cogens*) nuk ka asnjë dispozitë që të detyrojë respektimin e *ne bis in idem* mes shteteve. Zbatimi i tij në rang ndërkombëtar varet nga përmbajtja e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe marrëveshjet dy palëshe mes shteteve, për çështjet penale.

Zhvillimi i marrëdhënieve ndërkombëtare mes shteteve, e, në Europë, me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdamit, është krijuar një zonë e përbashkët Lirie, Sigurie dhe Drejtësie, duke shndërruar bashkëpunimin e mëparshëm mes shteteve në fushën penale, në një bashkëpunim të rëndësishëm gjyqësor mes vetë aktorëve të drejtësisë penale. Ky bashkëpunim ka çuar në njohjen e vendimeve penale të huaja, duke çuar, gjithashtu, në një funksionim pa kufij (ndarje kufitare) të sistemit të drejtësisë penale. Njohja e vendimeve penale të huaja tashmë shtrihet edhe në fazën e hetimeve paraprake si: sekuestrim, marrje provash dhe arrest.

Ne bis in idem gjendet i parashikuar si konventat për të drejtat e njeriut, ashtu dhe në marrëveshje bi ose multilaterale, që kanë të bëjnë me bashkëpunimin në çështjet penale. Në Bashkimin Europian, vendimet gjyqësore të një Shteti Anëtar kanë efekte ligjore në zonën BE. Njohja, nga shtetet palë, e Urdhrave Ndërkombëtarë të Arrestit ka çuar në njohjen dhe zbatimin ndërkombëtar të *ne bis in idem*. Një rëndësi të veçantë në këtë drejtim ka pasur jurisprudenca e GJEDNJ, e cila ka theksuar rëndësinë e zbatimit të këtij parimi në rang ndërkombëtar.

[467] Neni 68 i Kodit Penal Holandez.

Parimi *ne vis in idem* është parashikuar që herët si një e drejtë e individit. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat dhe Liritë Civile dhe Politike, i Dhjetorit 1966, në nenin 14/7 parashikon: "Askush nuk mund të ndiqet ose të ndëshkohet penalisht për një vepër për të cilën ai është dënuar ose shpallur i pafajshëm më parë, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të vendit". Konventa për Zbatimin e Marrëveshjes Shengen parashikon *ne bis in idem* në nenet 54 dhe 58 të saj. Konventa mbi të Drejtat Themelore e BE garanton këtë parim në nenin 50 të saj, duke theksuar shtrirjen e tij në të gjithë territorin e BE. Vendimi i Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Zgjidhjen e Konflikteve Juridiksionale në Çështjet Penale, parandalon ato situata ku individi mund të jetë subjekt i procedimeve penale paralele, në shtete të ndryshme anëtar, për të njëjtat fakte. KEDNJ nuk përmban një parashikim të tillë dhe Komisioni Europian, fillimisht, mohoi ekzistencën e një parimi të tillë në nenin 6 të KEDNJ, pa përjashtuar faktin se disa lloj procedimesh të dyfishta për të njëjtën vepër shkelnin procesin e rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6 të Konventës. Më pas, një parim tillë u fut në Protokollin e 7 të KEDNJ.

Në jurisprudencën e saj, GJEDNJ është shprehur se ka shkelje të *ne bis in idem* jo vetëm kur personi gjykohet dhe dënohet dy herë për të njëjtën vepër penale, por dhe në rast se ai ndiqet penalisht dy herë për vepra penale të ndryshme, elementët thelbësore të të cilave janë të njëjta.[468]

Ligji Model për Ekstradimin i Kombeve të Bashkuara parashikon: "Ekstradimi mund të refuzohet nëse ndaj personit për të cilin kërkohet ekstradimi është dhënë dhe zbatuar një vendim përfundimtar (në shtetin që zbaton ligjin ose në një shtet tjetër). Megjithatë, gjuha e përdorur u lë shteteve hapësira veprimi. Kështu p.sh., Në SHBA doktrina mbizotëruese është ajo e "sovranitetit të dyfishtë", e cila i lejon çdo shteti sovran të përndjekë penalisht një individ pavarësisht veprimeve të mëparshme, për të njëjtin veprim, të ndërmarra nga një shtet tjetër sovran, duke e bërë këtë doktrinë të padrejtë dhe jo efektive në mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarve.[469]

Një ndër shembujt e shumtë të SHBA është ai i Gabe Watson.[470] Watson, shtetas i SHBA, u dënua dhe u burgos për 18 muaj në Australi, për vrasjen e bashkëshortes së tij gjatë zhytjes nën det, në 2003. E pakënaqur nga dënimi i lehtë që iu dha, Gjykata e Alabamas në SHBA akuzoi Watson për vrasje për para dhe rrëmbim, përmes mashtrimit, dhe arriti të ekstradonte Watson nga Australia. Sipas legjislacionit australian, ndalohet ekstradimi i personit nëse personi është dënuar më parë për veprën penale, ose për një vepër tjetër, që bazohet në të njëjtin veprim/akt si dhe vepra për të cilën kërkohet ekstradimi. Si rrjedhojë, pavarësisht se veprat për të cilat Watson u akuzua në SHBA ishin të ndryshme nga ato në Australi, veprimi në fjalë ishte i njëjtë dhe ekstradimi i tij për në SHBA nuk duhej të ishte lejuar. Pavarësisht se çështja e Watson në SHBA u hodh

[468] *Fisher v Austria* (Application no. 37950/97).
[469] D.E. Lopez, *'Not Twice for the Same: How the Dual Sovereignty Doctrine is Used to Circumvent Non Bis In Idem', Vanderbilt Journal of Transnational Law* (2000), 33.
[470] *R v Watson; Ex parte A-G*, [2009] QCA 279.

poshtë, me pretendimin e mos pasjes së evidencave të mjaftueshme për çështjen, nëse çështja do të kishte përfunduar në gjyq, Watson mund të ishte gjykuar dhe dënuar dy herë për të njëjtën vepër. Në rastin e Sandra Avila Beltran, shtetase meksikane, shteti Meksikan refuzoi ekstradimin e kësaj shtetaseje në SHBA, për akuzat trafikimit të substancave narkotike (drogë), me pretendimin se kjo shtetase ishte gjykuar dhe dënuar, për çështjen në fjalë, nga shteti meksikan.[471]

Mundësitë e të akuzuarit për të gëzuar garancitë procedurale që i ofrohen mund të kompretohen kur bëhet fjalë për ndjekje penale ndërkombëtare. Pavarësisht se Neni 7 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut shprehet se: "Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe mbrohen, pa diskriminim, në mënyrë të barabartë nga ligji", çka nënkupton se trajtimi i të akuzuarve duhet të jetë i njëjtë si në rastet e veprave penale kombëtare, ashtu dhe ndërkombëtare; pavarësisht se neni 10 i kësaj Deklarate dhe neni 14/1 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike parashikojnë të drejtat e individëve për barazi dhe për një gjykim të drejtë ..., kërkesa që të gjithë të akuzuarit të jenë të barabartë para ligjit ka nevojë për trajtim të njëjtë procedural dhe substancial të të të akuzuarve, dhe garantim i të drejtave të tyre si në rastin kur bëhet fjalë për vepra penale të kryera brenda territorit të një vendi, ashtu dhe kur bëhet fjalë për vepër apo vepra penale të kryera në, ose që përfshijnë, territoret e disa shteteve.

Mungesa e një trajtimi të barakat të këtyre individëve, e një parimi ndërkombëtar të *ne bis in idem* dhe njohjes së *res judicata* dhe nga shtetet e tjera, çon në pasiguri dhe padrejtësi. Garancitë kushtetuese, që një shtet i ofron shtetasve të tij, duhet të gjejnë zbatim ndërkombëtarisht.

Lidhur me këtë, Gjykata e Lartë shqiptare është shprehur se: "Nëse ndodhemi apo jo përpara gjësë së gjykuar, nuk ka rëndësi fakti nëse vendimi penal i huaj, është njohur apo jo nga gjykata shqiptare. Vendimet e shtetit të huaj, rezulton të jenë administruar në dosjen gjyqësore konform rregullave që përcakton dispozita e nenit 509 të K.Pr.Penale dhe duke qenë se është marrë si prove sipas kërkesave të nenit 151 të K.Pr.Penale, Kolegji çmon se kjo tregon që i gjykuari, është gjykuar një herë për të njëjtin fakt kriminal, ç'ka nuk duhet të çonte gjykatat shqiptare të faktit në një gjykim e dënim të dytë. Sipas nenit 516 të K.Pr.Penale, njohja e vendimit të huaj lidhet vetëm me caktimin e dënimit që personi duhet të vuajë në shtetin shqiptar. Kolegji Penal çmon se aplikimi i parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (fakt kriminal), është i njëjtë në rastet e gjykimeve penale të zhvilluara në shtete të ndryshme të huaja me rastet e gjykimeve penale brenda vendit. Në nenin 34 të Kushtetutës, në nenin 54 të KEDNJ dhe në nenin 7 të K.Pr.Penale, nuk është vënë asnjë kufizim dhe nuk është bërë asnjë dallim apo përjashtim nëse gjykimi i mëparshëm është bërë nga gjykatë e huaj apo gjykatë penale brenda vendit, por thuhet në mënyrë të shprehur se askush nuk mund të dënohet

[471] H. Nelson Goodson, *'Mexican Federal Judge Cited Double Jeopardy To Prevent Female Druglord Extradition To The U.S.'*, *Hispanic News Network USA Blog*, 12 January 2012, < http://hngwiusa.wordpress.com/2012/01/13/mexican-federal-judge-cited-double-jeopardy-to-prevent-female-druglord-extradition-to-the-u-s/> aksesuar 06.04.2014.

më shumë se një herë për një vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve të shprehura konkretisht në këto dispozita, ç'ka tregon se rasti në gjykim nuk është në rastet përjashtimore të parashikuara në to".[472]

Jurisprudenca për *ne bis in idem*

Jurisprudenca amerikane e *ne bis in idem/double jeopardy*

Në jurisprudencën amerikane parimi i mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër parashikohet në Amendamentin e Pestë të Kushtetutës Amerikane - Procesi i Rregullt Ligjor. Amendamenti i Pestë i Kushtetutës Amerikane shprehimisht parashikon: " ... asnjë person nuk do t'i nënshtrohet rrezikut ndaj jetës dy herë për të njëjtën vepër penale ...". Në pamje të parë duket sikur kuptimi i këtij neni është i thjeshtë e i qartë. Duket se ai mbron individët nga rreziku i ndëshkimeve dhe ndjekjeve të vazhdueshme penale, për të njëjtën vepër, pasi ndaj personit është dhënë një vendim pafajësie ose dënimi. Megjithatë, kjo thjeshtësi është mashtruese. Ajo çka gjykatat duhet të vendosin është nëse kanë të bëjnë me *të njëjtën vepër* për qëllimet e Amendamentit të Pestë.

Çështja, nëse ky nen mbronte individin nga gjykimi dy herë për të njëjtën vepër penale, u parashtrua përpara Gjykatës Supreme në vitin 1902 me çështjen *Dreyer v. Illinois*.[473] Në këtë çështje, Edward Dreyer, ish drejtor i Thesarit për West Chicago-n pretendoi se shteti i Illinois-it kishte cenuar parimin e mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër, pasi e ishte gjykuar më parë për veprën e moskthimit të fondeve dhe pronave pasardhësit të tij në detyrë, çështje për të cilën gjykata nuk arriti të shprehej, pasi juria nuk arriti të merrte vendim. GJS u shpreh se, edhe pse Amendamenti i Pestë për Proces të Rregullt Ligjor garantonte mbrojtjen nga mosgjykimi dy herë për të njëjtën vepër, rigjykimi i Dreyer, pas një gjykimi për të cilën juria nuk kishte arritur në marrjen e një vendimi, nuk cenonte këtë parim.

Në çështjen *Diaz v. United States*,[474] GJS u shpreh se: "Vrasja për të cilin i akuzuari u dënua nga gjykata e shkallës së parë dhe agresioni, për të cilin ai u gjykua nga gjyqtari i paqes, pavarësisht se identike në disa elementë, ishin vepra të ndryshme si përsa i përket fakteve, ashtu dhe ligjit ... Gjyqtari i paqes, megjithëse kishte juridiksion për ta gjykuar të akuzuarin për agresion, nuk kishte juridiksion për ta gjykuar atë për veprën penale të vrasjes. Si rrjedhojë, kërkesa për cenim të mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër nuk përbënte pengesë për procedim penal për vrasje". Pra, sipas këtij vendimi, shprehja "i njëjti veprim" nënkuptonte të njëjtin veprim.

[472] Vendim nr.194, datë 22.04.2009 i Gjykatës së Lartë të RSH..
[473] *Dreyer v. Illinois*, 187 U.S. 71 (1902).
[474] *Diaz v. United States*, 223 US 442, 448-49 (1912).

Në çështjen *Blockburger v. United States,*[475] i pandehuri ishte akuzuar për dy vepra penale: 1) shitjen e medikamenteve pa paketimin origjinal dhe 2) shitjen e medikamenteve pa urdhër, në cenim të ligjit Harrison për Narkotikët. GJS, pasi mori në konsideratë pretendimin se akuzat e veçanta cenonin mbrojtjen e ofruar nga parimi i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër, u shpreh se i akuzuari mund të akuzohej për dy vepra, sepse secila prej tyre kërkonte të provuarit e një elementi tjetër, që nuk kërkohej nga vepra tjetër. Sipas *Blockburger*, një vepër më e rëndë trajtohet njëlloj me veprën më të lehtë, të përfshirë në të. Ky test u kritikua shpesh nga komentuesit, sepse mund të çonte në rezultate të pabarabarta dhe absurde. Sipas tij, vrasja e mbetur në tentativë duhej konsideruar njëlloj si vrasja me paramendim.[476]

Në *Palko v. Connecticut,*[477] shteti i Connecticut akuzoi Frank Pallko me vrasje të shkallës së parë/me paramendim. Juria e dënoi me vrasje të shkallë së dytë/pa paramendim, ndërsa gjyqtari e dënoi me burgim të përjetshëm. Shteti, bazuar në një ligj të tij, si dhe me lejen e gjyqtarit, bëri ankim, në të cilin u pretendua se gjyqtari kishte bërë një sërë gabimesh procedurale, si gjatë periudhës së ndjekjes penale, para gjykimit të çështjes, ashtu dhe në instruktimin e gabuar të jurisë mbi dallimin mes vrasjes së shkallës së parë dhe vrasjes së shkallës së dytë. GJS e Gabimeve e Connecticut anulloi dënimin e Palko-s dhe urdhëroi gjykimin e tij përsëri për vrasje të shkallës së parë. Përpara rigjykimit, Palko pretendoi se gjykimi i ri do të cenonte parimin e mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër. Gjyqtari i çështjes hodhi poshtë pretendimin e tij dhe vazhdoi gjykimin. Këtë herë juria dënoi Palko-n me vdekje për vrasje të shkallës së parë. Gjyqtari Benjamin Cordozo, në një opinion të tij, u shpreh se në çështjen *Kepner v. United States,*[478] Gjykata kishte vendosur se moslejimi i dënimit dy herë për të njëjtën vepër, i parashikuar në Amendamentin e Pestë, ndalonte vendosjen e individit në një situatë të tillë, kur gjykimi i dytë kishte ardhur për shkak të kërkesës dhe këmbënguljes së qeverisë dhe jo të të akuzuarit. Në vendimin e saj, GJS u shpreh: "Shteti nuk po përpiqet të lodhë të akuzuarin përmes shumë gjykimeve kundër tij. Ajo çka kërkohet s"është asgjë më shumë se kryerja e një gjykimi të drejtë, pa gabime ligjore. Kjo nuk është aspak mizori dhe as nuk ka për qëllim të irritojë të akuzuarin. Nëse gjykimi është kryer me parregullsi të pafavorshme ndaj të akuzuarit, ai do të kishte paraqitur kërkesë për rishikim. Një privilegj reciprok, që i nënshtrohet gjithmonë diskrecionit të gjyqtarit të çështjes, tashmë i

[475] *Blockburger v. United States*, 284 US 299 (1932).
[476] <http://law.bepress.com/cgi/viewcontent.cgi?article=6282&context=expresso&sei-redir=1&referer=http%3A%2F%2Fwww.google.com%2Furl%3Fsa%3Dt%26rct%3Dj%26q%3Dnon%2522bis%2520in%2520idem%2520and%2520the%2520rome%2520statute%2520of%2520the%2520international%2520criminal%2520court%26source%3Dweb%26cd%3D2%26ved%3D0CC8QFjAB%26url%3Dhttp%253A%252F%252Flaw.bepress.com%252Fcgi%252Fviewcontent.cgi%253Farticle%253D6282%2526context%253Dexpresso%26ei%3D42j_UfenKM7_PM-xgPgN%26usg%3DAFQjCNHE62b0JCNbuVwBPIYK04bhET6gag#search=%22non%20bis%20idem%20rome%20statute%20international%20criminal%20court%22>, p. 6, aksesuar më 17 Maj 2013.
[477] *Palko v. Connecticut* , 302 U.S. 319 (1937), ndryshuar me *Benton v. Maryland*, 395 U.S. 784 (1969).
[478] *Kepner v. United States*, 195 U.S. 100 (1904).

është dhënë dhe shtetit. S'kemi të bëjmë me asgjë të re. Përkundrazi, për shumë njerëz, institucioni i drejtësisë qëndron më lart së më parë".

Çështja *Grady v. Corbin*,[479] shënoi një ndryshim nga *Blockburger*. I akuzuari ishte dënuar për drejtimin e automjetit në gjendje të dehur dhe mosqendrimi në anën e duhur të rrugës, duke shkelur rregullat e qarkullimit rrugor. Pas marrjes dijeni, në një periudhë të mëvonshme, se individi, që i akuzuari kishte aksidentuar gjatë dhënies së automjetit në gjendje të dehur, kishte vdekur, ai u akuzua dhe dënua dhe për veprat penale të vrasjes dhe drejtimit të automjetit në gjendje të dehur. Në apelim, Gjykata Supreme u shpreh se: "Nuk mund të ketë ndjekje të dytë penale nëse "gjatë gjykimit për të dytën herë të të akuzuarit, shteti paraqet si element thelbësor një element/fakt mbi bazën e të cilit i akuzuari është dënuar më parë"". Si rrjedhojë, GJS u shpreh se parimi për mosgjykim dy herë për të njëjtën vepër gjente zbatim në këtë rast.

Në çështjen *United States v. Dixon*[480], GJS riktheu testin *Blockburger*. Dy të akuzuarit u dënuan për përbuzje të gjykatës, për shkak të mosbindjes së urdhrit të saj, sipas të cilit të akuzuarve u ndalohej kryerja e veprave penale pas lirimit nga burgu. Si rrjedhojë, ata u ndoqën penalisht për të njëjtin veprim për të cilin gjykata ishte shprehur me vendim. GJS u shpreh se, për shkak se dy veprat penale përbënin saktësisht të njëjtin element - përbuzje, akuzat duhet të hidheshin poshtë bazuar në parimin e mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër.

Në çështjen *Brock v. North Carolina*,[481] shteti i Karolinës së Veriut dënoi Brock dhe dy të tjerë, të përfshirë në një konflikt me të shtëna drejt një shtëpie nga një automjet në lëvizje. Si fillim i gjykuan bashkëpunëtorët e Brock, të cilët u dënuan për agresion me armë vdekjeprurëse. Brock iu nënshtrua një gjykimi të veçantë. Ndjekja penale thirri në gjykim dy bashkëpunëtorët e tij, me qëllim që të konfirmonin dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë në favor të shtetit. Të dy bashkëpunëtorët pretenduan para gjyqtarit të çështjes, se do të apelonin vendimin e dhënë ndaj tyre, si dhe kërkuan përdorimin e privilegjit kundër vetëinkriminimit. Për shkak të refuzimit të tyre për të dëshmuar, gjyqtari vendosi pushimin e gjykimit. Pasi GJS e Karolinës së Veriut la në fuqi dënimet e dhëna për bashkëpunëtorët e Brock, ndjekja penale ridërgoi çështjen në gjyq për herë të dytë. Brock kundërshtoi, duke pretenduar se gjykimi i ri cenonte të drejtën për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër. Gjykata e shkallës së parë hodhi poshtë kundërshtimet dhe Brock u gjykua e dënua me dy vjet burgim. GJS e Karolinës së Veriut la në fuqi këtë vendim. Gjatë gjykimit të çështjes në GJS të SHBA, kjo Gjykatë u shpreh se gjykimi i dytë nuk cenonte këtë parim. Ashtu si në çështjen *Palko*, GJS u shpreh se: "Gjykimi i dytë nuk cenon parimet themelore të lirisë dhe drejtësisë, që shtrihen në themelet e institucioneve [tona] civile dhe politike. Gjykata është shprehur kohë më parë se është në

[479] *Grady v. Corbin*, 495 US 508 (1990).
[480] *United States v. Dixon*, 509 US 688 (1993).
[481] *State v. Brock*, 67 S.E.2d 282 (N.C. 1951).

diskrecionin e gjyqtarit të çështjes të deklarojë pavlefshmërinë e gjykimit dhe të kërkojë gjykimin e të akuzuarit nga një panel i ri, nëse këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë".[482]

Në çështjen *Benton v. Maryland*,[483] shteti i Maryland akuzoi Benton për dy forma vjedhjeje.[484] Juria e shpalli të pafajshëm për njërën formë, por e dënoi atë për të dytën. Gjyqtari e dënoi me 10 vjet burgim. Megjithatë, pas gjykimit, u vu re se si juria e madhe që kishte akuzuar Benton, ashtu dhe ajo që e kishte gjykuar, ishin përzgjedhur në mënyrë të paligjshme. Benton iu dha mundësia e zgjedhjes që të pranonte dënimin ose të riakuzohej e rigjykohej. Benton zgjodhi opsionin e dytë. Ai u akuzua përsëri për të dy format e vjedhjes. Benton pretendoi se, duke qene se juria e kishte shpallur të pafajshëm për njërën formë, rigjykimi do të cenonte parimin kushtetues të mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër. Gjyqtari i çështjes hodhi poshtë këtë pretendim dhe shqyrtimi gjyqësor i çështjes u krye për të dy format e vjedhjes. Në përfundim të gjykimit, juria e deklaroi fajtor për të dy format dhe gjyqtari e dënoi me 15 vjet burgim. Gjatë shqyrtimit të çështjes në GJS të SHBA, kjo Gjykatë hodhi poshtë vendimin e saj të mëparshëm *Palko v. Connecticut,* duke u shprehur se standardi i mosgjykimit dy herë për të njëjtën çështje zbatohet si në nivel shtetëror, ashtu dhe federal. Sipas Gjykatës, "Natyra themelore e garancive kundër mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër, është e padiskutueshme. Origjina e saj shkon gjer në kohët greke e romake dhe u fut në *common law* të Anglisë, shumë kohë para shpalljes së pavarësisë së saj. Ashtu si dhe elementë të tjerë të *common law*, u mbart në jurisprudencën e [këtij] vendi përmes ndihmës së Blackstone, i cili kodifikoi doktrinën në Komentarët e tij. "Pretendimi *autrefois acquit* - shkroi ai - është rrënjosur në parimet e *common law* të Anglisë dhe askush nuk mund të vihet në rrezik të jetës së tij dy herë për të njëjtën vepër". Sot, çdo shtet ka inkorporuar këtë parim në kushtetutë ose *common law*. Parimi se asnjë shtet nuk duhet të lejohet të bëjë përpjekje të përsëritura për dënimin e një personi për një vepër penale, ka qenë, që nga fillimi, pjesë e traditës [sonë] kushtetuese. Është e qartë se rëndësia e tij është themelore në sistemin e drejtësisë amerikane".

Në çështjen *Brown v. Ohio*,[485] që kishte të bënte me vjedhjen e një automjeti dhe drejtimin e tij me shpejtësi të lartë për 9 ditë, prokuroria u mundua të ndajë veprën penale të drejtimit të automjetit me shpejtësi të madhe, nga vjedhja. Gjykata Supreme u shpreh se, sipas parimit të mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër, vjedhja dhe drejtimi me shpejtësi të lartë i automjetit, përbënin të njëjtën vepër.

Në çështjen *Blueford v. Arkansas*,[486] gjatë gjykimit të çështjes, juria ishte shprehur para gjyqtarit të çështjes, se gjatë diskutimeve për çështjen, anëtarët e jurisë

[482] *Brock v. North Carolina*, 344 U.S. 424 (1953).
[483] *Benton v. Maryland*, 395 U.S. 784 (1969).
[484] *Burglary* dhe *larceny*. E para ka të bëjë me hyrjen e paligjshme në banesën e dikujt me qëllim vjedhjen e pasurisë së tij. E dyta ka të bëjë me marrjen e paligjshme të pasurisë së dikujt, me qëllim privimin e zotëruesit, përgjithmonë, nga kjo pasuri.
[485] *Brown v. Ohio*, 432 U.S. 161 (1977).
[486] *Blueford v. Arkansas*, 132 S. Ct. 2044 (2012).

ishin shprehur unanimisht kundër akuzës për vrasje me paramendim, ndërsa nuk kishin arritur të merrnin vendim për akuzën e vrasjes nga pakujdesia. Duke qene se juria ishte në pamundësi për të vendosur për këtë akuzë, gjyqtari vendosi pushimin e gjykimit. Për këtë shkak, u caktua një gjykim i ri i çështjes. Përpara rigjykimit, Bluford pretendoi se rigjykimi për akuzën e vrasjes me paramendim ndalohej nga parimi për mosgjykim sy herë të së njëjtës vepër, pasi juria ishte shprehur unanimisht për rrëzimin e kësaj akuze. Lidhur me këtë pretendim, gjykata e shkallës së parë u shpreh se nuk kishte pasur deklarim të tij të pafajshëm, pasi juria nuk kishte arritur të marrë vendim e, për rrjedhojë, nuk pati vendimmarrje të gjykatës. Të njëjtin qëndrim mbajti dhe Gjykata Supreme e SHBA.

Pra, si rregull i përgjithshëm, vendimet e pafajësisë, të dhëna nga juria ose gjykata, për shkak të pamjaftueshmërisë së evidencës, nuk mund të apelohen nga shteti.[487] Në rast se vendimi i pafajësisë është rrjedhojë e një gabimi të parëndësishëm, i akuzuari nuk mund të gjykohet dy herë për të njëjtën vepër.[488]

Procedimi dy herë për të njëjtën vepër mund të lejohet nëse dënimi i të akuzuarit është lënë mënjanë për shkak të pamjaftueshmërisë së provave.[489] Gjykimet e pushuara, të justifikuara nga "një nevojë e manifestuar", mund të rihapen,[490] edhe nëse pushimi ka qenë rezultat i një gabimi të pafajshëm procedural të prokurorit.[491]

Jurisprudenca europiane e *ne bis in idem*

Parimi *ne bis in idem* gjen zbatim në tre raste: së pari, në lidhje me ndjekjet penale brenda shtetit, duke ndaluar gjykimin dhe dënimin dy herë për të njëjtën vepër dhe të njëjtat fakte brenda juridiksionit të një shteti; së dyti, në marrëdhëniet mes shteteve të ndryshme; dhe së treti, në marrëdhëniet mes shteteve dhe gjykatave ndërkombëtare. Në nivel ndërkombëtar, natyra e krimeve ndërkombëtare dhe parimet juridiksionale të zbatueshme nga një numër i konsiderueshëm shtetesh, i vënë të akuzuarit përballë mundësisë së ndjekjes penale dhe gjykimit për krime ndërkombëtare.

Ne bis in idem parashikohet në nenin 4 të Protokollit 7 të KEDNJ, sipas të cilit: "Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksionet e të njëjtit Shtet për një vepër për të cilën ai më parë ka qenë deklaruar i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të këtij

[487] *United States v .Scott*, 437 US 82 (1978).
[488] *United States v. Martin Linen Supply Co*, 430 US 564, 571 (1977).
[489] *Ball v. United States*, 163 US 662 (1896).
[490] *Arizona v. Washington*, 434 US 497 (1978).
[491] *Illinois v. Somerville*, 410 US 458 (1973).

Shteti. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit në fjalë, në rast se fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, ose një mangësi themelore në procedurën e mëparshme janë të një natyre të tillë, që mund të cenojnë vendimin e dhënë".

Ky parim nuk kufizohet vetëm në të drejtën për t'u dënuar dy herë për të njëjtën vepër, por shtrihet dhe në të drejtën për të mos u përndjekur ose gjykuar dy herë. Në rast se nuk do të ishte kështu, nuk do të kishte qenë e nevojshme që fjalës "gjykuar" t'i shtohej fjala "dënuar", pasi thjesht do të kishim ripërsëritje. Neni 4 i Protokollit 7 zbatohet dhe ndaj procedimeve që nuk kanë përfunduar me dënim të personit të akuzuar. Ky nen përmban tre garanci të dallueshme dhe parashikon se asnjë nuk do të (i) konsiderohet fajtor dhe ndiqet penalisht, (ii) gjykohet ose (iii) të dënohet për të njëjtën vepër penale.[492]

GJEDNJ, në jurisprudencën e saj, është shprehur se, kur gjykata vendos pushimin e gjykimit të dytë për një çështjeje, duke njohur një vendim të mëparshëm të dhënë nga gjykatat po për këtë çështje, atëherë nuk ka shkelje të këtij parimi.[493] Neni 4 i Protokollit 7 të KEDNJ zbatohet jo vetëm ndaj rasteve kur i akuzuari është dënuar dy herë për të njëjtën vepër, por dhe në rastet kur ai është ndjekur penalisht dy herë për të njëjtën vepër. Në rastet kur gjykatat shqyrtojnë njëkohësisht dy procedime të njëjta, por më pas njohin se ka pasur shkelje të *ne bis in idem* dhe ofrojnë mënyra për korrigjimin e situatës përmes, p.sh. dhënies fund ose anullimit të procedimit të dytë dhe fshirjes së efekteve të tij, atëherë mund të thuhet se i akuzuari nuk ka më statusin e "viktimës". Ky parim nuk gjen zbatim as në rastet kur prokurori ka vendosur mosvazhdimin e procedimit, duke mos pasur në këtë mënyrë një vendim të formës së prerë për pafajësinë ose për dënimin e të akuzuarit.[494]

Nëse gjatë procedurave gjyqësore gjykata nuk shprehet, në një mënyrë ose tjetër, lidhur me një element specifik të akuzës, një gjykim i dytë për vepër penale të ngjashme, bazuar në atë element, nuk përbën shkelje pasi i akuzuari është gjykuar ose dënuar për këtë shkak.[495] *Ne bis in idem* nuk gjen zbatim as në rastin e vendosjes së disa ndëshkimeve për një dënim, p.sh. burgim, dënim me gjobë si dhe revokim i patentës së automjetit, për shkak të veprës penale të drejtimit të automjetit në gjendje të dehur.[496]

Sipas GJEDNJ, procedurat administrative të cilat penalizojnë të njëjtin veprim, të marrë në shqyrtim nga një gjykatë, cenojnë këtë parim, pavarësisht përcaktimeve dhe qëllimeve të ndryshme të procedimeve. Kështu, në çështjen *Gradinger v. Austrisë*[497]

[492] *Sergey Zolotukhin v. Russia*, (Application no 14939/03), pp.110.
[493] *Zigarella v. Italy*, (Application no. 48154/99).
[494] *Smirnova v. Russia* (Application nos. 46133/99 and 48183/99).
[495] Karen Reid, *A Practitioner's Guide to the European Convention on Human Rights*, Sweet & Maxwell, (2012), 136.
[496] *RT v Switzerland*, (Application no. 31982/96).
[497] *Gradinger v. Austria*, (Application no.15963/90).

kërkuesi, i cili kishte shkaktuar vdekjen e një çiklisti, gjatë drejtimit të automjetin, ishte dënuar për vrasje për neglizhencë dhe jo për krimin e dhënies së makinës në gjendje të dehur, pasi niveli i akolit të tij në gjak ishte poshtë limitit. Autoritetet administrative, bazuar në një raport mjekësor, sipas të cilit niveli i alkoolit në gjak ishte mbi limitin, e dënuan atë me gjobë. Duke qenë se të dy vendimet ishin bazuar në të njëjtat sjellje, GJEDNJ u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 4 të Protokollit 7 të KEDNJ.

Sipas GJEDNJ, fakti se një person është dënuar për vepra penale të veçanta, të ardhura si pasojë e të njëjtit veprim, është në përputhje me *ne bis in idem*. Në çështjen *Oliveira v. Switzerland* kërkuesja u dënua, së pari për moskontrollimin e automjetit dhe mospërshtatjen e shpejtësisë së tij kushteve të rrugës, dhe, së dyti, për shkaktim aksidenti për shkak neglizhence. GJEDNJ u shpreh se do kishte qenë me mirë nëse të dy veprat penale do të gjykoheshin nga e njëjta gjykatë, në të njëjtin gjykim, dhe jo të ndara nga njëra - tjetra. Megjithatë, fakti se dënimet për dy procedimet ishin të ndryshme, ishte vendimtar në përcaktimin se nuk ka shkelje kur, për të njëjtën vepër (akt), iniciohen procedura të ndryshme.[498] Në rastin konkret një veprim i vetëm përbënte vepra të ndryshme penale.

Në çështjen *Franz Fischer v. Austria*,[499] GJEDNJ u shpreh se neni 4 i Protokollit të 7 të KEDNJ shtrihet jo vetëm në të drejtën për të mos u dënuar dy herë, por dhe në të drejtën për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër. GJEDNJ u shpreh se vepra penale administrative e dhënies së makinës në gjendje të dehur dhe rrethanat e veçanta, siç ishin shprehur gjykatat vendase, të parashikuara në Kodin përkatës Penal, në thelb nuk ndryshonin nga njëra-tjetra.

Në çështjen *Sergey Zolotukhin v. Russia*, Dhoma e Madhe u mundua të harmonizojë pikëpamjet e ndryshme që ekzistonin. Ajo u shpreh se fokusi nuk duhet të jenë "elementët thelbësorë" të veprave penale respektive ose përcaktimi ligjor i tyre, pasi do të kishim një interpretim shumë të kufizuar të një të drejte themelore. Përkundrazi, fokusi duhet të jetë nëse të dy veprat penale bazohen në të njëjtat fakte, ekzistenca e të cilëve duhet të provohet, që të ketë një dënim ose ndërmarrje procedurash penale.[500] Kështu, vendosja e sanksioneve administrative për akte të tilla si sharja e një nëpunësi publik dhe prishja e rendit në një qendër policore përmes shtyrjes së nëpunësit, e më pas dënimi për të njëjtin incident të sharjes dhe sjelljes së padenjë në rajonin e policisë, kishin për bazë të njëjtat fakte. Një rast i tillë përbën shkelje të parimit. Në këtë çështje, GJEDNJ theksoi se neni 4 i Protokollit 7 përmban tre garanci të rëndësishme: askush nuk mund të (i) bëhet përgjegjës për tu gjykuar, (ii) të gjykohet ose (iii) të dënohet për të njëjtën vepër penale.[501] E drejta për të mos u bërë përgjegjës për tu gjykuar dy herë për të njëjtën vepër, ose e thënë ndryshe, e drejta për të mos u ndjekur penalisht dy herë për të

[498] *Oliveira v. Switzerland* , (Application no. 25711/94), pp 27 dhe 35.
[499] *Franz Fischer v. Austria*, (Appl. No. 37950/97).
[500] *Sergey Zolotukhin v. Russia*, (Application no 14939/03), pp.78-87.
[501] ibid, pp.110.

njëjtën vepër, përbën shtesë logjike të së drejtës për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër.

Në çështjen *Tsonyo Tsonev v. Bulgaria (No. 2)*[502] gjobitja për thyerje të një dere dhe kërcënim i një personi kishin të bënin me të njëjtat fakte mbi të cilat ishte ngritur akuza për dëmtim trupor. Në çështjen *Ruotsalainen v. Finalnd*[503] ndaj kërkuesit ishte marrë një vendim penal e njëkohësisht duhej të paguante shuma të caktuara për shkak të përdorimit të naftës së një kategorie që taksohej më pak. Që të dy veprimet bazoheshin në të njëjtat fakte.

Në çështjen *Xheraj v. Albania,*[504] GJEDNJ u shpreh se "Qëllimi i nenit 4 të Protokollit nr.7 është që të parandalojë përsëritjen e proceseve penale që kanë përfunduar me vendim përfundimtar. Qëllimi i raportit shpjegues të Protokollit nr.7 është të ndalohet përsëritja e procesit penal për të cilin është dhënë një vendim përfundimtar. Sipas raportit shpjegues të Protokollit nr.7, i cili në vetvete i referohet Konventës Europiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Vendimeve Penale, "një vendim është përfundimtar "nëse, sipas legjislacionit vendas, ai ka marrë fuqi *res judicata*. Ky është rasti kur vendimi është i pakthyeshëm, pra kur nuk ka mjete të tjera të disponueshme pasi palët ose i kanë shfrytëzuar këto mjete, ose kanë lejuar skadimin e afatit kohor pa i përdorur ato"". Paragrafi i parë i nenit 4 të Protokollit 7 nuk ndalon rihapjen e çështjes në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të shtetit në fjalë, nëse ka prova ose fakte të reja të zbuluara rishtazi, ose nëse ka pasur defekt thelbësor në proceset e mëparshme, defekt i cili mund të ketë ndikuar në rezultatin e çështjes".

Në çështjen *Nikitin v. Russia*, kërkesa e Prokurorit për rishikim të mbikëqyrur të pafajësisë u konsiderua si rihapje pasi, nëse do të pranohej, ky rishikim do të anullonte vendimet e dhëna më parë nga gjykatat për çështjen dhe do të çonte në riakuzim të të pandehurit. Si rrjedhojë, bazuar në nenin 4 të Protokollit 7, i akuzuari nuk mund të gjykohej përsëri.

Në Bashkimin Europian një rëndësi e veçantë i kushtohet *ne bis in idem* në "Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian", sipas të cilës një i akuzuar nuk mund të gjykohet ose ndëshkohet përsëri penalisht, për një vepër penale për të cilën ai është shpallur i pafajshëm ose dënuar, me vendim të formës së prerë, brenda Bashkimit, në përputhje me ligjin.[505] *Ne bis in idem* u fut në Europë që me Konventën për Implementimin e Marrëveshjes Shengen, e cila vinte me shume theksin në bashkëpunimin mes shteteve sesa në njohjen e këtij parimi si një e drejtë individuale. Brenda këtij sistemi kishte kufizime lidhur me mbrojtjen qe i duhej ofruar individit, duke u munduar, në një farë mënyre, të kufizonin sovranitetin gjyqësor të shteteve.

[502] *Tsonyo Tsonev v. Bulgaria (No. 2)*, (Application no. 21124/04), pp. 51-52.
[503] *Ruotsalainen v. Finalnd*, (Application no. 13079/03), pp. 56-57.
[504] *Xheraj v. Albania*, (Application no. 37959/02), pp. 69-70.
[505] Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, neni 50.

Parimi gjen zbatim të veçantë në procedurat penale për njohjen e ndërsjellë të vendimeve të marra në shtetet anëtare. Në nivel ndërkombëtar, zbatimi i tij vështirësohet për shkak të disa faktorëve: 1) njohja e një vendimi penal të huaj përbën kufizim të sovranitetit, 2) ka debate të shumta lidhur me zbatimin e tij në nivel kombëtar, 3) njohja e vendimeve penale të huaja ose gjykimi nga gjykatat ndërkombëtare kërkon besim në administrimin e drejtësisë nga një juridiksion tjetër.[506]

Disa instrumente, të iniciuara nga Këshilli i Europës, zgjeruan nocionin e shteteve anëtare lidhur me këtë parim si: Konventa Europiane për Ekstadim dhe Dy Protokollet Shtesë (KEE),[507] Konventa Europiane për Transferimin e Procedimeve në Çështje Penale (KETPCP),[508] Statuti i Romës,[509] Konventa Europiane mbi Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale (KEVNGJP)[510].

---

[506]< http://law.bepress.com/cgi/viewcontent.cgi?article=6282&context=expresso&sei-redir=1&referer=http%3A%2F%2Fwww.google.com%2Furl%3Fsa%3Dt%26rct%3Dj%26q%3Dbis%2520in%2520idem%26source%3Dweb%26cd%3D13%26ved%3D0CDIQFjACOAo%26url%3Dhttp%253A%252F%252Flaw.bepress.com%252Fcgi%252Fviewcontent.cgi%253Farticle%253D6282%2526context%253Dexpresso%26ei%3DV5b3UeXkBeiC4ASYu4CIBw%26usg%3DAFQjCNHE62b0JCNbuVwBPIYK04bhET6gag#search=%22bis%20idem%22>, aksesuar më 01.06.2013.

[507] KEE, ratifikuar nga RSH me ligjin nr.8322, datë 02.04.1998, neni 9

[508] KETPCP, ratifikuar nga RSH me ligjin nr. 8497, datë 10.06.1999, nenet 35-37: "Një person, në lidhje me të cilën është dhënë një vendim gjyqësor penal përfundimtar dhe i detyrueshëm, për të njëjtin akt, mund të mos ndiqet penalisht, dënohet ose t'i nënshtrohet një sanksioni në një shtet tjetër kontraktues: (a) në qoftë se ai është falur; (b) në qoftë se sanksioni i kërkuar për t'u zbatuar: (i) ka qenë zbatuar plotësisht ose është duke u zbatuar, ose (ii) i është nënshtruar faljes ose amnistisë, plotësisht, ose në lidhje me pjesën e pazbatuar, ose (iii) nuk mund të zbatohet për shkak të kalimit të afatit kohor; c) në qoftë se gjyqi e ka shpallur fajtor të pandehurin pa kërkuar zbatimin e një sanksioni. Megjithatë, një shtet kontraktues, përderisa nuk ka kërkuar procedime, nuk do të jetë i detyruar të njohë efektin e ne bis in idem në qoftë se akti që shkaktoi gjykimin është drejtuar kundër një personi, institucioni ose ndonjë gjëje me status publik, ose në qoftë se subjekti i gjykimit kishte vetë një status publik në atë shtet. Përveç kësaj, një shtet kontraktues, në të cilin akti është kryer ose konsideruar si i tillë sipas ligjit të atij shteti, nuk është i detyruar të njohë efektin e ne bis in idem, në qoftë se ai nuk ka kërkuar vetë procedimet."

[509] Statuti i Romës, miratuar nga RSH me ligjin nr.8984, datë 23.12.2002, neni 20: "Nëse nuk është parashikuar ndryshe në këtë Statut, asnjë person nuk gjykohet nga kjo Gjykatë në lidhje me një sjellje që ka qenë baza e krimeve për të cilën ai ka marrë fajësi ose pafajësi nga gjykata. Asnjë person nuk gjykohet nga ndonjë gjykatë tjetër për një krim të përmendur në nenin 5 për të cilin ai person ka marrë fajësi ose pafajësi nga Gjykata. Asnjë person i gjykuar nga një gjykatë tjetër për sjelljen e parashikuar në nenet 6, 7 ose 8 nuk gjykohet nga kjo Gjykatë në lidhje me të njëjtën sjellje, përveç kur gjykimi në gjykatën tjetër: (a) ishte për qëllimin e mbrojtjes së personit përkatës nga përgjegjësia penale për krimet në juridiksionin e Gjykatës; ose (b) nuk është kryer në mënyrë të pavarur ose të paanshme në pajtim me normat procedurale të njohura nga e drejta ndërkombëtare dhe është kryer në mënyrë të tillë që, në bazë të rrethanave, nuk i shërbente qëllimit të çuarjes së personit përkatës para drejtësisë.

[510] KEVNGJP, ratifikuar nga RSH me ligjin nr. 9068, datë 15.5.2003, nenet 53-57: "Një person, ndaj të cilit është zhvilluar një gjykim penal europian, nuk mund të procedohet, gjykohet apo të bëhet objekt ekzekutimi i një sanksioni në një shtet tjetër palë për të njëjtin fakt kur: a) ai është shpallur i pafajshëm; b) sanksioni i vendosur: i) është ekzekutuar plotësisht ose është duke u ekzekutuar; ii) është objekt i një faljeje ose amnistie në tërësinë e tij ose për pjesën e paekzekutuar; iii) nuk mund të ekzekutohet më, pasi është parashkruar; c) gjykata konstaton fajësinë e autorit, por nuk vendos ndonjë sanksion. Sidoqoftë, një shtet palë nuk është i detyruar, përveçse, kur ai vetë ka kërkuar procedimin, të njohë pasojat e "ne bis in idem",

Një rëndësi e madhe i kushtohet këtij parimi në çështjet që kanë të bëjnë me ekstradim të shtetasve. Në çështjen *Soering v. U.K,*[511] GJEDNJ vendosi lidhur me zbatimin e Neneve 3 dhe 6 të KEDNJ për ekstradimin e një të dyshuari në Amerikë. Sipas Gjykatës, Neni 1 i Konventës, i cili parashikon se: "Palët e Larta Kontraktuese i sigurojnë çdokujt, që ndodhet në juridiksionin e tyre, të drejtat dhe liritë e përcaktuara në seksionin e I të Konventës", vendos një kufizim, veçanërisht territorial, mbi shtrirjen e Konventës. Në veçanti, detyrimi i marrë përsipër nga një Shtet Kontraktues konsiston në "sigurimin" e të drejtave dhe lirive themelore të individit, brenda "juridiksionit" të tij. Për më tepër, Konventa nuk vendos detyrime për veprimet që ndërmarrin Shtetet Jo Palë, e as nuk ka për qëllim të detyrojë Shtetet Palë të vendosin detyrime për zbatimin e Konventës ndaj Shteteve të tjera. Neni 1 nuk duhet interpretuar se justifikon një parim të përgjithshëm deri në atë masë sa, pavarësisht detyrimeve për ekstradim, një Shtet Kontraktues nuk mund të dorëzojë një individ nëse nuk bindet se kushtet, që e presin këtë individ në vendin destinues, janë në përputhje të plotë me garancitë e Konventës. Sigurisht, ... qëllimi i ekstradimit në marrjen e masave parandaluese ndaj arratisjes së kriminelëve, në mënyrë që ata të vihen para drejtësisë, nuk mund të injorohet në përcaktimin e qëllimit të zbatimit të Konventës dhe Nenit 3 në veçanti".

Sipas Gjykatës, dërgimi i personave në juridiksione të huaja nga cilido Shtet Kontraktues, nuk e përjashton këtë Shtet nga përgjegjësia, ..., për të gjitha pasojat e parashikueshme të ekstradimit që mund të vuhen nga personi në këto shtete. Shteti që do të dërgojë individin ka detyrimin të kontrollojë nëse shteti kërkues respekton siç duhet të drejtat dhe liritë e individit. Respekti për këto të drejta është përgjegjësi e të dy shteteve dhe shtetasit kanë të drejtë për mjete efektive në këtë drejtim. Kjo nënkupton që procedurat e ekstradimit prekin jo vetëm marrëdhëniet mes shteteve, por njëkohësisht dhe të drejtat subjektive të individëve.

Një ndër rastet e cenimit të *ne bis in idem* gjatë ekstradimit ishte ai i Alan Hickey, një shofer kamioni nga Londra, i cili u dënua në Francë, me 18 muaj burgim, për trafikim të qenieve njerëzore. Alan pranoi fajësinë, pasi u informua nga gjyqtari i çështjes se, nëse do të vepronte në këtë mënyrë, do të lirohej më shpejt. Gjatë qëndrimit të tij në burg në Francë, u informua se Belgjika kishte lëshuar një Urdhër Ndalimi Ndërkombëtar ndaj tij, përmes të cili kërkohej dorëzimi i tij nga Franca, në mënyrë që të gjykohej, nga

---

nëse veprimi që i dha shkas gjykimit është drejtuar kundër ndonjë personi, institucioni ose sendi që ka karakter publik në këtë shtet ose nëse personi objekt i gjykimit kishte një karakter publik në këtë shtet.
Gjithashtu, çdo shtet palë në të cilin është kryer veprimi ose është konsideruar i tillë në përputhje me legjislacionin e atij shteti, nuk është i detyruar të njohë pasojat e "ne bis in idem" përveçse, kur ky shtet ka kërkuar procedimin. Nëse fillohen procedime të reja kundër një personi të gjykuar për të njëjtin fakt në një shtet tjetër palë, çdo periudhë heqje lirie e vuajtur për ekzekutimin e një vendimi do të llogaritet në sanksionin që mund të vendoset. Ky seksion nuk pengon zbatimin e rregullave kombëtare më të gjera lidhur me pasojat e "ne bis in idem" për gjykimet penale të huaja."

[511] *Soering v. U.K,* (Application no. 14038/88), pp. 86.

autoritetet Belge, për trafikim të qenieve njerëzore në rrethana rënduese si dhe për shkak të qënies anëtar i një grupi konspirativ.

Alan-it nuk iu dha informacion i saktë se si ose kur kishte ndodhur konspiracioni. Ai ishte i shqetësuar se akuzat belge kishin të bënin me të njëjtën çështje për të cilën ishte dënuar në Francë. Megjithatë, për shkak të mungesës së informacionit lidhur me akuzat belge, mbrojtësi francez i Alan nuk ngriti pretendime lidhur me zbatimin e *ne bis in idem* gjatë gjykimit të kërkesës për ekstradim. Si rrjedhojë, ekstradimi i Alan drejt Belgjikës u krye.

Gjykimi i tij në Belgjikë u zhvillua në mungesë të tij. Pas ndërhyrjes së Fair Trial International në këtë çështje, përmes gjetjes së një mbrojtësi, gjyqtari i çështjes në Belgjikë konkludoi se disa nga akuzat kishin të bënin me të njëjtat fakte për të cilat Alan ishte dënuar në Francë. Ekstradimi i Alan në Belgjikë, në kundërshtim me parimin e *ne bis in idem* mund të ishte shmangur nëse, që në fillim të procedimit penal, atij do t'i ishte ofruar ndihmë ligjore efektive.

Jurisprudenca shqiptare e *ne bis in idem*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon: "Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj".[512] Kodi i Procedurës Penale Shqiptare parashikon: "Askush nuk mund të gjykohet rishtas për të njëjtën vepër penale, për të cilën është gjykuar me vendim të formë së prerë, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga gjykata kompetente".[513]

Parimi *ne bis in idem* është njohur nga e drejta jonë e brendshme dhe nga e drejta ndërkombëtare penale si një prej të drejtave të njeriut të mbrojtura nga Kushtetuta dhe nga instrumentet kryesorë juridikë të brendshëm e ndërkombëtarë, që rregullojnë marrëdhëniet në fushën penale si dhe përgjegjësinë për kundravajtje. Sipas këtij parimi, "individi nuk mund të ndiqet e nuk mund të gjykohet nga juridiksionet e të njëjtit shtet për një shkelje, për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm apo është dënuar në bazë të një vendimi gjyqësor përfundimtar të ligjshëm".[514]

[512] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 34.
[513] Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 7.
[514] Vendimi i datë 14.09.1999, Dhoma (Seksioni) i III të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, ankimet nr.36855/97 dhe 41731.98.

Pranimi i parimit të mësipërm në gjykimin dhe vendimmarrjen për një çështje penale kërkon përmbushjen e dy kritereve që janë, ai i veprës penale "të njëjtë" me të mëparshmen dhe ai i kryerjes së saj "përsëri".

Kriteri "e njëjta vepër" i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar. Në këtë rast, është fjala kur si sjellja, ashtu edhe krimi bëhen për të njëjtat fakte të ndodhura në të njëjtën kohë dhe që cilësohen njëlloj nga ligji.

Duke u nisur nga interpretimet e mësipërme rezulton se, ky parim nuk mund të gjejë zbatim në rastet kur të dy veprat penale nuk kanë elementë të njëjtë. Nëse gjenden elementë të njëjtë, parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër apo procedim të mëtejshëm.

Sipas kuptimit të mësipërm, kur me vendim të formës së prerë është vendosur për një çështje, atëhere ajo nuk mund të gjykohet përsëri. Ky rregull është i vlefshëm edhe për të gjitha gjykatat e tjera brenda kufijve të të njëjtit juridiksion.

Nga ana tjetër, parimi *ne bis idem*, që ndalon rigjykimin e ridënimin për të njëjtën vepër, nuk gjen zbatim në rastet kur i njëjti veprim përbën dhunim të dy dispozitave të ndryshme ligjore. Për të njëjtat shkelje mund të zhvillohen procese me karakter të ndryshëm, penal dhe disiplinor. I njëjti veprim mund të konsiderohet si shkelje e të dy ligjeve (normave) edhe në rastet kur njëri prej tyre kërkon provën e një fakti shtesë, që ligji (norma) tjetër nuk e ka të nevojshme. Në këtë rast, pafajësia apo dënimi në bazë të njërit ligj, nuk e përjashton ndëshkimin sipas tjetrit"[515].

Njëkohësisht, neni 34 i Kushtetutës dhe neni 7 i Protokollit të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut nuk janë pengesë për gjykimin e dënimin e personave që kryejnë sjellje kriminale të njëpasnjëshme, edhe nëse sjelljet janë të ngjashme ndërmjet tyre. Ideja e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron tek zbatimi dy a më shumë herë i të njëjtën normë penale, por tek mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e ligjshme. Megjithatë, aktet e mësipërme lejojnë rigjykimin, kur dalin fakte të reja, të cilat janë të një natyre të tillë, që mund të cenojnë vendimin e dhënë. Në këtë rast e drejta për rishqyrtim nuk mund të bazohet mbi skema logjike të supozuara në mënyrë apriori por mbi kritere praktike të mundshme.

Parimi *ne bis in idem* si dhe trajtimi i barabartë i të gjykuarve cenohen jo vetëm kur personi dënohet përsëri për të njëjtën vepër, por edhe kur ndiqet penalisht në mënyrë të përsëritur për këtë vepër. Prandaj, ky parim gjen zbatim edhe për rastet e mbrojtjes nga masat shtrënguese e ndaluese, të cilat janë të lidhura ngushtë me procedimin. Megjithatë, një person, që është thirrur si i pandehur dhe është dënuar penalisht gjatë një procesi,

[515] (vendimi 282 US. 299/1932) për çështjen "Blochburger v.Shteteve të Bashkuara".

mund t'i nënshtrohet një procesi të dytë civil për të njëjtën vepër si përgjegjës për dëmin e shkaktuar, duke u dënuar me gjobë, në zbatim të parimit se "gjëja e gjykuar është e vërtetë".[516]

GJEDNJ, në çështjen *Sergey Zolotukhin kundër Rusisë*, datë 10 shkurt 2009, § 82, është shprehur si vijon "... kjo Gjykatë mban qëndrimin se neni 4 i Protokollit nr. 7 duhet të kuptohet në sensin e ndalimit të ndjekjes penale ose gjykimit për një akuzë, e cila buron nga fakte identike ose fakte që substancialisht janë të njëjta". GJEDNJ ka vlerësuar se, "garancia e përkufizuar në nenin 4 të Protokollit nr. 7 është e rëndësishme kur fillon një ndjekje e re penale nëse një vendim pafajësie ose dënimi ka marrë fuqinë e *res judicata.* Kjo nënkupton që vendimi është i pakthyeshëm, që do të thotë se nuk ka më mjete ankimuese të disponueshme ose kur palët i kanë shteruar mjetet juridike të mundshme apo kanë lejuar kalimin e afatit pa ushtruar mjetet ankimore të disponueshme" (shih vendimet *Nikitin kundër Rusisë*, datë 20 korrik 2004, § 37; *Horciag kundër Rumanisë*, datë 15 maj 2005).[517]

Sipas këtij parimi, askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht për një vepër penale për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm ose është dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar. Ideja e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron tek zbatimi dy a më shumë herë i të njëjtës normë penale, por te mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kriteri "e njëjta vepër" i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar. Nëse gjenden elementë të njëjtë, parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër ose procedim të mëtejshëm.

Gjykata Kushtetuese ka çmuar se *res judicata* nënkupton, në aspektin formal e procedural, mosankueshmërinë e vendimit, ndërsa, në atë substancial, fuqinë e detyrueshme të vendimit.[518]

Edhe Gjykata e Lartë është shprehur lidhur me rëndësinë e zbatimit të këtij parimi në çështjet penale. I tillë është rasti i Xh.H., i cili, me vendim të Gjykatës Themelore të Strugës në Republikën e Maqedonisë ishte deklaruar fajtor për veprën penale të "trafikimit të narkotikëve" dhe ishte dënuar me 7 (shtatë) vjet burgim. Nga ana tjetër, Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë kishte regjistruar procedim penal në ngarkim të tij dhe, në përfundim, Gjykata e Shkalles së Parë për Krime të Rënda Tiranë e kishte deklaruar fajtor e dënuar me 12 vjet burgim, për veprën penale të "trafikimit të narkotikëve". Ky vendim ishte lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me arsyetimin se, edhe pse i gjykuari ishte deklaruar fajtor dhe dënuar për të njëjtin fakt

[516] Vendim nr.05, datë 08.03.2005 i Gjykatës Kushtetuese të RSH. Vendim nr.10, datë 02.04.2009 i Gjykatës Kushtetuese të RSH. Vendim 33, datë 22.07.2011 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.
[517] Vendim nr. 29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.
[518] ibid Vendim nr.47, datë 07.11.2011 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.

kriminal nga një gjykate e huaj, përsëri ai mund të deklarohej fajtor nga gjykata shqiptare, sepse veprën e kishte kryer edhe në territorin shqiptar.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, Kolegji Penal u shpreh se aplikimi i parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (fakt kriminal), është i njëjtë në rastet e gjykimeve penale të zhvilluara në shtete të ndryshme të huaja me rastet e gjykimeve penale brenda vendit. "Në rastin eventual kur çështja penale jo vetëm ka filluar, por ka avancuar deri ne deklarimin fajtor dhe dënimin e të gjykuarit me 12 vjet burgim për të njëjtën vepër penale, për të njëjtin fakt kriminal, për të cilin më parë është gjykuar e dënuar nga një gjykatë e huaj, vendimet duhet të prishen dhe çështja penale duhet pushuar, për shkak se ndjekja penale ndaj tij nuk duhet të vazhdojë".[519]

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata e Lartë dhe në çështjen e G.H., duke vendosur, me të njëjtin arsyetim, pushimin e çështjes në ngarkim të tij.[520]

Në çështjen e E.B., kërkuesi pretendonte se kishte pasur shkelje të parimit *ne bis in idem* për shkak të vendosjes së masës së sigurimit, në mënyrë të përsëritur, për të njëjtat vepra penale. Gjykata e Lartë u shpreh se parimi *ne bis in idem* nuk ka të bëjë me masën e sigurimit personal të caktuar ndaj personave të dyshuar për kryerjen e veprës penale, por garanton individin që të mos i nënshtrohet gjykimit të themelit (dënimit të tij) dy herë për të njëjtën vepër, për të cilën ai është gjykuar një herë me vendim të formës së prerë.

Në çështjen e B.G., Gjykata e Lartë u shpreh se, në rigjykim, është detyrë e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda të vlerësojë vlerën juridike të vendimit penal të gjykatës së huaj si dhe të përcaktojë nëse jemi përpara të njëjtit fakt penal, me qëllim shmangien e dënimit të të gjykuarit dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*), sipas ndalimit të parashikuar në nenin 34 të Kushtetutës dhe nenit 7 të Kodit të Procedurës Penale.[521]

KONKLUZIONE

Të përballur me një periudhë diktature komuniste dhe me kujtime të freskëta të qeverie që akuzonte njerëzit për krime që ata nuk kishin kryer dhe që i dënonte përmes një gjykimi të njëanshëm e të padrejtë, Kushtetutbërësit shqiptarë ndërmorën hapa të rëndësishëm që të siguronin se qeveritë e krijuara pas rënies së regjimit totalitar nuk do të kryenin veprime të tilla. Për këtë qëllim, një rëndësi e madhe iu kushtua krijimit dhe

[519] Vendim nr.194, datë 22.04.2009 i Gjykatës së Lartë.
[520] Vendim nr.292, datë 20.09.2009 i Gjykatës së Lartë.
[521] Vendim nr.211, datë 11.07.2012 i Gjykatës së Lartë.

forcimit të shtetit të së drejtës, garantimit të procesit të rregullt ligjor, gjykimit të drejtë dhe mbrojtjes së të drejtave të të akuzuarve.

Një ndër qëllimet e ligjshme të çdo shteti është dënimi i atyre individëve që dhunojnë të drejtat e të tjerëve, përmes kryerjes së veprave që bien në kundërshtim me ligjet në fuqi. Ndërkohë që ruajtja dhe garantimi i të drejtave të çdokujt është i një rëndësie të veçantë në një shoqëri demokratike, po aq e rëndësishme është dhe marrja e të gjitha masave që i pafajshmi të mos dënohet, që shteti të mos përdorë pa të drejtë forcën e tij ndëshkuese dhe që njerëzit të jenë në gjendje të jetojnë të lirë jetën e tyre.

Legjislacioni procedural penal ka për qëllim ofrimin e të gjitha garancive procedurale të nevojshme, të cilat i japin, një personi të akuzuar për një vepër penale, mundësinë të mbrohet. Te drejtat themeltare, të pranuara nga shoqëria, duhet të ruhen të paprekshme e të pacenueshme, pavarësisht seriozitetit të veprës penale. Drejtësia, edhe pse për shkak të veprimeve të të akuzuarit, është gjithashtu për shkak të veprimeve të akuzuesit. Koncepti i drejtësisë nuk duhet të tërhiqet deri në atë masë sa të shndërrohet në një fije të hollë. Detyra e organeve gjyqësore është të garantojnë një balancë të tillë.

Të drejtat e të akuzuarit kanë një histori shumë të hershme. Ato janë përpunuar gjatë shekujve duke arritur në të drejtat që i akuzuari gëzon sot. Arrijmë të kuptojmë qartë rëndësinë e këtyre të drejtave kur ndodhemi vetë përpara situatave të tilla ku akuzohemi pa të drejtë.

Në ditët e sotme, këto të drejta konsiderohen të shenjta dhe të gjitha shtetet demokratike angazhohen për zbatimin e tyre. Mbrojtja e tyre garantohet jo vetëm përmes instrumenteve kombëtare, Kushtetutë e ligje, por dhe atyre ndërkombëtare, të ratifikuara nga shtetet e, për rrjedhojë, pjesë e legjislacioneve të tyre të brendshëm.

Shumica e akteve që mbrojnë të drejtat e të akuzuarve janë formuluar në gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme për individët në përgjithësi, megjithatë, në rastet kur ata nuk arrijnë të kuptojnë të drejtat e tyre, shtetet kanë marrë masa për të siguruar që informacioni që u jepet individëve të cilët vihen para drejtësisë, të jetë i plotë, i qartë e i kuptueshëm, duke u ndihmuar dhe nga avokatë mbrojtës të zgjedhur vetë ose të caktuar kryesisht.

Dhënia e të drejtave individëve të akuzuar është shumë e rëndësishme për sistemet ligjore që bazojnë drejtësinë penale në prezumimin e pafajësisë, duke vendosur në shkallë të lartë të drejtat e shtetasve e duke kaluar barrën e provës organeve të ndjekjes penale. Përmes dhënies së të dyshuarve e të akuzuarve të një sërë mbrojtjesh ligjore, shteti përpiqet të garantojë që të drejtat e atyre ndaj të cilëve nuk është provuar fajësia, të mos cenohen.

Në mënyrë që në procesin penal procedurat gjyqësore të konsiderohen të drejta nga të dy palët, të drejtat e të akuzuarit përfshijnë garancinë për asistencë/ndihmë ligjore

si dhe zhvillimin e një gjykimi në respektim të parimeve kushtetuese dhe ligjeve në fuqi. Duke qenë se sistemet ligjore janë të ndërlikuar, aksesi i të akuzuarit në ndihmë ligjore profesionale, konsiderohet shumë i rëndësishëm. Për këtë qëllim, parimet kombëtare e ndërkombëtare njohin dhe garantojnë të drejtën për mbrojtje dhe për personat në pamundësi financiare për të siguruar atë.

Një rëndësi të madhe në mbrojtjen e garantimin e të drejtave të të akuzuarve kanë dhënë jo vetëm aktet kombëtare dhe ndërkombëtare, por dhe gjykatat, të cilat, përmes vendimmarrjes së tyre kanë vendosur kufizime ndaj ushtrimit të pushtetit të shtetit, kanë njohur të drejtat materiale dhe procedurale të personave të akuzuar, si dhe kanë shërbyer si udhërrëfyese për veprimtarinë e organeve shtetërore.

Sigurisht, sistemi i drejtësisë penale është në ndryshim të vazhdueshëm. Disa veprime përjashtohen nga ndjekja penale, të tjerë futen në tërësinë e veprave të dënueshme. Që sistemi i drejtësisë penale të funksionojë siç duhet, ajo çka është e rëndësishme të mbahet parasysh në çdo rast është respektimi i të drejtave të të akuzuarve.

BIBLIOGRAFIA

Libra

Bianku L, *Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut*, Qendra Europiane (2005)
Boas G, Bischoff J, Reid N., Tayler B, *International Criminal Procedure*, Cambridge University Press, (2011)
Bockel B, *The ne bis in idem principle in EU law, A conceptual and jurisprudential analysis*, Ipskamp Drukkers, Amsterdam (2005)
Caenigem RC Van, *The birth of the English Common Law*, 2nd edition, Cambridge, (1988)
Elezi I, Elezi E, *Historia e të Drejtës Penale*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar (2010)
Gjoleka A, Gjoleka E, *Avokati në procesin penal*, ALBJURIS
Imeraj E, *Provat në procesin penal*, MIRGEERALB (2010)
Islami H, *Demokratizimi i legjislacionit penal*, Shtëpia Botuese "Luarasi" (2000)
Mawbray A, *Cases and Materials on the European Convention on Human Rights*, Oxford University Press, 2-nd edition, (2007)
McBride J, *Human rights and criminal procedure, The case law of the European Court of Human Rights*, Council of Europe Publishing (2009)
Ovey C, White R, *European Convention Human Rights*, Oxford University Press 3rd Edition, (2006)
Palmer A, *Principles of Evidence*, Cavendish Pub. Australia, (1998)
Pollock F and Maitland FW, *The history of English Law Before the Time of Edward I*, revised by S.F.C.Milsom, London, (1968)
Reid K, *A Practitioner's Guide to the European Convention on Human Rights*, Sweet & Maxwell, (2012)
Sassoon J, *Ancient Laws and Modern Problems: The Balance Between Justice and a Legal System*, Third Millenium Publication, (2011)
Spenser J, *European Criminal Procedure. Early history and ordeals*, Cambridge University Press (2002)
Stavros S, *The Guarantees for Accused Persons Under Article 6 of the European Convention on Human Rights: An Analysis of the Application of the Convention and a Comparison with Other Instruments*, Martinus Nijhoff Publishers, (1993)
Stephen JF, *A history of criminal law of England*, London: Macmillan (1883)
Trechsel S, *Human Rights in Criminal Proceedings*, Oxford University Press, (2005)
Vitkauskas D, Dikov G, *Protecting the right to a fair trial under the European Convention on Human Rights*, Council of Europe, (2012)
Vorpsi A, *Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë*, Maluka (2011)

Revista Juridike

A. Ashworth, *Four Threats to the Presumption of Innocence,* International Journal of Evidence and Proof 10 (2006)
Charles Nesson, *The Evidence or the Event? On Judicial Proof and the Acceptability of Verdicts.* 98 Harvard Law Review, Volume 98, Nr.7, 1357 (1985)
Charles P. Curtis, *The Ethics of Advocacy*, 4 Stanford Law Review 3, (1951)
Charles Wolfram, *Client Perjury,* 50 *S.* California Law Review, (1977)
David R. Dow, *The State, The Death Penalty, and Carl Johnson*, 37 Boston College Law Review, (1996)
David S. Rudstein, A *brief history of the fifth amendment guarantee against double jeopardy*, William & Mary Bill of Rights Journal, (2005), Volume 14, Issue I;
Dean s. Daskal, *Assertion of the Constitutional Privilege Against Self-Incrimination in Federal Civil Litigation: Rights and Remedies,* Marquette Law Review, Volume 64, Issue 2, Winter, (1980);
François Quintard-Morénas, *The Presumption of Innocence in the French and Anglo-American Legal Traditions*, The American Journal of Comparative Law, 58.1 (2010)
Gabriel Hallevy, *The Defense Attorney as mediator in plea bargains,* Yale Law Journal, Vol. 9, 2009.
Gary Goodpaster, *The adversary system, advocacy, and effective assistance of counsel in criminal cases,* New York University Law Journal, Review of Law and Social Change
I Dennis, *Codification and Reform of Evidence Law in Australia*. Criminal Law Review, (1996)
Jenny Roberts, *Effective Plea Bargaining Counsel*, The Yale Law Journal, Vol 122, No.100 (2013)
Jim McElhaney, *The Burden of Reasonable Doubt When a Standard Designed to Protect Defendants Actually Hurts them,* ABA Journal, October 2011 Issue
John A.E.Vervaele, *The transnational ne bis in idem principle in the EU, Mutual recognition and equivalent protecyio of human rights*, Utrecht Law Review (2005)
John H. Langbein, *The Historical Origins of the Privilege Against Self-incrimination at Common Law*, Michigan Law Review, Vol 92, 1993-1994
Joseph P. Stulberg, *Fairness and Mediation,* 13 Ohio State Journal on Dispute Resolution (1998).
Larry Laudan, *The Presumption of Innocence: Material or Probatory*, Legal Theory Cambridge Journals, Volume 11, Issue 4, (2005)
Lauren Sudeall Lucas, *Effectively Ineffective: The Failure of Courts to Address Underfunded Indigent Defense Systems,* 118 Harvard Law Review 1731 (2005).
Lonneke Stevens, *Pre-Trial Detention: The Presumption of Innocence and Article 5 of the European Convention on Human Rights Cannot and Does Not Limit its Increasing Use*, European Journal of Crime, Criminal Law and Criminal Justice 17 (2009)
Maria Jane Chiepalich Wells, *The Lawyer's Responsibility When a Defendant Intends To Commit Perjury*, Journal of Legal Profession, Vol.3, (1978-1979)
Mari-Ann Roos, *Analysis of The Criminal Justice System of Albania,* Report by the fair trial development project, OSCE 2006

Mirjan R. Damaska, *Evidentiary Barriers to Conviction and Two Models of Criminal Procedure: A Comparative Study*,University of Pennsylvania Law Review, 506 (1973)
Monroe Freedman, *Professional Responsibility of the Criminal Defense Lawyer: The Three Hardest Questions*, 64 Michigan Law Review (1966)
Paul Mahoney, *Right to a fair trial in criminal matters under article 6 E.C.H.R.*, Judicial Studies Institute Journal
Richard Klein & Robert Spangenberg, *The indigent defense crisis*, American Bar Association, 26 n.16 (1993).
Robert E. Scott & William J. Stuntz, *Plea Bargaining as Contract*, 101 Yale Law Journal (1992)
Roberta K Flowers, *The Role of the Defense Attorney: Not Just an Advocate*, Ohio State Journal of Criminal Law, Vol.7, (2010).
Shima Baradaran, *Restoring the Presumption of Innocence*, Ohio State Law Journal, 2011, Vol. 72, No. 4
Warren E. Burger, *The Special Skills of Advocacy: Are Specialized Training and Certification of Advocates Essential to Our System of Justice?*, 42 Fordham Law Review 227 (1973).

Jurisprudenca Amerikane

Argersinger v. Hamlin, 407 U.S. 25, 38 (1972)
Arizona v. Washington, 434 US 497 (1978)
Ball v. United States, 163 US 662 (1896)
Bell v. Wolfish, 441 U.S. 520 (1979)
Benton v. Maryland, 395 U.S. 784 (1969)
Benton v. Maryland, 395 U.S. 784 (1969)
Berger v United States, 295 U.S. 78, (1935)
Blockburger v. United States, 284 US 299 (1932)
Blueford v. Arkansas, 132 S. Ct. 2044 (2012)
Bram v. United States, 168 U.S. 532 (1897)
Brock v. North Carolina, 344 U.S. 424 (1953)
Brown v. Ohio, 432 U.S. 161 (1977)
Burdine v. Johnson, 262 F.3d 336 (5th Cir. 2001)
Burdine v. State, 719 S.W.2d 309 (Tex.Crim.App. 1986)
California v. Byers, 402 U.S. 424 (1971)
Coffin v. *United States*, 156 U.S. 432 (1895)
Commonwealth v Alderman, 437 A.2d 36 (Pa. Super. Ct. 1981)
Councilman v United States, 420 U.S. 738
Deputy v. State, 500 A.2d 581, 596 (Del. 1985), *cert. denied*, 480 U.S. 940 (1987)
Diaz v. United States, 223 US 442, 448-49 (1912)
Doe v. United States, 487 U.S. 201 (1988)
Douglas v. California, 372 U.S. 353 (1963)

Dreyer v. Illinois, 187 U.S. 71 (1902)
Escobedo v. Illinois, 378 U.S. 478 (1964)
Estelle v. Williams, 425 U.S. 501 (1976)
Geders v. United States, 425 U.S. 80 (1976)
Gideon v. Wainwright, 372 U.S. 335 (1963)
Gideon v. Wainwright, 372 U.S. 335 (1963)
Gideon v. Wainwright, 372 U.S. 335, 342 (1964)
Gideon v. Wainwright, 372 U.S. 335, 342 (1964)
Glasser v. United States, 315 U.S. 60 (1942), 70
Grady v. Corbin, 495 US 508 (1990)
Hamdan v. Rumsfeld, 548 U.S. 557 (2006)
Herring v. New York, 422 U.S. 853 (1975); *cf. United States v. Decoster*,624 F.2d 196, 201 (D.C. Cir. 1976)
Holloway v. Arkansas, 435 U.S. 475 (1978)
Illinois v. Somerville, 410 US 458 (1973)
Kepner v. United States, 195 U.S. 100 (1904)
Knighton v. Maggio, 740 F.2d 1344 (5th Cir. 1984), *cerl. denied, 105* S. Ct. 32 (1984)
Lafter v. Cooper, 132 S.Ct. 1376 (2012)
Lefkowitz v. Turley, 414 U.S. 70 (1973)
Louisiana v. Peart , 621 So.2d 780 (La. 1993)
Mapp v. Ohio, 367 U.S. 643 (1961)
McFarland v. State, 928 S.W.2d 482 (Tex. Cr. App. 1996)
McMann v. Richardson, 397 U.S. 759 (1970)
McMann v. Richardson, 397 U.S. 759 (1970)
McNeil v. Wisconsin, 501 U. S. 171, 175 (1991)
Michigan v. Jackson, 475 U. S. 625, (1986)
Miranda v. Arizona, 384 U.S. 436 (1966)
Missuri v. Frye, 132 S. Ct. 1399 (2012)
Moran v. Burbine, 475 U. S. 412, 430 (1986)
Nix v. Whiteside, 475 U.S. 157 (1986)
Padilla v. Kentucky, 130 S. Ct. 1473 (2010)
Palko v. Connecticut , 302 U.S. 319 (1937)
Pennsylvania v. Muniz, 496 U.S. 582 (1990)
People v Blye, 233 Cal. App. 2d 143, 43 Cal. Rptr. 231 (1965)
Powell v. Alabama 287 U.S. 45 (1932)
Powell v. Alabama, 287 U.S. 45 (1932), 71-72
Rothgery v. Gillespie County, 554 U.S. 191 (2008)
Rothgery v. Gillespie, 554 U.S. 191 (2008)
Schmerber v. California, 384 U.S. 757 (1966)
Shapiro v. United States, 335 U.S. 1 (1948)
State ex rel. Met-ropolitan Public Defender Services, Inc. v. Courtney, 64 P.3d 1138 (Or. 2003)
State v. Brock, 67 S.E.2d 282 (N.C. 1951)
State v. Craig dhe *State v. Harris* , 637 So. 2d 437 (La. 1994)

State v. Green, 275 So. 2d 184, 186 (La., 1973)
State v. Henderson, 205 Kan. 231, 468 P.2d 136 (1970)
State v. Lynch, 796 P.2d 1150, 1153 (Okla. 1990)
State v. Quitman County, 807 So. 2d 401 (Miss. 2001)
State v. Smith, 681 P.2d 1374, 1382 (Ariz. 1984)
Strickland v. Washington, 466 U.S. 668 (1984)
Strickland v. Washington, 466 U.S. 668 (1984)
United States v .Scott, 437 US 82 (1978)
United States v. Cronic, 466 U.S. 648 (1984)
United States v. Dixon, 509 US 688 (1993)
United States v. Martin Linen Supply Co, 430 US 564, 571 (1977)
Washington v. Strickland, 693 F.2d 1243, 1255 (5th Cir. 1982)
Whiteside v. Scurr, 744 F.2d. 1323 (8th Cir. 1984)

Jurisprudenca Europiane

Adolf v. Austria, (Application no. 8269/78);
Artico v. Italy (Application no. 6694/74)
B. v. Austria, (Application no. 11968/86)
Balliu v. Albania, (Application no. 74727/01)
Barberà, Messegué and Jabardo v. Spain, (Application no. 10588/83, 10589/83, 10590/83)
Bendenoun v. France, (Application no. 12547/86)
Benham v. The United Kingdom, (Application no. 19380/92)
Benham v. United Kingdom, (Application no. 19380/92)
Bönisch v. Austria, (Application no. 8658/79)
Brumarescu v Romania, (Application no. 28342/95)
Buchholz v. Germany, (Application no. 7759/77)
Campbell and Fell v. UK, (Application no. 7819/77; 7878/77)
Campbell and Fell v. United Kingdom (Application nos 7819/77 7878/77),
Capeau v. Belgium, (Application no. 42914/98)
Chatellier v. France, (Application no. 34658/07)
Chevrol v France, (Application no. 49636/99)
Clooth v. Belgium, Application no. 12718/87)
Coëme and others v. Belgium, (Applications nos. 32492/96, 32547/96, 32548/96, 33209/96 and 33210/96)
Croissant v. Germany, (Application no. 13611/88)
Dattel (No. 2) v. Luxembourg, (Application no. 18522/06)
De Cubber v.Belgium, (Application no. 9186/80)
Delcourt v. Belgium, (Application no. 2689/65
Didier v. France, (Application no. 58188/00)
Doorson v. The Netherlands, (Application no. 20524/92)
Ebanks v. the United Kingdom, (Application no. 36822/06)

Eckle v. Germany (Application no. 8130/78)
Eckle v. Germany, (Application no. 8130/78)
Ekbatani v. Sweden, (Application no. 10563/83)
Engels and others v. The Netherlands, (Application no. 5100/71; 5101/71; 5102/71; 5354/72; 5370/72)
Escoubet v. Belgium , (Application no. 26780/95)
Fatullayev v Azerbaijan, (Application no. 40984/07)
Fayed v United Kingdom, (Application no. 17101/90)
Fedotova v. Russia, (Application no. 73225/01)
Filippini v. San Marino, (Application no. 10526/02).
Fitt v. The United Kingdom, (Application no. 29777/96)
Foti and othersv. Italy, (Application no. 7604/76; 7719/76; 7781/77; 7913/77)
Franz Fischer v. Austria, (Application no. 37950/97)
Funke v. France, (Application no. 10828/84)
G.K v. Poland, (Application no. 38816/97)
Gheorghe v. Romania, (Application no. 19215/04)
Goddi v. Italy (Application no. 8966/80)
Golder v. The United Kingdom, (Application no. 4451/70)
Gradinger v. Austria, (Application no.15963/90)
Gregory v. United Kingdom, (Application no. 22299/93)
Guvec v. Turkey, (Application no. 70337/01)
H. v. Belgium, (Application no. 8950/80)
Hadjianastassiou v. Greece, (Application no. 12945/87)
Häkkä v Finland (Application no. 758/11)
Hauschildt v. Denmark, (Application no. 10486/83)
Hornsby v. Greece, (Application no. 18357/91)
Jabloński v. Poland, (Application no. 33492/96)
John Murray v. UK, (Application no. 18731/91)
Jorgic v. Germany, (Application no. 74613/01)
Jussila v. Finland, (Application no. 73053/01)
Karakas and Yesilımak v. Turkey, (Application no. 43925/98)
Kauczor v. Poland, (Application no. 45219/06)
Khan v. United Kingdom, (Application no. 35394/97)
Khuzhin and others v. Russia, (Application no.13470/02)
Kolomiyets v. Russia, (Application no. 76835/01)
Kreuz v. Poland, (Application no. 28249/95)
Labita v. Italy, (Application no. 26772/95)
Latasiewicz v. Poland, (Application no. 44722/98)
Letellier v. France, (Application no. 12369/86)
Lutz v. Germany, (Application no. 9912/82)
Mađer v. Croatia (Application no. 56185/07)
Martins Moreira v. Portugal, (Application (no. 11371/85)
Mellors v UK, (Application no. 57836/00)
Meznaric v Croatia, (Application no. 71615/01)

Milasi v. Italy, (Application no. 10527/83)
Minelli v. Switzerland, (Application no. 8660/79)
Monnell and Morris v. United Kingdom, (Application no. 9562/81; 9818/82)
Neumeister v. Austria, (Application no. 1936/63)
Oliveira v. Switzerland , (Application no. 25711/94)
Olujić v. Croatia, (Application no. 22330/05)
Özturk v. Germany, (Application no. 8544/79);
Pandjikidze and others v. Georgia, (Application no. 30323/02)
Panovits v. Cyprus, (Application no. 4268/04)
Panteleyenko v. Ukraine, (Application no. 11901/02)
Papon v. France, (Application no. 54210/00)
Piersack v. Belgium, (Application no. 8692/79)
Piersack v. Belgium, (Application no. 8692/79)
Piersack v. Belgium,(Application no. 8692/79)
Pullar v. United Kingdom, (Application no. 22399/93)
Quaranta v. Switzerland, (Application no. 12744/87)
Ramishvili and Kokhreidze v. Georgia, (Application no. 1704/06)
Remli v. France (Application no. 16839/90)
Rowe and Davis v. The United Kingdom, (Application no. 28901/95)
RT v Switzerland, (Application no. 31982/96)
Ruotsalainen v. Finalnd, (Application no. 13079/03)
Saunders v. UK, (Application no. 19187/91)
Sergey Zolotukhin v. Russia, (Application no 14939/03)
Sergey Zolotukhin v. Russia, (Application no 14939/03)
Simonavicius v Lithuania, (Application no. 37415/02)
Shabanov and Tren v. Russia, (Application no. 5433/02)
Smirnova v. Russia (Application nos. 46133/99 and 48183/99)
Smirnova v. Russia, (Applications no. 46133/99 and 48183/99)
Sobolewski v. Poland (No. 2), (Application no. 19847/07)
Soering v. U.K, (Application no. 14038/88)
Staroszczyk v. Poland, (Application no. 59519/00)
Tedesco v France, (Application no. 11950/02)
Teixeira de Castro v. Portugal, (Application no. 25829/94)
Tsonyo Tsonev v. Bulgaria (No. 2), (Application no. 21124/04)
Vaivada v. Lithuania, (Applications no. 66004/01 and 36996/02)
Vanyan v. Russia, (Application no. 53203/99)
Windisch v. Austria , (Application no. 12489/86)
X v. Austria,(Application no. 2676/65)
Xheraj v. Albania, (Application no. 37959/02)
Zaichenko v. Russia, (Application no. 33720/05)
Zigarella v. Italy, (Application no. 48154/99)

Jurisprudenca Shqiptare

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese Shqiptare,

Vendim nr. 95, datë 27.07.2001 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 4, datë 07.02.2001 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 222, datë 04.11.2002 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 5, datë 17.02.2003 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 33, datë 24.11.2003 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 9, datë 28.04.2004 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 15, datë 10.11.2004 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 05, datë 08.03.2005 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 7, datë 27.04.2005 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 16, datë 08.06.2006 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendimi nr. 19, datë 03.05.2007 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 7 datë 11.03.2008 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendimi nr. 11, datë 02.04.2008 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendimi nr. 12, datë 20.05.2008 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 5 datë 06.03.2009 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 10, datë 02.04.2009 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 14 datë 3.6.2009 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 17, datë 19.06.2009 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 18, datë 08.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 23, datë 23.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendimi nr. 11, datë 06.04.2010 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 23, datë 17.05.2010 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 54, datë 16.07.2010 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 8, datë 16.03.2011 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 22, datë 11.03.2011 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 25, datë 10.06.2011 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 33, datë 22.07.2011 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 37, datë 19.09.2011 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 47, datë 07.11.2011 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 50, datë 01.11.2011 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 4, datë 10.02.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 16, datë 26.03.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 19, datë 02.204.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 21, datë 16.04.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 37, datë 24.12.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 44, datë 11.04.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 50, datë 01.11.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 54, datë 03.05.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH
Vendim nr. 57, datë 21.12.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH

Vendim nr. 58, datë 24.12.2012 i Gjykatës Kushtetuese të RSH

Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë të RSH

Vendim Unifikues nr.2, datë 29.01.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
Vendimi Unifikues nr.03, datë 27.09.2002 i Gjykatës së Lartë.
Vendim nr.194, datë 22.04.2009 i Gjykatës së Lartë.
Vendim nr.292, datë 20.09.2009 i Gjykatës së Lartë.
Vendim nr.211, datë 11.07.2012 i Gjykatës së Lartë.

Akte Ndërkombëtare

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,
Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian
Karta Europiane e Parimeve Themelore të e Profesionit të Avokatit
Kodi i Veprimit për Avokatët Europianë
Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut
Konventa Europiane mbi Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale
Konventa Europiane për Ekstadim dhe Dy Protokollet Shtesë
Konventa Europiane për të Drejtat e Njerut
Konventa Europiane për Transferimin e Procedimeve në Çështje Penale
Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike,
Konventa për Implementimin e Marrëveshjes Shengen
Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës
Rregulla të Veprimtarisë Profesionale të Avokatit, American Bar Association.

Legjislacion shqiptar

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë
Ligj nr. 7541, date 18.12.1991 "Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë".
Ligj nr. 9109, datë 17.07.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë"
Ligj nr. 10039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike".

Websites

< http://www.wcl.american.edu/journal/lawrev/15/mueller.pdf>
<http://law.case.edu/journals/JIL/Documents/%2816%29Mikhail%20Wladimiroff.pdf>
<http://www.roberthjackson.org/the-man/speeches-articles/speeches/speeches-by-robert-h-jackson/the-federal-prosecutor/>

<http://havilahlegal.com.au/index.php/weblog/entry/lawyers_duty_as_an_officer_of_the_court_unmasked/>
http://www.criminalcle.net.au/attachments/Right_To_Silence_paper.pdf
<http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2071312>
http://law.bepress.com/cgi/viewcontent.cgi?article=6282&context=expresso&sei-redir=1&referer=http%3A%2F%2Fwww.google.com%2Furl%3Fsa%3Dt%26rct%3Dj%26q%3Dnon%2522bis%2520in%2520idem%2520and%2520the%2520rome%2520statute%2520of%2520the%2520internatioint%2520criminal%2520court%26source%3Dweb%26cd%3D2%26ved%3D0CC8QFjAB%26url%3Dhttp%253A%252F%252Flaw.bepress.com%252Fcgi%252Fviewcontent.cgi%253Farticle%253D6282%2526coconte%253Dexpresso%26ei%3D42j_UfenKM7_PM-xgPgN%26usg%3DAFQjCNHE62b0JCNbuVwBPIYK04bhET6gag#search=%22non%20bis%20idem%20rome%20statute%20international%20criminal%20court%22
< http://law.bepress.com/cgi/viewcontent.cgi?article=6282&context=expresso&sei-redir=1&referer=http%3A%2F%2Fwww.google.com%2Furl%3Fsa%3Dt%26rct%3Dj%26q%3Dbis%2520in%2520idem%26source%3Dweb%26cd%3D13%26ved%3D0CDIQFjACOAo%26url%3Dhttp%253A%252F%252Flaw.bepress.com%252Fcgi%252Fviewcontent.cgi%253Farticle%253D6282%2526context%253Dexpresso%26ei%3DV5b3UeXkBeiC4ASYu4CIBw%26usg%3DAFQjCNHE62b0JCNbuVwBPIYK04bhET6gag#search=%22bis%20idem%22>
<http://www.abajournal.com/magazine/article/the_burden_of_reasonable_doubt_when_a_standard_designed_to_protect_defendan>
http://www.ejtn.eu/Documents/Themis/Written%20paper%20Italie/Themis%20written%20paper%20RomaRom%202.pdf

Fjalorë

Ballentine's Law 3rd Edition
Black's Law Dictionary 7th Edition
Bloomsbury Reference Dictionary of Law 4th Edition
Fjalor i Shqipes së Sotme
Oxford Dictionary of Law 5th Edition
Oxford Dictionaries Online
The Essential Law Dictionary 1st Edition

Qëllimi i çdo shteti është jo vetëm parandalimi i krimeve, por njëkohësisht shmangia e dënimit të personave të pafajshëm, duke rritur në këtë mënyrë ndjenjën e sigurisë në shoqëri, që është një nga funksionet kryesore të procedurave penale. Ligjet procedurale penale përcaktojnë mënyrat se si duhen administruar ligjet penale substanciale. Pa procedurat përkatëse ligjet substanciale nuk do të kishin vlerat dhe rëndësinë e duhur. Rregullat e procedurës penale kanë për qëllim gjetjen e së vërtetës, kusht ky i rëndësishëm në dhënien e drejtësisë. Zbulimi i së vërtetës për krimet e dyshuara nuk mund të jetë funksion ekskluziv i drejtësisë penale. Shteti duhet të shmangë përdorimin e metodave ose mjeteve që cenojnë të drejtat e individëve, pavarësisht se ato mund të jenë efektive në zbulimin e të vërtetës dhe kapjen e autorit të veprës. Ruajtja e të drejtave dhe lirive të individit nga abuzimet e mundshme të pushtetit nga ana e ushtruesve të ndjekjes penale, si dhe ruajtja e drejtësisë, janë qëllimet bazë të një shoqërie demokratike. Me qëllim që të japin drejtësi, shteti dhe institucionet shtetërore duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të individit, që nënkupton, ndër të tjera, dhe respektin ndaj të drejtave të të akuzuarit. Një rol të rëndësishëm në garantimin e të drejtave të të akuzuarit luan dhe mbrojtësi i tij.

Fjalë kyçe: i akuzuar, të drejta, ligj, penal, mbrojtës

The goal of each state is not only to prevent crime, but also to avoid conviction and punishment of the innocent, thereby increasing the sense of security in society, which is the main scope of criminal proceedings. Criminal procedural laws determine how substantive criminal laws should be administered. Without proper procedures, substantive laws would have neither value nor importance. Criminal procedure rules aim at finding the truth, this being the most important aspect of criminal justice. But discovering the truth about alleged crimes cannot be the exclusive role of criminal justice. The state should avoid the use of methods or means which violate individuals' rights and freedoms, even if such methods or means would help in discovering the truth. Safeguarding the rights and freedoms of individuals against abuses of power as well as protection of justice and legal order, constitute the core elements of the functioning of a democratic society. In order to provide criminal justice, the state must respect the rights and freedoms of the accused. An important role in the protection of the rights of the accused in criminal matters is played by the defense lawyer.

Keywords: accused, criminal, law, lawyer, procedure